



INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT
INSTITUCIJA OMBUDSMANA
OMBUDSPERSON INSTITUTION

RAPORTI VJETOR 2024 NR. 24



Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit · Institucija Ombudsmana · Ombudsperson Institution



RAPORTI VJETOR

2024

NR. 24

Prishtinë, 2025

Përmbajtja

Fjala e Avokatit të Popullit	11
Mandati i Avokatit të Popullit	13
Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.....	13
Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut.....	13
Roli i Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut.....	14
Roli i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës.....	14
Roli i Avokatit të Popullit si mekanizëm i barazisë.....	14
Ndryshimi i praktikave të raportimit të Avokatit të Popullit në Kuvendin e Kosovës.....	14
Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve	18
Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit	28
Mbrojtja e të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit	34
Të drejtat themelore	35
Dinjiteti i Njeriut.....	35
E Drejta për Jetën.....	36
E Drejta e Integritetit Personal.....	38
Liria e Lëvizjes.....	39
Mbrojtja e Pronës.....	40
E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë.....	43
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm.....	43
E Drejta për Mjete Juridike.....	46
E Drejta e Privatësisë.....	47
E Drejta e Martesës dhe Familjes.....	49
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë.....	51
Liria e Shprehjes.....	52
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike.....	55
Liria e Medieve.....	56
Liria e Tubimit.....	59
Liria e Asociimit.....	59
Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	61
Avokati i Popullit si organ i barazisë dhe i mbrojtjes nga diskriminimi.....	62
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.....	63
Barazia Gjinore.....	71

Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre.....	81
Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.....	87
Të Drejtat e Fëmijës.....	90
E Drejta për Arsimin	99
Liria e Artit dhe e Shkencës	101
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit.....	102
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	105
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor.....	109
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës	114
Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës	128
Të drejtat e personave në kuptim të “Drejtësisë Tranzicionale”	130
Shërbimet digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut.....	134
Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese.....	136
Mbikëqyrja e legjislacionit në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me standardet ndërkombëtare.....	137
Kërkesat dhe komentet e Avokatit të Popullit dërguara në Gjykatën Kushtetuese.....	138
Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.....	139
Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti	141
Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Statutit (QRK) nr. 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.....	143
Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12, të Ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore.....	145
Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 331 (paragrafët 2, 4, 5, 6 dhe 7) të Kodit nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave.....	148
Komentet e Avokatit të Popullit lidhur me nenin 55 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e Kërkesës KO 96/24, të datës 3 maj 2024.....	149
Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 153/24 dhe KO 156/24, të datës 26 korrik 2024.....	150
Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 152/24 dhe KO 158/24, të datës 29 korrik 2024.....	151
Raportet e hartuara përgjatë vitit 2024 që ndërlidhen me të drejta kushtetuese	154
Dinjiteti i Njeriut dhe Barazia para Ligjit	155
» Zbatimi e masave të veçanta të parapara me nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore, nga organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, në të gjitha nivelet, si dhe nga institucionet e tjera publike në Kosovë.....	155
» Respektimi i të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit	

të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat për realizimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj.....	157
» Diskriminim mbi baza gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës.....	164
» Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për ndërrimin, mirëmbajtjen apo vendosjen e protezave vetëm për personat që kanë status të invalidit të luftës së UÇK-së duke i përjashtuar invalidët civilë të luftës konsiderohet diskriminues.....	166
» Opinion në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	167
» Opinion në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.....	168
E Drejta për Jetën	170
» Vlerësimi i trajtimit dhe i respektimit të të drejtave të pacientit në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë.....	170
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm.....	171
» Raportet që i referohen zvarritjes së procedurave gjyqësore në të gjitha nivelet e gjykatave.....	171
» Mosndërmarrja e veprime nga Inspektorati Policor i Kosovës për përfundimin e procedurës hetimore ndaj parashtruesit të ankesës.....	172
E Drejta për Mjete Juridike	174
» Opinion lidhur me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet, rregullat e përgjithshme, kushtet e pranueshmërisë si dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.....	174
Liria e Shprehjes	175
» Gjuha në diskursin publik në raport me detyrimet që ka shteti për garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes	175
Liria e Asociimit.....	181
» Opinion në lidhje me pretendimet për cenim të lirisë së asociimit dhe ushtrimit të aktivitetit sindikal si dhe diskriminim për shkak të angazhimit sindikal.....	181
Mbrojta e Pronës.....	182
» Opinion për procesin e shpronësimit në komunitetet Leosaviq dhe Zubin Potok të Republikës së Kosovës.....	182
E Drejta për Arsimin	184
» Ofrimi i sigurtisë në mbarëvajtjen e mësimin në shkollën fillore të mesme të ulët në fshatin Livoç	184
» Përfshirja e standardeve të zbatueshme të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë.....	184
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit.....	187
» Opinion në lidhje me largimin nga puna të disa zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.....	187
Të Drejtat e Fëmijës.....	187
» Trajtim jo i barabartë i fëmijës me aftësi të kufizuar në të drejtën për arsim parashkollor.....	187

» Mohimi i së drejtës për arsimim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë.....	189
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale.....	190
» Mbledhja dhe raportimi i të dhënave shëndetësore në Republikën e Kosovës.....	190
» Raport lidhur me ndryshimin e Rregullores nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.....	194
» Detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën e Kosovës.....	197
» Zgjerimi i listës së barnave esenciale duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda.....	201
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor.....	201
» Gjendja e lumit dhe e hapësirave përreth tij në lagjen “Kalabria” në Prishtinë.....	201
» Cenimi i së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si pasojë e derdhjes së ujërave të zeza në kanalën e ujërave atmosferike, në fshatin Dujakë të komunës së Gjakovës.....	203
» Opinion në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut përkritazi me rastin e ndërtimit të fabrikës së çimentos në Dollc, komuna e Klinës.....	204
Raportet e vizitave të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim.....	206
» Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën Korrektuese në Dubravë.....	206
» Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në pikën e kalimit kufitar Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.....	207
» Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll.....	208
» Raport për vizitat e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në stacionet policore.....	209
» Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.....	210
Mendimet e Avokatit të Popullit të shprehura në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae).....	211
» Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+.....	211
» Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) ofruar Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, lidhur me detyrimet e organeve shtetërore për respektimin e parimit të ligjshmërisë me rastin e anulimit të vendimeve.....	213
» Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) ofruar Gjykatës Themelore në Prishtinë.....	214
Promovimi i drejtave dhe i lirive themelore të njeriut nga IAP-ja gjatë vitit 2024.....	216
Roli i IAP-së në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë.....	217
» Bashkëpunimi me shoqërinë civile për promovimin e të drejtave të njeriut.....	218
» Bashkëpunimi me shoqërinë civile, me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet publike në vend.....	226
» Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, në kuadër të projekteve të ndryshme.....	227

» Forumi për Dialog me Shoqërinë Civile.....	228
Bashkëpunimi ndërkombëtar	229
» Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare.....	232
» Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.....	241
Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut.....	242
Komunikimi me publikun dhe mediat.....	243
Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2024-2025.....	245
Buxheti i IAP-së	247
Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës.....	247

Fjala e Avokatit të Popullit

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kam nderin që në përputhje me detyrimin kushtetues të paraqes para jush Raportin Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2024. Ky Raport pasqyron gjendjen e të drejtave të njeriut në vend, përpjekjet dhe angazhimin e Avokatit të Popullit për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Gjatë vitit 2024, qytetarët kanë adresuar 1410 ankesa, prej të cilave 110 janë adresuar nga qytetarë të nacionalitetit serb dhe 104 nga qytetarë të komuniteteve të tjera joshumicë. Nga hetimi i ankesave dhe hetimet sipas detyrës zyrtare, kemi adresuar gjithsej 176 rekomandime.

Ajo që konstatohet përgjithësisht nga analiza e rasteve të hetuara del se vazhdon të mbetet shqetësues fakti i pamundësisë që institucionet e drejtësisë të garantojnë gjykim të drejtë, për shkak të kohëzgjatjes dhe zvarritjeve të procedurave gjyqësore. Numri i madh i ankesave të qytetarëve, për shkak të mospërgjigjeve nga ana e autoriteteve publike, është tregues i mosfunksionimit të mekanizmave të përgjegjësisë për zbatim të ligjit, mungesës së efikasitetit dhe neglizhencës së administratës publike në shqyrtim të ankesave të qytetarëve, gjë që ndikon edhe në rritjen e numrit të rasteve në gjykata.

Kategoritë e ndjeshme janë përballur me sfida gjatë realizimit të të drejtave të tyre. Në disa situata, Avokati i Popullit ka konstatuar edhe mungesë të trajtimit me dinjitet të këtyre kategorive. Mungesa e mbulimit të trajtimit mjekësor për persona me status të invalidit të luftës; pengesat që hasin viktimat e dhunës seksuale gjatë realizimit të statusit të tyre, si në fazën e aplikimit, ashtu edhe gjatë marrjes së shërbimeve që u takojnë; detyrimi i personave tetraplegjikë dhe paraplegjikë që të paraqiten për rivlerësim në komisionet mjekësore janë disa nga shqetësimet që Avokati i Popullit i ka ngritur këtë vit.

Avokati i Popullit ka konstatuar vazhdimisht nevojën për dialog social, si parakusht për të arritur deri te nënshkrimi i kontratës së përgjithshme kolektive, funksionalizimin e Këshillit Ekonomiko-Social dhe të mekanizmave të tjerë që garantojnë respektimin e së drejtës në punë. Aksidentet në vendin e punës me pasoja për shëndetin vazhdojnë të jenë shqetësuese, sidomos rastet e shumta që përfundojnë me fatalitet. Një aspekt tjetër shqetësues është mospërputhja e të dhënave për rastet e raportuara të këtyre incidenteve si dhe mungesa e inspektimeve efektive dhe e zbatimit të masave mbrojtëse për punëtorët.

Hetimet gjithashtu kanë gjetur se sfida për qytetarët e vendit vazhdon të jetë realizimi i të drejtave sociale dhe shëndetësore, duke përfshirë mungesën e një sistemi funksional të sigurimeve shëndetësore dhe mungesën e furnizimeve me barna dhe me pajisje medicinale.

Barazia gjinore ende mbetet një synim i porealizuar plotësisht. Rastet e raportuara të dhunës në familje janë tregues të përmasave shqetësuese të kësaj dukurie negative në shoqërinë tonë. Viktimat shpesh përballen me mungesë të mbështetjes institucionale, sidomos në riintegrimin e tyre. Gratë ende përballen me diskriminim në tregun e punës, mundësi të kufizuara për avancim dhe përballje me barrierat për t'u punësuar në profesione të caktuara. Avokati i Popullit edhe këtë vit ka bërë thirrje për t'i vazhduar përpjekjet për të siguruar mundësi të barabarta për gratë në të gjitha fushat e jetës, për të garantuar mbrojtjen e grave nga dhuna dhe për të përmirësuar përfaqësimin gjinor në pozita vendimmarrëse.

Të drejtat e komuniteteve janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, megjithatë zbatimi i legjisllacionit që i garanton këto të drejta kërkon angazhim të shtuar, pasi vërehen mangësi në zbatim, sidomos për sa i përket përfshirjes në punësim, të drejtave gjuhësore dhe të drejtave në arsim. Përmirësimi i zbatimit të legjisllacionit ekzistues, fuqizimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të të drejtave të komuniteteve janë detyrime kushtetuese për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Avokati i Popullit u kushton rendësi të veçantë të drejtave të fëmijëve, të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë si kategori e mbrojtur me Kushtetutë. Është detyrim i autoriteteve publike të sigurojnë mjedis të sigurt për fëmijët, duke siguruar qasje në shërbime dhe mbështetje të veçantë për ta. Avokati i Popullit ka konstatuar mangësi të dukshme në zbatimin e detyrimeve që ka shteti për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve. Mosfunksionalizimi i organit të kujdestarisë dhe mungesa e masave efikase për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna vazhdojnë të jenë probleme që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe të koordinuar. Në anën tjetër, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me barrierat fizike dhe sociale, që pengojnë qasjen në shërbime edukative, shëndetësore dhe sociale.

Avokati i Popullit gjatë vitit për të cilin po raportohet, përmes rekomandimeve konkrete u ka bërë thirrje të vazhdueshme institucioneve për një angazhim të shtuar për zbatimin efektiv të ligjeve, garantim të mbrojtjes gjyqësore në kohë të arsyeshëm, përmirësim të transparencës dhe të llogaridhënies duke shmangur praktikën e mosdhënies së përgjigjeve, avancim të sistemit shëndetësor për të siguruar mbulim të plotë me sigurime shëndetësore dhe qasje të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët, dialog social duke mundësuar përmirësimin e të drejtave të punëtorëve, fuqizim të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të cenueshme, politika më të qarta për t'i mbështetur të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës.

Pavarësisht angazhimit të Avokatit të Popullit, edhe këtë vit raportues vërehet nivel jo i kënaqshëm i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve duke i rivendosur të drejtat që janë cenuar. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka një rol të rëndësishëm në garantimin e llogaridhënies së institucioneve shtetërore, prandaj është thelbësore që Kuvendi të ushtrojë një mbikëqyrje më të fortë mbi institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe t'i vendosë ato para përgjegjësisë për moszbatimin e këtyre rekomandimeve.

Më 23 maj 2024, Kuvendi votoi kundër miratimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2022. Votimi kundër, pa debat dhe pa ndonjë bazë të qëndrueshme, shkaktoi reagime nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Ky rast imponon nevojën e ndryshimit të mënyrës se si trajtohet Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit në Kuvend. Shqyrtimi i raportit duhet ta vërë theksin te gjetjet e raportit dhe te mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve, duke u mundësuar deputetëve ta ushtrojnë mandatin e tyre për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve dhe për të siguruar që institucionet shtetërore të veprojnë në përputhje me standardet më të larta demokratike. Ky ndryshim do të jetë një hap i rëndësishëm me qëllim të forcimit të institucioneve të pavarura dhe ruajtjes së pavarësisë së tyre prej çfarëdo ndërhyrjeje.

Fjalën time do ta përmbyll duke theksuar se mbrojtja e të drejtave të njeriut është një proces i vazhdueshëm që kërkon përkushtim dhe bashkëpunim të gjerë për të garantuar sundimin e ligjit dhe respektimin e standardeve demokratike të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit do të vazhdojë të qëndrojë i përkushtuar në përmbushjen e mandatit të tij kushtetues dhe ligjor, në shërbim të qytetarëve, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

Mandati i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i paraparë me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, bazuar në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, është institucion i pavarur në aspektin funksional, organizativ dhe buxhetor. Aspekti më i rëndësishëm i pavarësisë së Avokatit të Popullit është përcaktimi kushtetues që nuk pranon udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë organ apo institucion tjetër në Republikën e Kosovës. Kompetenca kryesore kushtetuese e Avokatit të Popullit është mbikëqyrja dhe mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Këtë mbikëqyrje dhe mbrojtje Avokati i Popullit fillimisht e ushtron duke kërkuar informacione nga çdo autoritet që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, informacione këto që autoritetet e kanë për detyrim t'i përgjigjen sipas përcaktimit në Kushtetutë.

Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, ushtron disa kompetenca/mandate, përkatësisht: (I) Mandatin e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; (II) Mandatin e Avokatit të Popullit si Organ i Barazisë; (III) Mandatin e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Përveç të tjerash, Avokati i Popullit është palë e autorizuar për referimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.¹

Kompetencë e rëndësishme e punës së Avokatit të Popullit është që në bazë të hetimeve të tij në rastet ku konstatohen shkeljet e të drejtave të njeriut, përpilohen raporte me gjetjet përkatëse dhe autoriteteve u drejtohen rekomandimet dhe propozohen masat konkrete.

Po ashtu, një aspekt tjetër i rëndësishëm së Avokatit të Popullit është fakti se për gjetjet

e tij në fushën e shkeljeve të të drejtave të njeriut paraqet Raport Vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mund të paraqesë edhe raporte të tjera të veçanta.

Është detyrë dhe përgjegjësi e autoriteteve publike respektimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si një matës i respektimit të sundimit të ligjit dhe i funksionimit të demokracisë në vendin tonë.

Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, nëpërmjet mekanizmit të hetimit të rasteve të paraqitura nga ankuesit, hetimit sipas detyrës zyrtare të shkeljeve të mundshme, kontestimit të një akti të administratës për mbrojtjen e interesit publik, dhënies së rekomandimeve të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, dhënies së opinionëve në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curie*), dhënies së rekomandimeve në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, udhëheqjes së procedurës së ndërmjetësimit dhe të pajtimit, dhënies së asistencës viktimeve të diskriminimit, dhënies së rekomandimeve për institucionet publike për zbatimin e detyrimeve në fushën e ndalimit të diskriminimit dhe të barazisë, referimit të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në mekanizma të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të monitorimit të rasteve gjyqësore, ku palët kanë statusin e viktimeve të pretenduar të shkeljes së të drejtave të njeriut, apo sipas detyrës zyrtare konsiderohet se mund të ketë shkelje sistematike të të drejtave të njeriut; nëpërmjet mekanizmit të detyrimit të autoriteteve

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 2.

publike për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit; monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit; mbikëqyrjes së standardit të hartimit të legjislacionit për sa u përket përcaktimeve të të drejtave të njeriut dhe përputhshmërisë me Kushtetutën; monitorimit të zbatimit të ligjeve që kanë për fokus të drejtat e njeriut dhe mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

Roli i Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ka një rol të rëndësishëm në promovimin e të drejtave të njeriut, rol të cilin e ushtron nëpërmjet mekanizmit të ngritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe të institucioneve publike për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore. Këtë e bën nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe ligjëratave, publikimit të opinioneve dhe të broshurave që paraqesin qëndrimin e Avokatit të Popullit për çështje të caktuara, deklaratave për zbatim të masave të caktuara, organizimit të ditëve të hapura për të drejtat e njeriut, organizimit të konferencave, tryezave tematike, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me partnerë socialë, shkëmbimit të vizitave me institucione homologe, paraqitjes në media të opinioneve të Avokatit të Popullit dhe të mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

Roli i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Avokati i Popullit ushtron mandatin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, nëpërmjet vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigrantëve dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut. Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit jep rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve dhe të akteve

të tjera me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare në parandalimin e torturës. MKP-ja bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë, vendorë dhe me mekanizmat e tjerë që përcaktohen me ligj të veçantë në fushën e parandalimit të torturës.

Roli i Avokatit të Popullit si mekanizëm i barazisë

Avokati i Popullit ushtron mandatin e tij si mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit. Një mandat të tillë, Avokati i Popullit e ushtron përmes mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, hetimit të rasteve të diskriminimit, promovimit të praktikave të mira të barazisë, të informimit të publikut për rastet e diskriminimit, trajtimin e rasteve që lidhen me diskriminimin gjinor, si dhe bashkëpunon me partnerë socialë, me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

Ndryshimi i praktikave të raportimit të Avokatit të Popullit në Kuvendin e Kosovës

Në një demokraci funksionale, institucionet e pavarura luajnë një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e balancës së pushteteve, garantimin e të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrjen e funksionimit të institucioneve shtetërore. Ndër këto institucione, Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur kushtetues, ka mandat të veçantë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke kërkuar llogaridhënie dhe duke ofruar rekomandime për përmirësimin e gjendjes. Në këtë kontekst, trajtimi i Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është një element thelbësor për funksionimin demokratik të shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 135, paragrafi 1, e përcakton qartë se Avokati i Popullit "paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës".

Përzgjedhja e fjalës “paraqet” dhe shmangia e fjalës “raporton” në të gjitha versionet gjuhësore të Kushtetutës nuk është rastësore. Ky formulim tregon se Avokati i Popullit nuk është subjekt i një raportimi kontrollues nga Kuvendi, por thjesht paraqet të dhëna dhe rekomandime për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Çdo tentativë për ta trajtuar këtë raport si një dokument që duhet të miratohet ose refuzohet bie ndesh me garancitë kushtetuese të pavarësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj).

Megjithatë, një analizë e hollësishme e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe e praktikave ndër vite, ka nxjerrë në pah një çështje të rëndësishme që kërkon trajtim: mënyra se si trajtohet Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit në Kuvend. Sipas nenit 98 të Rregullores, raportet vjetore të organeve të pavarura, të themeluara nga Kuvendi, u nënshtrohen një procedure të caktuar shqyrtimi, e cila kulmon me një votim për miratim nga deputetët.

Rregullorja e Kuvendit i konsideron të gjitha institucionet e pavarura si të barasvlershme, pa bërë një dallim mes atyre që janë themeluar nga Kuvendi dhe atyre që burojnë drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Avokati i Popullit është një institucion kushtetues dhe ekzistenca e tij nuk varet nga një vendim i Kuvendit, por nga vetë Kushtetuta e Kosovës. Prandaj, ai nuk mund të trajtohet si një organ i krijuar me vullnetin politik të ligjvënësve dhe, për rrjedhojë, as Raporti i tij Vjetor nuk duhet të jetë subjekt i një votimi për miratim në Kuvend.

Votimi për miratimin e një raporti që ka për qëllim të evidentojë shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të japë rekomandime për përmirësimin e gjendjes e devijon vëmendjen nga qëllimi kryesor i këtij raporti. Një raport i tillë nuk është një dokument administrativ që kërkon miratim formal, por një mekanizëm për të nxitur përmirësime në qeverisje të mirë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Kjo qasje e gabuar krijon një rrezik të dyfishtë. Së pari, duke e futur Raportin e Avokatit të

Popullit në të njëjtën procedurë me raportet e tjera, ekziston mundësia që ai të përdoret si një mjet për ndërhyrje në pavarësinë e Institucionit, duke u dhënë deputetëve hapësirën për ta miratuar ose refuzuar pa u bazuar në përmbajtjen e raportit. Së dyti, kjo qasje nuk ndihmon aspak në përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet shtetërore, duke e kufizuar rolin e Kuvendit në një procedurë formale votimi, në vend që të fokusohet në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të bëra në raport.

Duke marrë në konsideratë këto sfida, Avokati i Popullit në vitin 2016 pati adresuar në Kuvend, Raportin Ex.officio Nr. 563/2016 në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilin pati propozuar një ndryshim thelbësor në mënyrën se si Kuvendi trajton raportin e tij vjetor. Ky raport konstaton se në vend të një votimi për miratim, Kuvendi duhet të përqendrohet në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet përkatëse. Një kërkesë e tillë ripërsëritet edhe nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i cili thotë: *“Parlamenti duhet ta adresojë çështjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit duke përmirësuar rolin e tij mbikëqyrës.”*

Në nivel ndërkombëtar, institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut funksionojnë si mekanizma llogaridhënieje dhe legjislativat duhet të luajnë një rol mbështetës për punën e tyre, duke garantuar që rekomandimet e tyre të merren seriozisht dhe të zbatohen nga institucionet shtetërore. Kjo është një praktikë e njohur në vendet demokratike dhe një standard i promovuar nga organizata ndërkombëtare, si: Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, përmes Parimeve të Parisit dhe Parimeve të Venecias, të cilat përcaktojnë se Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje politike. Për më tepër, shtetet duhet të sigurojnë që ato ta paraqesin raportin e tyre vjetor para parlamentit për shqyrtimin e tij, e po ashtu një përcjellje efektive e rekomandimeve të IKDNj-ve

brenda afateve. Kurse Rekomandimi për Politika të Përgjithshme nr. 2 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) rekomandon që mekanizmat e barazisë duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur në nivel operacional dhe të lirë nga çdo “ndërhyrje nga shteti, nga partitë politike apo nga aktorë të tjerë” dhe në mënyrë eksplicite rekomandon që raportet vjetore të mekanizmave të barazisë duhet të diskutohen në parlament apo nga komisionet e tij dhe nga qeveria, por ato nuk duhet t’i nënshtrohen miratimit të tyre.

Më 23 maj 2024, Kuvendi shqyrtoi me vonesë dhe votoi kundër miratimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2022, edhe pse ai mori dritën e gjelbër dhe u rekomandua për miratim nga tri komisione funksionale të Kuvendit. Votimi kundër i Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, pa debat dhe pa ndonjë bazë të qëndrueshme, jo vetëm që minon besueshmërinë dhe autonominë e institucionit, por gjithashtu krijon një precedent shqetësues, që mund ta dëmtojë besimin e publikut në rolin e Avokatit të Popullit si garantues i të drejtave të njeriut. Ky ishte një akt i paprecedentë që shkaktoi reagime të ashpra nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Në deklaratën e tij, Avokati i Popullit theksoi se ky votim përbënte një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë institucionale dhe rrezikonte të minonte rolin e tij si mekanizëm monitorues i të drejtave të njeriut në Kosovë. Rrjetet ndërkombëtare si ENNHRI dhe EQUINET adresuan një letër të përbashkët reagimi te Kryetari i Kuvendit dhe te Presidentja e Republikës së Kosovës, siç bënë edhe organizatat kryesore ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë si dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat kërkuan respektimin e pavarësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe domosdoshmërinë e ndryshimit të praktikave ekzistuese dhe të sigurimit të një qasjeje më të harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, ka qenë i domosdoshëm shqyrtimi i praktikave të vendeve të tjera në rajon për të kuptuar se si mund të përmirësohet procedura në Kosovë. Një shembull i rëndësishëm është praktika e ndjekur në Shqipëri, ku raporti vjetor i Avokatit të Popullit prezantohet para Kuvendit, shqyrtohet në komisionin përkatës parlamentar, pastaj diskutohet në seancë plenare dhe konkludohet me miratimin e një rezolute, e cila shërben si bazë për përmirësime të politikave publike dhe shtyrjen përpara të çështjeve që kanë nevojë të adresohen nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Rrjedhimisht, me qëllim të fuqizimit të rolit të mbikëqyrjes efektive nga ana e Kuvendit, është e rëndësishme që të ndërmerren hapat në vijim:

1. Ndryshimi i Rregullores së Kuvendit për ta harmonizuar trajtimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit me standardet ndërkombëtare:

- Heqja e procedurës së votimit për miratimin ose refuzimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, duke e trajtuar atë si një dokument informues dhe rekomandues për sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut në vend.
- Në vend të votimit, të përfshihet një mekanizëm i diskutimit të thelluar mbi përmbajtjen e raportit dhe rekomandimeve të tij.

2. Krijimi i një mekanizmi efektiv të mbikëqyrjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit:

- Caktimi i një komisioni parlamentar që do të merret me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet përgjegjëse.
- Ky mekanizëm të sigurojë raportim të rregullt nga institucionet e synuara për masat e ndërmarra në lidhje me rekomandimet e dhëna.

3. Vendosja e afateve të qarta për shqyrtimin dhe diskutimin e raportit në Kuvend:

- Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit të shqyrtohet brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e dorëzimit.
- Seanca plenare e Kuvendit ta trajtojë raportin si një pikë të parë të rendit të ditës për të siguruar vëmendjen e duhur.

4. Miratimi i një rezolute parlamentare që siguron veprim të mëtejshëm mbi çështjet e ngritura në raport:

- Pas shqyrtimit të raportit, Kuvendi të miratojë një rezolutë që përmbledh prioritetet dhe çështjet më urgjente të të drejtave të njeriut.
- Rezoluta të përfshijë udhëzime konkrete për institucionet shtetërore mbi masat që duhet të ndërmerren për adresimin e rekomandimeve.

Ndryshimi i mënyrës se si trajtohet Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit në Kuvend nuk është thjesht një çështje teknike, por një hap i rëndësishëm drejt forcimit të institucioneve demokratike dhe llogaridhënies në Kosovë. Duke miratuar një qasje të re që e vë theksin tek mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve, Kuvendi i Kosovës do të dëshmonte angazhimin e tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar që institucionet shtetërore të veprojnë në përputhje me standardet më të larta demokratike. Ky propozim nuk është vetëm një rregullim procedural, por një reflektim i një kulture të re politike – një kuadër ku transparencja, përgjegjshmëria dhe respektimi i të drejtave të njeriut bëhen shtylla qendrore e vendimmarrjes dhe qeverisjes në Kosovë.

Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve

Nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2024, në Institucionin e Avokatit të Popullit, zyra qendrore në Prishtinë dhe zyrat rajonale: Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Gjakovë dhe Graçanicë, janë parashtruar 1410 ankesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, me pohimet ankimore për shkelje të drejtave dhe të lirive të njeriut nga autoritetet publike në Republikën e Kosovës, por edhe me kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike.

Nga analiza e ankesave të paraqitura nga qytetarët, sipas kategorive kushtetuese të të drejtave dhe të lirive të njeriut, vërehet se numri më i madh i tyre kanë të bëjnë me: *të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, mbrojtjen e pronës, barazia para ligjit, të drejtat e të akuzuarit, të drejtat e fëmijës etj.*

Në paraqitjet e mëposhtme tabelore, në mënyrë më të detajuar janë paraqitur shënimet për numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar, të shqyrtuara dhe të vendosura për pranushmërinë apo papranueshmërinë e tyre për hetim, rastet e hapura për hetim me vetiniciativë të Avokatit të Popullit, pastaj përkatësia etnike e ankuesve dhe përkatësia gjinore, autoritetet përgjegjëse publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat, numrin e rasteve të vendosura si të **përfunduara/mbyllura, numri raporteve dhe** i rekomandimeve të publikuara ndaj autoriteteve publike dhe zbatueshmëria e rekomandimeve nga këto autoritete.

Tabela 1. Ankesat e paraqitura te Avokati i Popullit në vitin 2024

Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura	1410
Numri i personave të përfshirë në ankesa	4528
Përkatësia etnike e ankuesve	
Shqiptarë	1196
Serbë	110
Ashkalinj	23
Boshnjakë	20
Romë	17
Turq	12
Egjiptianë	10
Goranë	7
Të tjerë	15
Ankesat e paraqitura, të ndara sipas zyrave të Avokatit të Popullit	
Zyra Qendrore-Prishtinë	666
Zyra Rajonale-Prizren	138
Zyra Rajonale-Gjiilan	132
Zyra Rajonale-Pejë	124
Zyra Rajonale-Ferizaj	99

Zyra Rajonale-Gjakovë	97
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Jugut	80
Zyra Rajonale-Mitrovicë e Veriut	39
Zyra Rajonale-Graçanicë	35
Përkatësia gjinore e ankuesve bazuar në ankesat e paraqitura	
Meshkuj	1031
Femra	379
Autoritetet publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	
Ministritë	467
Gjykatat	432
Komunat	220
Policia	95
Prokuroritë	63
Ndërmarrjet publike	43
Të tjera	294

Tabela 2. Numri i ankesave të paraqitura, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një ankesë mund të përfshijë disa të drejta e liri)

E Drejta për Mjete Juridike	394
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	361
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	218
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	164
Mbrojtja e Pronës	112
Të Drejtat e të Akuzuarit	84
Barazia para Ligjit	74
Të Drejtat e Fëmijës	52
Ndalimi i Torturës	33
E Drejta për Arsimin	29
Dinjiteti i Njeriut	28
E Drejta e Martesës dhe Familjes	17
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	15
E Drejta për Jetën	13
E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	13
E Drejta e Privatësisë	8
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	7
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	4
Liria e Medieve	4

Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	4
Liria e Lëvizjes	3
Liria e Shprehjes	3
Të tjera	12

Tabela 3. Numri i ankesave të paraqitura, sipas Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) - një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	1,137
3. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	134
10. Pabarazitë e Reduktuara	49
8. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	33
17. Partneritetet për Qëllime	17
5. Barazia Gjinore	13
4. Arsim Cilësor	11
7. Energji e Përbalueshme dhe e Pastër	8
15. Jeta dhe Toka	7
6. Uji i Pastër dhe Kanalizimi	7
9. Industria e Inovacionit dhe Infrastrukturës	4
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	3
12. Konsumi dhe Prodhimi i Përgjithshëm	2
2. Zero Uri	1

Tabela 4. Ankesat e vendosura si të papranueshme

Numri i ankesave të papranueshme	826
Ankesat e papranueshme, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit	
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	279
S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	203
Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	178
Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	138
Mosinteresim, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	21
E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	4
Shënim zyrtar	2
Keqpërdorim i së drejtës së ankesës - Neni 21, pika 1.3.4	1

Tabela 5. Ankesat në pritje për shqyrtim

Numri i ankesave në pritje për shqyrtim	2
--	----------

Tabela 6. Ankesat e vendosura si të pranueshme për hetim

Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim	582
Numri i rasteve të hetuara me iniciativë të Avokatit të Popullit (Ex officio)	39
Ankesat e hapura për hetim, sipas përkatësisë etnike të ankuesve	
Shqiptarë	455
Serbë	86
Boshnjakë	8
Romë	7
Turq	6
Ashkalinj	5
Egjiptianë	5
Goranë	5
Tjetër	5
Përkatësia gjinore e ankuesve, bazuar në ankesat e hetuara	
Meshkuj	417
Femra	165
Autoritetet publike ndaj të cilave janë hapur hetime sipas ankesave (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	
Ministritë/Administrata	197
Gjykatat	194
Komunat	107
Policia	32
Ndërmarrjet publike	21
Prokuroritë	19
Të tjera	109

Tabela 7. Numri i ankesave të hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një ankesë mund të përfshijë disa të drejta e liri)

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	179
E Drejta për Mjete Juridike	165
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	75
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	73
Barazia para Ligjit	53
Mbrojtja e Pronës	40
Të Drejtat e Fëmijës	36
E Drejta për Arsimin	22
Dinjiteti i Njeriut	17
Ndalimi i Torturës	15
Të Drejtat e të Akuzuarit	14
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	11
E Drejta për Jetën	7
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	6
E Drejta e Martesës dhe Familjes	5
E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	4
E Drejta e Privatësisë	3
Liria e Medieve	3
Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale	2
Liria e Shprehjes	2
Liria e Tubimit	2
Liria e Asociimit	2
Liria e Lëvizjes	1
Konfesionet Fetare	1
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	1
Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes	1
Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	1
Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore	1

Tabela 8. Numri i ankesave të hetuara, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	483
3. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	45
10. Pabarazitë e Reduktuara	20
8. Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	14
17. Partneritetet për Qëllime	7
4. Arsim Cilësor	6

5. Barazia Gjinore	5
15. Jeta dhe Toka	4
7. Energji e Përballueshme dhe e Pastër	3
6. Uji i Pastër dhe Kanalizimi	2
9. Industria e Inovacionit dhe Infrastrukturës	2
11. Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme	1
12. Konsumi dhe Prodhimi i Përgjithshëm	1
2. Zero Uri	1

Tabela 9. Numri i rasteve ex.officio, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore (një rast mund të përfshijë disa të drejta e liri)

Barazia para Ligjit	11
Të Drejtat e Fëmijës	11
E drejta për Jetën	5
E Drejta për Arsimin	5
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	5
Dinjiteti i Njeriut	2
Ndalimi i Torturës	2
E Drejta për Mjete Juridike	2
E Drejta e Martesës dhe Familjes	2
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit	2
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	2
Të Drejtat e të Akuzuarit	1
E Drejta e Privatësisë	1
Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë	1
Liria e Shprehjes	1
Liria e Medieve	1
Mbrojtja e Pronës	1
Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	1

Tabela 10. Numri i rasteve ex.officio, sipas OZhQ (një rast mund të përfshijë disa OZhQ)

16. Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta	28
3. Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë	6
4. Arsim Cilësor	4
10. Pabarazitë e Reduktuara	2
17. Partneritetet për Qëllime	1
5. Barazia Gjinore	1
7. Energji e Përballueshme dhe e Pastër	1
6. Uji i Pastër dhe Kanalizimi	1

Tabela 11. Ankesat e vendosura me përfundim të hetimeve (përfshijnë ankesat e vitit 2024 dhe viteve paraprake)

Numri i përgjithshëm i ankesave të përfunduara/mbyllura	906
Ankesat e përfunduara/mbyllura, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit	
I zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5	312
I mbyllur me raport, kur konstatohen shkelje të të D.Nj. - Neni 24, pika 3	256
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	194
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	61
I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	40
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	35
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	8

Tabela 12. Raportet me rekomandime dhe Letrat me rekomandime

Raporte për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	54
Raporte për rastet hetimore me iniciativë të AP, Ex officio	8
Raportet e MKP-së	6
Letra me rekomandime për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	3
Rekomandime në Raportet dhe Letrat me rekomandime	176

Tabela 13. Statusi i rekomandimeve

Rekomandime të zbatuara	37
Rekomandime pjesërisht të zbatuara	7
Rekomandime të pazbatuara	13
Rekomandime në pritje për zbatim	119
Totali	176

Tabela 14. Krahasimi i përqindjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit të adresuara gjatë vitit 2023, gjendja sipas raportimit për periudhën 31 dhjetor 2023 dhe përditësimi më datë 31 dhjetor 2024

Rekomandimet 2023	Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve më 31 dhjetor 2023	Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve më 31 dhjetor 2024
Rekomandime të zbatuara	41 - 14%	69 - 23%
Rekomandime pjesërisht të zbatuara	7 - 2%	17 - 6%
Rekomandime në pritje për zbatim	252 - 84%	200 - 66%

Rekomandime të pazbatuara	0 - 0%	14 - 5%
Totali i rekomandimeve	300	300

Tabela 15. Statusi i rekomandimeve sipas nivelit institucional

Niveli institucional	Gjithsej rekomandime	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara	Në pritje për zbatim
Niveli qendror	108	21	7	11	69
Niveli lokal	13	4	0	0	9
Gjyqësori/Prokuroria	55	12	0	2	41
Totali	176	37	7	13	119

Tabela 16. Kërkesat dhe opinionet

Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese	5
Opinione drejtuar Gjykatës Kushtetuese	3
Opinione drejtuar autoriteteve të tjera	7
Amicus Curiae	3

Tabela 17. Ankesat e pranuar dhe të hetuara nga Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Numri i ankesave të paraqitura	63
Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim	50
Numri i ankesave të papranueshme	13
Numri i rasteve hetimore me vetiniciativë ex.officio	13
Totali	76

Tabela 18. Zbatueshmëria e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, nga autoritetet publike përgjegjëse

Autoriteti përgjegjës	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime pjesërisht të zbatuara	Rekomandime të pazbatuara	Në pritje për zbatim
Kuvendi i Republikës së Kosovës	0	0	0	3
Qeveria e Republikës së Kosovës	0	0	2	13
Ministria e Shëndetësisë	5	0	0	11
Ministria e Drejtësisë	3	5	2	10
Ministria e Punëve të Brendshme	2	0	0	12
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	4	0	2	0
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	0	0	6
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	0	0	1
Akademia e Drejtësisë	1	0	0	0
Agjencia për Barazi Gjinore	0	0	0	1
Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës	0	0	0	4
Inspektorati i Punës	2	0	0	3
Inspektorati Policor i Kosovës	0	0	2	0
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	0	0	2	1
Komisioni i Pavarur i Mediave	0	2	0	0
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	1	0	0	4
Oda e Avokatëve të Kosovës	0	0	1	0
Radiotelevizioni i Kosovës	2	0	0	0

Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	0	0	2
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	0	0	0	4
DhPGjSK	3	0	1	10
Gjykata e Apelit	3	0	1	3
Gjykata Komeriale e Kosovës	1	0	0	0
Gjykata Themelore në Prishtinë	4	0	0	18
Gjykata Themelore në Prizren	0	0	0	2
Gjykata Themelore në Pejë	1	0	0	0
Gjykata Themelore në Gjiilan	0	0	0	2
Komuna e Prishtinës	2	0	0	1
Komuna e Skenderajt	0	0	0	1
Komuna e Fushë Kosovës	0	0	0	3
Komuna e Gjakovës	2	0	0	0
Komuna e Gjilanit	0	0	0	1
Komuna e Istogut	0	0	0	1
Komuna e Graçanicës	0	0	0	1
Komuna e Novobërdës	0	0	0	1
Totali	37	7	13	119

Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit

1 janar 2024 - 31 dhjetor 2024

Figura 1. Paraqitja grafike e ankesave të qytetarëve të shqyrtuara/vendosura nga Avokati Popullit

- Ankesat e vendosura të pranueshme për hetim
- Ankesat e vendosura si të papranueshme për hetim
- Ankesat në pritje për shqyrtim




Figura 2. Përqindja e ankesave sipas përkatësisë etnike të qytetarëve

- Shqiptarë
- Serbë
- Ashkalinj
- Boshnjakë
- Romë
- Turq
- Egjiptianë
- Goranë
- Të tjerë




Figura 3. Përkatësia gjinore e ankesve bazuar në ankesat e paraqitura

- Meshkuj
- Femra




Figura 4. Autoritetet publike ndaj të cilave janë paraqitur ankesat

- Ministrinë
- Gjykatat
- Komunat
- Policia
- Prokuroritë
- Ndërrmarjet publike
- Të tjera




Figura 5. Ankesat e paraqitura, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

- E Drejta për Mjete Juridike
- E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm
- Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale
- E Drejta e Punës
- Mbrojtja e Pronës
- Të Drejtat e të Akuzuarit
- Barazia para Ligjit
- Të Drejtat e Fëmijës
- Ndalimi i Torturës
- E Drejta për Arsimin
- Dinjiteti i Njeriut
- E Drejta e Martesës dhe Familjes
- Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor
- Të tjera




Figura 6. Numri i ankesave të paraqitura, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)

- Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta
- Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë
- Pabarazitë e Reduktuara
- Partneritetet për Qëllime Ekonomike
- Barazia Gjinore
- Arsim Cilësor
- Jeta dhe Toka
- Energji e Përballeshme dhe e Pastër
- Uji i Pastër dhe Kanalizimi
- Industria e Inovacionit dhe Infrastrukturës
- Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme
- Konsumi dhe Prodhimi i Përgjithshëm
- Zero Uri




Figura 7. Ankesat e hapura për hetim, sipas përkatësisë etnike të ankuesve

- Shqiptarë
- Serbë
- Ashkalinj
- Boshnjakë
- Romë
- Turq
- Egjiptianë
- Goranë
- Të tjerë




Figura 8. Autoritetet publike ndaj të cilave janë hapur hetime sipas ankesave

- Ministrinë/Administrata
- Gjykatat
- Komunat
- Policia
- Ndërmarrjet publike
- Prokuroritë
- Të tjera




Figura 9. Ankesat e hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

- E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm
 - E Drejta për Mjete Juridike
 - Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale
 - E Drejta e Punës
 - Barazia para Ligjit
 - Mbrojtja e Pronës
- Të Drejtat e Fëmijës
 - E Drejta për Arsimin
 - Dinjiteti i Njeriut
 - Ndalimi i Torturës
 - Të Drejtat e të Akuzuarit
 - Të tjera




Figura 10. Numri i ankesave të hetuara, sipas OZhQ (një ankesë mund të përfshijë disa OZhQ)

- Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta
 - Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë
 - Pabarazitë e Reduktuara
 - Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike
 - Partneritetet për Qëllime
 - Arsim Cilësor
 - Barazia Gjinore
- Jeta dhe Toka
 - Energji e Përballueshme dhe e Pastër
 - Industria e Inovacionit dhe Infrastrukturës
 - Uji i Pastër dhe Kanalizimi
 - Konsumi dhe Prodhimi i Përgjithshëm
 - Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme
 - Zero Uri




Figura 11. Ankesat e hetuara Ex.officio, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Liritë Themelore

- Barazia para Ligjit
 - Të Drejtat e Fëmijës
 - E Drejta për Jetën
 - E Drejta për Arsimin
 - Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale
 - Dinjiteti i Njeriut
- Ndalimi i Torturës
 - E Drejta për Mjete Juridike
 - E Drejta e Martesës dhe Familjes
 - E Drejta e Punës
 - Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor
 - Të tjera




Figura 12. Numri i rasteve ex.officio, sipas OZhQ (një rast mund të përfshijë disa OZhQ)

- Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta
- Pabarazitë e Reduktuara
- Partneritetet për Qëllime
- Energji e Përballueshme dhe e Pastër
- Shëndeti dhe Mirëqenia e Mirë
- Arsim Cilësor
- Barazia Gjinore
- Uji i Pastër dhe Kanalizimi




Figura 13. Rastet e vendosura me përfundim/mbyllje të hetimeve (përfshijnë rastet e vitit 2024 dhe të viteve paraprake)

- Zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit
- Të papranueshme
- Raport me rekomandime i publikuar
- Mosinteresim i ankuesit




Figura 14. Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit të publikuara gjatë vitit 2024, nga autoritetet publike përgjegjëse

- Rekomandime të zbatuara
- Rekomandime pjesërisht të zbatuara
- Rekomandime të pazbatuara
- Rekomandime në pritje për zbatim




Figura 15. Përqindja e ankesave të hetuara dhe të papranueshme nga Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

- Ankesat e papranueshme **21%**
- Ankesat e vendosura si të pranueshme për hetim **79%**





Figura 16. Përqindja e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2024, në zyrën qendrore dhe në zyrat rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit

- Zyra Qendrore-Prishtinë
- Zyra Rajonale-Prizren
- Zyra Rajonale-Gjilan
- Zyra Rajonale-Pejë
- Zyra Rajonale-Ferizaj
- Zyra Rajonale-Gjakovë
- Zyra Rajonale-Mitrovicë e Jugut
- Zyra Rajonale-Mitrovicë e Veriut
- Zyra Rajonale-Graçanicë



**Mbrojtja e të
drejtave të njeriut
nga Avokati i
Popullit**

Të drejtat themelore

Dinjiteti i Njeriut

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj shteti ka për obligim që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e dinjitetit si dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka pranuar njëzet e gjashtë (26) ankesa me pretendime për shkelje të dinjitetit të njeriut, prej të cilave pesëmbëdhjetë (15) janë proceduar për hetime të mëtejme, ndërsa njëmbëdhjetë (11) janë shpallur të papranueshme. Ndërsa ka filluar hetimin sipas detyrës zyrtare në dy raste.

Cenimi i dinjitetit të njeriut shpesh ndërlihet me shkeljen e të drejtave të tjera fundamentale, dhe mbi bazën e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit vërehet se ato shpesh pasqyrojnë shkelje të thelbit të këtyre të drejtave, të cilat janë të mbrojtura nga instrumentet ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Këto përfshijnë të drejtat për arsim, barazinë para ligjit, mosdiskriminimin, të drejtën për jetën, ndalimin e torturës, të drejtën për privatësi, si dhe të drejtat për punësim dhe ushtrim të profesionit.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit mbi bazën e një ankesë² të pranuar ka trajtuar çështjen e mosmbulimit të shpenzimeve të ndërrimit të protezave për invalidët civilë të luftës. Rrjedhimisht, në vitin 2024 Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi një vendim për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me statusin e invalidit të luftës, për qëllime të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave jashtë institucioneve shëndetësore publike, në rastet kur këto

institucione nuk ofrojnë shërbime të tilla. Ndërsa Ministria e Shëndetësisë (MSh) më vonë nxori vendim për mbulimin e trajtimit mjekësor vetëm për personat me statusin e invalidit të UÇK-së. Duke konsideruar këtë qasje diskriminuese dhe trajtim jo të dinjitetshëm për këtë kategori, Avokati i Popullit në dhjetor të vitit 2024 publikoi një raport me rekomandime, ku i rekomandoi Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta anulonte Vendimin e nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, ndërkaq Ministrinë e Shëndetësisë i rekomandoi që të ndërmarrë masa në përputhje me Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, për ofrimin e përfitimeve të veçanta për invalidët civilë të luftës. Lidhur me rekomandimet e adresuara, Avokati i Popullit është njoftuar nga MSh-ja se ka nxjerrë një vendim, me të cilin ka obliguar bordin për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike ta mbulojë financiarisht trajtimin mjekësor të invalidëve civilë të luftës për ndërrimin, mirëmbajtjen apo vendosjen e protezave, sipas zgjedhjes së aplikuesve.

Po ashtu në tetor të vitit 2024, Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare³ inicioi hetime, pas njoftimit përmes mediave se personat mbi moshën 65-vjeçare, që kanë nevojë për proteza në kërdhokull apo gjunjë, për dallim nga ata nën moshën 65-vjeçare, duhet të paguajnë vetë për shpenzimet e materialit, që arrin një vlerë afërsisht 700 euro, ku Klinika e Ortopedisë në QKUK këtë vendim e arsyeoi për shkak të mungesës së furnizimit të qëndrueshëm me këtë material. Kjo çështje është në trajtim e sipër në IAP.

Gjithashtu përmes Raportit të publikuar ex-officio nr. 436/2023⁴ lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat për realizimin e beneficioneve të përcaktuara me

2 R/522/2024

3 Ex-officio 1125/2024

4 <https://oik-rks.org/2024/10/31/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-436-2023-lidhur-me-respektimin-e-te-drejtave-te-njeriut-gjate-zhvillimit-te-procesit-te-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-viktimes-se-dhunes-seksuale/>

ligj, Avokati i Popullit, për sa i përket mënyrës së organizimit dhe realizimit të intervistave, i ka rekomanduar Komisionit Qeveritar që të gjenden mundësitë dhe modalitetet e nevojshme për organizimin më të mirë të kohës së intervistimit, në mënyrë që viktimave t'u sigurohet ruajtja e identitetit të tyre nga zbulimi dhe ruajtja e konfidencialitetit të procedurës dhe e të dhënave të palëve me rastin e pritjes për intervistim. Po ashtu, të sigurohet respektimi i dinjitetit të të mbijetuarave/ve në procesin e intervistimit, përmes sigurimit të respektimit të qasjes së viktimave në qendër, trajtimit me humanizëm dhe shmangien nga ritraumatizimi apo ringjallja e ngjarjeve traumatike.

Avokati i Popullit, në Raportin ex officio nr. 521/2022, të publikuar në vitin 2023, lidhur me bazën ligjore të rivlerësimit nga Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ka konstatuar se dinjiteti i personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë në rend të parë cenohet për shkak të vështirësive praktike që ata i kanë për t'u paraqitur para Komisionit Vlerësues, aq më parë që Rregullorja nuk ka paraparë shprehimisht obligimin që Komisioni Vlerësues të mund t'i vizitojë këta persona në vendbanimet e tyre. Qasshmëria në hapësirat dhe në objektet publike për personat me aftësi të kufizuar është po ashtu çështje tjetër shqetësuese në këtë kontekst. Andaj Avokati i Popullit ka rekomanduar iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, ndër të tjerash, në atë mënyrë që: të përcaktojnë se Komisioni Vlerësues nuk mund të rivlerësojë personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilëve u është njohur statusi i personave të grupit të parë si dhe rivlerësimi i personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të grupit të dytë të bëhet vetëm në rastet e caktuara, kur natyra e sëmundjes është në zhvillim të shpejtë dhe për pasojë ka përkeqësimin e gjendjes shëndetësore. Monitorimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve ka vazhduar edhe

në vitin 2024, ku Avokati i Popullit, sipas përgjigjes që ka pranuar nga MFPT-ja, është njoftuar se Projektregullorja është trajtuar në përputhje me rekomandimin e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, gjithashtu përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka realizuar vizita monitoruese të paplanifikuara në të gjitha institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut dhe trajtimit të tyre në mënyrë të dinjitetshme.

Vizita të rregullta dhe sistematike janë realizuar edhe në Qendrat e Shëndetit Mendor, Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK), Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB), si dhe në Shtëpitë e të Moshuarve, me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit dhe parandalimit të shkeljes së dinjitetit dhe të të drejtave të njeriut.

E Drejta për Jetën

E drejta për jetën është e garantuar me Kushtetutë. Askush nuk mund të privohet nga jeta, pasi kjo është një e drejtë absolute. Dënimi me vdekje është i ndaluar në çfarëdo rrethane.⁵

Në frymën e normës kushtetuese dhe siç është interpretuar nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, shteti ka obligim për të mbrojtur me ligj jetën dhe ndalimin e privimit të qëllimshëm nga jeta dhe detyrimin procedural për të kryer një hetim efektiv. Në Udhëzuesin për nenin 2 të KEDNj-së⁶, është përcaktuar: “KEDNj përcakton të drejtën për jetë, Neni 2 përmban dy detyrime thelbësore: detyrimin e përgjithshëm për të mbrojtur me ligj të drejtën për jeta, dhe ndalimi i privimit të qëllimshëm nga jeta, i kufizuar nga një listë përjashtimesh. Duke pasur parasysh karakterin e tij themelor, neni 2 i Konventës përmban gjithashtu detyrimi procedural për të kryer një hetim efektiv për shkeljet e supozuara të përmbajtjes së tij gjymtyrë (Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], 2016, § 229). e cila parasheh detyrimin pozitiv të shteteve për të hetuar

5 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24.

6 https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_2_eng

rastet e vdekjeve, që kanë elemente të shkëljes së këtij neni.”⁷

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues ka pranuar 7 ankesa me pretendim për shkeljen e kësaj të drejte, prej tyre 2 raste janë hapur për hetim, ndërsa 5 raste janë shpallur të papranueshme, ndërsa sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit ka hapur 5 raste për hetim.⁸

Rasti i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët (SHFMU) “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët, Komuna e Gjilanit

Pasi kemi pranuar informatën nga prindi i një fëmije se në një klasë të ShFMU “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët, Komuna e Gjilanit, ku nxënësit mbanin mësim, kishin rënë pjesë të gëlqeres nga tavani, duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e nxënësve dhe të personelit të shkollës, Avokati i Popullit ka filluar hetimet lidhur me këtë rast. Nga hetimet e kryera, Avokati i Popullit ka konstatuar se autoritetet përgjegjëse duhet të gjejnë një zgjidhje, në mënyrë që të garantojnë një ambient të sigurt për nxënësit dhe për personelin gjatë qëndrimit në shkollë, po ashtu të garantojnë përkujdesjen efektive për fëmijët, shëndeti dhe mirëqenia e të cilëve janë në rrezik.

Në drejtim të kësaj, Avokati i Popullit vlerëson se vazhdimi i mësimit në objektin e ShFMU-së “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët, në këto kushte, paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe të personelit të shkollës, prandaj institucionet përgjegjëse duhet ta trajtojnë me prioritet çështjen në fjalë. Kështu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Gjilanit që pa vonesa të mëtutjeshmet i ndërmarrë të gjitha masat e duhura për t’ua siguruar të gjithë fëmijëve një mjedis shkollor të shëndetshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm, sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor.

Rasti i Vrasjes së 21-vjeçares në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj

Avokati i Popullit ka hapur rast sipas detyrës zyrtare, *ex officio* nr. 563/2024, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për marrjen e masave

preventive në Qendra për Punë Sociale për mbrojtjen e integritetit fizik, gjegjësisht të drejtën për jetë, si një e drejtë absolute. Ky rast është iniciuar bazuar në raportimet e “Kallxo.com”⁹, të datës 12 prill 2024, me titullin: “*Vrasja e 21 vjeçares në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj, çka dihet deri tash?*” Ky portal raportoi se bëhej fjalë për vrasje, duke theksuar se viktima dhe dorasi kishin qenë bashkëshortë faktikë dhe nga kjo bashkësi martesore kishin pasur një fëmijë. Hetimi i këtij rasti është orientuar në vlerësimin e përmeshjes së detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën në jetë të qytetarëve, duke analizuar veprimet dhe mosveprimet e tyre, gjegjësisht ndërmarrjen e masave preventive si parakusht për të siguruar jetën si të zyrtarëve ashtu edhe të palëve që marrin shërbime në këtë institucion. Avokati i Popullit ka analizuar zbatimin e dispozitave kushtetuese, instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, praktikës së Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), ligjeve, politikave dhe strategjisë kundër dhunës në familje, së drejtës në jetë dhe ka konstatuar nevojën që komunat duhen pajisur me detektorë dhe roje fizike. Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit do të publikojë raport me rekomandime konkrete.

Rasti i vrasjes së viktimës H. M. në QKUK dhe vrasjes së viktimës S. D. në Dragash

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka zhvilluar hetime përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, gjegjësisht lidhur me vrasjen e shtatzënës H. M. nga bashkëshorti i saj, më 30 nëntor 2022, në oborrin e Klinikës së Gjinekologjisë, pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), pavarësisht se ishte në fuqi një urdhër mbrojtjeje, si dhe lidhur me vrasjen e S. D., e rrahur për vdekje nga familjarët e saj (kunata), më 26 dhjetor 2022, në fshatin Kuk të komunës së Dragashit.

Në rastin e parë, Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimeve ka konstatuar se kjo

7 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 2.

8 R/292/2024, Ex-Officio dhe R/563/2024, Ex-Officio, R/1380/2024, R/1333/2024, R/1206/2024;

9 <https://kallxo.com/lajm/vrasja-e-21-vjecares-ne-ferizaj-detaje-nga-vendi-i-ngjarjes/>

ngjarje tragjike do të mund të shmangej sikur autoritetet shtetërore ta zbatonin legjislacionin në fuqi, gjegjësisht sikur të gjente zbatim Ligji nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Më 8 mars 2021, Avokati i Popullit publikoi Raport *Ex-officio* nr. 621/2018¹⁰ në lidhje me masat operative parandaluese për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Raporti ka synuar tërheqjen e vëmendjes së institucioneve përgjegjëse për obligimet pozitive të shtetit në kontekstin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, por këto rekomandime nuk u zbatuan deri më 10 dhjetor të vitit 2024, kur u publikua lajmi se ka filluar përdorimi i sistemit të hallkave për mbikëqyrje elektronike ndaj kryerësve të dhunës në familje.¹¹

Gjatë hetimeve të zhvilluara në rastin e dytë, Avokati i Popullit vërejt se viktima e dhunës në familje S. D. hasi në probleme të mëdha në kuptim të marrjes së shërbimeve shëndetësore dhe strehimit jashtë familjes, si rrjedhojë e problemeve që kishte me shëndetin mendor. Prandaj Avokati i Popullit inicioi hetime me vetiniciativë (rasti *Ex officio* nr. 601/2023) në lidhje me detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën e Kosovës, me qëllim që të identifikojë sfidat ekzistuese dhe të propozojë rekomandime konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare, duke siguruar një qasje të barabartë e pa diskriminim për të gjithë.

Si përfundim, Avokati i Popullit konstatoi se kufizimi i moshës deri në 65 vjeç, si kriter për t'u pranuar në institucione rezidenciale, përbënte shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Avokati i Popullit

vërejt se mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor sfidon zbatimin e ligjit dhe krijon hapësirë për praktikat diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor lidhur me kufizimin e moshës për personat mbi 65 vjeç. Po ashtu Avokati i Popullit konstatoi se, përveç mungesës së akteve nënligjore, mungesa e kriterëve të qarta në aktet nënligjore ekzistuese, shfuqizimi i akteve nënligjore me vendime të qeverisë në vend të nxjerrjes së akteve të reja nënligjore¹² dhe kufizimi i të drejtave të garantuara me ligj me anë të akteve nënligjore janë në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit.

Si përfundim, Avokati i Popullit përmes këtij raporti nxori 16 rekomandime, duke e rekomanduar autoriteteve gjegjëse për veprimet që duhen ndërmarrë, prandaj edhe kjo çështje mori epilog.

Sipas statistikave që kemi siguruar nga Policia e Kosovës, gjatë vitit 2024 në vend kanë ndodhur 17 vrasje. Duke pasur parasysh raportimet e Policisë së Kosovës për numrin e vrasjeve në vend, Avokati i Popullit bën thirrje për ndërmarrjen e masave urgjente për parandalimin e kësaj dukurie.

Shtetet kanë për obligim që të garantojnë që kjo e drejtë të mbrohet me ligj dhe që askush nën juridiksionin e tyre të mos privohet nga jeta në mënyrë arbitrare.

E Drejta e Integritetit Personal

E drejta e integritetit personal është e drejtë e garantuar me nenin 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit gjatë vitit raportues nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me cenimin e kësaj të drejte.

Megjithatë, Avokati i Popullit ka ngritur shqetësimin përkitazi me mosndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Shëndetin Mendor dhe dështimin për miratimin e Projektligjit për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor.

10 <https://oik-rks.org/2021/03/09/raport-me-rekomandime-ex-officion-rasti-nr-6212018-ne-lidhje-me-masat-operative-parandaluese-per-mbrojtjen-e-viktimave-te-dhunes-ne-familje-sipas-ligjit-nr-05l-003-per-mbikeqyrjen-elektronike-t/>

11 Shih linkun: <https://kallxo.com/lajm/lasohet-sistemi-i-hallkave-per-mbikeqyrje-elektronike-kurti-pa-dyshim-do-ta-reduktoje-shume-dhunen-ne-familje/>

12 Udhëzimit Administrativ nr.07/2009 (në Shëndetësi) për shërbimet profesionale të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës, i cili është shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50, datë 23.12.2021.

Avokati i Popullit ka vazhduar të reagojë përkitazi me trajtimin e pavullnetshëm të personave me çrregullime kronike psikike në repartet dhe klinikat psikiatrike pa vendim të gjykatës dhe pa respektuar afatet ligjore. Gjatë vizitave që ka realizuar në Repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) është konstatuar se edhe gjatë vitit raportues ka ndalime të pacientëve për trajtim të pavullnetshëm psikiatrik pa u njoftuar gjykata kompetente si dhe ka vonesa në marrjen e vendimeve nga gjykata për rastet e paraqitura nga UKIP-i në gjykatë.¹³

Lidhur me këtë situatë, përveç Avokatit të Popullit, ka reaguar edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), në raportin për vizitën në Kosovë në vitet 2007, 2010, 2015 dhe së fundmi edhe në raportin për vizitën në Kosovë, i publikuar në shtator 2021.¹⁴

Në të gjitha këto raporte, siç ka konstatuar Avokati i Popullit, ka mungesë të harmonizimit dhe moszbatim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (nenet 75 deri në 96) dhe dispozitave ligjore të Ligjit nr. 05/L -025 për Shëndetin Mendor (nenet 20 deri 24).

Avokati i Popullit vlerëson se është e domosdoshme që autoritetet përgjegjëse të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje, ngase paraqet shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Liria e Lëvizjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 35 e garanton të drejtën e lirisë së lëvizjes¹⁵, të papenguar brenda shtetit dhe jashtë kufijve të tij, në mënyrë të barabartë për të gjithë banorët e shtetit, pa kufizime dhe ndërhyrje të kundërligjshme. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur

në vend rregullohet me ligj.

Legjislacioni i Republikës së Kosovës¹⁶ parasheh lëvizjen e lirë brenda shtetit, udhëtimin jashtë vendit, emigracionin dhe riatdhesimin. Institucionet përgjegjëse kanë obligim që, pa asnjë diskriminim dhe kufizim të paligjshëm, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që lëvizja e lirë në përgjithësi të sigurohet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Liria e lëvizjes nuk është absolute dhe u nënshtrohet disa kufizimeve të vendosura me ligj.

Në bazë të nenit 2 të Protokollit numër 4 të KEDNj-së¹⁷, kufizimet e lirisë së lëvizjes lejohen në kushte të ngjashme të parashikuara në nenin 8 deri në nenin 11 të KEDNj-së; pra kur: janë në përputhje me ligjin; janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për qëllime specifike, përkatësisht; janë në interes të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike dhe të rendit publik; parandalimit të krimit; mbrojtjen e shëndetit dhe moralit; mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

Avokati i Popullit ka regjistruar 3 ankesa që kanë të bëjnë me të drejtën e lirisë së lëvizjes. Dy ankesa janë shpallur të papranueshme, meqë çështja e shtruar në ankesë nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit.¹⁸ Ndërsa për ankesën tjetër¹⁹ janë zhvilluar hetimet në bazë të pretendimit të ankuesit se i është cenuar liria e lëvizjes me ndalimin e hyrjes në Republikën e Kosovës nga autoritetet përkatëse të vendit. Hetimet lidhur me këtë rast kanë përfunduar në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, marrë parasysh se në rastet kur palët nuk i shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion bazuar në legjislacionin në fuqi, Avokati i Popullit mund të refuzojë trajtimin e ankesës, përkatësisht nëse *“të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shtruar nga pala”*. Lidhur me këtë rast Avokati

13 <https://oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-ne-qkuk/>

14 https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-

15 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 35

16 [Ligji nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës](#), [Ligji nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin](#), [Ligji nr. 05/L -015 për Letërnjoftim](#), [Ligji nr. 06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt](#)

17 <https://www.coe.int/sq/web/echr-toolkit/protocole-4>

18 R/826/2024 dhe R/1426/2024

19 R/486/2024

i Popullit ka theksuar se kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të kufizohet vetëm për arsye të ligjshme, si: mbrojtja e sigurisë kombëtare, e rendit publik, parandalimi i krimit dhe mbrojtja e të drejtave të tjerëve. Megjithatë është e rëndësishme që kufizimet të jenë të justifikuar, të bazuara në ligj dhe të sigurojnë një balancë të duhur mes lirisë individuale dhe sigurisë publike, duke respektuar të drejtat e qytetarëve.

Avokati i Popullit konstaton se në Republikën e Kosovës, e drejta e lëvizjes respektohet në përgjithësi. Megjithatë është vërejtur se ka vonesa në trajtim dhe në përgjigje, gjatë trajtimit të kërkesave për leje qëndrimi të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Kosovës.

Mbrojtja e Pronës

E drejta e pronës është e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës. Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar ankesa dhe po ashtu ka hapur raste sipas detyrës zyrtare lidhur me cenimin e së drejtës së pronës.

Njëra ndër çështjet që ishte në fokus të Avokatit të Popullit ka qenë procesi i shpronësimit të pronave të pronarëve në komunat Zubin Potok dhe Leposaviq. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit kishte hapur rast sipas detyrës zyrtare, e po ashtu ka pranuar disa ankesa nga pronarët e pronave që ishin në proces të shpronësimit dhe në këtë drejtim nga afër ka përcjellë zhvillimet procedurale të procesit të shpronësimit të theksuar më sipër.

Në kuadër të aktiviteteve të tij, Avokati i Popullit përveçqë ka zhvilluar komunikime dhe ka kërkuar informacione të hollësishme nga institucionet e Republikës së Kosovës, që ishin kompetente për zhvillimin e procedurës së shpronësimit, ka realizuar takim edhe me disa nga banorët e atyre zonave, nga të cilët ka dëgjuar shqetësimet e tyre rreth kësaj çështjeje. Pas përfundimit të hetimeve në këtë rast, Avokati i Popullit ka publikuar *Opinion në lidhje me procedurën e shpronësimit në komunat Leposaviq dhe*

Zubin Potok dhe të njëjtin ia ka adresuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit përmes këtij opinioni ka paraqitur qëndrimin e përgjithshëm lidhur me procesin e shpronësimit, në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore, për sa i përket mbrojtjes të së drejtës së pronës. Avokati i Popullit ka vlerësuar se institucionet e Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës, kanë autorizime në realizimin e procesit të shpronësimit, si dhe nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik. Avokati i Popullit ka vënë në pah se nuk mund të kontestohet shpronësimi, por mund të kontestohen veprimet procedurale, të cilat duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Ankuesit kishin deklaruar se ishin në dijeni se këto veprime të Qeverisë kishin të bënin me çështjet e sigurisë së përgjithshme (ndërtimin e stacionit të policisë), edhe pse kjo nuk ishte përcaktuar shprehimisht në vendimet që ishin nxjerrë në procedurën e shpronësimit. Avokati i Popullit konsideron se çështjet e sigurisë së përgjithshme e konsumojnë në vete qëllimin legjitim, si kusht fillestar i procesit të shpronësimit.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka hetuar disa ankesa të pranuar kohë më parë, nga disa ankues nga Komuna e Vitisë, pronat e të cilëve kanë kaluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si rezultat i Ratifikimit të Marrëveshjes për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.²⁰ Lidhur me këtë çështje ankuesit pretendonin se prej momentit kur është ratifikuar marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, ata nuk po mund t'i shfrytëzojnë lirshëm pronat e tyre, që kanë qenë objekt i kësaj marrëveshjeje. Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës ka pasur përgjegjësinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe është akoma në fazën e sigurimit të informatave, sepse nuk ka arritur të

²⁰ Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes të cilit është ratifikuar marrëveshja në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 03-V-203, i datës 17 tetor 2009.

mernte përgjigje nga Qeveria rreth veprimeve lidhur me zbatimin e marrëveshjes, por edhe mbrojtjes të së drejtës së pronës së pronarëve, pronat e të cilëve kanë kaluar në administrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Po ashtu gjatë vitit raportues Avokati i Popullit ka pranuar një numër të madh të ankesave për zvarritjen e procedurave gjyqësore, që objekt kontesti kanë çështjet e mbrojtjes së pronës apo pengim posedimit. Lidhur me këto çështje Avokati i Popullit ka realizuar komunikimet me gjykatat e Republikës së Kosovës, të cilat janë përgjigjur se janë në pritje të zhvillimit të procedurave gjyqësore sipas planeve të miratuara nga KGjK-ja. Edhe për kundër të gjitha masave të ndërmarra, vazhdon të jetë shqetësuese zvarritja e procedurave gjyqësore dhe dështimi i sistemit të drejtësisë për të garantuar të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Me qëllim të promovimit sa më shumë të të drejtave të grave për pronë, Avokati i Popullit më 20 nëntor 2024 ka organizuar tryezë dhe ka ftuar ekspertë të fushës, me qëllim të ngritjes së çështjeve të rëndësishme, të cilat do kenë reflektim pozitiv në të drejtat pronësore të grave.

Çështja e legalizimit të objekteve

Në vitin 2023, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime sipas detyrës zyrtare²¹ lidhur me procesin e legalizimit të objekteve pa leje, ndërtimi i të cilave ka përfunduar dhe ndikimin e saj në të drejtat e njeriut, e veçanërisht në gëzimin e papenguar të të drejtave pronësore. Çështja është duke u trajtuar në kontekst të analizimit të faktorëve që ndikojnë në zvarritjen e procedurës së trajtimit të kërkesave për legalizim nga ana e komunave, duke përfshirë mungesën e burimeve njerëzore, mungesën e përgatitjes profesionale për trajtimin e çështjes dhe pengesat ligjore. Po ashtu hetimi synon të vlerësojë sfidat me të cilat ballafaqohen komunat në zhvillimin e procedurës së legalizimit të objekteve, përfshirë ato administrative, ligjore apo financiare. Një aspekt i rëndësishëm i hetimit përfshin analizën komparative të kërkesave ligjore për legalizimin e objekteve dhe ndryshimet

në nivelin e taksave që kanë qenë në fuqi para dhe pas miratimit të Ligjit nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

Sipas informatave që IAP-ja ka pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI), numri i përgjithshëm i aplikimeve të pranuar për legalizim të objekteve pa leje, deri në vitin 2023, në nivel vendi, është 27 301. Deri në vitin 2023 janë lëshuar 11 191 vendime për legalizim dhe 6 279 janë në listë të pritjes. Ndërkaq ndërtimet e regjistruara në kadastër janë 8 601. Të dhënat për vitin 2024 ende nuk janë azhurnuar nga MMPHI-ja. Po ashtu, sipas të dhënave të MMPHI-së, numri i ankesave të pranuar nga ky institucion ndaj vendimeve komunale për legalizimin e objekteve sipas viteve vijon se MMPHI-ja ka pranuar 18 ankesa në vitin 2020, 27 ankesa në 2021, 32 ankesa në 2022, 21 ankesa në 2023 dhe 16 ankesa në 2024.

Të dhënat e deritanishme tregojnë se procesi i legalizimit të objekteve pa leje në vend po vazhdon me ritëm të ngadaltë, siç reflektohet në numrin e përgjithshëm të aplikimeve dhe të ndërtesave të legalizuara. Kjo tregon për vonesat dhe sfidat me të cilat ende përballen komunat dhe autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë vështirësi në përfundimin e këtij procesi në mënyrë sa më efikase. Këto vonesa dhe sfida në procesin e legalizimit të objekteve pa leje kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në kufizimin e ushtrimit të të drejtave pronësore. Ndërtesat që ende nuk janë të legalizuara nuk mund të regjistrohen në regjistrat e pronës në kadastër, çka pengon pronarët nga ushtrimi i plotë i të drejtave të tyre, siç janë shitja, hipotekimi apo gëzimi i benefiteve të tjera të pronësisë.

Të drejtat e autorit dhe pronësia intelektuale

Të drejtat e autorit dhe pronësia intelektuale janë një aspekt thelbësor i mbrojtjes së krijimtarisë intelektuale dhe njëkohësisht e drejtë themelore për mbrojtjen e krijimtarisë artistike. Sipas Kushtetutës së Kosovës, pronësia është e garantuar si një e drejtë themelore për çdo qytetar. Në nenin 46, paragrafi 5, të Kushtetutës potencohet: *“Prona intelektuale mbrohet me ligj.”*

21 Rasti ex-officio 253/2023

Po ashtu të drejtat e autorit janë të mbrojtura edhe me Ligjin nr. 08/l-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili u miratua në vitin 2023. Ky ligj rregullon edhe veprimtarinë e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës. Kjo zyrë ndër të tjerash ka kompetencë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave adekuate për mbrojtjen dhe zbatimin e së drejtës së autorit si dhe udhëheq dhe koordinon Task-Forcën kundër Piraterisë. Po ashtu ajo ka rolin e promovimit dhe ndërgjegjësimit të institucioneve dhe të publikut lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave autoriale.

Për sa u përket të drejtave të autorit, IAP-ja gjatë vitit 2024 nuk ka marrë ndonjë ankesë me pretendim për shkelje të kësaj të drejte.

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën 2024, Kosova ka pasur përparim në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale. Në lidhje me miratimin e Ligjit të ri për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, raporti thekson: “Ligji i miratuar synon përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Direktivat e BE-së për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe licencimin shumëterritorial të të drejtave në veprat muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm dhe për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Tregun e Vetëm Digjital.”²²

Sipas verifikimit në ueb-faqen zyrtare të Gjykatës Komerciale të Kosovës²³ vërehet se gjykata gjatë vitit 2024, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe në Dhomën e Shkallës së Dytë ka shqyrtuar dhe publikuar 12 aktgjykime lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të përafërta. Raporti i Progresit për vendin për 2024 thekson gjithashtu: “Gjykata Komerciale e specializuar në çështjet komerciale dhe gjykata që ka mandat të zgjidhë rastet dhe

kontestet në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe të drejtave të autorit, kanë dëshmuar se janë efikase në përpunimin e lëndëve.”²⁴

Ndërkaq pronësia intelektuale, e cila përfshin të drejtat mbi krijimet dhe shpikjet, është e rregulluar sipas Ligjit nr. 08/L-059 për Patentat dhe Ligjit nr. 08/l-075 për Markat Tregtare. Sipas legjislacionit në fuqi, Agjencia për Pronësi Industriale, si organ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimit të origjinës, treguesve gjeografikë dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës.

Edhe pse Raporti Vjetor për vitin 2024 i Agjencisë për Pronësi Industriale²⁵ ka prezantuar disa përparime, si: rritjen e numrit të ekzaminimeve dhe zvogëlimin e kohës së regjistrimit, forcimin e kapaciteteve të stafit dhe digjitalizimin e shërbimeve, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2024 thekson nevojën për ristrukturim dhe shtimin e stafit të agjencisë për të përmirësuar administrimin e të drejtave të pronësisë industriale. Po ashtu raporti thekson nevojën për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi; miratimin e legjislacionit për zbatimin e ligjeve të pronësisë industriale si dhe nevojën për forcimin e bashkëpunimit me Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelektuale.²⁶

Në raport me ankesat e pranuar në IAP gjatë vitit 2024²⁷, të njëjtat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me cenimin e të drejtave të autorit apo të pronësisë intelektuale, por lidhen me ndërrimin e destinimit për dhënie të shfrytëzimit të pronës komunale në Komunën e Fushë Kosovës, ankesë kjo e cila është parashtruar nga kryetari i Organizatës për Kultivimin e Traditave Kulturore Shqiptare

22 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Kosovo-2024-Report-SQ.pdf> , fq.66

23 <https://komerciale.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/?r=M>

24 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Kosovo-2024-Report-SQ.pdf> , fq.67.

25 <https://kipa.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,10,197>

26 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Kosovo-2024-Report-SQ.pdf> , fq.12 dhe 66

27 R.nr.1153/2024 dhe R.nr.1043/2024

dhe ankesa tjetër e cila ndërlihet me dhënien me qira të disa objekteve publike në territorin e Komunës së Shtërpçës.

E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë

E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës²⁸ si dhe me aktet e tjera ndërkombëtare, si: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike²⁹ dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.³⁰

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e radhit këtë të drejtë si një ndër të drejtat themelore dhe neni 5 i KEDNj-së, ku përcakton rëndësinë e parandalimit dhe mbrojtjes nga privimi arbitrar dhe i pajustificuar nga liria.

Avokati i Popullit, përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), ka vizituar rregullisht dhe pa paralajmërim vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të vlerësimit të respektimit të të drejtave të njeriut, duke hapur kutitë e ankesave, si dhe duke zhvilluar intervista me personat e ndaluar. Përgjithësisht kjo e drejtë respektohet në Republikën e Kosovës, janë ndërtuar kapacitete dhe standarde që garantojnë mbikëqyrje të rasteve të privimit nga liria, mbajtjes në ndalim dhe vuajtje të dënimit apo në çfarëdo forme mbajtje në qendrat korrektuese dhe edukuese në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit përmes MKP-së vazhdimisht monitoron vendet e ndalimit ku mbahen dhe trajtohen personat për shkak të sëmundjeve mendore, personat e ndaluar për shkak të hyrjeve të paligjshme në Republikën e Kosovës dhe pasqyron gjetjet në raportet e hartuara pas vizitave.

Gjatë vitit raportues ankesat e pranuar kryesisht kanë të bëjnë me përdorimin e forcës gjatë ndalimit dhe arrestimit. Çdo rast i raportuar te Avokati i Popullit është hetuar dhe në asnjë rast nuk është konstatuar ndonjë tejkallim i përdorimit të forcës.

28 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

29 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 9.

30 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 5.

Të gjitha rastet e privimit nga liria me ndalim dhe paraburgim të qytetarëve nga komuniteti serb, kur ka pasur informatë, MKP-ja i ka vizituar dhe intervistuar me qëllim që të sigurohet se janë respektuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Avokati i Popullit rithekson obligimin e autoriteteve përgjegjëse që të garantojnë sigurinë e personave të cilët janë nën përkujdesjen e tyre dhe obligimin e tyre për ndërmarrjen e veprimeve efektive hetimore dhe të pavarura me qëllim të ndriçimit të rasteve.

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm është një indikator i veçantë i sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Reflekton nivelin e drejtësisë dhe barazisë brenda një sistemi gjyqësor dhe lidhet ngushtë me besimin publik në institucionet e drejtësisë. Si indikator i veçantë, kjo e drejtë shërben për të matur integritetin dhe paanshmërinë e gjykatave dhe për t'i garantuar çdo individ një proces të drejtë gjyqësor, të pavarur nga ndikimet e jashtme. Kjo e drejtë garantohehet përmes pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve; barazisë para ligjit për të gjithë qytetarët; transparencës dhe qasjes publike; mbrojtjes efektive ligjore; si dhe të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm është garantuar me Kushtetutë, me nenin 31 dhe nenin 6 të KEDNj-së [E drejta për një proces të rregullt]. Nën garancitë kushtetuese, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, në vendin tonë po ashtu është rregulluar edhe me ligje të tjera bazike.

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm nuk kufizohet vetëm në fushën gjyqësore, por përfshin gjithashtu proceset administrative, pra shtrihet edhe mbi organet e administratës shtetërore. Kjo e drejtë përfshin trajtimin e rasteve të qytetarëve nga organet

e administratës shtetërore (si p.sh. ministritë, agjencitë, ose autoritetet e tjera publike), duke garantuar që qytetarët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme nga këto organe administrative dhe mundësinë e tyre për të shfrytëzuar të drejtën e ankesës apo për të kundërshtuar çdo vendim që mund të ndikojë në të drejtat e tyre.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka publikuar 47 raporte me rekomandime, në të cilat ka konstatuar se ankuesve u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Avokati i Popullit vlerëson hartimin e Planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi³¹, mirëpo, marrë parasysh numrin e lartë të ankesave që vazhdon të pranojë, është tregues që situata nuk ka përmirësim të ndjeshëm.

Mbetet shqetësues fakti se nuk ka pasur qasje të duhur nga autoritetet kompetente që të shtynjë përpara nismën ligjore për krijimin e një mekanizmi ligjor, përmes së cilit ankuesit do të mund të ankohen për zvarritje të procedurës, për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit, që është edhe rekomandim i Avokatit të Popullit, i adresuar qysh në vitin 2018.³² Gjithashtu kjo mund të shihet edhe si mungesë e mjeteve efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore. Avokati i Popullit e vlerëson si cenim për sundimin e ligjit kur brenda rendit ligjor vendor nuk është paraparë procedurë për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore.

Shqetësuese për Avokatin e Popullit janë deklaratat dhe kritikrat që i bëhen gjyqësorit (gjykatave dhe prokurorive) nga përfaqësues të Qeverisë, deputetë të Kuvendit, grupe të ndryshme të interesit, OJQ-të dhe mediat. Avokati i Popullit i konsideron ndërhyrje në sistemin e drejtësisë prononcimet e tyre të përditshme, qoftë për rastet që janë duke u trajtuar nëpër gjykata dhe prokurori për vendimet gjyqësore, për performancën

e gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo për mosveprimet e tyre. Kjo ndërhyrje cenon rëndë pavarësinë e gjyqësorit dhe për pasojë ka rënien e besimit të qytetarëve në drejtësi.

Avokati i Popullit thekson se sipas Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare, pavarësia e gjyqësorit, si pushtet i ndarë nga ai ekzekutiv dhe legjislativ, është një nga komponentët kryesorë të shtetit të së drejtës. Në këtë drejtim, vendi ynë ka marrë obligime ndërkombëtare për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe pavarësia e gjykatave nga ndërhyrjet e jashtme, vendimmarrje të bazuar në ligj dhe pa presion është e domosdoshme për të mbrojtur këto të drejta dhe për të garantuar barazinë para ligjit për të gjithë qytetarët.

Avokati i Popullit nga 300 ankesa të parashtruara nga qytetarët për zvarritje të procedurës gjyqësore, 120 prej tyre i ka hapur si raste për hetim, ndërsa të tjerat i ka refuzuar si të papranueshme, për shkak se nuk i kanë plotësuar kushtet procedurale për hetim dhe nuk janë në kompetencë të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në cilësinë e institucionit të pavarur dhe me qëllim të përmirësimit të të drejtave të njeriut në procedura gjyqësore, ka kompetencë të veçantë dhënien e rekomandimeve të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste apo në procedura që zhvillohen në gjykata.

Duke vëzhguar ndër vite ankesat nga palët dhe problematikat e tjera, Avokati i Popullit konsideron se kërkojnë trajtim të veçantë nga institucionet përgjegjëse çështjet si: (i) E drejta në gjykim në kohë të arsyeshme; (ii) E drejta e të akuzuarit në mbrojtje; (iii) Kriteret e caktimit të masës së paraburgimit dhe dënimit alternative; (iv) Pranimit i fajësisë në procedurë penale; dhe (v) Trajtimi i personave me çrregullime mendore.

Lidhur me temën e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Avokati i Popullit

31 https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK_Plani_strategjik_per_permiresimin_qasjes_ne_drejttesi_2022_2025_lidhur_me_efikasitetin_dhe_prioritizimin_lendeve_brenda_sistemit_gjyqesor.pdf

32 <https://oik-rks.org/2018/03/29/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1292018/>

duke e parë këtë problematikë që e përcjellë gjykimin e lëndëve në Kosovë, në vitin 2018 i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës nxjerrën e ligjit përkatës për përcaktimin e mjeteve efektive juridike për kompensimin në rast të shkeljes së të drejtave gjyqësore në kohë të arsyeshme. Avokati i Popullit rikujton se ashtu siç i trajton edhe rastet që paraqiten në IAP, kur shikohet “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore sipas GjEDNj-së, duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, bazuar në katër aspekte themelore: (i) ndërlikueshmërinë e rastiit; (ii) sjellja e palëve në procedurë; (iii) sjellja e gjykatës kompetente ose e autoriteteve të tjera publike; si dhe (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon pala në kontest.

Për sa i përket së drejtës së të akuzuarit në mbrojtje, Avokati i Popullit rikujton se në Opinionin e tij A.nr 230/2023 lidhur me të drejtën e të pandehurit për t’u mbrojtur me ndihmën e mbrojtësit, ka theksuar se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të akuzuarit i lejohet që të komunikojë lirisht me mbrojtësin e tij. Avokati i Popullit thekson se GjEDNj-ja përcakton parimet përkatëse dhe thekson në rastin *Salduz kundër Turqisë* (vendim i 27 nëntorit 2008, paragrafin 55), se me qëllim që e drejta për një proces të drejtë gjyqësor të jetë mjaftueshëm “*praktike dhe efektshme*”. Neni 6, paragrafi 1, i KEDNj-së kërkon që, si rregull, “*kontakti me avokatin duhet të sigurohet që në fillim të marrjes në pyetje nga policia të një të dyshuari, përveç rasteve kur, sipas rrethanave të veçanta të një çështje, demonstron se ekzistojnë arsye detyruese për kufizimin e kësaj të drejte*.” Edhe atje ku të tilla arsye detyruese mund të justifikojnë në mënyrë përjashtuese mohimin e kontaktit me avokatin, ky kufizim – çfarëdo qoftë justifikimi për të – nuk duhet të paragjykojë të drejtat e të akuzuarit sipas Nenit 6 të KEDNj-së. Të drejtat e mbrojtjes, në parim, janë të paragjykuara në mënyrë të pakthyeshme kur për dënimin përdoren deklarata inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa praninë e avokatit.

Për sa i përket kritereve të caktimit të masës së paraburgimit dhe dënimeve alternative,

Avokati i Popullit thekson se sipas praktikës së GjEDNj-së, janë tri kritere themelore që duhen ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë është i ligjshëm dhe jo arbitrar, më konkretisht: (i) së pari duhet të ekzistojë “*dyshimi i bazuar*” që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale (shih rastin e GjEDNj-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, [DHM], Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 184); (ii) qëllimi i privimit të lirisë “është që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale” (shih *Ostendorf kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 7 marsit 2013, paragrafi 68) dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “*për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse*” (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 185); (iii) privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 186).

Avokati i Popullit duke iu referuar raportit të OSBE-së (shih Raportin e Monitorimit)³³, vërejtji nga statistikat e rasteve të monitoruara që ekziston numër i madh i personave që janë paraburgosur. Rrjedhimisht Avokati i Popullit konsideron se arsyet për shqiptimin e masës së paraburgimit duhet të shikohen në këndvështrim të arsyeshmërisë së shqiptimit të tyre, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me “*dyshimin e bazuar*” dhe “*funksion të zbatimit të procedurës penale*”.

Avokati i Popullit, për sa u përket dënimeve alternative, konsideron se çështja e dënimeve alternative është paraparë me standarde evropiane dhe me legjislacion, për të shmangur kufizimin e lirisë me burg për kryerësit e veprave të vogla penale dhe për t’i humanizuar dënimet duke u mundësuar atyre rehabilitim pa u fokusuar vetëm në dënim, dhe njëkohësisht t’i mundësojë shtetit të monitorojë kryerësin me infrastrukturën e nevojshme, pa pasur nevojë për mbipopullim të burgjeve apo shpenzime të mëdha për mbajtjen e personave në burg. Në rastin *Affaire Torreggiani et Autres kundër Italisë* nga GjEDNj-ja është vendosur: “*Për t’i bërë dënimet*

33 <https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/556431.pdf>

alternative të besueshme ndaj dënimeve me burgim afatshkurtër, është e nevojshme të sigurohet zbatimi efikas i tyre.[...].”

Lidhur me pranimin e fajësisë në procedurë penale, Avokati i Popullit konsideron se GjEDNj-ja ka përcaktuar se efekti i marrëveshjes për pranimin e fajësisë në procedurën penale përbën, në thelb, një heqje dorë nga një sërë të drejtash procedurale (shih *Navalnyy dhe Ofitserov kundër Rusisë*, 2016, paragrafi 100), por çdo vendim për të pranuar marrëveshjen e fajësisë duhet të shoqërohet nga kushtet si në vijim: (i) marrëveshja duhet të pranohet në dijeni të plotë të fakteve për rastin dhe pasojat juridike dhe në mënyrë vërtet vullnetare; (ii) përmbajtja e marrëveshjes dhe drejtësia e mënyrës në të cilën është arritur ajo mes palëve duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të mjaftueshëm gjyqësor (*Natsvlshvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*, 2014, paragrafët 91-92). Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishëm faktin e sigurimit të njoftimit të saktë dhe të detajuar për të pandehurin në mënyrë që ai të jetë i njoftuar për çdo pasojë të mundshme të pranimit të fajësisë dhe kur shqyrtohet kjo marrëveshje nga gjykata, të sigurohet që standardet procedurale janë respektuar nga autoritetet publike, por edhe nga avokati i palës.

Në fund, për sa i përket trajtimit të personave me çrregullime mendore, Avokati i Popullit thekson se lidhur me masat mbrojtëse, ka një mungesë qartësie në lidhje me dispozitat ligjore që rregullonin vendosjen e pavullnetshme dhe trajtimin e pavullnetshëm të pacientëve në institucionet psikiatrike. Është veçanërisht shqetësuese që, në praktikë, gjykatat ende nuk janë të përfshira në procedurat e vendosjes së pavullnetshme. Problemi i identifikuar në praktikë është zbatimi i garancive që përcaktohen me Ligjin për Procedurë Jokontestimore, në raport me ndalimin e pavullnetshëm, propozimin për caktimin e përfaqësuesit ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të garantuara me ligj. Kjo vërehet sidomos me propozimin e caktimit të përfaqësuesit ligjor nga radhët e avokatëve për mbrojtjen e interesave të pacientit,

siç përcaktohet me Ligjin për Shëndetin Mendor, përkatësisht nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.3, dhe nenin 85 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Sipas Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, Avokati i Popullit pranon ankesa kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka kompetencën për t'ia dërguar autoritetit kompetent ankesën që ka pranuar nga qytetarët ndaj një gjyqtari ose prokurori, kompetencën për t'i kërkuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës fillimin e procedurës disiplinore dhe kompetencën për të ushtruar ankesë te Gjykata Supreme, në rastet e përcaktuara me ligj.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar 12 ankesa. Lidhur me këtë çështje, pas shqyrtimit të këtyre ankesave, 8 ankesa janë shpallur të papranueshme, për shkak se nga përmbajtja e tyre është konsideruar se ato janë parashtruar për shkak të pakënaqësive të palëve me vendimet gjyqësore dhe nuk janë parashtruar për iniciimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ndërsa Avokati i Popullit, në përputhje me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në dy raste i ka përcjellë ankesat te autoriteti kompetent, ka pranuar vendimet brenda afatit të paraparë me ligj dhe i ka njoftuar ankuesit për vendimet që ka pranuar. Dy raste të tjera janë përcjellë tek autoritetet kompetente dhe janë në fazën e hetimeve për veprime të më tutjeme.

E Drejta për Mjete Juridike

E Drejta për Mjete Juridike është e garantuar në nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku parashihet: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat dhe interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*³⁴

KEDNj-ja në nenin 13 zgjeron shtrirjen e mbrojtjes edhe në aspekt të zgjidhjes efektive

34 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

duke theksuar: “Çdo kush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.”

Çdo qytetar mund t'i shfrytëzojë mjetet juridike kundër çdo vendimi të nxjerrë nga autoritetet publike shtetërore. Shfrytëzimi i mjetit juridik është një mundësi e mirë që autoritetet publike shtetërore t'i rishqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet, lëshimet eventuale që mund të ndodhin gjatë zhvillimit të procedurave të ndryshme. Përcaktimi i mjeteve juridike dhe i afateve ligjore mundësuan parandalimin e padrejtësive, shpërdorimit e pushtetit dhe garanton sundimin e ligjit.

Njëra ndër sfidat e sistemit gjyqësor mbetet zbatimi i standardeve për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit, interpretimi i të drejtave në fjalë duhet të bëhet në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Nga ana e gjykatave të rregullta referimet në praktikën e GjEDNj-së gjatë arsyetimit të vendimeve të tyre vazhdojnë të jenë të pakta.

Sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNj-së, është përcaktuar: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga një gjykatë ..., e krijuar me ligj.” Përveçse gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, si kërkesë themelore e cila ka për qëllim të parandalojë organizimin e sistemit gjyqësor mbi baza të paqëndrueshme dhe të paparashikueshme, gjykata duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme, përveç këtyre garancive institucionale, kemi edhe garancitë procedurale, siç janë: efektiviteti i procedurës; barazia e procedurës dhe transparenca e procedurës. Qytetarët e Republikës së Kosovës ende vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në sistemin

gjyqësor, sidomos me kohëzgjatjen apo zvarritjen e procedurave gjyqësore.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar 254 ankesa me pretendimin për shkelje të së drejtës për mjete juridike, për shkak të mospërgjigjes brenda afatit në ankesat e parashtruara, 118 prej të cilave janë hapur për hetim.

Nga analizimi i rasteve³⁵ të hapura del se në raport me procedurat gjyqësore, kjo e drejtë cenohet për shkak të kohëzgjatjes (zvarritjes) së procedurës së shqyrtimit, që ndikon në cenimin e së drejtës për zgjidhje efektive. Ndërsa në raport me procedurat administrative konstatohet se cenimi më i shpeshtë i kësaj të drejte vjen si rezultat i heshtjes (mospërgjigjes) së administratës, ndërsa mospërgjigjja në kërkesat e parashtruara rezulton me mosrespektimin e pritëshmërive legjitime përkundër obligimit ligjor lidhur me afatin për përfundimin e procedurës administrative sipas Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.³⁶

Avokati i Popullit vazhdimisht ka ngritur shqetësimin lidhur me shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, problematikën lidhur me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe mungesën e përmbushjes së detyrimit të autoriteteve publike për t'u përgjigjur kërkesave në procedurat administrative. Gjithashtu Avokati i Popullit ka kërkuar nga autoritetet kompetente që të marrin të gjitha masat me qëllim të zgjidhjes së kësaj problematike, e cila nuk mund të arrihet pa një strategji të koordinuar.

E Drejta e Privatësisë

Në një epokë ku informacioni dhe të dhënat personale ndihmojnë në përcaktimin e shumë aspekteve të jetës së përditshme, mbrojtja e privatësisë është bërë një çështje kyçe për ruajtjen e dinjitetit dhe lirisë individuale. E Drejta e Privatësisë ndërthet në

35 R/2/2024, R/54/2024, R/86/2024, R/94/2024, R/96/2024, R/121/2024, R/124/2024, R/126/2024, R/176/2024, R/178/2024, R/185/2024, R/200/2024, R/216/2024, R/231/2024, R/234/2024, R/244/2024, R/244/2024, R/271/2024, R/274/2024, R/291/2024, R/295/2024, [...]

36 Neni 98 “1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...”

vete të drejtën për jetën private, jetën familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera. Në vendin tonë, kjo e drejtë garantohet me Kushtetutë, me nenin 36, që përcakton se mbledhja, ruajtja, qasja, korigjimi dhe shfrytëzimi i të dhënave personale rregullohet me ligj. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton qartë qëllimin dhe parimet e përpunimit të të dhënave personale. Ky ligj i përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. E Drejta e Privatësisë garantohet edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj).³⁷

Lidhur me të drejtën e privatësisë dhe pretendimeve për shkelje të kësaj të drejte, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2024 ka regjistruar 8 raste. Nga to, 7 janë ankesa individuale, ndërsa 1 është rast i regjistruar sipas detyrës zyrtare. Nga 7 ankesat individuale, 5 janë shpallur të papranueshme si më poshtë:

- 2 janë shpallur të papranueshme, sepse nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi;
- 1 ankesë është shpallur e papranueshme, sepse nga shënimet e paraqitura ka rezultuar se ankesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit;
- 2 ankesa janë shpallur të papranueshme, sepse nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se çështja e shtruar nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

Njëra nga ankesat individuale e hapur për hetim ka të bëjë me pretendimet për shkelje të privatësisë me rastin e publikimit të deklarimit të pasurisë së anëtarëve të familjeve të zyrtarëve publikë. Hetimi dhe

hulumtimi për çështjen e ngritur është ende duke vazhduar.³⁸

Tjetra ankesë ka të bëjë me pretendimet për shkelje të privatësisë me rastin e kërkesës së personave të autorizuar të Policisë së Kosovës, që sipas autorizimit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ta marrin telefonin e ankuesit, meqë ankuesi ishte në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë dhe ishte nën hetime për një vepër penale sipas legjislacionit të Kosovës. Hetimi dhe hulumtimi për çështjen e ngritur është ende duke vazhduar.³⁹

Ndërsa rasti i hapur sipas detyrës zyrtare ka të bëjë me ndikimin e inteligjencës artificiale në të drejtat e njeriut. Hetimi dhe hulumtimi për çështjen e ngritur është ende duke vazhduar.⁴⁰

Avokati i Popullit thekson se mbrojtja e së drejtës së privatësisë dhe siguria e të dhënave personale janë çështje të rëndësishme për garantimin e dinjitetit dhe lirisë individuale. Ndërsa Kushtetuta dhe ligji ofrojnë garanci dhe mbrojtje të fortë, zbatimi i tyre mbetet i rëndësishëm për të siguruar se të drejtat e individëve nuk shkelen nga ndërhyrje të paautorizuara. Qëllimi i kufizimeve në privatësi duhet të jetë gjithmonë i ligjshëm, i justifikuar, proporcional dhe në përputhje me interesin e përgjithshëm të publikut.

Në tryezën e organizuar nga Avokati i Popullit në komunën e Shtërpçës, më 26 qershor 2024, është informuar nga pjesëmarrësit në takim për një rast kur autoritetet publike, përmes publikimit të listave të përfituesve të ndihmave për qytetarët në nevojë, janë publikuar të dhënat personale dhe diagnozat e sëmundjeve për përfituesit e këtyre ndihmave. Avokati i Popullit këtë çështje e ka vlerësuar si shqetësuese dhe është duke e hetuar rastin.

Më 10 dhjetor 2024, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën: “Të Drejtat e Njeriut në Epokën e Inteligjencës Artificiale”, e organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi në bashkëpunim me Institutin për Teknologji dhe Shoqëri, ku u diskutua

37 KEDNj, neni 8.

38 R/438/2024

39 R/1418/2024

40 R/932/2024

për ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të drejtat e njeriut. Konferenca u përmyll duke e theksuar rolin e institucioneve publike në përshtatjen me teknologjitë moderne për qeverisje transparente dhe të përgjegjshme, ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të drejtat digjitale dhe sfidat që lidhen me keqinformimin dhe rreziqet e të dhënave të pasakta në sistemet e IA-së. Po ashtu u theksua nevoja për t'i integruar parimet e privatësisë qysh në fazat e hershme të zhvillimit të teknologjive, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë për sfidat dhe mundësitë që sjell IA-ja.

Më 19 dhjetor 2024, Avokati i Popullit mori pjesë në seminarin rajonal në temën "Horizontet digjitale: Mbrojtja e të dhënave në epokën e inovacionit", e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe partnerët e tij rajonal në bashkëpunim me Western Balkans Fund dhe Bashkimin Evropian, ku u diskutua për mbrojtjen e të dhënave personale në procesin e digjitalizimit të administratës publike, për nevojën për qasje të të gjithëve, pa dallim, në shërbimet e administratës publike që ofrohen në platformat digjitale/online. Po ashtu u diskutua për mundësitë për ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

Avokati i Popullit vëren se gjatë vitit 2024, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), si institucion kompetent për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka adresuar dhe trajtuar çështjet që lidhen me këtë të drejtë, si dhe ka zhvilluar aktivitete për informimin e institucioneve publike e private dhe publikun e gjerë.⁴¹ Avokati i Popullit e vlerëson se për sa i përket gjendjes në përgjithësi për të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, ka

përmirësime, por mbetet ende shumë punë për t'u bërë në të kuptuarit e kësaj të drejte.

E Drejta e Martesës dhe Familjes

Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtën e martesës dhe familjes dhe se në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.⁴² Më tej Kushtetuta përcakton se martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.⁴³ Gjithashtu, Kushtetuta garanton se familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.⁴⁴

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 22 ankesa lidhur me të drejtën e martesës dhe familjes. Nga ky numër, 12 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë kanë qenë jashtë juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk kanë pasur shkelje të të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike, ndërsa 10 ankesa janë proceduar për hetime të mëtejme.

Bazuar në analizën e rasteve të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, ankesat kanë të bëjnë me: vrasjen e një gruaje në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj⁴⁵; çështjen e krijimit të lehtësirave për prindin vetushqyes në rritjen e fëmijëve dhe jetesës së dinjitetshme⁴⁶; kërcënimin e ish-bashkëshortes nga ish-bashkëshorti gjatë realizimit të kontaktit me fëmijën e tyre në Qendrën për Punë Sociale⁴⁷; zvarritjen e procedurës në çështjen e adoptimit të fëmijës⁴⁸; marrjen e kundërligjshme të fëmijës nga ish-bashkëshorti⁴⁹; besimin e fëmijës⁵⁰; çështjen e lejes së qëndrimit të

41 <https://aip.rks-gov.net/java-e-mbrojtjes/>

42 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 1.

43 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 2.

44 Kushtetuta, neni 37, paragrafi 3.

45 Ex - officio nr. 563/2024

46 Ex - officio nr. 610/2024

47 Ankesa nr. 762/2024

48 Ankesa nr. 1239/2024 dhe Ankesa 1091/2024

49 Ankesa nr.33/2024

50 Ankesa nr.144/2024

përkohshëm⁵¹; shkurorëzimin⁵² dhe besimin e fëmijëve dhe alimentacion.⁵³

Në kontekstin e së drejtës së martesës dhe familjes, pas hetimeve të rasteve gjatë vitit raportues, është e qartë se një nga problemet kryesore mbetet realizimi i kontaktimit të fëmijëve kur prindërit jetojnë ndaras. Ky problem, i shoqëruar shpesh nga prishja dhe acarimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore midis ish-bashkëshortëve, ka krijuar pengesa të konsiderueshme për prindin që nuk jeton me fëmijët. Shpesh njërit prind i mohohet kontakti me fëmijët nga tjetri, duke u shkaktuar dëme psikologjike fëmijëve dhe duke përkeqësuar procesin e zhvillimit të marrëdhënieve të shëndetshme mes tyre dhe prindërve.

Për sa u përket rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit filloi hetimet zyrtare lidhur me çështjen e krijimit të lehtësirave për prindin vetushqyes, veçanërisht në kontekstin e rritjes së fëmijëve dhe sigurimit të një jetese dinjitoze. Roli i prindit vetushqyes është shumëdimensional dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme për të siguruar që fëmijët të kenë mundësi të rriten dhe të zhvillohen në një mjedis të sigurt, të shëndetshëm dhe mbështetës, përkundër mundësive të kufizuara ekonomike. Andaj, Avokati i Popullit është në proces të analizimit të dispozitave përkatëse ligjore lidhur me çështjen dhe marrjes së informacioneve të nevojshme për të parë në aspektin praktik nga institucionet shtetërore se cilat beneficione i ofrojnë për prindin vetushqyes. Më pas, varësisht nga të gjeturat, mund të propozohet ndonjë nismë për ofrimin e beneficioneve për prindin vetushqyes.⁵⁴

Duke marrë shkas nga rasti tragjik i vrasjes së një gruaje, viktimë e dhunës në familje, e vrarë nga bashkëshorti i saj brenda objektit të Qendrës për Punë Sociale, Avokati i Popullit filloi hetimet zyrtare lidhur me kushtet e sigurisë gjatë trajtimit të palëve në Qendrat për Punë Sociale me theks të veçantë realizimit të kontakteve të prindërve

me fëmijët e tyre. Siguria e Qendrave për Punë Sociale në realizimin e kontakteve të palëve është një aspekt shumë i rëndësishëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për kontakte që lidhen me fëmijët dhe prindërit, si dhe për situata që mund të përfshijnë ndarje ose kushte të tjera të ndërlikuara familjare. Këto qendra shpesh ofrojnë shërbime për monitorimin e vizitave, mbikëqyrjen e takimeve të fëmijëve me prindërit, dhe mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve gjatë ndërveprimeve të tilla. Andaj, Avokati i Popullit është në proces të hetimit dhe marrjes së informacioneve nga Qendrat për Punë Sociale përkitazi me çështjen e sigurisë gjatë trajtimit të palëve në objektet e tyre.⁵⁵

Avokati i Popullit ka mirëpritur miratimin e Ligjit nr. 08/l-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili ka për qëllim rregullimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve publike dhe private që i ofrojnë këto shërbime. Miratimi i këtij ligji është hap i rëndësishëm drejt reformës së shërbimeve sociale, duke u fokusuar në zhvillimin e shërbimeve të familjes dhe atyre me bazë në komunitet, zgjerimin e formave të mbrojtjes dhe zhvillimit të strehimit familjar për të rinjtë pas moshës 18-vjeçare, si dhe krijimin e mundësisë për “Jetesën e pavarur të mbikëqyruar”, që mund të vazhdojë deri në moshën 26-vjeçare⁵⁶, pas një rivlerësimi të nevojave të individëve.

Fëmijët pa prindër, ata që janë nën përkujdesje sociale apo të vendosur në familje strehuese, përballen me nevoja të mëdha për mbrojtje, kujdes dhe mbështetje për zhvillimin e tyre emocional, fizik dhe social. Pas mbushjes së moshës 18-vjeçare, këta fëmijë shpesh përballen me vështirësi të shtuar, pasi kalojnë në një fazë të re të jetës pa mbështetje të qëndrueshme. Pavarësisht përpjekjeve të shtetit për t’u ofruar ndihmë, është e qartë se ka ende nevojë për përmirësime të mëdha në sistemin e mbrojtjes sociale dhe në

51 Ankesa nr. 1350

52 Ankesa nr.1329

53 Ankesa nr. 560/2024

54 Ex - officio nr. 610/2024

55 Ex - officio nr. 563/2024

56 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 28

ofrimin e mbështetjes, për të siguruar kushte më të mira dhe mundësi për zhvillimin e këtyre fëmijëve, sidomos pas kalimit të moshës 18-vjeçare, sipas rrethanave e caktuar me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, që kjo mbështetje të vazhdojë të ofrohet deri në moshën 26-vjeçare. Një sfidë e rëndësishme që mbetet është numri i kufizuar i familjeve strehuese për fëmijët pa kujdes prindëror. Aktualisht, vetëm 36 familje strehuese janë aktive në 17 komuna të Kosovës⁵⁷, që do të thotë se shumica e komunave nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor për të përcaktuar të paktën tri (3) familje strehuese për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilat duhet të jenë të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të ministrisë përkatëse. Gjithashtu, aktet nënligjore të parapara nga Ligji nr. 08/I-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, të cilat janë një nga indikatorët e zbatimit të tij, ende nuk janë miratuar në tërësi. Këtu përfshihen veçanërisht aktet nënligjore që lidhen me organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Kujdes Ditor dhe Qendrave për Pranim.⁵⁸ Mosmiratimi i këtyre akteve pengon zbatimin e plotë të ligjit, ndërkohë që gjatë këtij viti janë miratuar vetëm pesë akte nënligjore për zbatimin e tij.⁵⁹

Për më tepër, Avokati i Popullit thekson faktin se Ligji për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme përcakton të drejtën për ndihmë materiale, si një masë mbrojtjeje për këta fëmijë. Megjithatë ky ligj nuk ofron një mbrojtje të plotë për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, por ua njeh këtë të drejtë vetëm fëmijëve që kanë aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore ose shqisore dhe të cilët janë të paaftë të kryejnë veprimet e përditshme jetësore pa ndihmën e një kujdestari.

Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë në Kosovë garantohet me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 9 të KEDNj-së dhe me Ligjin nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.

Statusi juridik i bashkësive fetare është i rregulluar në mënyrë joadekuate, sepse ligji ekzistues nuk lejon rregullimin e kësaj fushe. Puna për ndryshimin e ligjit ekzistues dhe miratimin e Ligjit të ri për Lirinë Fetare ende nuk ka përfunduar, megjithëse përpjekjet për ta bërë këtë kanë vazhduar për më shumë se dhjetë vjet. Avokati i Popullit gjatë ushtrimit të mandatit të tij ka identifikuar nevojat dhe problemet e besimtarëve dhe komuniteteve fetare dhe në bazë të këtyre njohurive, prej vitesh në raportet vjetore vazhdimisht ka vënë në dukje nevojën e rregullimit të kësaj fushe, përkatësisht domosdoshmërinë e miratimit të këtij ligji.

Ndër çështjet që kanë vazhduar të jenë shqetësuese edhe këtë vit, është çështja e mbajtjes së shamive në shkolla, e cila çështje mbetet ende e parregulluar. Në lidhje me këtë çështje, Avokati i Popullit hapi një hetim sipas detyrës zyrtare⁶⁰, pasi mori informacion se një nxënëse në një shkollë të mesme në Pejë nuk ishte lejuar të vijonte mësimin nga drejtori i shkollës, për shkak se filloi të mbante shami. Për zgjidhjen e këtij rasti janë bërë përpjekje nga përfaqësues të Avokatit të Popullit, si dhe nga institucionet dhe organizatat e tjera relevante, ashtu që nxënësjë është lejuar të rifillonte mësimin. Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2023 vuri në pah mendimin e Avokatit të Popullit se Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, nr. 06/2014, nuk përbën bazë për ndalimin e mbajtjes së shamisë, por se praktika të tilla duhet të rregullohen me ligj dhe të

57 Takimi avokues “Qëndrueshmëria e shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë”, i mbajtur më 13 dhjetor 2024, i organizuar nga Organizata për Fëmijët pa Përkujdesje Prindërore.

58 Shih nenet 61 dhe 62 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

59 Rregullorja nr.13/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim rezidencial; Rregullorja nr. 09/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim familjar; Rregullorja nr.10/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për adoptim; Rregullorja nr.08/2024 për organizimin dhe funksionimin e këshillit profesional për shërbime sociale dhe familjare.

60 Ex officio R.nr.878/2024

harmonizohen me nenin 55 të Kushtetutës, i cili lejon kufizime të drejtave dhe lirive vetëm në rastet kur ka një qëllim legjitim.

Një çështje tjetër që Avokati i Popullit e ka hasur në ankesat që ka pranuar gjatë vitit raportues, është çështja e rregullimit të mënyrës së regjistrimit të bashkësive fetare dhe pasojave negative që i shkakton mungesa e zgjidhjes ligjore për disa bashkësi fetare në Kosovë, e cila do të shtjellohet në pjesën e diskriminimit mbi bazën besimit, të ndërgjegjes dhe të fesës, e ndërlidhur me procesin e regjistrimit të popullsisë ku figurojnë vetëm disa nga besimet fetare dhe, duke pasur parasysh se Kushtetuta dhe legjislacioni në Kosovë nuk parasheh një religjion zyrtar, sipas ankuesve, mund të paraqesë diskriminim mbi këtë bazë.

Avokati i Popullit pranoi një ankesë⁶¹ nga një OJQ e përfaqësuar nga z. Vladimir Rakiq, në lidhje me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për largimin nga territori i Republikës së Kosovës të një prifti të Kishës Ortodokse Serbe – igumeni Manastirit “Devina Voda” (shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut). Edhe pse ankesa nuk ishte parashtruar nga vetë personi ndaj të cilit ishte marrë vendimi, Avokati i Popullit ka hapur rast për hetim, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e rastit dhe interesin për t’u siguruar nëse autoritetet përgjegjëse kishin respektuar procedurat ligjore gjatë marrjes së vendimit. Pas kryerjes së hetimeve dhe përgjigjes që ka marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, është vërtetuar se ankuesi është udhëzuar për shfrytëzimin e mjeteve juridike në dispozicion, e që nga informacionet e siguruar del se nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë. Avokati i Popullit, bazuar në këto fakte dhe në mbështetje të nenit 22.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka konstatuar se nuk ka bazë për vazhdimin e hetimit të mëtejshëm të këtij rasti.

Avokati i Popullit ka filluar hetimet lidhur me një ankesë⁶² që ka pranuar nga përfaqësuesi ligjor i Kishës Ortodokse Serbe, lidhur me pretendimet se Policia - Stacioni Policor i Kosovës në Podujevë nuk e ka pranuar

kallëzimin penal që ai ka dashur ta paraqiste në lidhje me hyrjen e paautorizuar të personit N.N. në objektin e kishës ortodokse serbe në fshatin Rakitincë të komunës së Podujevës. Pas korrespondencës së Avokatit të Popullit me drejtorin e përgjithshëm të Policisë, Avokati i Popullit mori njoftim me dokumentacion përcjellës se Policia e Kosovës ka kryer veprime hetimore në koordinim me prokurorinë kompetente. Pas kryerjes së hetimeve, prokuroria, më 28 maj 2024, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër të dyshuarve.

Avokati i Popullit vlerëson se Republika e Kosovës është shembull i mirë i tolerancës dhe i respektimit të lirive fetare dhe, pavarësisht rasteve individuale të izoluar, në përgjithësi është ndërtuar një standard i respektimit të plotë i të drejtave të respektimit të lirisë së besimit dhe lirive fetare. Është me rëndësi që ky standard i ndërtuar të përcillet me legjislacionin përkatës të harmonizuar me nevojat e rregullimit ligjor të çështjeve që mund të jenë të hapura, si garanci e vazhdimësisë së praktikave që promovojnë tolerancën dhe mirëkuptimin mes besimeve fetare.

Liria e Shprehjes

Në Republikën e Kosovës, liria e shprehjes garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 40, e cila garanton të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Liria e shprehjes garantohet edhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës.

Sipas Kushtetutës⁶³, liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme, me qëllim të vendosjes së kufijve të lirisë së shprehjes në raport me të drejtat e tjera. Kufizimet e lirisë së shprehjes sipas legjislacionit të Kosovës konsistojnë me qëllim të shmangies së gjuhës së urrejtjes, nxitjes së dhunës, gjuhës diskriminuese, fyese dhe shpifjes. KEDNJ-ja qartëson: “*Ushtrimi i këtyre lirive, meqë*

61 R.nr.54/2024

62 A.nr. 649-2023

63 Kushtetuta, Neni 40, paragrafi 2.

përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”⁶⁴

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar 3 ankesa që kanë të bëjë me lirinë e shprehjes, dy prej të cilave janë vendosur si të papranueshme - jashtë mandatit të Avokatit të Popullit - dhe njëra prej tyre është hetuar dhe trajtuar. Megjithatë, numri i vogël i ankesave të pranuar nuk e ka penguar Avokatin e Popullit të përcjellë respektimin e lirisë së shprehjes në vend dhe të ndër marrë veprime konkrete mbi bazën e mandatit ex-officio.

Avokati i Popullit me vëmendje të veçantë e ka përcjellë nivelin e respektimit të lirisë së shprehjes si dhe gjuhën e përdorur në diskursin publik në vend. Mediat dhe portalet informative janë në funksion të realizimit të lirisë së shprehjes dhe janë burim thelbësor i informacionit. Gjithashtu, platformat e rrjeteve sociale, përmes të cilave tashmë zhvillohet komunikim interaktiv, ofrojnë mundësi dhe infrastrukturë të lehtë për lirinë e shprehjes, por gjithashtu edhe mund të japin mundësi keqpërdorimi. Mungesa e rregullimit ligjor mbi përdorimin e platformave të rrjeteve sociale vazhdon të paraqesë problem në rritje për sa i përket tejkalimit të limiteve të lirisë së shprehjes, besueshmërisë së informacionit si dhe identifikimit dhe përgjegjësisë së informacionit të shpërndarë, si mjedise ku mund të abuzohet me lirinë e shprehjes duke vënë në dyshim qëllimin dhe saktësinë e informacionit, si dhe komunikimit me gjuhë degraduese dhe të urrejtës.

Më 15 janar 2024, mbi bazën e hetimeve me vetiniciativë, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin ex-officio nr. 146/2021 “Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka

shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”. Raporti ka për qëllim ta pasqyrojë gjendjen e gjuhës së përdorur në diskursin e komunikimit publik në Kosovë, i cili është bazuar në monitorimin, hulumtimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura nga seancat parlamentare, debatet televizive dhe komentet në mediat sociale, për periudhën kohore nga viti 2020 deri në vitin 2022. Avokati i Popullit, nga të gjeturat e këtij hulumtimi dhe bazuar në kërkesat që dalin nga *Rekomandimi CM/Rec(2022)161 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes*, ka konstatuar se është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë Kodin e Sjelljes së Deputetëve, në mënyrë që të sanksionohet përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme, ofenduese, denigruese, poshtëruese dhe gjuhës së urrejtjes. Nisur nga rëndësia e Lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj në rastet kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime, Avokati i Popullit ka vërejtur se është i domosdoshëm angazhimi i institucioneve edukative e arsimore në mënyrë që të krijohen programe arsimore për nxënësit dhe studentët për të mësuar për pasojat e përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Avokati i Popullit në këtë raport po ashtu ka konstatuar se në Programet trajnuese të Akademisë së Drejtësisë nuk ka module të veçanta apo të përfshira në programin e trajnimit të vazhdueshëm që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së përkitazi me këtë tematikë. Po ashtu, Avokati i Popullit, për qarkun kohor që ka shqyrtuar ky raport, ka konstatuar se mungon moderimi në media që ekspozojnë opinionin publik ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes, si dhe e ka vlerësuar si të rëndësishëm angazhimin e KPM-së për fushata të vazhdueshme kundër gjuhës së urrejtjes si dhe të bashkëpunojë me media dhe gazetarë për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe reagimin në kohë reale dhe të shpejtë kundër gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, Avokati i Popullit e vlerësoi si shumë të rëndësishme që të

64 KEDNJ, neni 10, paragrafi 2.

gjitha shtyllat e pushtetit në vend të punojnë së bashku, për të rritur ndërgjegjësimin, për të identifikuar praktikën më të mira, për të dënuar aktet e gjuhës së urrejtjes ose krimin e urrejtjes dhe për të riafirmuar parimet e demokracisë, sundimit të ligjit, barazisë dhe mosdiskriminimit. Rrjedhimisht, mediat dhe platformat e mediave sociale duhet të angazhohen në rishikimin e kodeve të tyre të sjelljes për të nxitur moderimin e përmbajtjes dhe – kur është e nevojshme – për të hequr përmbajtjen me urrejtje, duke mos lënë anash ofrimin e trajnimeve profesionale për gjuhën e urrejtjes për punonjësit e tyre, si dhe të lehtësojnë shpërndarjen e fushatave ndërgjegjësuere për të parandaluar gjuhën e urrejtjes. Avokati i Popullit, mbi bazën e konstatimeve në raport me të gjeturat, u ka adresuar rekomandime specifike autoriteteve përgjegjëse.⁶⁵

Më 6 shkurt 2024, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi për prezantimin e raportit me rekomandime *“Gjuha në diskursin publik në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”*, në të cilën morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile. Në tryezë Avokati i Popullit theksoi detyrimin e shtetit për të ndërmarrë masa që i kundërvihen gjuhës që nxit urrejtje kundër individit apo grupeve të caktuara, në bazë të racës dhe diskriminimit racor, diskriminimit me bazë gjinore, homofobisë, transfobisë, ksenofobisë, si dhe të gjitha formave që në thelb kanë diskriminimin dhe jo tolerancën. Avokati i Popullit po ashtu theksoi se gjuha e urrejtjes me bazë diskriminuere ndaj grave, personave LGBTI dhe grupeve të tjera të cënueshme është në rritje, sidomos në rrjetet sociale, andaj kjo ka shtruar nevojën e monitorimit, të parandalimit dhe të luftimit të kësaj gjuhe në të gjitha format e saj. Pjesëmarrësit në cilësinë e panelistëve theksuan se raporti është publikuar në kohën kur gjuha e përdorur në

publik është e brishtë, e sidomos në rrjetet sociale, prandaj theksuan se duhet të bëhet më shumë që të shmangët gjuha e urrejtjes, fyerja dhe shpifja, të ruhet privatësia dhe t'i kushtohet kujdes hapësirës publike që të mos abuzohet me lirinë e shprehjes. Në tryezë u prezantuan të gjeturat në këtë raport, nga hulumtimi dhe analizimi i të dhënave të mbledhura nga seancat parlamentare, nga debatet televizive dhe nga komentet në mediat sociale, për periudhën kohore nga viti 2020 deri në vitin 2022.

Duke u bazuar në hetimin e ankesës të cilën Avokati i Popullit e ka pranuar më 1 mars 2024, nga 5 organizata joqeveritare, të përfaqësuara me autorizim nga “Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut”, kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës, që lidhej me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të personave LGBTIQ+ gjatë seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 16 mars 2022, dhe duke marrë parasysh se po ashtu më 1 mars 2024 ankuesit kanë paraqitur edhe padinë (C.nr 2993/2024) në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave të rastit, më 17 tetor 2024 ka dërguar një *amicus curiae* në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në të cilën, ndër të tjerash, ai ka theksuar se në kontekst të rastit ka parasysh rëndësinë e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ka theksuar se çdo individ ka të drejtë të shprehë mendimin dhe qëndrimet e tij personale, gjë që përbën bazën e çdo shoqërie të lirë demokratike. Megjithatë, e drejta për lirinë e fjalës, pavarësisht mënyrës së shprehjes dhe publikimit të ideve dhe të qëndrimeve, nuk duhet të jetë një justifikim për diskriminim. Prandaj shprehja e qëndrimeve dhe e bindjeve që e shkelin dinjitetin e personave ose të grupit të personave dhe dëmtojnë reputacionin, si dhe të drejtat e garantuara të të tjerëve, nuk mund të justifikohet me të drejtën për lirinë e shprehjes.⁶⁶

65 <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/>

66 <https://oik-rks.org/2024/12/05/opinion-ligjor-i-avokatiit-te-popullit-ne-cilesine-e-mikut-te-gjykates-amicus->

E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike

Kushtetuta⁶⁷ garanton të drejtën e secilit person për qasje në dokumentet publike në mënyrë që të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike. E drejta për qasje në dokumente publike është thelbësore në krijimin e një ambienti të hapur për qytetarët duke u mundësuar informim dhe angazhim në çështjet me interes publik.

E drejta për qasjes në dokumente publike, përveç me Kushtetutë, garantohet edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut⁶⁸, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶⁹, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike.⁷⁰

Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) e garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.⁷¹ Ky ligj i përcakton parimet kyçe, si: qasje pa pengesa në dokumente publike; kufizimet për raste specifike, siç janë dokumentet që lidhen me sigurinë kombëtare, hetime penale ose mbrojtjen e të dhënave personale; dhe rishikimin e vendimeve, procedurat mbi ankimin administrativ. Agjencia për Informim dhe Privatësi është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të LQDP-së dhe sigurimin e balancës mes qasjes në informacion dhe mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë dhe shërben si shkallë e dytë, kompetente për shqiptimin e masave të parapara me LQDP.

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 21 të LQDP-së, i ndihmon qytetarët në realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike sipas Kushtetutës, Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe ligjeve përkatëse që

rregullojnë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit. Secili person ka të drejtë t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit me kërkesë apo ankesë nëse konsideron se ndonjë e drejtë e njohur me këtë Ligj apo akte të tjera për qasje në dokumente publike është cenuar.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka regjistruar 4 ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, 3 nga këto janë shpallur të papranueshme dhe 1 është hapur për hetim. Ankesat janë shpallur të papranueshme si më poshtë:

- Një ankesë është shpallur e papranueshme në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pas shqyrtimit të shënimeve të paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi.
- Dy ankesa janë shpallur të papranueshme në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, pas shqyrtimit të shënimeve të paraqitura dhe nga rrethanat e rastit ka rezultuar se procedurat për lëndën në fjalë janë duke u zhvilluar në organet kompetente.

Ndërsa ankesa që është hapur për hetim ishte parashtruar kundër Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), për mostrajtim të ankesës brenda afatit të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Nga komunikimi i zhvilluar me AIP-në përkitazi me këtë ankesë, Avokati i Popullit është njoftuar për arsyet e mostrajtit të ankesës në AIP brenda afatit të përcaktuar ligjor. Si arsye për këtë vonesë është pohuar vëllimi i madh i ankesave dhe numri i vogël i kapaciteteve njerëzore për shqyrtimin e ankesave. AIP-ja po ashtu ka njoftuar se kanë rekrutuar zyrtarë të rinj si kapacitete shtesë për shqyrtimin e ankesave dhe se shumë shpejt çështja e ankuesit do të

[curiae-per-gjykatën-themelore-te-prishtinës-r-nr-175-2024-lidhur-me-diskriminimin-dhe-shkeljen-e-dinjitetit-te-pjeset/](#)

67 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41 - E drejta e Qasjes në Dokumente Publike.

68 DUDNJ, neni 19.

69 KEDNJ, neni 10.

70 PNDKP, Neni 19:

71 Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, neni 1.

marrë epilog, siç edhe ka ndodhur. Hetimet përkitazi me këtë ankesë kanë përfunduar në bazë të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit thekson se Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike u mundëson qytetarëve të kenë rol aktiv në zhvillimin e shoqërisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve publike. Agjencia për Informim dhe Privatësi, si institucion kompetent për zbatimin e këtij ligji, ka adresuar dhe trajtuar çështjet që lidhen me këtë të drejtë, përfshirë dhe aktivitetet që kjo agjenci i ka zhvilluar në informim e institucioneve publike dhe të shoqërisë civile. Po ashtu, Avokati i Popullit e thekson se është e nevojshme që ky mekanizëm të zbatohet me kujdes dhe përkushtim, duke ruajtur balancën mes transparencës dhe mbrojtjes së interesave të ligjshme të shtetit dhe individëve.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit, për sa i përket së drejtës për qasje në dokumente publike, duke marrë parasysh edhe raportet e AIP-së⁷², e vlerëson se ka një ndërgjegjësim të qytetarëve, të organizatave joqeveritare dhe të medieve për të kërkuar llogaridhënie dhe informacion publik, por mbetet ende shumë punë për t'u bërë në të kuptuarit e kësaj të drejte.

Liria e Medieve

Respektimi i plotë i lirisë së mediave është thelbësor për funksionimin e demokracisë, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Liria e mediave është garanci që siguron rol aktiv të qytetarëve që të kenë rol aktiv në jetën publike dhe në proceset demokratike.

Kushtetuta me nenin 42⁷³ [Liria e Mediave] garanton lirinë dhe pluralizmin e mediave, përveç kësaj, ndalon censurën dhe përcakton se *“askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”*.

72 <https://aip.rks-gov.net/java-e-qasjes-ne-dokumente-publike/>

73 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42, paragrafi 1.

74 <https://regjistri.kpm-ks.org/>

Në Kosovë ekziston një pluralizëm i gjerë i mediave, përfshirë mediat që publikojnë në gjuhë të ndryshme të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Sipas Komisionit të Pavarur të Mediave, organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, në Kosovë ekzistojnë 19 televizione: një televizion publik (i cili transmeton në të gjitha gjuhët e komuniteteve), 13 TV stacione në gjuhën shqipe, 4 TV stacione në gjuhën serbe) dhe të licencuara janë 79 radiostacione.⁷⁴

Burimet e gazetarëve mbrohen me Ligjin nr. 04/L-147 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë. Ekzistojnë edhe ligjet e tjera që përmbajnë dispozita të hollësishme për zbatimin e garancive kushtetuese, si Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për të Drejtat e Autorit, si dhe ekziston vetërregullimi i mediave përmes Kodit të Etikës që mëton përgjegjësinë më të madhe në gazetari.

Avokati i Popullit ka trajtuar katër raste që kishin të bënin me lirinë e mediave, dy raste për pengim të gazetarit në kryerje të detyrës, një ankesë nga sindikata e Radiotelevizionit të Kosovës në lidhje me buxhetin e transmetuesit publik dhe një rast i hapur sipas detyrës zyrtare përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), komente të cilat tashmë i ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit në dy rastet e hetuara për pengim të gazetarëve ka konstatuar se në rastin e parë, nga të dhënat e siguruar, organet e ndjekjes kanë konstatuar se nuk janë gjetur elemente të veprës penale, ndërsa policia në konsultim me Prokurorin e Shtetit, rastin e ka përfunduar me shënim zyrtar. Rasti i dytë është mbyllur për shkak se pala nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike dhe se ankesa ka të bëjë me publikimin e të dhënave personale të ankuesit nga një portal.

Në anën tjetër, në emër të sindikatës së

RTK-së është bërë kërkesë që Avokati i Popullit ta referojë në Gjykatën Kushtetuese, Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, përkatësisht buxhetin e ndarë për RTK-në. Pretendimet e paraqitura në ankesë theksojnë faktin se autoritetet përgjegjëse kanë dështuar të rregullonin me ligj financimin e RTK-së, ndërsa ndarjet buxhetore për vitin 2025 nuk janë në përputhje me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës, ligj i cili përcakton se buxheti për RTK-së duhet të jetë 0.7% e buxhetit vjetor të shtetit. Gjithashtu kanë theksuar se buxheti i ndarë në disa vitet e fundit nuk siguron vazhdimësi të punës dhe në këtë mënyrë do të dëmtohet rëndë roli i televizionit publik, avancimi dhe investimi në ruajtjen e kapaciteteve ekzistuese. Nga përmbajtja e ankesës del se autoritetet kompetente, në këtë rast Kuvendi i Republikës së Kosovës, pavarësisht detyrimit ligjor për të rregulluar me ligj të veçantë çështjen e financimit të RTK-së, nuk ka marrë një iniciativë të tillë dhe deri me tani nuk ka arritur ta rregullonte këtë çështje.

Në opinionin e tij, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka shtjelluar nenin 18 [Shkarkimi i kryetarit dhe anëtarit të KPM-së] dhe për rastin konkret ka theksuar se duhet pasur kujdes te procedurat e shkarkimit, përkatësisht të shumica e thjeshtë, e cila kërkohet nga Kuvendi për shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të KPM-së. Avokati i Popullit konsideroi se mundësia e shkarkimit të kryetarit apo anëtarit të KPM-së me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, në dukje shpërfaq mundësi shumë më të lehtë të ndikimit politik të kryetari apo anëtari i KPM-së. Avokati i Popullit thekson se në këtë rast vendosja e mënyrës së shkarkimit me një shumicë më të lartë sesa shumica e thjeshtë do të sillte siguri më të madhe të kryetari apo anëtari i KPM-së në ushtrimin e funksioneve të tyre. Megjithatë, shkarkimi me 2/3 e të gjithë deputetëve nuk duhet të shihet si garanci, përmes së cilës kryetari apo anëtari i KPM-së mund të abuzojë me detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat janë të ngarkuara.

Me rastin e shënimit të 3 Majit - Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, Avokati i Popullit theksoi

rëndësinë e lirisë së shtypit dhe sigurisë së gazetarëve, si një ndër elementet thelbësore të një shoqërie demokratike. Avokati i Popullit theksoi se kërcënimet verbale dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve dhe punëtorëve tjerë mediatikë vazhduan të jenë të pranishëm në punën e tyre, duke shtuar se edhe presionet ndaj tyre vazhdojnë të mbesin një shqetësim, siç janë etiketimet dhe diskreditimi që u bëhet gazetarëve për shkak të raportimeve të tyre, e që janë në interes të publikut.

Gjatë vitit 2024, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka raportuar për 53 raste, përfshirë kërcënimet me vrasje, sulme ndaj gazetarëve, pengim në kryerje të detyrës, gjuhë dhe fushata të rrezikshme ndaj gazetarëve dhe mediave, dëmtim të pronës e të tjera. AGK-ja në disa raste ka reaguar kundër gjuhës së përdorur nga figura të larta shtetërore ndaj disa medimeve. Asociacioni ka reaguar po ashtu kundër presionit politik që i është bërë transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), duke marrë si shkas dorëheqjen e drejtorit gjeneral të RTK-së.⁷⁵

Për sa i përket transmetuesit publik, RTK, ajo vazhdon të funksionojë me ligj të vjetër, marrë parasysh se Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës ka hyrë në fuqi më 12 prill 2012 dhe periudha tranzitore trevjeçare ka përfunduar më 2015. Mungesa e ligjit të ri po shkakton probleme të mëdha brenda transmetuesit publik, e në veçanti mungesa e financimit të plotë dhe të qëndrueshëm, çështja e pronës e të tjera. Buxheti i RTK-së vazhdon të ndahet nga buxheti i shtetit në shumën prej 8 milionë e 960 mijë eurosh për vit. Ndërsa me ligjin e skaduar të RTK-së, neni 21, paragrafi 4 i këtij neni përcakton: *“Për një periudhë tranzitore, deri trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së i ndahet zero pikë shtatë për qind (0.7 %) e të hyrave nga Buxheti i Kosovës duke përjashtuar të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.”*

Në anën tjetër nuk kanë munguar edhe kritikant ndaj RTK-së në lidhje me pavarësinë

75 <https://agk-ks.org/rastet/presion-politik-ndaj-rtk-prishtine-07.07.2024/>

editoriale të saj. RTK-ja është kritikuar për shkak të publikimit të një artikulli, të huazuar nga një medium boshnjak, e i cili etiketonte dy portale kosovare se financohen dhe janë nën kontrollin e shtetit të Serbisë. Ky lajm është ripublikuar në ueb-faqen e RTK-së dhe nuk ofronte fakte për këtë gjë dhe ka munguar një verifikim i thjeshtë për t'u bërë nga ana e RTK-së, para se të publikohej një lajm i tillë. Një pjesë e stafit të RTK-së, redaktorë dhe moderatorë, u distancuan nga ky lajm i publikuar. Për një kohë është diskutuar brenda bordit dhe menaxhmentit të RTK-së për dhënie të përgjegjësisë për këtë lajm. Ndërsa pasuan dorëheqjet e kryetarit dhe një anëtar tjetër nga pozitat e tyre në bord të RTK-së, e më vonë dorëheqje dha edhe një anëtar tjetër i bordit.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) trajton ankesat e palëve të treta kundrejt televizioneve dhe radiostacioneve në rast të shkeljes së Kodit të Etikës. Gjatë vitit të kaluar, KPM-ja ka miratuar dy rregullore⁷⁶: Rregullorja për Mbrojtjen e Përdoruesve në Fushën e Ofrimit të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale, e cila ofron informim më të qartë të qytetarëve që blejnë pako televizive nga operatorët e shpërndarjes, mbron përdoruesit nga reklamata mashtruese, ua ofron qytetarëve mundësinë e ndërprerjes së kontratës apo kthimit të mjeteve në rast se kushtet e kontratës shkelen njëanshëm.

Rregullorja e dytë ka të bëjë me procedurën e trajtimit të ankesave në KPM, e cila mëton që ankesat të trajtohen në një procedurë më të shpejtë, por pa e kaluar afatin ligjor 45-ditor. Një regjistër i ankesave do të krijohet, ku qytetarët mund ta shohin procesin deri ku ka mbërritur trajtimi i ankesave të tyre.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është një trup tjetër vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Në tetor 2024, KMSHK-ja ka miratuar statutin e ri duke u përshtatur me kërkesat e kohës, duke përfshirë në kompetencë të saj trajtimin e videove që

prodhohen nga mediat e shkruara në Kosovë, një çështje që nuk është e qartë se kujt i bie kjo kompetencë.⁷⁷ Sipas statutit të ri, media të shkruara janë: “*Mediat e shkruara (tutje: mediat – ku përfshihen gazetat, revistat e shtypura dhe online, agjencitë e lajmeve dhe në përgjithësi mediat online që në përmbajtje të tyre prodhojnë tekst, audio, fotografi, video dhe grafika që transmetohen përmes internetit për t'i parë ose dëgjuar në internet.*”

Me statutin e ri, KMSHK-ja do të ketë të drejtë të trajtojë ankesat e palëve të treta që ankohen për përmbajtjet që i publikojnë mediat në kanalet zyrtare në rrjetet sociale apo në platforma të tjera, gjë që do të rrisë përgjegjësinë e mediave të shkruara në raport edhe me publikimet e tyre në rrjetet sociale zyrtare apo edhe në platforma të tjera. Po ashtu, statuti i ri parasheh largimin e anëtarëve nëse një media dështon të ndreqë gabimet ose injoron vërejtjet publike.

Nuk ekziston një numër i saktë i gazetave online dhe i portaleve, por KMSHK-ja ka 43 anëtarë të regjistruar në këtë këshill, redaktorët e të cilëve takohen një herë në muaj për t'i trajtuar ankesat për supozimet për shkelje të Kodit të Etikës nga ana e portaleve. Gjatë vitit 2024, KMSHK-ja ka trajtuar 31 ankesa të palëve të treta kundrejt mediave të shkruara. Nga ky numër, 17 ankesa janë miratuar për shkeljet e pretenduara të Kodit të Etikës, specifikisht të kapitujve 2 dhe 4, respektivisht të kapitullit “Raportimi i së vërtetës” dhe “E drejta për t'u përgjigjur”. Tutje 9 ankesa nuk janë miratuar dhe 5 të tjera janë miratuar pjesërisht.

Shqetësuese mbetet gjuha e përdorur nëpër media dhe për të prekur këtë çështje kërkohet një qasje shumëdimensionale. Gjuha e urrejtjes, ajo diskriminuese dhe narracioni përçarës prek individët, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi. Kjo ka nxitur edhe fyerje dhe ofendime ndaj individëve ose grupeve bazuar në attribute të tilla si raca, feja, përkatësia etnike, gjinia, orientimi seksual, paaftësia ose karakteristika të tjera. Faqet

76 https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3734

77 https://kallxo.com/gjate/ndryshimet-e-rregullatives-qe-synojne-avancimin-e-etikes-ne-media/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR11XUjl_6egoGJYOX-bqEjuisPeihRbij_zskhznHcR5f4oKMrOgHuRj1c_aem_OFexCBfcqWCqdt3GdyHtag

zyrtare në Facebook të mediave online apo të portalet dhe të televizionet nuk e kanë ende të rregulluar ndonjë mënyrë për të larguar komentet e qytetarëve që përbëjnë gjuhë të urrejtës, fyerje dhe ofendime ndaj palëve për të cilat këto media raportojnë.

Liria e Tubimit

Liria e tubimit është e garantuar me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 43 të saj, ku shprehimisht përcaktohet: *“Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.”*

Po ashtu, Ligji nr. 08/L-166 për Tubime Publike, i miratuar në vitin 2023, garanton të drejtën e secilit person pa dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, besimi, përkatësisë nacionale, gjendje ekonomike e financiare etj. që të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime publike, sipas rregullave të përcaktuara me ligj.

Në vështrim të përgjithshëm, liria e tubimit respektohet në vendin tonë dhe numri i ankesave që pranohen në IAP për këtë çështje është shumë i vogël.

Ndër tubimet më të mëdha që organizohet çdo vit konsiderohet edhe “Parada e Krenarisë”, e cila është organizuar edhe këtë vit dhe mbarëvajtja e saj ka qenë e mirë pa ndonjë incident apo parregullsi të raportuar. Ndërsa, pas përfundimit të paradës, persona të pidentifikuar kanë vandalizuar, duke ngjyrosur grafitë që përmbanin gjuhë të urrejtjes kundër komunitetit LGBTQI+, në vendkalim në rrugën “Xhorxh Bush”, në pjesën ku pjesëmarrësit e paradës kishin ngjyrosur këtë pjesë të rrugës me ngjyrat e ylberit për nder të “Javës së Krenarisë”. Pas raportimit të këtij rasti më 10 qershor 2024, Avokati i Popullit ka reaguar publikisht duke dënua fuqishëm gjuhën fyese dhe

diskriminuese që është përdorur me rastin e vandalizmit të simboleve të personave LGBTQI+, duke bërë thirrje për respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike, të të drejtave të njeriut, me qëllim të promovimit të një kulture të respektimit dhe të tolerancës ndaj diversitetit të orientimeve seksuale dhe të identiteteve gjinore.⁷⁸

Në raport me ankesat e pranuar⁷⁹, të njëjtat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me cenimin e lirisë së tubimit, por me veprimet e autoriteteve – Policisë së Kosovës – në rastin e arrestimit të tyre dhe që në mënyrë të tërthortë kanë të bëjnë edhe me këtë të drejtë. Të dy rastet janë në hetim të mëtejme.

Liria e Asociimit

Liria e asociimit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sipas nenit 44, paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës: *“... Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t’u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.”*

Në vështrim të përgjithshëm mund të vlerësohet se kjo liri respektohet mjaftueshëm në Kosovë. Një konstatim i tillë mbështetet edhe në Raportin e Progresit për Kosovën, i publikuar nga Komisioni Evropian më 30 tetor 2024, ku ndër të tjerash potencohet: *“Kushtetuta dhe ligjet garantojnë lirinë e tubimit dhe organizimit dhe zbatimin e tyre është i kënaqshëm. [...] Ligji për Lirinë e Asociimit dhe legjislacioni zbatues i tij në përgjithësi përmbushin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.”*⁸⁰

Në anën tjetër, Liria e asociimit, përveç me Kushtetutë, është e garantuar dhe e rregulluar edhe me Ligjin nr.04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë dhe me

78 <https://oik-rks.org/2024/06/18/reagim-i-avokatit-te-popullit-per-vandalizmin-e-simboleve-te-komunitetit-lgbtiq/>

79 R.nr.1126/2024 dhe R.nr.612/2024

80 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

Ligjin nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar 2 ankesa lidhur me këtë çështje. Njëra nga ankesat⁸¹ ka të bëjë me pretendimin për kufizimin e lirisë së asociimit dhe pengim nga punëdhënësit për pjesëmarrje në aktivitete sindikale, të cilën ankesë e kemi pranuar nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës (FSShK), në emër të anëtarëve sindikalë, kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Megjithatë, hetimet e iniciuara për këtë çështje kanë përfunduar në mungesë të dokumentacionit argumentues dhe mbështetës për pretendimet e palëve. Ndërkaq ankesën tjetër⁸² e kemi pranuar prej 4 punëtorëve të FSShK-së, me pretendimin për ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënies së punës, pa i respektuar procedurat e parapara me Ligjin e Punës. Kjo ankesë është në trajtim e sipër dhe për të akoma nuk është nxjerrë një vendim.

Me qëllim të adresimit të çështjeve të ndryshme që ndërlidhen me respektimin e të drejtave të të punësuarve, me dialogun social dhe me lirinë e organizimit sindikal, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësuesit e sindikatave të vendit.⁸³

Përfaqësuesit e sindikatave të sektorit të arsimit, të policisë, të shëndetësisë, të shërbimit korrektues, të shërbimit të zjarfikësve, të doganave, të administratës tatimore, të aeroportit dhe të sektorit të minierave ngritën shqetësimet dhe sfidat e tyre, veçanërisht për mungesën e dialogut social me pushtetin ekzekutiv. Si rezultat i kësaj tryeze, u arrit dakordim i përbashkët i Avokatit të Popullit me përfaqësues sindikalë, që në të ardhmen, përmes një takimi të përbashkët me qeverinë dhe ministrinë përkatëse, të adresohen shqetësimet dhe kërkesat e sindikalistëve, të cilat u ngritën në këtë tryezë.

Po ashtu, për sa i përket kufizimit të lirisë së asociimit, Avokati i Popullit më 13 maj 2024 ka publikuar Opinionin për rastin Anr.

81 R/564/2024

82 R/1174/2024

83 <https://oik-rks.org/2024/03/12/avokati-i-popullit-takoi-perfaqesuesit-e-sindikatave/>

84 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2024/05/Opinion-i-AP-295-2022.pdf>

295/2022⁸⁴ lidhur me kufizimin e aktivitetit sindikal dhe diskriminim për shkak të angazhimit sindikal, të punëtorëve të Limak Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Ankesa është iniciuar në IAP nga kryetari i Shoqatës Sindikale të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”, me pretendim për largim të tij nga puna dhe moslejim të qasjes në zyrat e sindikatës dhe ushtrim të aktivitetit sindikal. Ankesa ka të bëjë edhe me pretendimin për largim kolektiv nga puna të punëtorëve pas grevës 3-ditore të mbajtur në vitin 2019 dhe diskriminimin e tyre në punë, për shkak të asociimit të punëtorëve të aeroportit në sindikatë.

Avokati i Popullit në këtë opinion ka konstatuar se pengimi i qasjes në hapësirat e sindikatës përbën kufizim të ushtrimit të aktivitetit sindikal dhe të lirisë së asociimit si edhe çdo largim eventual nga puna apo cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës e punëtorëve, për shkak të angazhimit në aktivitete sindikale, përbën diskriminim mbi bazën e lirisë së asociimit. Avokati i Popullit, ndër të tjerash ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse ndërmarrjen e masave për garantimin e ushtrimit të aktivitetit sindikal, krijimin e një dialogu të mirëfilltë të komunikimit dhe ndalimin e çfarëdo mase diskriminuese në raport me punëtorët e angazhuar në aktivitete sindikale.

Avokati i Popullit vlerëson se liria e asociimit në Kosovë përgjithësisht respektohet, përveç rasteve të përshkruara në këtë raport, nuk ka pasur asnjë shqetësim tjetër të ngritur përgjatë vitit raportues lidhur me këtë çështje.

Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

E drejta për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur, si një nga të drejtat themelore të njeriut, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës⁸⁵, si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.

Të drejtat zgjedhore dhe e drejta e përfaqësimit janë të lidhura ngushtë me demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ofrojnë një kornizë të rëndësishme për sigurimin e këtyre të drejtave, ndërsa implementimi dhe mbikëqyrja e tyre janë po aq të rëndësishme për të arritur një demokraci funksionale dhe gjithëpërfshirëse.

Të drejtat zgjedhore janë element thelbësor i demokracisë, duke garantuar mundësinë secilit të shprehë mendimin e tij dhe të kontribuojë në procese vendimmarrëse.

E drejta e përfaqësimit siguron që zëri i qytetarëve të dëgjohet nga institucionet vendimmarrëse dhe është veçanërisht e rëndësishme për përfaqësimin e interesave të tyre. Indikator kyç i realizimit të kësaj të drejte është dëgjimi i zërit të të gjitha grupeve shoqërore në vend. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale është instrument qenësor në këtë drejtim dhe përcakton krijimin e mekanizmave për përfaqësimin e grupeve të ndryshme të shoqërisë. Përfaqësimi i duhur në nivelin lokal është thelbësor për të siguruar që nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve të ndryshme të merren parasysh.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka regjistruar 2 raste për hetim, që kanë të bëjnë me të drejtën zgjedhore dhe të përfaqësimit. Një rast është hapur sipas detyrës zyrtare, ndërsa tjetri sipas ankesës.

Rasti i hapur sipas ankesës⁸⁶ ka të bëjë me ankesën e paraqitur nga një grup qytetarësh me pretendimet për mostransparencë nga

Komuna e Prizrenit, me rastin e ndarjeve të bashkësive lokale. Rasti është ende duke u hetuar.

Ndërsa rasti i hapur sipas detyrës zyrtare⁸⁷, është regjistruar për të vlerësuar nëse neni 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Më 16 janar 2024, Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese, Kërkesë për vlerësimin e nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nëse kjo dispozitë është në pajtim me nenin 7, me nenin 24 dhe me nenin 45, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit, nëpërmjet kësaj kërkesë ka vlerësuar se, megjithëse kuota e përcaktuar në ligjin e kontestuar nuk paraqet kufizim të së drejtës, paraqitja e saj si limit minimal i pjesëmarrjes në rastin konkret nuk është proporcionale dhe nuk pasqyron barazinë gjinore dhe si e tillë nuk është në përputhje as me parimin e mosdiskriminimit. Gjithashtu, një vendosje e tillë është në kundërshtim me qëllimin legjitim të ndjekur për arritjen e barazisë gjinore, siç kërkohet me Kushtetutë” *“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”* Përveç kësaj, një përcaktim i tillë e cenon esencën e së drejtës së garantuar, që në rastin konkret është e drejta për t'u zgjedhur, e drejta e pjesëmarrjes dhe e drejta e barazisë para ligjit. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur me Aktgjykimin KO15/24 dhe ka vlerësuar se norma e kontestuar është në pajtim me Kushtetutën. Duhet theksuar se për të njëjtën çështje, Avokati i Popullit ka iniciuar procedurë gjyqësore në procedurë të rregullt gjyqësore. Në raport me atë që është konstatuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ndërlidhur me qëndrimin e Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje,

85 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45.

86 R/236/2024

87 Ex officio 6/2024

do të shtjellohet me gjerësisht në pjesën e raportit për rolin e Avokatit të Popullit, si organ i barazisë.

Gjatë vitit raportues, në vijimësi të ngjarjeve që pasuan pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave në veri të vendit (Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan,) të 23 prillit 2023, Qeveria më 5 shtator 2023 miratoi Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.02/2023 për Iniciativën e Qytetarëve për Largimin e Kryetarit të Komunës nga funksioni. Pas mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme në peticionin për të shkarkuar kryetarët e komunave veriore, më 21 prill 2024 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në katër komunat veriore. Avokati i Popullit vëzhgoi këtë proces dhe gjatë kohës së vëzhgimit nuk është raportuar për ndonjë incident dhe përgjithësisht votimi në këtë proces ishte i rregullt. Ajo që duhet cekur në këtë rast është fakti se ky proces është bojkotuar nga qytetarët e komunitetit serb dhe numri i atyre që kanë votuar ka qenë shumë i ulët.

Edhe sipas KQZ-së dhe vëzhguesve që ndihmuan KQZ-në në organizimin e këtij procesi, pavarësisht disa sfidave, votimi në përgjithësi ishte i organizuar mirë.⁸⁸

Më 16 gusht 2024, Presidentja e vendit, me Dekretin nr. 119/2024, ka caktuar datën e zgjedhjeve të rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Zgjedhjet e rregullta u mbajtën më 9 shkurt 2025.

Më 11 shtator 2024, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka publikuar Këshillë për vendosjen e ngjyrës matrikuluese gjatë procesit të votimit, me të cilën AIP-ja ka këshilluar dhe inkurajuar KQZ-në që veprimet që do t'i ndërmarrë për organizimin e zgjedhjeve t'i orientojë në harmoni me mbrojtjen e të dhënave personale dhe me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Lidhur me përdorimin e ngjyrës matrikuluese gjatë procesit të votimit në zgjedhjet që u mbajtën më 9 shkurt 2025, përfaqësues të Avokatit të Popullit, më 19 dhjetor 2024, janë takuar me përfaqësues të KQZ-së. Në këtë takim u bisedua për arsyet e kalimit në përdorimin e ngjyrës matrikuluese. Përfaqësuesit e KQZ-së njoftuan se pajisjet që janë përdorur në zgjedhjet e mëparshme për sigurimin e procesit të votimit dhe parandalimin e keqpërdorimit eventual janë të vjetruara. Ata po ashtu njoftuan se gjatë aplikimit të ngjyrës matrikuluese në zgjedhjet për largimin e kryetarëve të komunave nga funksioni, në prill të viti 2024, KQZ-ja nuk ka marrë asnjë ankesë, me çka KQZ-ja e konsideronte të nevojshme dhe të përshtatshme për përdorim. Përfaqësuesit e KQZ-së pohuan se do të vazhdojnë me veprimet operacionale sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe akteve të tjera nënligjore.

Avokati i Popullit si organ i barazisë dhe i mbrojtjes nga diskriminimi

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.⁸⁹

Roli dhe mandati i Avokatit të Popullit më tej specifikohet me Ligjin 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.⁹⁰

Ligji 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi⁹¹ përcakton kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin. Ndërsa Ligji 05/L-020

88 <https://kqz-ks.org/konferenca-e-katert-kqz-iniciativa-qytetare-per-largimin-e-kryetareve-te-komunave-leposaviq-zubin-potok-zvecan-dhe-mitrovica-e-veriut-ka-deshtuar/>

89 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1.

90 Ligji 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 2.

91 Ligji 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9, neni 12 dhe neni 18.

për Barazi Gjinore⁹² e përcakton Avokatin e Popullit si institucionjard të barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor.

Ligji për Avokatin e Popullit është ligj organik dhe procedurat lidhur me trajtimin e rasteve, duke përfshirë këtu edhe rastet e diskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me Ligjin për Barazi Gjinore, zbatohen në përputhje me procedurat e specifikuar me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD) përcakton kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e këtij ligji. Neni 9, paragrafi 2.12, i LMD-së i kërkon Avokatit të Popullit të paraqesë një raport të paktën çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji. Më 11 dhjetor 2024, Avokati i Popullit për herë të parë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ka dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës *Raportin Vjetor 2023 për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës*.⁹³

Raporti vë në pah një mungesë të theksuar të vetëdijes institucionale përdomosdoshmërinë e mbledhjes së të dhënave dhe evidentimit të rasteve të diskriminimit. Duhet theksuar se mungesa e dëshmimeve institucionale lidhur me shkeljet e LMD-së nuk është tregues i gjendjes faktike të rasteve të diskriminimit. Është i njohur fakti se raportimet dhe ankesat për diskriminim, në sektorin publik dhe privat, janë të shpeshta; po ashtu edhe procedurat administrative dhe gjyqësore të nisura nga persona që pretendojnë se janë viktimat të shkeljes të së drejtës për barazi para ligjit dhe mosdiskriminimit. Këto janë fakte të njohura publikisht. Prandaj ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet rasteve të pretenduara të diskriminimit dhe dëshmimeve zyrtare për to.

Po ashtu, mosplotësimi i infrastrukturës institucionale duke marrë parasysh që një numër komunash ende nuk e kanë emëruar

zyrtarin për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe mungesa e standardizimit të përshkrimit të punës së njësive dhe zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi, në nivelin e ministrisë dhe komunave, paraqitet si gjetje e këtij raporti.

Raporti ofron gjashtë rekomandime konkrete dhe praktike, të cilat synojnë adresimin e problemit të zbatimit të pjesshëm të LMD-së, duke qenë se, nëse nuk mblidhen të dhëna për rastet e diskriminimit nga institucionet gjegjëse, është e pamundur të konkludohet se LMD-ja zbatohet në tërësi.

LMD-ja aktualisht është duke kaluar në një proces rishikimi. Qëllimi i këtij rishikimi legjislativ është përshtatja e këtij Ligji për t'u përgjigjur sfidave, nevojave dhe transformimeve shoqërore, si dhe harmonizimi i mëtejme i tij me standardet e Këshillit të Evropës (KiE) që evoluojnë vazhdimisht dhe të *acquis* të Bashkimit Evropian (BE). Ky proces i shqyrtimit vjen pas Raportit për Vlerësimin Ex-Post të Zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përgatitur nga Zyra Ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit dhe me pjesëmarrjen e aktorëve kyçë institucionalë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimit, duke përfshirë Avokatin e Popullin.

Gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminimin në Kosovë

Për të dhënë një pasqyrë lidhur me diskriminimin në Kosovë, Avokati i Popullit bazohet ekskluzivisht në të dhënat që institucioni i mban lidhur me ankesat e pranuar dhe të hetuara. Avokati i Popullit është i vetmi institucion në Republikën e Kosovës që mban evidencë për rastet e diskriminimit, ngase në Raportin e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e LMD-së, dërguar Kuvendit më 11 dhjetor 2024, është konstatuar se asnjë autoritet në Republikën e Kosovës nuk mban të dhëna lidhur me ankesat dhe rastet e diskriminimit. Mungesa e të dhënave lidhur me rastet e diskriminimit në nivel vendi ndikon në pasqyrimin e saktë të diskriminimit dhe se të dhënat dhe të gjeturat nga Avokati i Popullit mund të mos

92 Ligji 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

93 <https://oik-rks.org/2024/12/10/raporti-vjetor-2023-per-zbatimin-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi/>

pasqyrojnë gjendjen në përgjithësi, duke pasur parasysh se në praktikë mund të ketë akoma më shumë raste të diskriminimit sesa gjetjet e Avokatit të Popullit, të përmbledhura në këtë raport.

Numri i përgjithshëm i ankesave të evidentuara në Departamentin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i Avokatit të Popullit, është 142, prej të cilave 95 janë hapur për hetim, ndërsa 47 janë shpallur të papranueshme. Nga 142 ankesa të pranuar, 61 janë paraqitur me pretendime për diskriminim, prej të cilave 41 janë hapur për hetim, ndërsa 20 janë shpallur të papranueshme.

Gjatë periudhës raportuese janë hapur 9 raste sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).

Natyrë e ankesave me pretendime për diskriminim ka të bëjë me çështjet shëndetësore dhe sociale, çështjet e pensioneve, çështjet nga marrëdhënia e punës (duke përfshirë konkurset, avancimet, vendosjen e koeficienteve, keqtrajtim në vend të punës, ndërprerje të kontratës së punës et.), të drejtat e komuniteteve joshumicë, pengesat në realizimin e të drejtave për shkak të mosnjohjes së bashkësive fetare etj. Ndërsa bazat e pretenduara të diskriminimit janë aftësia e kufizuar, moshë, përkatësia etnike, përkatësia fetare, statusi social, gjinia, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, përkatësia politike dhe baza të tjera të mbrojtura me nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Nga 14 raporte me rekomandime të publikuara bazuar në ankesat e pranuar ose të hapura sipas detyrës zyrtare, 6 prej tyre kanë të bëjnë me konstatime për shkelje të të drejtave të njeriut, trajtim të pabarabartë dhe diskriminim.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka publikuar dy Opinione, dy Opinione në cilësi të mikut të gjykatës, si dhe 1 kërkesë kushtetuese që ndërlikohen me gjetjet e Avokatit të Popullit për diskriminim.

Kur bëhet fjalë për gjetjet lidhur me diskriminimin në Kosovë, Avokati i Popullit bazohet në qëndrimet e tij të shprehura

nëpërmes Raporteve me Rekomandime dhe opinioneve adresuar autoriteteve përgjegjëse dhe të publikuara në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit, të cilat përmbledhen në këtë kapitull.

Aktet normative në raport me parimin e mosdiskriminimit

Rregullorja (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.

Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime⁹⁴, me të cilin ka kërkuar Ndryshimin e Rregullores (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktojnë pesë kategori të profesioneve dhe profesioneve deficitare, për të cilat mund të merret kompensim për kushtet e tregut të punës, si edhe një kategori shtesë “*profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës*”, kategori për të cilën, përveç kushteve të përgjithshme, Rregullorja përcakton kushte të veçanta për përfitime shtesë, të cilat punonjësit duhet t’i plotësojnë kumulativisht, përkatësisht punonjësit duhet të kenë qenë pjesë e *programit të studimeve të nivelit të dytë të arsimit të lartë*, të jetë i financuar ose bashkë-financuar nga Qeveria e Kosovës dhe të kenë të përfunduar studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në universitete jashtë vendit.

Në bazë të analizës së rrethanave të rastit, Avokati i Popullit ka konstatuar se Rregullorja me kushtet e përmendura, në një situatë të krahasueshme, ka vënë në pozitë të pabarabartë dhe të pafavorshme punonjësit e shërbimit civil të Kosovës, të cilët, me qëllim të një niveli më të lartë të arsimit, i kishin vetëfinancuar studimet jashtë vendit dhe i kishin kryer ato pa mbështetje financiare nga Qeveria, ose që i kishin përfunduar studimet dhe kishin marrë kualifikime përkatëse deficitare në institucionet e licencuara të arsimit të lartë publik ose privat në Republikën e Kosovës. Me këtë lloj të trajtimit është

94 Ex officio nr. 224/2023

bërë një diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i shumëfishtë.

Avokati i Popullit në këtë rast ka konstatuar se ka diskriminim dhe ka kërkuar ndryshimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, të cilat krijojnë trajtim të pabarabartë dhe në kundërshtim me parimin “punë e njëjtë, pagë e njëjtë”.

Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme

Më 16 janar 2024, Avokati i Popullit ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e kushtetutshmërisë të nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me të cilin përcaktohet kuota gjinore në listat e kandidatëve të secilit subjekt politik, sipas të cilit, së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra. Avokati i Popullit në kërkesën kushtetuese ka konsideruar se përcaktimi i kuotës (së paku 30%) për secilën gjini, në dukje nuk paraqet trajtim të pabarabartë mes meshkujve dhe femrave, megjithatë në praktikë nuk ka pasur raste kur subjektet politike i kanë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me 50% femra dhe 50% meshkuj. Sipas Avokatit të Popullit, mbajtja e kriterit prej 30% e përligj trajtimin e pabarabartë, sepse subjektet politike e plotësojnë kriterin ligjor për të garuar në zgjedhje me dërgimin e listës së kandidatëve me 30% femra në listat zgjedhore, ndërsa pjesa tjetër u lihet në vullnetin e tyre, rrjedhimisht në praktikë femrat në vazhdimësi mbeten të nënparaqësura.

Gjykata Kushtetuese, më 27 dhjetor 2024, nëpërmes Aktgjykimit KO 15/24 ka vendosur se neni 28 [Kuotat gjinore] i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se objekt i kërkesës kushtetuese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit

të kontestuar dhe nëse ky nen është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se neni 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa nuk ka ndonjë konstatim lidhur me pajtueshmërinë e nenit 28 të Ligjit me Vlerat dhe Barazinë para Ligjit, që këtë aktgjykim e lë të mangët dhe të paarsyetuar duke mos vendosur për çështjet thelbësore të ngritura nga Avokati i Popullit lidhur me atë nëse akti i kontestuar është në pajtim me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit].

Sidoqoftë, Avokati i Popullit vlerëson se një përcaktim i tillë nuk është në harmoni me frymën e Kushtetutës që përcakton se Republika e Kosovës aspiron të sigurojë barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Avokati i Popullit lidhur me këtë çështje ka pritur një reagim më të fuqishëm nga aktivistë dhe mbrojtës të të drejtave të grave në respektim të barazisë gjinore. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit, në cilësinë e organit të barazisë, do të vazhdojë që të angazhohet edhe më tej me të gjitha kapacitetet që ka për të avancuar barazinë gjinore deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë mes grave dhe burrave, në të gjitha proceset.

Diskriminimi mbi bazën e moshës

Avokati i Popullit ka vazhduar të trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin mbi bazën e moshës. Sipas Këshillit të Evropës, *Ageismi (Ageism)*⁹⁵ – përkufizohet si stereotip, paragjykim dhe praktikë diskriminuese në bazë të moshës – përforcon perceptimin se pabarazitë dhe diskriminimi ndaj të moshuarve është i natyrshëm ose i pashmangshëm, gjë që nuk është kështu.

95 <https://rm.coe.int/as-ega-report-overcoming-age-based-discrimination-against-older-person/1680b2ba50#:~:text=In%20a%20statement%20from%202023,which%20reflect%20or%20reinforce%20ageism.>

Personat e moshuar duhet të përballen me një diskurs që tërheq vëmendjen për pasojat e zhvendosjes demografike drejt një popullsie më të vjetër, “barrës” në rritje që ata përfaqësojnë dhe “kostos së lartë” për garantimin e barazisë së tyre dhe për të drejtat njeriut për ta.

Nga gjetjet e Avokatit të Popullit rezulton se diskriminimi mbi bazën e moshës shpesh ndërlihet edhe me bazat e tjera të mbrojtura me LMD. Personat e moshuar në përgjithësi janë viktimat të diskriminimit të shumëfishtë, sepse, përveç diskriminimit për shkak të moshës, ata përballen edhe me forma të tjera të diskriminimit.

Raporti i Avokatit të Popullit, *ex-officio* nr. 601/2023 në lidhje me detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën e Kosovës,⁹⁶ sjell një analizë dhe vlerësim lidhur me detyrimet e shtetit në ofrimin e mbështetjes dhe të shërbimeve të shëndetit mendor për personat me moshë mbi 65-vjeçare, në institucionet përkatëse në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit konsideron se shërbimet e shëndetit mendor dhe ato të përkujdesjes sociale, të cilat përfshijnë kujdesin spitalor dhe rezidencial, të ofruara nga institucionet përkatëse, nuk janë të adaptuara për të adresuar nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen personat e moshës mbi 65-vjeçare. Kufizimi i moshës deri në 65-vjeçare, si kriter për t’u pranuar në institucione rezidenciale, përbën shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Avokati i Popullit gjatë hetimit të rastit lidhur me viktimitën e dhunës në familje S. D.⁹⁷, që ka përfunduar me fatalitet, ka hasur në probleme të mëdha lidhur me mungesën e strehimit në institucione rezidenciale të personave

mbi moshën 65-vjeçare. Sipas Avokatit të Popullit, kjo përbën shkelje të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Përveç kësaj, mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor sfidon zbatimin e ligjit dhe krijon hapësirë për praktikat diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor lidhur me kufizimin e moshës për personat mbi 65-vjeçare. Mungesa e akteve nënligjore, mungesa e kriteve të qarta në aktet nënligjore ekzistuese, shfuqizimi i akteve nënligjore me vendime të qeverisë⁹⁸ dhe kufizimi i të drejtave të garantuara me ligj me anë të akteve nënligjore janë në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit. Mungesa e përkujdesjes nga ana e shtetit për personat mbi 65 vjeç me çrregullime mendore rezulton me dhunë dhe vrasje, sikur në rastin konkret.

Diskriminimi mbi bazën e moshës dhe gjinisë është formë e diskriminimit të shumëfishtë kur viktimat përballen njëkohësisht me diskriminimin mbi bazën e moshës dhe atë të gjinisë ku viktimat janë kryesisht gratë në moshë para pensionimit dhe pas pensionimit. Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar një rast (R/50/2024 S.G.P. kundër Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale - KPMM), për shkak të vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës si kryesuese e Bordit të KPMM-së. Më 6 dhjetor 2021, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka zgjedhur Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale (KPMM) me mandat 5-vjeçar, me ç’ rast ankuesja është zgjedhur kryesuese e Bordit. Ndërsa më 29 dhjetor 2022, tre anëtarë të Bordit të KPMM-së kanë marrë vendim për pensionimin e ankueses duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe në Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale. Nga përshkrimi i rastit duket se tre nga anëtarët e Bordit të KPMM-së kanë tejkaluar kompetencat e tyre, duke marrë vendim për

96 <https://oik-rks.org/2024/09/10/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-601-2023-ne-lidhje-me-detyrimet-e-shtetit-per-mbeshtetjen-dhe-ofrimin-e-sherbimeve-te-shendetit-mendor-per-personat-e-moshes-mbi-65-vjecare-ne-republiken/>

97 Rasti Ex officio nr. 601/2023

98 Udhëzimi Administrativ nr.07/2009 (në Shëndetësi) për shërbimet profesionale të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës, i cili është shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50, datë 23.12.2021.

mandatin e ankueses, kompetencë kjo që i takon Kuvendit të Kosovës, si emërues i saj. Ndërsa më 26 tetor 2023 Kuvendi i Kosovës mori vendim për shkarkimin e saj sipas rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.

Në kërkesën e Avokatit të Popullit lidhur me ligjshmërinë e vendimit për pensionim të ankueses, KPMM-ja ka ofruar një arsytim se pensionimi i ankueses është bërë për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa ligji nuk përcakton moshë të pensionimit për të emëruarit nga ana e Kuvendit. Avokati i Popullit madje ka kërkuar nga Kuvendi një interpretim autentik të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, respektivisht të nenit 59, paragrafi 3, i cili përcakton: “Çdo anëtar i Bordit të KPMM që mban mandatin në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojë të shërbejë në atë pozitë deri [...] ose largimin e ligjshëm nga ajo pozitë [...]”, mirëpo nuk ka marrë përgjigje. Ndërsa nga përgjigja e KPMM-së në kërkesën e Avokatit të Popullit nëse ka pasur raste kur anëtarët e Bordit kanë vazhduar mandatin edhe pas arritjes së moshës së pensionimit mësohet lidhur me një rast të njëjtë sikurse i ankueses, ku njëri nga anëtarët e Bordit (mashkull) gjatë ushtrimit të mandatit e ka arritur moshën e pensionimit (2010-2014) dhe përkundër kësaj ai ka vazhduar ta ushtrojë mandatin deri në fund. Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit, më 3 dhjetor 2024, ka publikuar Opinion⁹⁹ lidhur me detyrimet e organeve shtetërore që gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësisive të tyre të veprojnë në përputhje me parimet e LMD-së dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Formë tjetër e diskriminimit të shumëfishtë shfaqet te personat e moshuar me aftësi të kufizuar, të cilët nuk marrin akomodime të përshtatshme dhe kanë vështirësi shtesë në shëndetësi. Të moshuarit që vijnë nga shtresat e varfra që nuk kanë kursime

pensionit, strehim të sigurt apo kujdes mjekësor të mjaftueshëm përballën me pabarazi ekonomike dhe sociale, në veçanti personat të moshuar të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur ta fitonin të drejtën e një pensioni kontributpagues apo që nuk kanë kursime në Trustin Pensional.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen te rasti të cilin e ka hapur sipas detyrës zyrtare, e që ka të bëjë me mosofrimin nga ana e QKUK-së të kërdhokullave artificiale për personat mbi 65-vjeçar. Po ashtu është e rëndësishme të përmendet se gjatë vitit raportues janë pranuar një numër ankesash për vlerën e ulët të pensionit. Avokati i Popullit vlerëson se, megjithëse ka pasur një rritje të pensioneve bazë, shuma prej 120 EUR është tepër e ulët për të plotësuar nevojat e personave të moshuar dhe se rritja e numrit të ankesave për shkak të shumës së ulët të pensionit bazë është një tregues për përkeqësim të situatës ekonomike dhe sociale të personave të moshuar.

Diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka vazhduar të përcjellë çështjet që ndërlidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga Raporti i Avokatit të Popullit *ex officio* nr. 479/2022¹⁰⁰ përkitazi për vlerësimin e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës vë në pah se komunat nuk kanë bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për krijimin e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se lidhur me zbatimin e legjislacionit që ka të bëjë

99 <https://oik-rks.org/2024/12/05/avokati-i-popullit-opinion-r-nr-50-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shteterore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi/>

100 <https://oik-rks.org/2023/12/29/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4792022-ne-lidhje-me-vleresimin-e-qasshmerise-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-bazuar-ne-udhezimin-administrativ-nr-332007-per-kushtet-teknike-te-o/>

me punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, më 23 dhjetor 2023 ka publikuar një Raport me rekomandime *ex officio* nr. 519/2022.¹⁰¹ Sipas konstatimeve të Avokatit të Popullit, ekziston mungesë e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, andaj ka rekomanduar masa specifike të synuara nga ana qeverisë, të cilat do ta mundësonin zgjidhjen universale të sfidave në tregun e punës që të arrihej qëllimi i sigurimit të të drejtave dhe të mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe të zbatoheshin dispozitat përkatëse të instrumenteve ligjore në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.

Avokati i Popullit vëren se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ MFPT-nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 6, paragrafi 1, i të cilit ka të bëjë me shpalljen e konkursit publik për personat me aftësi të kufizuara. Megjithëse gjatë vitit raportues Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë¹⁰² lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të këtij Udhëzimi Administrativ, pas hetimit dhe analizimit të çështjes ka ardhur në përfundim se dispozitat e këtij neni paraqesin një masë të synuar, të bazuar në një arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm, që kontribuon në përmbushjen e detyrimit ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku një institucion publik *“me aktin e brendshëm bën identifikimin e pozitave për këtë kategori dhe shpall konkurs për plotësimin e këtyre vendeve të punës.”*

Varësisht nga shkalla e aftësisë së kufizuara, punëdhënësi e ka detyrim ligjor t'i përcaktojë vendet e përshtatshme të punës. Kjo nënkupton se ky udhëzim administrativ e njeh nevojën objektive dhe të arsyeshme që një institucion publik t'i përcaktojë pozicionet

sipas përgjegjësi dhe detyrave të punës, të cilat, sipas aftësive të punës me kualifikime të duhura, mund të kryhen nga personat me aftësi të kufizuara në mënyrë efikase dhe pa pengesa, gjë që nuk do ta rrezikonte gjendjen e tyre shëndetësore.

Për sa i përket Raportit *ex officio* nr. 521/2022¹⁰³ lidhur me rivlerësimin e aftësisë së kufizuara për njohjen e statusit të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, një ndër rekomandimet e dërguara për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfere (MFPT) është që të plotësojë dhe të ndryshojë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, duke fshirë tërë paragrafin 1 të nenit 9, që përcakton rivlerësimin e aftësisë së kufizuara të këtyre personave, në çdo pesë vjet.

Më 4 prill 2024, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga MFPT-ja, sipas së cilës, rregullorja në fjalë është në procedurë të ndryshimit dhe ajo do të përcillet në Qeverinë e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe aprovim.

Përmes Vendimit Nr.08/216, të datës 14 gusht 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Rregulloren (QRK) – Nr.23/2024 për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Njohjes së Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë. Në nenin 8, paragrafi 2 përcakton: *“Njohja e statusit të personit paraplegjik/tetraplegjik të paraqitësit të kërkesës, ka karakter të përhershëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të rregullt të rivlerësimit.”*, kështu, duke zbatuar rekomandimin e IAP-së në Raportin me Rekomandime *ex officio* me nr. 521/2022.

Gjatë viti raportues, Avokati i Popullit është

101 <https://oik-rks.org/2023/12/18/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-5192022-ne-lidhje-me-punesimin-ne-institucionet-qendrore-dhe-ne-organet-e-vetqeverisjes-lokale-ne-kosove-te-personave-me-aftesi-te-kufizuara/>

102 R.nr. 274-2024

103 <https://oik-rks.org/2023/12/22/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-5212022-lidhur-me-bazen-ligjore-te-ri-vleresimit-nga-komisioni-per-vleresimin-dhe-percaktimin-e-procedurave-per-njohjen-e-statusit-dhe-te-drejtave-te-pe/>.

njoftuar lidhur me situatën e personave të shurdhër, të cilët e përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë, por që nuk dinë shkrim-lexim, ani pse në diplomat e tyre ata dalin me nota të larta. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka iniciuar hetimin *ex officio*, qëllimi i të cilit është të mësohet nëse ekzistojnë kurrikula dhe masa të përshtatshme për përgatitjen arsimore të personave të shurdhër dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në Kosovë. Po ashtu është me interes të bëhet e ditur nëse ka staf arsimor, i cili është i aftë dhe i kualifikuar për t'u përgjigjur nevojave specifike për mësim-nxënie nga këta persona.

Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë individuale lidhur me mungesën e testit të vozitjes në gjuhën e shenjave për persona të shurdhër, rast i cili është në hetim e sipër.

Avokati i Popullit ka trajtuar një ankesë në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e LMD-së dhe me legjislacionin në fuqi për ofrimin e kujdesit shëndetësor stomatologjik. Gjatë hetimit të rastit janë identifikuar shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut nga ana e Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK), lidhur me ankesën e një vajze me aftësi të kufizuara për mosofrimin e trajtimit shëndetësor stomatologjik sipas nevojave të veçanta që ajo i ka. Avokati i Popullit konsideron se mostrajtimi shëndetësor stomatologjik nga QKSUK-ja i pacientes sipas karakteristikave të veçanta që ajo i ka shpie në diskriminim mbi bazën e gjendjes shëndetësore të saj dhe diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu Avokati i Popullit konstaton se rasti i vajzës shpërfaq dukurinë që potencialisht në një situatë të tillë mund të gjenden edhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara apo persona me veçori shëndetësore, kur ata kërkojnë shërbime stomatologjike. Duket se personeli shëndetësor në QKSUK nuk e ka mjaftueshëm të qartë trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të personave me veçori specifike shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore stomatologjike. Për pasojë, prindërve të vajzës u është

dashur të kërkonin shërbime stomatologjike në Shqipëri, me shpenzime të veta, duke rënduar akoma më shumë gjendjen e familjes së vajzës.

Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandim¹⁰⁴ lidhur me Vendimin Nr. 43/III/2024 të Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 22 mars 2024, përkitazi me mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së. Avokati i Popullit konstaton se Vendimi nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga MSh-ja, përben diskriminim në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për arsye se vendimi në fjalë përcakton vetëm beneficionet për personat me *statusin e invalidit të luftës së UÇK-së* duke përjashtuar kategorinë e personave me *status të invalidit civil të luftës*, edhe pse këto dy kategori i gëzojnë beneficionet e njëjtat, të cilat shprehimisht përcaktohen në nenin 6, paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Më 26 dhjetor 2024, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ministri i MSh-së, me të cilën u njoftua se më 3 dhjetor 2024 ka nxjerrë një vendim të ri, ku ka obliguar Bordin për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, që personave me status Invalid Civil i Luftës, për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave, të vendosë sipas kërkesës të përzgjedhur nga aplikuesi me rastin e aplikimit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, vetëm për sa i përket mbulimit financiar.

Diskriminimi mbi bazë të gjendjes shëndetësore

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar tri ankesa në lidhje me ndërmarrjen e veprime përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda.

104 R. nr. 522/2024

Avokati i Popullit ka publikuar një raport me rekomandime dhe i ka bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë që të zgjerojë listën e barnave esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe që kanë nevojë të domosdoshme për trajtim mjekësor më efektiv.

Për sa i përket ofrimit të kujdesit shëndetësor në institucionet e shëndetit publik, Avokati i Popullit vlerëson se qytetarët vazhdojnë të përballen me shërbime mjekësore jocilësore, trajtim joadekuat, vazhdon referimi i pacientëve në klinika private qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmes dekurajimit në forma të ndryshme të pacientëve për të mos vazhduar trajtimin në institucionet publike shëndetësore. Mungesa e funksionalizimit të Sistemit Informativ Shëndetësor, pastaj mungesa e sigurimeve shëndetësore godet rëndë shtresën e varfër të qytetarëve, të cilët, në pamundësi për të paguar shërbimet në klinikat private, kërkojnë shërbime shëndetësore në spitalet publike, me ç' rast ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor nuk plotëson as standardet minimale, sidomos qasja në raport me pacientin, e cila qasje është e nevojshme të ndryshohet me qëllim të trajtimit mjekësor të dinjitetshëm. Në raport me mungesën e Sistemit Informativ Shëndetësor ndërlidhur me respektimin e të drejtave për shërbime shëndetësore Avokati i Popullit këtë vit ka publikuar Raportin me rekomandime Ex.officio nr. 241/2022, lidhur mungesën e funksionalizimit të plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe pasojave që ka në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët.

Diskriminimi mbi bazën e Lirisë së Besimit, Ndërgjegjes dhe Fesë

Avokati i Popullit vlerëson se në Kosovë, Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë në përgjithësi respektohet në përputhje me Kushtetutën dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Edhe përkundër kësaj, Avokati i Popullit ka trajtuar 2 çështje që kanë të bëjnë me Lirinë e Besimit, Ndërgjegjes dhe Fesë.

Çështja e parë ka të bëjë me mosnjohjen e bashkësive fetare dhe mungesën e statusit ligjor të disa bashkësive fetare, e cila vjen si pasojë e mosrregullimit të duhur ligjor dhe nevojës për nxjerrjen e një ligji të ri për liritë fetare. Edhe pse ligji aktual për liritë fetare në Kosovë ka përcaktuar qartë neutralitetin e shtetit në raport me besimet fetare, e përcaktuar me nenin 5 të tij, ku përcaktohet: *“Nuk do të ketë asnjë fe zyrtare.”*, ligji më tej nuk përcakton mënyrën e njohjes së bashkësive fetare.

Çështja e dytë ka të bëjë me përmbajtjen e formularëve për regjistrimin e popullsisë, ku në pjesën e pyetjes për përkatësinë fetare janë shënuar vetëm disa besime fetare në Kosovë, ani pse Ligji për Liritë Fetare konstaton se në Kosovë nuk do të ketë asnjë fe zyrtare.

Në të dy situatat, Avokati i Popullit vlerëson se si pengesë kryesore në përcaktimin në mënyrë të qartë të statusit juridik të bashkësive fetare është mosmiratimi i Ligjit për Liritë Fetare. Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, neni 5, paragrafi 4, përcakton: *“Të gjitha besimeve dhe bashkësive të tyre në Kosovë duke përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebrej, dhe Kishën Evangjeliste, do t'u ofrohet çdo lloj mbrojtjeje dhe mundësi për të gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuar me këtë Ligj.”*

Avokati i Popullit mbështetur në nenin 53 të Kushtetutës, që përcakton se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së, me qëllim të krijimit të opinionit për këtë çështje, ka analizuar disa raste të kësaj gjykate në kuptim të njohjes me ligj dhe regjistrim të bashkësive fetare. GjEDNj-ja e njuh lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë sipas nenit 9 të KEDNj-së.

Sipas GjEDNj-së, shtetet duhet të mbeten neutrale dhe të paanshme në çështjet fetare (*Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë*, 2000).

Për sa i përket njohjes me ligj dhe regjistrim, shtetet kanë një farë diskrecioni për të vendosur kushte për njohjen ligjore të grupeve fetare (*Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës kundër Rusisë*, 2010). Megjithatë,

mohimi arbitrar i regjistrimit ose njohjes mund të shkelë nenin 9 dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.

Sipas GjEDNJ-së, nuk guxon të ketë asnjë monopol për një degë të caktuar. Një shtet nuk mund të japë status ligjor ekskluziv për një degë të veçantë duke përjashtuar të tjerat pa një arsye legjitime (*Kisha Metropolitane e Besarabisë kundër Moldavisë, 2001*).

Çështjet e brendshme fetare (si konfliktet midis degëve të së njëjtës fe) duhet t'i lihen vetë komuniteteve fetare, jo shtetit (*Sindicatul "Păstorul cel Bun" kundër Rumanisë, 2013*). Megjithatë, shtetet nuk mund të bëjnë dallime arbitrare midis degëve të së njëjtës fe në atë mënyrë që të kufizojë të drejtat themelore (*Kisha e Scientologjisë Moskë kundër Rusisë, 2007*).

Një çështje tjetër për të cilën Avokati i Popullit ka pranuar ankesë gjatë vitit raportues ka të bëjë me largimin nga shkolla të një nxëneseje për shkak të mbajtjes së shamisë. Referuar këtij rasti, për të cilin Avokati i Popullit ka filluar hetimet, është analizuar Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 06/2014 - *Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta*. Nga përmbajtja që ka ky akt administrativ del se është e ndaluar veshja e uniformës fetare nga ana e nxënësve në shkollat publike në arsimin parauniversitar në Kosovë. Lidhur me këtë çështje ka pasur debat të vazhdueshëm për një kohë të gjatë. Avokati i Popullit edhe në të kaluarën ka dalë me qëndrime, të cilat janë bërë publike.

Duke parë se ky problem po vazhdon dhe nuk është arritur të zgjidhej përfundimisht, Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimeve të nisura në këtë rast do të publikojë edhe një opinion lidhur me këtë çështje. Qëndrimi që Avokati i Popullit mban për këtë çështje është se Udhëzimi MASHT nr.06/2014 nuk e plotëson kriterin e ligjshmërisë. Kjo për shkak se Ligji për Arsimin Parauniversitar nuk paraqet bazë të mjaftueshme për kufizim dhe se Udhëzimi nuk ofron ndonjë sqarim se çka paraqet uniformë fetare. Mospërcaktimi i asaj se çfarë paraqet uniformë fetare apo simbole fetare ka rezultuar

me ndalimin e vijimit të mësimi kryesisht për vajzat që bartin shami koke, e që në rastin konkret do të mund të përbënte diskriminim të shumëfishtë. Më tej, nga informatat që Avokati i Popullit i posedon dhe nga ajo çfarë dihet publikisht është se disa shkolla nëpër komuna të ndryshme lejojnë vijimin e mësimi për vajzat që bartin shami e disa shkolla nëpër komuna të tjera jo, duke krijuar kështu një situatë të paparashikueshme dhe deri diku arbitrare. Për më tepër, Avokati i Popullit e konsideron jetike për zhvillimin e fëmijës të drejtën në arsim dhe rikujton se, në rastin konkret, autoritetet përkatëse duhet të kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, që buron nga Kushtetuta dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Sipas nenit 3.1 të Konventës përcaktohet: "*Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.*"

Për sa i përket sigurisë dhe sulmeve ndaj objekteve fetare, Avokati i Popullit ka siguruar të dhënat nga Policia e Kosovës, sipas të cilave, për periudhën janar - dhjetor 2024 kanë ndodhur 53 raste të sulmeve në objekte fetare, prej të cilave 34 raste ose 64% kanë ndodhur në objektet myslimane, 16 raste ose 30% në ato ortodokse dhe 3 raste ose 6% në ato katolike. Natyra e sulmeve në 36 raste ose 68% kanë të bëjnë me vjedhje dhe vjedhje e rëndë, kurse 16 raste ose 30% kanë të bëjnë me asgjësim apo dëmtim të pasurisë, dëmtimi i varreve apo i kufomave dhe 1 rast ose 2% është nxitje e përçarjes apo mosdurimit.

Barazia Gjinore

Kushtetuta¹⁰⁵ përcakton: "*Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*" Ndërsa Ligji për Barazi Gjinore¹⁰⁶ e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë, që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor.

105 Kushtetuta, neni 7, paragrafi 2.

106 Ligji për Barazi Gjinore, neni 13.

Me qëllim të ushtrimit të mandatit të tij si institucion i barazisë, Avokati i Popullit ka trajtuar dhe ka përfunduar dy çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

Barazia gjinore në të drejtën në punë

Më 13 dhjetor 2024, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin Ex officio 535/2019 në lidhje me zbatimin e masave të veçanta të parapara me nenin 6 [Masat e veçanta] të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, nga ana e organeve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, në të gjitha nivelet, si dhe nga institucionet e tjera publike në Kosovë.

Sipas Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, institucionet publike janë të obliguara të marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.

Për këtë qëllim, Avokati i Popullit nëpërmes një pyetësi drejtuar institucioneve, autoriteteve dhe organeve publike ka siguruar informata lidhur me përfaqësimin gjinor dhe masat që këto kanë ndërmarrë për arritjen e barazisë gjinore. Deri në publikimin e raportit, pyetësorit i janë përgjigjur 50 autoritete publike, përfshirë këtu institucionet në nivel qendror dhe ato lokal.

Të ndara në tri nivele kryesore të hierarkive institucionale – niveli i lartë drejtues, niveli i mesëm drejtues, si dhe stafi mbështetës, shifrat tregojnë për një përfaqësim të pabarabartë gjinor.

Mesatarisht, pozicionet e larta drejtuese vazhdojnë të jenë dukshëm më të përfaqësuara nga burrat me 77.1%, dhe me vetëm 22.9% nga gratë. Ndërkaq në dy nivelet e tjera, në bazë të të dhënave, gratë përbëjnë rreth 31% të tyre, dhe burrat rreth 69%. Për rrjedhojë, mund të konstatohet se administrata shtetërore është më dominuar nga gjinia mashkullore, e aq më shumë në pozicione të larta vendimmarrëse.

Lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime lidhur me diskriminimin mbi baza gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit

të Radiotelevizionit të Kosovës. Avokati i Popullit ka vlerësuar se procesi i rregullt dhe i drejtë nga ana e RTK-së në rastin konkret është vënë në pyetje. Kjo jo vetëm për faktin që çështja i kthehet në rishqyrtim të njëjtin Komision Përzgjedhës, i cili me lëshimet që janë evidentuar nga Komisioni i Ankesave ka dëmtuar një proces rekrutues, por edhe për faktin se paqartësia dhe jotransparenca e rregulloreve të brendshme të punësimit ka ndikime negative të shumta në të drejtat e kandidatëve dhe punonjësve. Ndryshimi i shpeshtë i rregulloreve të brendshme, në rastin konkret brenda një afati tremujsh, nga ndryshimi i *Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Manxhmentit të Lartë të RTK-së*, e datës 17.05.2022, me numër protokolli 0097/22, deri në nxjerrjen e *Rregullores nr. 0165/22 për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, më datë 08.09.2022*, krijon pasiguri juridike. Siguria juridike është një ndër elementet kyçe të parimit të sundimit të ligjit. Ky parim siguron që ligjet, në këtë rast rregullat, të jenë të qarta dhe të sakta si dhe të parashikueshme.

Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret është shkelur edhe parimi i barazisë duke marrë parasysh faktin se nga katër kandidatët të cilët u janë nënshtruar proceduarave të rekrutimit, ankuesja ka qenë e vetmja kandidate femër.

Lidhur me çështjen e punësimit në sektorin publik, Avokati i Popullit, më 23 dhjetor 2024, ka publikuar Opinion lidhur me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet, rregullat e përgjithshme, kushtet e pranueshmërisë si dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Opinioni i është drejtuar kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, si dhe për dijeni i është dërguar ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së Kryeministrit/ Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Rasti ka të bëjë me aplikimin për pozitën stomatolog në QKMF në Fushë Kosovë, në Konkursin nr. 686, shpallur më 7 korrik 2022

nga Komuna e Fushë Kosovës/Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sipas pohimit të ankueses, komisioni për përzgjedhje e ka njoftuar për mbajtjen e testit me shkrim më 29 korrik 2022, përderisa për intervistën me gojë nuk e ka njoftuar fare.

Më tutje ankuesja pohoi se për emrat e kandidatëve dhe me pikët e fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ajo ka kuptuar kur ka shkuar në QKMF në Fushë Kosovë, ku është publikuar lista me emra dhe se tek emri i saj ishin dhënë pikët në testin me shkrim, ndërsa në rubrikën e pikëve të intervistës me gojë është shënuar “*ska ardh*”. Ankuesja shtoi se kundër kësaj liste të publikuar, më 29 gusht 2022, nëpërmjet postës i ka parashtruar ankesë Komisionit të Ankesa në Komunën e Fushë Kosovës, por sipas saj, ajo nuk ka marrë përgjigje në ankesën e saj.

Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje në Opinionin e dërguar, duke vlerësuar se Komuna e Fushë Kosovës, përveç shkeljeve të shprehura në Opinionin e Avokatit të Popullit, është një ndër komunat më mosbashkëpunuese me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Barazia gjinore në të drejtën në pronë dhe në trashëgimi

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë Kadastarale e Kosovës, të reflektuara në raportet vjetore të kësaj agjencie, vërehet një trend i rritjes në regjistrimin e pronave në emër të femrave. Megjithatë numri i pronareve gra mbetet i ulët. Të dhënat e fundit tregojnë se vetëm 19.79% të pronave të regjistruara janë gra.

Avokati i Popullit, më 20 nëntor 2024, ka mbajtur e një tryezë ku janë shtruar çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të grave dhe veprimet e autoriteteve publike.

Si përfundim i përbashkët nga kjo tryezë doli se legjislacioni i Republikës së Kosovës siguron të drejta plotësisht të barabarta pronësore për të gjithë pa dallime dhe përmban masa siguresë për realizimin e këtyre të drejtave.

Përkundër këtij fakti, sfidat kryesore për

gëzimin e plotë të të drejtave pronësore nga ana e grave paraqiten në praktikë e që janë: e drejta zakonore; normat kulturore; informaliteti; mosinformimi i mjaftueshëm për të drejtat në trashëgimi; mosinformimi i të gjithë trashëgimtarëve për iniciimin e procedurës së trashëgimisë; si dhe zvarritjet e procedurave gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave pronësore. Po ashtu, sfidat e tjera janë heqja dorë nga trashëgimia, realizimi i të drejtave në trashëgimi nga bashkësia jomartësore dhe një numër çështjesh të cilat u shpalosën sikur nga panelistët, ashtu edhe nga pjesëmarrësit.

Një ndër çështjet që vazhdimisht identifikohet si pengesë për realizimin e të drejtave pronësore të grave dhe të vajzave e që është trajtuar edhe në këtë tryezë, është heqja dorë nga prona, e cila përcaktohet me ligj, por që lidhur me këtë të drejtë shfaqen qëndrime të ndryshme nëse heqja dorë do të duhej të bëhej pas fitimit të pronës, gjë që do të forconte pozitën e grave dhe të vajzave për nga aspekti i të drejtave të tyre.

Konkluzionet kryesore që dolën nga kjo tryezë janë: zbatimi i plotë i ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore; vetëdijesimin dhe informimin e plotë të grave për të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe ligj; si dhe zvogëlimin e informalitetit në të drejtat pronësore.

Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje

Në fund të tetorit të vitit 2023 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore. Për dallim nga Ligji Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ligji i ri sjell ndryshime dhe përmirësime në mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Risitë që sjell ligji i ri përfshin jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore dhe trajton një spektër më të gjerë të formave të dhunës. Janë shtuar përkufizimet e formave të dhunës, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike dhe forma të tjera të dhunës gjinore. Janë përcaktuar

mekanizmat për parandalim dhe trajtim të rasteve të dhunës si dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve relevante. Janë parashikuar fushat edukative dhe të ndërgjegjësimit, janë vendosur mekanizma për raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës, duke siguruar mbledhjen e të dhënave të sakta dhe veprime të shpejta.

Që nga data 14 prill 2019 është në fuqi Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i cili e kriminalizon dhunën në familje si vepër të veçantë penale. Si forma të kryerjes së kësaj vepre penale janë përcaktuar: keqtrajtimi fizik, seksual, psikologjik dhe ekonomik. Kjo vepër penale është ndër veprat e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe jo sipas propozimit. Kriminalizimi i dhunës në familje është standard i vendosur nga Konventa e Stambollit. Po ashtu me standardet e përcaktuara me këtë konventë, ndjekja penale për dhunë në familje nuk është e kushtëzuar me propozimin e viktimës së dhunës në familje.

Më 10 dhjetor 2024, në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në bazë gjinore është lansuar sistemi i hallkave për mbikëqyrje elektronike. Avokati i Popullit e vlerëson se aktivizimi i këtij sistemi është zbatim i ligjit pas 10 vitesh dhe mundëson monitorimin elektronik të masave mbrojtëse të kufizimit të afrimit ndaj palës së mbrojtur. Lansimin e hallkave elektronike, Avokati i Popullit e ka adresuar dhe e ka përsëritur vite me radhë, e që në fakt ka qenë pengesë në zbatimin e Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, ligj ky i cili ka qenë dashur të zbatohet qysh nga 1 korriku i vitit 2015.

Rrjedhimisht mund të thuhet se Kosova ka ndërmarrë veprime të shumta në drejtim të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Megjithatë dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna mbi baza gjinore vazhdon të mbetet e përhapur dhe se nga

viti në vit ka shënuar rritje. Sipas të dhënave që i kemi siguruar nga Policia e Kosovës, vazhdon të ketë rritje të rasteve të dhunës në familje. Përderisa vitin e kaluar ishin raportuar 2460 raste, këtë vit janë raportuar 2547 raste.

Nga informatat që kemi kërkuar nga Policia e Kosovës për vitin 2024, janë raportuar 102 raste për ngacmimet seksuale, sipas nenit 183 - Ngacmimi Seksual.

Sidoqoftë, Avokati i Popullit nga hetimi i rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, përkatësisht mbikëqyrjen e veprimeve të autoriteteve përkatëse në trajtimin e rasteve të dhunës, disa herë ka ardhur në përfundim se rastet e dhunës në familje nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate, me ç' rast shteti nuk ka arritur t'i përmbushte detyrimet pozitive për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Përderisa ekziston një kornizë ligjore e avancuar përkitazi me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, ndërsa dhuna në familje vazhdon të jetë një fenomen shqetësues, Avokati i Popullit vlerëson se çështja ka të bëjë me moszbatim të plotë të politikave, strategjisë, ligjeve dhe standardeve nga ana e autoriteteve përgjegjëse.

Avokati i Popullit përmes raporteve të adresuara vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve për detyrimet pozitive të shtetit në drejtim të marrjes së masave të përshtatshme për mbrojtjen e së drejtës për jetë dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, duke konstatuar se këto masa duhet të jenë të koordinuara, efektive dhe në përputhje me legjislacionin dhe procedurat standarde të veprimit.¹⁰⁷

Organizatrat e shoqërisë civile kanë paraqitur qëndrime të ngjashme në raportet e tyre hulumtuese në dështimin e shtetit në mbrojtjen nga dhuna në familje. Me këtë rast mund t'i referohemi raportit të publikuar nga

107 <https://oik-rks.org/2022/07/22/raport-ex-officio-132022-perkitazi-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-pe-te-mbrojtur-te-drejten-ne-jete-dhe-per-te-siguruar-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje/>
<https://oik-rks.org/2021/04/27/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1502021-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-per-te-drejten-ne-ujete-dhe-mbrojtjen-nga-dhuna-ne-familje/>

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), *Konventa e Stambollit në Aktgjykimet e Gjykatave në Kosovë*,¹⁰⁸ ku vihen në pah çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga ana e gjyqësorit.

Ky raport ka analizuar 50 aktgjykime lidhur me dhunën në familje. Sipas raportit, rastet e dhunës në familje trajtohen brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe që mesatarja e trajtimit të lëndëve nga momenti i kryerjes deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallën e parë është 266 ditë apo 8.5 muaj. Më tej është konstatuar se cilësimi juridik i veprës penale për rastet e dhunës në familje nuk bëhet në pajtim me Kodin Penal dhe as me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, sipas Kodit Penal të Kosovës. Nga 50 raste të analizuar, 29 prej tyre janë trajtuar në drejtim të veprës penale *dhunë* në familje, nga neni 248 i Kodit Penal, derisa në 6 raste vepra është cilësuar si *dhunë në familje* dhe krahas saj është shtuar edhe një vepër penale. Rastet e tjera janë cilësuar si lëndim i lehtë trupor, sulm apo kanosje për të cilat Kodi Penal parasheh dënime më të vogla sesa për dhunën në familje. Sipas gjetjeve të këtij raporti është konstatuar se për rastet e dhunës në familje zbatohen dënime të buta ndëshkimore, duke marrë parasysh faktin se për një numër të vogël të rasteve është shqiptuar dënim me burgim efektiv. Nga 50 aktgjykimet e analizuar, ndaj 37 prej tyre është shqiptuar burgim me kusht, ndërsa vetëm ndaj 5 personave gjykatat themelore kanë shqiptuar dënime me burgim efektiv. Ndërsa siç thuhet në raport, është identifikuar një rast skandaloz i dhunës në familje, ku Prokurori i Shtetit kundërligjshëm është tërhequr nga akuza, me arsyetimin se palët janë ish-bashkëshortë, duke amnistuar kundërligjshëm të pandehurin për dhunë në familje. Përveç të tjerash, në analizën e 50 aktgjykimeve të gjykatave themelore rezulton se nga këto 50 raste, vetëm në 11 prej tyre viktimat e dhunës në familje janë përfaqësuar në procedurë gjyqësore përmes mbrojtësve të viktimave, në dy raste ka qenë

e pamundur të kuptohet nëse viktimat janë përfaqësuar përgjatë procesit gjyqësor apo jo.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit është se përkundër masave të ndërmarra, strategjive të aprovuara dhe avancimit të legjislacionit me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore, prezenca e dhunës në familje është e lartë duke u referuar në numrin e rasteve të raportuara. Prandaj është e domosdoshme që autoritetet përgjegjëse në koordinim të rivlerësojnë politikat institucionale me qëllim të parandalimit përmes edukimit të hershëm, vetëdijësimin të publikut dhe masave të tjera që do të ndikonin në parandalim. Është domosdoshëm unifikimi i masave mbrojtëse dhe i politikave ndëshkimore nga ana e gjykatave me qëllim të respektimit të së drejtës për drejtësi për viktimat. Duhet të jetësohen në praktikë politikat institucionale të miratuara për fuqizimin ekonomik të viktimave si parakusht për parandalimin e rasteve të përsëritjes së veprave penale dhe riviktimizimit si dhe masave të tjera të fuqizimit të pozitës së gruas në shoqëri.

Gratë viktimat/mbijetuarat të dhunës seksuale gjatë luftës

Duke pasur parasysh shqetësimet e vazhdueshme të ngritura për çështje që ndërlidhen me procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës si dhe pengesat në realizimin e beneficioneve që u takojnë viktimave mbi bazën e ligjit, Avokati i Popullit në vitin 2023 ka iniciuar hetime mbi këtë çështje, sipas detyrës zyrtare.¹⁰⁹

Trajtimi i kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit dhe perspektiva e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut fokusohet në respektimin e afateve ligjore nga ana e komisionit, në procesin e trajtimit të aplikacioneve për verifikim dhe njohje të statusit të viktimës; individualizimi i arsyetimit të vendimeve për secilin rast veç e veç,

108 <https://kli-ks.org/konventa-e-stambollit-ne-aktgjykimet-e-gjykatave-ne-kosove/>

109 Rasti ex-officio nr. 436-2023

duke u shmangur arsyetimeve shabllone apo të njëjta për raste të ndryshme; kufizimi i afatit kohor për dorëzimin e aplikaiconeve; organizimi dhe realizimi i procesit të intervistimit të viktimave si edhe qasja e viktimave në hapësirat ku realizohet intervistimi; si dhe ngritja e vetëdijesimit dhe sensibilizimit të opinionit publik për aplikim për njohje dhe verifikim të statusit të viktimës.

Më 24 gusht 2024, Avokati i Popullit publikoi raportin mbi respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, si dhe pengesat në realizimin e beneficioneve të garantuara me ligj. Raporti iu dorëzua autoriteteve përkatëse për shqyrtim dhe veprime të mëtejshme.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se Rregullorja nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës përmban zbrazëtira ligjore që krijojnë pasiguri dhe paqartësi në procedurën e njohjes së statusit. Konkretisht mungon përcaktimi i qartë i afateve kohore për zhvillimin e procedurës dhe nxjerrjen e vendimeve, duke krijuar konfuzion midis afateve të ndryshme të përcaktuara në rregulloren dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjithashtu, terminologjia e përdorur për mjetet juridike në dispozicion, si “ankesë” dhe “kërkesë për rishqyrtim”, është e paqartë dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm.

Avokati i Popullit gjithashtu ngriti shqetësime mbi mënyrën e trajtimit të viktimave gjatë procesit të intervistimit, duke theksuar nevojën për ruajtjen e konfidencialitetit, shmangien e ritraumatizimit dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore. Është thelbësore që objektet ku zhvillohen intervistat të jenë të qasshme për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, dhe që oraret të organizohen në mënyrë që të shmanget ballafaqimi i viktimave.

Raporti gjithashtu evidenton vonesat në pajisjen e viktimave me kartela identifikuese, të parashikuara në nenin 37 të Rregullores, si dhe mungesën e dispozitave për mbështetje

psiko-sociale për viktimat, e cila është thelbësore për riintegrimin e tyre në shoqëri.

Rekomandimet specifike janë adresuar për Qeverinë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për të siguruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK), në vitin 2023, ka ngritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin Special, aktakuzat e para për gjykim në mungesë, kundërtë akuzuarve për dhunim gjatë luftës në Kosovë, përkatësisht aktakuza e parë është ngritur më 2 maj 2023. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur për rastin e parë të dënimit për dhunim seksual gjatë luftës, duke refuzuar si të pabazuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit dhe të të dënuarit Z. V., të paraqitura kundër Aktgjykimit PS.nr.28/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, datë 11.11.2022, dhe Aktgjykimit APS.nr.50/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, datë 15.2.2023.

Diskriminimi mbi bazën e përkatësisë etnike

Avokati i Popullit ka analizuar edhe të dhëna për sa i përket përfaqësimit etnik në sektorin publik. Lidhur me punësimin në sektorin publik nga radhët e komuniteteve joshumicë, Avokati i Popullit më 30 gusht 2024 i dërgoi një shkresë Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për të kërkuar informata lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkitazi me përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, që sipas ligjit duhet të jetë 10% në nivel qendror. Avokati i Popullit ka kërkuar informata nëse kuota prej 10% nënkupton që secili institucion publik në nivel qendror duhet që minimum 10% të vendeve punës të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve apo nëse ky 10% i vendeve të punës nënkupton së bashku të gjitha institucionet publike qendrore. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar informata statistikore të të punësuarve në institucionet

publike qendrore (përfshirë agjencitë dhe institucionet e pavarura), të ndara sipas përkatësisë etnike.

Më 30 shtator 2024, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga MPB-ja, sipas së cilës, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, edhe pas shfuqizimit, por edhe me Ligj të ri për Zyrarë Publikë, përcakton të njëjtën dispozitë për kuotën prej 10% të vendeve të punës nga komunitetet joshumicë në nivel qendror në institucione publike, por që ligji në fjalë nuk e ka specifikuar që kjo përqindje të arrihet në secilin institucion publik, por si një tërësi, njëjtë sikurse përcaktohet edhe në Rregulloren 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil. Gjithashtu, në këtë përgjigje të MPB-së thuhet se institucionet publike, me qëllim të plotësimit të kuotës së përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar.

Sipas statistikave të dërguara nga MPB-ja vërehet se të dhënat statistikore janë të vitit 2022. Raporti për numrin e të punësuarve nga radhët e komuniteteve joshumicë në shërbimit civil, i ndarë sipas përkatësisë etnike në institucione shtetërore në nivel qendrore tregon se: 92.2% janë të punësuar shqiptarë, 4.1% serbë, 0.8% boshnjakë, 0.6% turq, 0.6 të tjerë dhe 2.4% të padeklaruar. Sipas të dhënave të dërguara vërehet se nuk ka të dhëna për komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët, kroatët dhe malazezët. Nuk ka ndonjë sqarim apo arsye shtesë për mospërfshirjen e këtyre komuniteteve në të dhëna statistikore të dërguara nga MPB-ja.

Kur bëhet fjalë për incidente ndëretnike, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, janë raportuar 25 raste, 24 janë për shkak të nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit dhe 1 rast është shkaktim i rrezikut të përgjithshëm. Ndërsa nuk ka pasur raste të raportuara lidhur me gjuhën e urrejtjes.

Të drejtat e personave LGBTIQ+

Avokati i Popullit, më 15 janar 2024, ka publikuar Raportin *ex officio* nr. 146/2021 Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë

së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

Raporti analizon gjuhën e përdorur në komunikimin publik në Kosovë gjatë viteve 2020-2022, duke u fokusuar në gjuhën e urrejtjes në seancat parlamentare, debatet televizive dhe komentet në mediat sociale. Studimi evidenton shkaqet dhe objektivat e gjuhës së urrejtjes, përfshirë përkatësinë politike, etnike, fetare, seksuale dhe gjinore. Gjithashtu, theksohet ndikimi i diskursit mediatic në nxitjen e urrejtjes në rrjetet sociale dhe mungesa e moderimit të përmbajtjes.

Disa nga gjetjet e raportit ka të bëjë më të drejtat e personave LGBTIQ+, si në vijim:

Në Seancat parlamentare (2020-2022) nuk u gjetën nxitje të drejtpërdrejta të urrejtjes, por u identifikua “gjuhë e butë e urrejtjes” dhe shprehje diskriminuese të fshehura.

Debatet televizive dhe rrjetet sociale gjuha e urrejtjes është më e përhapur në komentet online, shpesh të ndikuara nga temat e debatit. 86% e komenteve të tilla vijnë nga burra dhe kryesisht synojnë figura publike, orientimin seksual dhe përkatësinë etnike.

Platformat e mediave sociale 1 në 15 komente përmban gjuhë urrejtjeje. Kategori më të shenjëstruara janë seksualiteti, bindjet politike dhe përkatësia etnike. Temat më të ndjeshme lidhen me martesat e të njëjtit seks dhe çështjet ndëretnike.

Raporti thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit të publikut dhe bashkëpunimit ndërinstytucional për të luftuar këtë fenomen në mënyrë efektive.

Avokati i Popullit, më 1 mars 2024 ka pranuar ankesë kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës, që lidhej me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të personave LGBTIQ+ gjatë seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 16 mars 2022. Ankesa është paraqitur në emër të organizatave të mëposhtme joqeveritare: “Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” e Kosovës (YIHR), “Qendra për Barazi dhe Liri”, “Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore”, “Mbrojtësit e të Drejtave Qytetare”, “Qendra Kosovare për Studime Gjinore”, të cilat me autorizim përfaqësohen

nga “Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” e Kosovës.

Duke marrë parasysh se ankuesit, më 1 mars 2024, në të njëjtën ditë kur kanë paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit, kanë paraqitur edhe padinë (C.nr 2993/2024) në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave të rastit, ka vendosur t’ia paraqesë kësaj gjykate mendimin e tij në cilësinë e *mikut të gjykatës (amicus curiae)*.

Më 17 tetor 2024, Avokati i Popullit ka dërguar një *amicus curiae* në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në të cilën, ndër të tjerash, ai ka theksuar se në kontekst të rastit ka parasysh rëndësinë e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ka theksuar se çdo individ ka të drejtë të shprehë mendimin dhe qëndrimet e tij personale, gjë që përbën bazën e çdo shoqërie të lirë demokratike. Megjithatë, e drejta për lirinë e fjalës, pavarësisht mënyrës së shprehjes dhe publikimit të ideve dhe të qëndrimeve, nuk duhet të jetë një justifikim për diskriminim. Prandaj shprehja e qëndrimeve dhe e bindjeve që e shkelin dinjitetin e personave ose të grupit të personave dhe dëmtojnë reputacionin, si dhe të drejtat e garantuara të të tjerëve, nuk mund të justifikohet me të drejtën për lirinë e shprehjes.

Këto qëndrime dhe deklarata kanë një peshë të veçantë kur merret parasysh se deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë pjesë e një institucioni, i cili është organi më i lartë përfaqësues dhe bartësi i pushtetit kushtetues dhe legjislativ në vend dhe që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendosjen e sistemit demokratik dhe që përfaqëson bazën për vendosjen e sundimit të ligjit, mbikëqyrjen e proceseve të qeverisjes dhe respektimin e instrumenteve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit e ka parasysh se deputetët kanë imunitet lidhur me deklaratat e tyre në parlament, megjithatë ky imunitet do të duhej të shqyrtohej kur bëhet fjalë për deklaratat që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim

dhe thekson se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është marrë me rastet që përfshijnë gjuhën diskriminuese të përdorur nga zyrtarët publikë, përfshirë politikanët dhe zyrtarët qeveritarë, në të cilat vazhdimisht ka mbështetur dënimet dhe sanksionet kundër zyrtarëve publikë, deklaratat e të cilëve mendohej se përbënin gjuhë të urrejtjes, duke pohuar rëndësinë e nxitjes së tolerancës dhe mbrojtjen e grupeve të cenushme nga diskriminimi.

Avokati i Popullit e ka vlerësuar se deklaratat e përfaqësuesve të popullit, të cilët përcjellin mesazhe dhe formësojnë qëndrimet e opinionit publik, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, prandaj deklaratat e tyre nuk duhet të mbështesin paragjykimet, stereotipat dhe modelet e tjera të papranueshme shoqërore. Për këtë arsye, të gjithë zyrtarët shtetërorë dhe organet publike kanë një përgjegjësi të veçantë dhe një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në promovimin e tolerancës, në promovimin e së drejtës për dallim dhe krijimin e një shoqërie ku të drejtat e të gjithëve respektohen pa diskriminim.

Avokati i Popullit vlerëson se deklarata e deputetëve të bëra më 16 mars 2022, gjatë debatit në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjatë shqyrtimit të nenit të Projektkodit Civil nr. 08/L-124, lidhur me nenin 1138, paragrafi 2, janë diskriminuese, shkelin dinjitetin e personave LGBTIQ+ duke krijuar një mjedis poshtërues dhe fyes ndaj tyre dhe, duke u bazuar në praktikën e GjEDNj-së, përbëjnë gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+.

Për sa u përket të drejtave të personave nga komuniteti LGBTIQ+, Avokati i Popullit, më 10 qershor 2024, nëpërmes një deklarimi publik ka shprehur zhgënjim dhe shqetësim për shkak të vandalizmit të simboleve LGBTIQ+, përkatësisht vandalizmit të vendkalimit në rrugën “Xhorxh Bush”, i cili është ngjyrosur me ngjyrat e ylberit për nder të Javës së Krenarisë. Avokati i Popullit dënon fuqishëm gjuhën fyese dhe diskriminuese që është përdorur me rastin e vandalizmit të simboleve të personave LGBTIQ+.

Avokati i Popullit e ka bërë të ditur se veprime

të tilla janë të papranueshme në një shoqëri ku vlerat kushtetuese bazohen në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave të njeriut, të sundimit të ligjit dhe të mosdiskriminimit.

Avokati i Popullit, më 22 korrik 2024 ka pranuar një ankesë nga G. M., parashtruar kundër Policisë së Kosovës (PK), për shkak të mosinformimit për denoncimin që ai ka paraqitur më 20 qershor 2024, që ka të bëjë me veprën penale sipas nenit 141 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas pohimeve të ankuesit, në Instagram në “meme.shqip.video” është shfaqur një video nga “Prishtina Pride 2024”, ku pjesëmarrës është edhe kryeministri i vendit dhe në këtë video ka komentuar një person (A. B. me llogarinë e tij në Instagram), si: *“Kapni pushkatonin kta hakubeta mos të na flliqin [...]”*, me çka ankuesi ka theksuar se ishin përmbushur elementet e veprës penale të përcaktuar me nenin 141 (Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ankuesi e ka denoncuar rastin në PK nëpërmjet adresës elektronike zyrtare të policisë, por nuk është informuar nëse është trajtuar dhe proceduar ky rast nga ana e PK-së. Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë drejtorit të përgjithshëm të PK-së për t’u informuar për veprimet që janë ndërmarre apo që planifikohen të ndërmerren nga policia në rastin e denoncuar nga ankuesi. Avokati i Popullit është njoftuar nga drejtori i përgjithshëm i PK-së se me ta pranuar shkresën e Avokatit të Popullit, PK-ja e ka trajtuar çështjen e ngritur nga ankuesi, janë ndërmarrë veprime të menjëhershme duke e adresuar për trajtim te njësitet relevante të PK-së. Me tutje drejtori ka njoftuar se Sektori i Hetimeve të Kryeqytetit, në konsultim me prokurorin kujdestar, ka hapur shënimin zyrtar me nr. 2024-AB-SHZ-463, me ç’ rast janë ndërmarrë veprime në drejtim të identifikimit të personit të dyshuar. Në njoftim thuhej se ankuesi është kontaktuar nga PK-ja nëpërmjet postës elektronike dhe i është kërkuar që të paraqitej në Stacionin

Policor “Qendra”, përkatësisht në Sektorin e Hetimeve të Kryeqytetit, për t’i ofruar informatat më të hollësishme që ai mund t’i posedonte. Avokati i Popullit vlerëson reagimin e PK-së dhe se do të vazhdojë të përcjellë punën e organeve të ndjekjes në rastet e nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit drejtuar ndaj komunitetit LGBTQ+.

Sipas të dhënave që i kemi siguruar nga Policia e Kosovës, janë raportuar pesë raste të veprave penale ndaj komunitetit LGBTI, një rast i nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit, një rast lëndim trupor, një rast shantazh përmes rrjeteve sociale, dy raste të kanosjes.

Më 30 prill 2024, Avokati i Popullit ka miratuar Udhëzuesin për Praktikën e Mira-Trajtimi i rasteve të personave LGBTQ+¹¹⁰, i cili është publikuar në ueb-faqen e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Po ashtu, Avokati i Popullit, më 25 mars 2024 ka miratuar Udhëzuesin për Trajtimin e Rasteve të Krimit të Urrejtjes¹¹¹, i cili është në ueb-faqen e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Viktimizimi dhe forma të tjera të diskriminimit

Avokati i Popullit ka trajtuar një ankesë të parashtruar nga G.F. kundër Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), për shkak të shkeljes së procedurave ligjore me rastin e dhënies së rekomandimit për suspendimin e tij nga puna prej 27 shtatorit 2018 deri më 10 janar 2019 dhe efektet negative që këto veprime i kanë shkaktuar atij në ndërtimin e karrierës.

Më 20 qershor 2024, Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandime duke konstatuar se zgjatja e procedurës hetimore penale nga IPK-ja prej vitit 2018 përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe shkel të drejtën e ankuesit për mjete efektive juridike, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Avokati i Popullit gjatë hetimit të rastit ka vërejtur se ankuesi

110 <https://oik-rks.org/2025/02/18/udhezues-per-praktika-te-mira-trajtimi-i-rasteve-te-personave-lgbtqi/>

111 <https://oik-rks.org/2025/02/18/udhezues-per-trajtimin-e-rasteve-te-krimit-te-urrejtjes/>

nuk është ankuar se është i diskriminuar mbi ndonjërin nga bazat e përcaktuara me ligj. Megjithatë, raportimi i ankuesit në IPK në lidhje me dyshimet për vepër penale gjatë implementimit të kontratës për furnizime [...] në PK dhe fillimi i një procedure parapenale nga IPK-ja ndaj tij, ngre dyshime për viktimizimin e tij dhe vendosjen e tij në kushte të disfavourshme, që në rastin konkret mund të cilësohet si viktimizim për shkak të raportimit për keqpërdorime.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar edhe ankesa me pretendime për shkëputje të kontratës apo transferim nga një pozitë në tjetrën për shkak të përkatësisë dhe mendimeve politike. Avokati i Popullit në dy këto rasteve ka dërguar opinione *amicus curiae* në gjykatë ku ankuesit kanë parashtruar padi, më shumë për shkak se vendimet për shkarkim dhe transferim duket se kanë qenë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë ose janë nxjerrë nga autoritetet jokompetentë.

Praktikat e përgjithshme të cilat bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit

Duke u nisur nga gjetjet e sipërpërmendura, Avokati i Popullit si përfundim sjell të përmbledhura disa nga praktikat që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit:

- Mungesa e të dhënave për rastet e diskriminimit krijon një pasqyrë të pasaktë të situatës reale që ka të bëjë me rastet e diskriminimit si dhe mosemërimi i zyrtarëve për mbrojtjen nga diskriminimi pengojnë zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD).
- Diskriminimi në trajtimin e kategorive të mbrojtura, siç janë personat me aftësi të kufizuara, individët me orientim seksual ndryshe, apo ata që përballen me diskriminim të bazuar në moshë, etni apo besim fetar, janë gjithashtu problematika që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve.
- Avokati i Popullit ka vërejtur se diskriminimi mbi bazën e moshës është një fenomen shqetësues, ku perceptimi i moshës si

një faktor që sjell diskriminim është ende i pranishëm. Ky diskriminim i shumëfishtë është veçanërisht i theksuar te të moshuarit, të cilët përballen me kufizime të ndryshme, duke përfshirë edhe ato që lidhen me shëndetin mendor dhe kujdesin social. Shërbimet e ofruara për këtë grupmoshë shpesh janë të papërshtatshme dhe nuk ofrojnë mbështetje të duhur.

- Në fushën e punësimit, diskriminimi në proceset e rekrutimit dhe mungesa e transparencës janë shqetësime të vazhdueshme. Dështimi për të ofruar mundësi të barabarta për aplikuesit dhe diskriminimi i grupeve të caktuara janë fenomene që ndodhin shpesh, duke e vështirësuar përparimin dhe barazinë e mundësive për të gjithë.
- Një tjetër çështje e rëndësishme është pabarazia gjinore në pozitat drejtuese, ku burrat dominojnë në mënyrë të ndjeshme. Gratë ende përballen me barriera për të arritur pozita vendimmarrëse; diskriminimi gjinor është gjithashtu evident në çështjet pronësore dhe trashëgimisë, ku normat kulturore dhe informacioni i pamjaftueshëm për të drejtat pronësore e vështirësojnë qasjen e grave në këto të drejta. Po ashtu, përfaqësimi i pamjaftueshëm i grave në listat e kandidatëve të partive politike është çështje që ka ngritur shqetësime. Ligji parashikon një kuotë minimale prej 30% për secilën gjini, por në praktikë përfaqësimi i grave mbetet i ulët.
- Dhuna në familje dhe dhuna gjinore vazhdojnë të mbeten të pranishme, pavarësisht përpjekjeve për t'i ndaluar këto fenomene.
- Afatet e paqarta dhe arsyetimi i përgjithshëm për vendimet e njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës krijojnë pasiguri dhe mund ta përkeqësojnë situatën e viktimave. Vonesa për pajisjen e viktimave me kartela identifikuese dhe mungesa e mbështetjes psiko-sociale ndikojnë negativisht në riintegrimin e tyre.

- Diskriminimi etnik, i cili manifestohet në punësimin në sektorin publik, është një tjetër sfidë. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i komuniteteve joshumicë, në veçanti romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, vazhdon të jetë problematikë që duhet adresuar për të siguruar përfshirje të barabartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.
- Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ vazhdon të mbetet i pranishëm, në veçanti në mediat sociale, ku përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe komentet negative kanë krijuar një atmosferë të pafavorshme dhe të dëmshme për këtë komunitet. Diskriminimi institucional është evidentuar gjatë seancave parlamentare e që ndikojnë negativisht në dinjitetin dhe në të drejtat e këtij grupi.

Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

Republika e Kosovës është e ndërtuar bazuar në vlerat e respektimit të të drejtave dhe lirive të komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë, duke garantuar respektimin e të drejtave politike, civile dhe të drejtat e tjera në përputhje me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të pakicave, siq është e përcaktuar në Kapitullin 3 të Kushtetutës - Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarët e tyre. Në këtë kapitull të Kushtetutës janë përcaktuar të drejtat e veçanta për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre.

Komunitetet joshumicë vazhdojnë të përballen me sfida të shumta në ushtrimin e të drejtave të tyre, në përgjithësi me sfida të ngjashme me të cilat ballafaqohet çdo qytetar i Republikës së Kosovës, kryesisht me mungesë të zbatimit të plotë të ligjeve, në këtë rast referuar Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, zbatimit të LMD-së, kushteve në arsim dhe punësimit.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar 214 ankesa të parashtruara nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, nga

të cilat 110 janë paraqitur nga pjesëtarët e komunitetit serb, 23 nga pjesëtarët e komunitetit ashkali, 20 nga pjesëtarët e komunitetit boshnjak, 17 nga pjesëtarët e komunitetit rom, 12 nga pjesëtarët e komunitetit turk, 10 nga pjesëtarët e komunitetit egjiptian, 7 nga pjesëtarët e komunitetit goran dhe 15 nga komunitetet e tjera. Nga përmbajtja e ankesave të pranuar mund të konstatohet se problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve joshumicë janë ende të njëjta si në vitet paraprake, që është tregues se autoritetet e kanë obligim të merren më me konsistencë me çështjet për të cilat Avokati i Popullit raporton nga viti në vit. Problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet joshumicë nuk mund të vërehen vetëm nga ankesat e parashtruara, por edhe duke e monitoruar gjithë situatën në terren, nga takimet me qytetarë, me organizata të shoqërisë civile, përmes tryezave të organizuara dhe formave të tjera të bashkëpunimit që kanë pasur për qëllim ndër të tjerash edhe identifikimin e çështjeve që janë me interes për t'u trajtuar nga Avokati i Popullit, çështje që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Kthimi dhe Siguria

Gjatë vitit raportues, sipas të dhënave që kemi pranuar nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, janë kthyer vullnetarisht 66 persona nga komunitetet joshumicë, nga të cilët 7 ashkalinj, 4 boshnjakë, 29 romë, 26 serbë. Ndërsa sipas vendeve ku janë, 48 nga ta janë kthyer në komunën e Gjilanit, 6 në Pejë dhe 12 në Prishtinë.

Nga ankesat që kemi pranuar, Avokati i Popullit vëren se shqetësimet më të mëdha të shprehura nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë janë: mosrespektimi i të drejtave gjuhësore, çështja e mosnjohjes së diplomave, problemet me pajisje me dokumente personale për shkak të problemeve të regjistrimit në regjistrat civil, etj.

Avokati i Popullit vazhdimisht ka theksuar se bojkotimi i institucioneve të Republikës së Kosovës dhe braktisja e vendeve të punës në formë bojkoti nga pjesëtarët e komunitetit

serb që jetojnë në pjesën e veriut të Kosovës, ka përkeqësuar gjendjen e këtij komuniteti në përfaqësim institucional. Këtë gjendje e ka përshkallëzuar edhe më tej bojkotimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale në këto komuna dhe mospjesëmarrja në votimin për ose kundër shkarkimit të kryetarëve të këtyre komunave.

Bazuar në raportin e Policisë së Kosovës, nga janari deri në fund të nëntorit 2024 janë regjistruar 23 raste të mundshme ndëretnike të karakterit *nxitje e përçarjes dhe mosdurimit*, dhe 1 rast *shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*. Nga këto, në 19 raste palë e dëmtuar janë shqiptarë, 3 janë serbë dhe 1 rast ndaj komunitetit rom.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) edhe këtë vit, duke vepruar në përputhje me mandatin dhe kompetencat e saj, ka ndihmuar dhe ka ofruar mbështetje për të gjithë të kthyerit dhe komunitetet në Kosovë. Avokati i Popullit e vlerëson punën e MKK-së në rritjen e kapaciteteve të ndihmës për popullatën joshumicë jo vetëm për sa i përket dhënies së ndihmës për të kthyerit, por edhe në zbatimin e një numri të madh projektesh, me të cilat janë përfshirë organizatat e shoqërisë civile nga të gjitha komunitetet njësoj, kompanitë e vogla private sipërmarrëse, fermat bujqësore dhe fermerët individualë, si dhe ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive për pjesëtarët e cenueshëm të komuniteteve joshumicë të Kosovës.

Është inkurajues angazhimi i autoriteteve përgjegjëse në reagimin e tyre lidhur me rastin e një familjeje të komunitetit kroat në fshatin Janjevë, komuna e Lipjanit.¹¹² Rasti ka të bëjë me një ankesë lidhur me kushtet e rënda dhe të rrezikshme, në të cilat jetojnë tri gra të moshuara, në një shtëpi të vjetër mbi 150-vjeçare, e cila gjendet në pjesën e mbrojtur kulturore dhe historike të Janjevës. Pas pranimit të ankesës, Avokati i Popullit ndërmori një iniciativë së bashku me OSBE-në dhe Zyrën për Komunitete të Komunës të Lipjanit, e cila rezultoi me një vendim pozitiv

nga Ministria e Kulturës për t'i lejuar MKK-së që ta ndërtojë një shtëpi për këtë familje tre anëtarëshe në një pjesë të oborrit, në mënyrë që ato të mos presin krijimin e kushteve të rinovimit të objektit me rëndësi historike dhe kulturore, në të cilin ato jetojnë aktualisht.

Ashtu si në vitet paraprake, Avokati i Popullit ka pranuar një sërë ankesash që kanë të bëjnë me problemin e qytetarëve në veri të Kosovës lidhur me rregullimin e gjendjes civile¹¹³ (lindjes, martesës, vdekjes dhe statusit martesor), të gjitha këto probleme që kanë të bëjnë me çështjen e shtetësisë, regjistrimit civil dhe dokumenteve personale. Avokati i Popullit e ka vënë në dukje këtë problem edhe në raportet e mëparshme, ndërsa këtë vit, pas takimit të mbajtur me përfaqësuese të Qeverisë dhe insistimit të Avokatit të Popullit, është treguar gatishmëri nga Qeveria për zgjidhjen e këtij problemi. Më 29 nëntor 2024, MPB-ja ka nxjerrë një vendim¹¹⁴, në bazë të të cilit qytetarët do të kenë mundësi ta rregullojnë gjendjen e tyre civile. Ky vendim ua mundëson të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilët nuk e kanë regjistruar gjendjen e tyre civile në territorin e Republikës së Kosovës në periudhën nga viti 1999, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, t'i paraqesin kërkesat për regjistrim në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit beson se qytetarët do ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe do ta rregullojnë gjendjen e tyre civile në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe kështu do ta lehtësojnë procesin e mëtutjeshëm të marrjes së dokumenteve të identifikimit.

Të drejtat e pronës

Nga gjithsej 214 ankesa të pranuar nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, gjatë këtij viti, pothuajse gjysma i referohen zvarritje së procedurave në gjykata dhe në prokurori. Këto ankesa kryesisht kanë të bëjnë me procedurat e kontesteve pronësore të uzurpimit, riuurpimit të pronës, rrënimit të objekteve të ndërtuara pa leje në pronë të të tjerëve.

112 A.nr. 673/2023

113 Ankesat 957/24, 814/24, 1346/24, 1350/24 dhe të tjerat

114 <https://mpb.rks-gov.net/f/57/7939/Pyetjet-me-t%C3%AB-shpeshta,-n%C3%AB-lidhje-me-procedur%C3%ABn-e-zbatimit-t%C3%AB-Vendimit-t%C3%AB-Ministrit--->

Zvarritjet e procedurave gjyqësore në rastet pronësore vazhdojnë të mbeten komplekse dhe problematike, veçanërisht kur merret parasysh kohëzgjatja në zgjidhjen e kërkesave juridike pronësore, të cilat nuk janë në përputhje me të drejtën për një gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Çështje të tjera problematike mund të konsiderohen edhe uzurpimet, riuurpimet dhe pamundësia e disponimit të pronës private, për të cilat Avokati i Popullit ka raportuar edhe gjatë viteve të kaluara.

Arsimi

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dhe rregullon të drejtën për arsimim, në nenin 47, si e drejtë e cila ngërthen tri obligime kryesore: (i) ofrimin e arsimit themelor të detyrueshëm dhe pa pagesë; (ii) krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili ofron mundësi të barabarta; dhe (iii) krijimin e një sistemi arsimor, i cili përmbush nevojat dhe aftësitë themelore e specifike të çdo fëmije.¹¹⁵ Kjo e drejtë përcaktohet edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj (KEDNj) dhe Konventën për Mbrojtjen e Fëmijës (KDF).¹¹⁶

Gjatë vitit 2024 janë nxjerrë aktet nënligjore, të cilat rregullojnë procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe të zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar¹¹⁷, si dhe Udhëzuesin për Drejtoritë Komunale të Arsimit për zbatimin e rregullores. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet edhe nxjerrja e Udhëzuesit Nr.2-2531 për Zëvendësimin e Mësimdhënësve me Gjendje të Rëndë Shëndetësore, datë 27.8.2024, përmes të cilit rregullohen procedurat për kompensimin e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore.

Me qëllim të përcaktimit të roleve, organizimit, funksionimit, bashkëpunimit si dhe detyrave dhe përgjegjësive për institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese është nxjerrë Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.05/2024 Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës.¹¹⁸

Në drejtim të mbrojtjes së këtyre të drejtave, në kuadër të aktiviteteve promovuese dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) edhe gjatë vitit 2024 zhvilloi fushata informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, për këtë qëllim u vizituan institucione arsimore parauniversitare, po ashtu Avokati i Popullit mori pjesë në takime të ndryshme.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar gjithsej 29 raste, prej tyre 7 ankesa janë shpallur të papranueshme, ndërsa 22 raste janë hapur për hetime, prej tyre 10 raste janë të hapura, ndërsa 12 raste janë mbyllur, nga rastet e hetuara 5 (pesë) prej tyre janë iniciuar sipas detyrës zyrtare.

Nga ankesat që kemi pranuar nga palët ankuese, 7 (shtatë) ankesa janë shpallur të papranueshme, prej të cilave 5 (pesë) ankesa për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike, 1 (një) për shkak se s'ka shkelje apo keqadministrim dhe 1 (një) është jashtë kompetencës së Avokatit të Popullit.

Rastet të cilat janë të hapura, 6 (gjashtë) raste janë hapur për hetime sipas ankesave individuale, ndërsa 4 raste janë të hapura sipas detyrës zyrtare, prej ankesave individuale, dy ankesa janë për shkak të mospërgjigjes në ankesat e parashtruara, dy ankesa për shkak të pretendimit lidhur me transportin e nxënësve, njëri me nevoja të veçanta arsimore, një ankesë me pretendimin për trajtim joadekuat të nxënësve në një shkollë private dhe një ankesë lidhur me akomodimin në Konviktin e Studentëve.

115 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47.

116 Protokollin nr. 1 i KEDNj-së, neni 2, dhe Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 28.

117 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=95292>

118 <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-qrk-nr-05-2024-edukimi-permbrojtjen-e-femijes/>

Rastet të cilat janë iniciuar sipas detyrës zyrtare e të cilat janë të hapura trajtojnë çështjen e mosakreditimit të programeve studimore¹¹⁹, braktisjen e nxënësve në komunën e Gjakovës¹²⁰, lidhur me përdorimin e gjuhës së shenjave dhe kurrikulat¹²¹, lidhur me përgjegjësitë dhe detyrimet e shtetit në raport me dhunën fizike dhe psikike në shkolla.¹²²

Pas përfundimit të hetimeve, 12 (dymbëdhjetë) ankesa janë mbyllur, prej tyre pesë ankesa janë zgjidhur sipas kërkesës së palëve, ndërsa një rast është zgjidhur sipas detyrës zyrtare¹²³, për katër ankesa është konstatuar se nuk ka shkelje apo keqadministrim nga institucionet kundër të cilave ishin hapur, dy raste janë mbyllur për shkak të dështimit të palës ankuese.

Gjatë vitit 2024, lidhur me të drejtën në arsim, Avokati i Popullit ka publikuar 3 (tri) raporte me rekomandime¹²⁴ dhe një letër rekomandim.¹²⁵ Po ashtu ka dhënë një Deklaratë në lidhje me raportimet e ngacmimeve seksuale, nëpërmjet së cilës ka shprehur shqetësimet në lidhje me deklaratimet për ngacmimet seksuale në Universitetin Publik të Prishtinës.¹²⁶

Për sa i përket arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, në vitin 2024 janë angazhuar një numër i asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, mirëpo edhe përkundër kësaj, ende kemi nxënës të cilëve nuk u sigurohet mbështetja e asistentëve, prandaj është e nevojshme që të vazhdohet me angazhimin e asistentëve sipas nevojave të nxënësve.

Edukimi në fëmijërinë e hershme, edhe gjatë kësaj periudhe kohore, numri i fëmijëve të cilët vijnë në çerdhe vazhdon të jetë i vogël, prandaj është e nevojshme të shtohen kapacitetet për përfshirje të fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme.

Sistemi arsimor për fëmijët e komunitetit serb vazhdon të funksionojë me planprograme mësimore të sistemit arsimor të Republikës së Serbisë pa njoftuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.¹²⁷

Lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, edhe këtë vit shkollor është raportuar se procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore është përcjellë me probleme dhe vonesa, lidhur me këtë çështje është raportuar se Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet Komisionit Hetimor Parlamentar, ka angazhuar ekspertë lidhur me procesin e subvencionimit të teksteve shkollore.¹²⁸ Prandaj Avokati i Popullit konsideron se është e nevojshme që procedurat e shpërndarjes së teksteve shkollore të fillohen në një periudhë të mjaftueshme kohore, në mënyrë që nxënësit të furnizohen pa vonesa me tekste shkollore.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit edhe përkundër shumë përpjekjeve, edhe këtë vit ka dështuar të përfundonte procedurat e rekrutimit të inspektorëve të arsimit, mungesa e numrit të mjaftueshëm të inspektorëve arsimorë krijon vonesa në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe ndikon edhe në sigurimin e cilësisë së arsimit.

119 R/1204/2024

120 R/1178/2024

121 R/1128/2024

122 R/661/2024

123 Ex Officio R/147/2024

124 Rastet nr.359/2023; 636/2023; 637/2023

125 R. nr.292/2024, <https://oik-rks.org/2024/12/05/lete-rekomandim-r-nr-292-2024/>

126 <https://oik-rks.org/2024/04/25/deklarate-e-avokatit-te-popullit-ne-lidhje-me-raportimin-e-ngacmimeve-seksuale/>

127 Neni 12, paragrafi 12.2, i Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës përcakton: “Shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.”

128 <https://www.youtube.com/watch?v=cLwk3uUjqA8> Lajmet e orës 20.00, Klan Kosova, 09.11.2024.

Duke u bazuar në rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Popullit, mund të përfundohet se në institucionet arsimore ende mbetet sfidë miratimi i Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi, të cilat do të mundësonin ngritjen e cilësisë në arsim, edhe përkundër disa përmirësimeve, mbetet sfidë gjithëpërfshirja në arsim, sidomos e grupeve të cenushme të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe fëmijëve pjesëtarë të komuniteteve. Po ashtu, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, mbetet sfidë edhe përkrahja më e madhe dhe sigurimi i transportit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore e sidomos sigurimi i numrit të mjaftueshëm të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Të drejtat gjuhësore

Një nga sfidat më të mëdha, kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë në Kosovë, është respektimi i të drejtave gjuhësore. Si në raportet e mëparshme edhe me këtë rast, për fat të keq, vetëm mund ta konstatojmë se të drejtat gjuhësore nuk respektohen sa duhet, edhe pse sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, shqipja dhe serbishtja janë gjuhë zyrtare dhe të barabarta. Gjithashtu nuk ka konsistencë në përdorimin e gjuhëve dhe komuniteteve të tjera që janë në përdorim zyrtar sipas rregulloreve pozitive. Si rrjedhojë, mekanizmat ekzistues të mbrojtjes janë ose të pamjaftueshëm ose nuk kanë mbështetje në drejtim të efikasitetit të tyre, në kuptim të sigurimit të përgjegjësisë së plotë të autoriteteve publike në zbatimin dhe respektimin e kuadrit legjislativ që u referohet të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë.

Gjithashtu, përveç komunitetit serb, boshnjakët, romët dhe turqit kanë vite që tregojnë për mosrespektimin e të drejtave gjuhësore të garantuara me ligj. Komuniteti i turqve veçoi pamundësinë e dhënies së testeve pranuese për Policinë e Kosovës, si

dhe pamundësinë e dhënies së provimit të jurisprudencës në gjuhën turke. Komuniteti boshnjak dhe goran vazhdojnë të paraqesin problemin e qasjes në shumë shërbime, përkthimin e dobët të teksteve, qasjen në tregun e punës, si dhe qasjen në shërbime për shkak të mosrespektimit të të drejtave gjuhësore. Komuniteti rom ende nuk është në gjendje t'i ushtrojë të drejtat e veta ndaj shërbimeve komunale në Komunën e Graçanicës në gjuhën e tij, edhe pse gjuha rome është në përdorim zyrtar në këtë komunë, e gjitha kjo për shkak të mungesës së një përkthyesi të përhershëm për këtë gjuhë. Problemet e qytetarëve serbë në komunikimin me institucionet, mungesa e materialeve edukative dhe e informacionit në gjuhën serbe janë evidente dhe kur mund të jetë i qasshëm një përkthim, ai vonohet ndjeshëm dhe është me plot gabime gramatikore dhe leksikore.¹²⁹

Gjatë vitit 2024, IAP-ja e ka pranuar edhe një numër të caktuar ankesash lidhur me të drejtat gjuhësore, megjithëse mandati primar i Zyrës së Komisionerit për Gjuhët është monitorimi i zbatimit të legjislacionit pozitiv në këtë fushë, si dhe pranimi dhe shqyrtimi i ankesave nga të drejtat gjuhësore.

Ankesat e pranuar nga IAP-ja në lidhje me përdorimin e gjuhës serbe, si një nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe komunikimin me autoritetet publike kanë të bëjnë me mosmarrjen e aktgjykimeve në gjuhën serbe, vendimet për ndalimet gjyqësore që janë vonuar për disa muaj, vendimet për refuzimin e kërkesave për regjistrim në librin e shtetasve dhe të gjitha komunikimet (me shkrim dhe me gojë) në Departamentin për Shtetësi dhe Azil të MPB-së në Republikën e Kosovës, vendimet për largim të dhunshëm nga territori i Republikës së Kosovës, komunikim i dobët me pjesëtarët e Policisë së Kosovës në veri për shkak të barrierave gjuhësore, problemit të mungesës së një përkthyesi me orar të plotë në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicën Veriore, komunikimi me zyrtarët e gjendjes

129 Informatat janë marrë në takimet me organizatat e shoqërisë civile, qytetarë dhe kryesuesin e Këshillit Këshillëdhënës për Komunitete, gjatë vitit 2024.

civile dhe zyrove të regjistrimit në Mitrovicën Veriore dhe Jugore etj.¹³⁰

Për sa i përket problemit të cilësisë së përkthimit të akteve ligjore dhe mospërputhjes së tyre gjuhësore, veçanërisht të përkthimit nga gjuha shqipe në serbisht, IAP-ja deklaroi në vitin 2024 se ato ende ekzistojnë dhe se rekomandimet e dhëna në fund të vitit 2023 do të zbatohen gjatë vitit 2025. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim reflektohet në faktin se Kuvendi i Kosovës ka zgjidhur çështjen e përkthimit dhe se ka filluar përkthimi në gjuhën serbe i mbledhjes së Qeverisë si dhe Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës është në proces të formimit të Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin e Gjuhëve. Mbetet të shihet në periudhën e ardhshme nëse zyra e lartpërmendur do të krijohet dhe nëse gabimet dhe mospërputhjet në akte ligjore dhe nënligjore do të harmonizohen dhe korrigjohen, por edhe në vetë Kushtetutën dhe në atë mënyrë do të zbatohen rekomandimet e IAP-së dhëna Kuvendit të Republikës së Kosovës, e gjithë kjo me qëllim të krijimit të sigurisë juridike për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë.

Në lidhje me monitorimin e situatës për respektimin e të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, IAP-ja e ka filluar bashkëpunimin me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët para disa vitesh me qëllim të koordinimit dhe promovimit më të mirë të të drejtave gjuhësore, si dhe bashkëpunimit me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të ankesave të parashtruara. Bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së Komisionarit për Gjuhët dhe IAP-së vazhdoi gjatë vitit 2024 dhe u zbatua një projekt i përbashkët në koordinim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), vazhdimi i të cilit është planifikuar për gjysmën e parë të vitit 2025. Projekti ka të bëjë me monitorimin e respektimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhës në komuna dhe gjykata të caktuara në Republikën e Kosovës. Në mars të vitit 2024, IAP-ja, së bashku me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët, përfunduan pjesën e parë të monitorimit

të institucioneve publike, gjetjet e të cilit u konsoliduan në raportin dygjuhësh “Zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna dhe Gjykata” (në komunat dhe gjykatat në Prishtinë, Graçanicë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicën Jugore dhe Veriore).

Konkluzioni i përgjithshëm i raportit është se gjendja aktuale në fushën e zbatimit të ligjit nuk mund të vlerësohet si e kënaqshme. Numri i përkthyesve është i pamjaftueshëm, po ashtu ka mungesë të personave të kualifikuar për kryerjen e shërbimeve të përkthimit, veçanërisht në komuna. Në disa raste dhe nëse konkursi shpallet më shumë se një herë, nuk aplikojnë kandidatë që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj. Shërbimet e përkthimit në shumicën e komunave nuk janë të kontraktuara me kompanitë e përkthimit, sepse asnjëri nga institucionet e përmendura nuk i është ndarë buxhet i veçantë për shërbime të përkthimit. Mangësitë e shumta janë vërejtur edhe në faqet e internetit të institucioneve, siç janë: faqet jo të përditësuara, përkthimet jo të plota dhe përkthimi dukshëm i pasaktë në gjuhën serbe. Me pjesën e dytë të projektit është paraparë vazhdimi i aktiviteteve të përbashkëta të IAP-së dhe Zyrës së Komisionarit me emrin “Progresi dhe promovimi i të drejtave gjuhësore”, me qëllim të monitorimit të mëtejshëm të respektimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nga autoritetet publike deri në fund të muajit maj të vitit 2025. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, IAP-ja organizoi dhe mbajti një tryezë të rumbullakët me temë “Të drejtat gjuhësore: Rruga drejt të drejtave themelore të njeriut”. Qëllimi i këtij aktiviteti është të theksohet rëndësia jetike e të drejtave gjuhësore në promovimin e përfshirjes, diversitetit dhe barazisë, si dhe ndikimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut. IAP-ja mendon se kjo ngjarje do t’u shërbejë institucioneve, mediave, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara që ta thellojnë angazhimin e tyre në mbrojtjen e së drejtës së gjuhës si një e drejtë themelore e njeriut.

130 Rastet 1328/24, 1327/24, 957/24, 526/24, 54/24.

Gjatë vitit 2024, IAP-ja me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka mbajtur një sërë tryezash të rrumbullakëta në komunat: Graçanicë, Mamushë, Dragash, Klinë, Rahovec, Shtërpçë dhe në fshatin Letnicë. Tryezat e rrumbullakëta u mbajtën me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve, në radhë të parë të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, lidhur me të drejtat e njeriut, rolin dhe mandatin e IAP-së, forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, informimin e qytetarëve për rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e tyre nga autoritetet publike, si dhe u fol për pranimin dhe zgjidhjen e ankesave të paraqitura nga qytetarët në IAP.

Gjatë tryezave të rrumbullakëta, IAP-ja ka identifikuar një sërë probleme, me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo ditë dhe ndaj të cilave është tërhequr vëmendja me këtë rast. Janë identifikuar problemet për të cilat është bërë fjalë më herët në këtë raport, siç janë: mosrespektimi i të drejtave gjuhësore në procedurat administrative dhe gjyqësore (vonesa në përkthimet e aktgjykimeve, si dhe komunikimi i vështirë me punonjësit e vetëqeverisjes lokale në veri të Republikës së Kosovës pas ndryshimit të strukturës së punëtorëve në këto komuna nga fundi i vitit 2022), po ashtu kur bëhet fjalë për shërbimet shëndetësore; nevoja për ofrimin e kurseve të gjuhës shqipe dhe serbe për zyrtarët komunalë dhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës; mungesa e angazhimit dhe aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile brenda komuniteteve; domosdoshmëria e angazhimit dhe bashkëpunimit më të madh të përfaqësuesve të komuniteteve brenda vetëqeverisjes lokale me qytetarët dhe vizitat në terren; mungesa e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara që u përkasin komuniteteve joshumicë dhe OJQ-ve që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtyre personave pranë autoriteteve qendrore dhe lokale; pengesat infrastrukturore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në gjykata, prokurori, komuna, institucione arsimore, hapësira publike etj.; komunikimi i pamjaftueshëm i disa zyrave komunale për komunitete me MKK-në; përfshirja e

pamjaftueshme e qytetarëve në marrjen e vendimeve me interes publik, sidomos kur bëhet fjalë për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, të cilët si popullatë numerikisht përfaqësojnë shumicën në komunat në veri të vendit, si dhe përfaqësimi i pamjaftueshëm i komunitetit serb në vetëqeverisjet lokale-autoritete në katër komuna në veri të Kosovës; problemet që kanë të bëjnë me mjedisin (menaxhimi jo i duhur dhe joadekuat i mbetjeve, ndotja e tokës dhe e lumenjve); mungesa e rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimit në disa fshatra të Kosovës.

Ngatëgjitha ato që uthanë më sipër, imponohet një përfundim logjik që autoritetet publike duhet ta trajtojnë në mënyrë më konsistente nevojën për t'i përfshirë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në mënyrë të barabartë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe publike, që të sigurohet në mënyrë të qëndrueshme gjithëpërfshirja dhe integrimi i të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë pa dallim, si dhe nevojën për mbrojtje më efektive të të drejtave të komuniteteve joshumicë me qëllim që të ndërtohet besimi i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në institucione.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.¹³¹

Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës përcakton se Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës inkurajohet dhe

131 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, paragrafi 1.

çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që u përkasin komuniteteve.¹³²

Megjithatë, ashtu sikurse viteve të kaluara, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë komunitete me gjendje më të rëndë ekonomike dhe sociale në Kosovë.

Gjatë vitit 2024, në Institucionin e Avokatit të Popullit janë parashtruar 26 ankesa nga komuniteti ashkali, 19 ankesa nga komuniteti rom dhe 13 ankesa nga komuniteti egjiptian.

Rastet e hetuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Institucionin e Avokatit të Popullit kryesisht kanë të bëjnë me pretendime për shkelje të të drejtave përkitazi me mungesën e kushteve të nevojshme të strehimit dhe banimit, uzurpim të pronës, me regjistrimin civil dhe zvarritje të procedurave gjyqësore.

Arsimi

Gjendja në arsim të komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdon të jetë po e njëjta sikurse edhe viteve të kaluara. Ndër problematikat më të mëdha është braktisja e shkollimit të obligueshëm nga fëmijët e këtyre komuniteteve. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka vazhduar me ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian.

Avokati i Popullit, në bazë të informatave të marra nga Grupi Teknik, ka identifikuar se 30 fëmijë të komunitetit ashkali, nxënës të shkollës fillore “Selman Riza” në Fushë Kosovë, nuk janë duke vijuar mësimin, si pasojë e ndërprerjes së mësimin alternativ. Lidhur me këtë çështje, më 23 maj 2024, Avokati i Popullit publikoi Raportin me Rekomandime nr. 637/2023 kundër Komunës së Fushë Kosovës dhe gjeti se në rastin konkret ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve për arsimim. Deri te ky konstatim ka ardhur pasi autoritetet përkatëse komunale nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore.

Së këndejmi, Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Fushë Kosovës që t'i ndërmarrë të gjitha masat që t'ua mundësojnë këtyre fëmijëve vijimin e mësimin dhe kështu t'ua garantojë të drejtën në arsim.

Punësimi

Situata socio-ekonomike e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe qasja e tyre në punësimin në sektorin publik dhe private mbetet sfidë. Shumica e pjesëtarëve të tri komuniteteve që janë të gatshëm për punë janë të papunë ose të përfshirë në sektorin ekonomik joformal.

Sipas gjendjes në terren, një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të detyruar të kërkojnë lëmshë në rrugët e qyteteve të Kosovës dhe disa fëmijë janë gjithashtu të angazhuar në mbledhjen e materialeve të riciklueshme.

Avokati i Popullit është në fazën e përfundimit të hetimeve në rastin e Z.G. kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me procedurat e rekrutimit, me pretendim për diskriminim mbi bazën e përkatësisë etnike. Gjatë trajtimit të këtij rasti, Avokati i Popullit ka ngritur çështjen e punësimit të komuniteteve joshumicë në institucionet e administratës publike. Sipas statistikave të dërguara nga MPB-ja, e që janë të vitit 2022, Avokati i Popullit vëren se nuk ka të dhëna statistikore lidhur me komunitetin rom, ashkali, egjiptian, kroat dhe malazez. Lidhur me këtë informatë, MPB-ja nuk ka dhënë sqarime nga të cilat do të kuptohej arsyeja e mungesës së të dhënave për të punësuarit nga këto komunitete. Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit do të dalë me qëndrim lidhur me këtë çështje.

Nga 58 ankesat e parashtruara në IAP nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në vitin 2024, vetëm 3 ankesa prej tyre kanë të bëjnë me pretendime ankimore në fushën e punësimit.

¹³² Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, neni 1, paragrafi 1.

Strehimi

Ndër çështjet që vazhdon të jetë problematike te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është strehimi dhe shumica prej tyre jetojnë në kushte të vështira. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në shtëpi që nuk kanë infrastrukturë, duke mos pasur qasje në ujë të pijshëm dhe energji elektrike. Problematika e vazhdueshme është edhe legalizimi i shtëpive apo banesave të tyre. Bazuar në aktivitetet e Avokatit të Popullit në terren, një pjesë e konsiderueshme e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në prona në të cilat nuk janë titullar të tyre. Shumë organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare në bashkëpunim edhe me institucionet publike kanë njoftuar për procedurat ligjore për rregullimin e dokumentacionit të nevojshëm për pronat, megjithatë shumë pak prej familjeve të këtyre komuniteteve kanë shfaqur interesim. Gjatë vitit 2024, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me ndërtimin e shtëpive për komunitetet joshumicë, përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Megjithatë, disa nga aplikuesit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë plotësuar ndër kriteret kryesore e që është certifikata e pronës në emër të aplikuesit.

Në muajin dhjetor 2024, Avokati i Popullit ka pranuar disa informacione nga përfaqësuesi i një lagjeje të banuar nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë, përkitazi me mungesën e kushteve të përshtatshme për jetesë, veçanërisht për mungesën e energjisë elektrike dhe pritet që të ndërmerren veprime, që krahas problematikës së adresuar, do të vlerësohen edhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me strehimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë komunë.

Çështjet shëndetësore

Mungesa e kujdesit shëndetësor është ndër sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në Kosovë, duke marrë parasysh që për disa është qasja e kufizuar në kujdesin shëndetësor,

meqenëse shumë prej këtyre komuniteteve jetojnë në zona të thella rurale, të izoluar ku institucionet shëndetësore nuk janë të qasshme lehtë. Avokati i Popullit ka pranuar informacione nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kushtet e rënda ekonomike si dhe mungesa e informimit për shërbimet shëndetësore shpesh i lënë ata jashtë mundësisë për përkujdesje shëndetësore.

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024, si dokumente të miratuara nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, krahas objektivave sikurse arsimit, punësimi dhe mirëqenia sociale, banimi, diskriminimi, ka edhe komponentin e shëndetësisë. Ky komponent përcakton tri objektiva specifike, si: përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali; përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit; dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve rom dhe ashkali. Megjithatë, bazuar në situatën në terren, nuk ka ndonjë të arritur konkrete rreth përmbushjes së këtyre specifikave.

Martestat e hershme

Edhe pse nuk ka ndonjë të dhënë të saktë për numrin e martesave të hershme te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese. Çështjet që ndikojnë te shfaqja e martesave të hershme janë pabarazia gjinore, braktisja e shkollës, varfëria, mungesa e informacionit, traditat kulturore si dhe komunikimi jo i mirëfilltë midis prindërve dhe fëmijëve të tyre adoleshentë.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i vitit 2024, ndër çështjet e përmendura është edhe ajo që ka të bëjë me martesat e hershme te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke thënë se “Martesa e hershme prek më së shumti vajzat nga këto komunitete.”¹³³

133 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, viti 2024, faqe 37 (versioni shqip).

Në fund të vitit 2023, Qeveria themeloi grupin punues ndërinstitucional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Më 7 qershor 2024, Zyra për Çështjen e Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit mbajti takim ku u prezantua Plani i Veprimit për Parandalimin e Martesave të Hershme të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi, i cili, sipas hulumtimeve dhe të dhënave të fundit, tregon rreth 200 raste në vit. Grupi punues në periudhën e ardhshme do të vizitojë çdo komunë me popullatë të konsiderueshme rom, ashkali dhe egjiptian, ku së bashku me të gjithë zyrtarët kompetentë në komunën përkatëse do të diskutojnë për praninë e martesave të hershme, si dhe mënyrat për parandalimin e saj.¹³⁴

Gjuha rome

Në përputhje me nenin 2 (3) të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, në komunat e banuara nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbën së paku pesë për qind të popullsisë së përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në komunë dhe është në përdorim të barabartë me gjuhët zyrtare. Për më tepër, ligji në fjalë përcakton se në komunat, personat të cilët u takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, kanë të drejtën të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhën e tyre nga institucionet dhe nga zyrtarët komunalë, nëse ata kërkojnë kështu. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë që personat e tillë të mund të paraqesin kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore si dhe të marrin përgjigjet në gjuhën e tyre.

Përderisa te komunitetet ashkali dhe egjiptian, gjuha nuk perceptohet si pengesë për qasjen në institucionet publike, pasi gjuha e tyre amtare është shqipja, te komuniteti

rom vazhdon të jetë sfiduese, pasi gjuha rome duke mos qenë gjuhë zyrtare dhe se vetëm dy komuna e kanë njohur atë si gjuhë në përdorim zyrtar, Komuna e Graçanicës dhe ajo e Prizrenit. Sipas informacioneve të Avokatit të Popullit, nuk është në nivel të kënaqshëm përdorimi i gjuhës rome si gjuhë në përdorim zyrtar, duhet angazhuar përkthyes në marrëdhënie të rregullt pune dhe se qytetarët romë po hasin në vështirësi në marrjen e informatave të kërkuara në gjuhën e tyre amtare.

Të Drejtat e Fëmijës

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një pjesë integrale të të drejtave të njeriut. Fëmijët kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme si të rriturit, por edhe të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Kushtetuta gjithashtu imponon detyrime ligjore për shtetin për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF).¹³⁵

Për sa i përket kornizës legjislative, gjatë këtij viti u miratua Ligji për Rininë dhe 8 akte të rëndësishme nënligjore në fushën e edukimit, aftësisë së kufizuar dhe mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna. Shtatë prej këtyre akteve rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF). Në vitin 2020, IAP-ja ka nisur hetimet ex-officio 381/2020 lidhur me vlerësimin e LMF-së. Avokati i Popullit ka theksuar se, ndonëse LMF-ja ka autorizuar institucionet kompetente që në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e tij në vitin 2020, të nxirreshin 18 akte nënligjore¹³⁶, kjo nuk ka ndodhur. Më në fund, pas gati 5 vjetësh u miratuan këto akte nënligjore, mirëpo ende nuk janë miratuar aktet nënligjore për organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Kujdes Ditor dhe Qendrave për Pranim të parapara me Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare. Mosmiratimi i këtyre akteve e

134 <https://zck-kpz-platform.rks-gov.net/prezantimi-i-planit-te-veprimit-per-parandalimin-e-martesave-te-hershme-te-komunitetit-rom-ashkali-dhe-egjiptian/>

135 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

136 <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi më datën 6.1.2025].

pengon zbatimin e plotë të ligjit.

Analiza e situatës së fëmijëve në Kosovë edhe këtë vit tregon se fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e plotë të drejtave të tyre. Këto vështirësi janë të shfaqura gati në të gjitha fushat e jetës së tyre, veçanërisht në realizimin e së drejtës për arsim, në procedurat gjyqësore dhe administrative dhe mbrojtjen sociale dhe shëndetësore. Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka pranuar 76 ankesa lidhur me të drejtat e fëmijëve, kryesisht të parashtuara nga prindër të fëmijëve, ndërsa 13 raste janë hapur për hetime sipas detyrës zyrtare. Për sa i përket gjinisë së ankuesve, 32 ankesa janë iniciuar nga burrat dhe 31 nga gratë. Më tutje, institucionet kundër të cilave janë pranuar ankesat ishin: 35 kundër komunave, 13 kundër gjykatave - kryesisht për zvarritje të procedurës gjyqësore dhe me kërkesë për monitorim të proceseve gjyqësore, 19 kundër ministrive, 6 ankesa kundër policisë, 2 kundër prokurorive si dhe 13 ankesa të natyrave të tjera.

Nga ky numër, 13 ankesa janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bënin kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk kanë pasur shkelje të të drejtave të njeriut apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzonin ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga ankesat që kemi pranuar prej qytetarëve, 50 ankesa janë hapur për hetim dhe shtjellohen më detajisht përgjatë raportit. Gjatë këtij viti, IAP-ja u ka adresuar 8 rekomandime autoriteteve përkatëse publike dhe u ka dërguar 58 letra rikujtuese këtyre autoriteteve lidhur me mospërgjigje dhe moszbatimin e rekomandimeve.

Ankesat e paraqitura nga individët	63
Rastet e hapura për hetim sipas ankësive të paraqitura nga ankuesit	50
Ankesat e papranuara	13
Rastet e hapura për hetim sipas detyrës zyrtare	13
Gjithsej	76

E drejta e fëmijëve për arsim

Rastet lidhur me të drejtën për arsim, të cilat janë hetuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: braktisjen e shkollës¹³⁷, infrastrukturën shkollore¹³⁸, përfaqësimin në gara sportive¹³⁹, pezullimin nga shkolla¹⁴⁰, dhunën në shkollë¹⁴¹, administratën e shkollës¹⁴², subvencionimin e teksteve shkollore¹⁴³, mungesën e transportit shkollë-shtëpi¹⁴⁴, nostrifikimin e dëftesës¹⁴⁵, mohimin e së drejtës për qasje në edukimin në fëmijërinë e hershme¹⁴⁶ dhe ndikimin e peshës së çantave të fëmijët e shkollave fillore.¹⁴⁷

Lidhur me të drejtën e fëmijëve në arsim, IAP-ja ka publikuar tri raporte: *Raport me rekomandime ex-officio nr. 636/2023 Përfshirja e standardeve të zbatueshme të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë*; *Raport nr. 637/2023 në lidhje me mohimin e së drejtës për arsimim dhe Raport A. nr. 359/2023 lidhur me trajtim jo të barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuara në të drejtën për arsim parashkollor.*

Rasti i përfshirjes së standardeve të zbatueshme të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë

137 Rastet **147/2024, 114/2024 dhe 1178/2024.**

138 Rasti **292/2024.**

139 Rasti 96/2024.

140 Rasti **25/2024.**

141 Rastet **661/2024 dhe 310/2024.**

142 Rastet 924/2024, 888/2024, 590/2024, 288/2024 dhe 1272/2024.

143 Rastet **851/2024 dhe 189/2024.**

144 Rastet 1234/2024, 1052/2024, 1103/2024 dhe 1308/2024.

145 Rasti 927/2024.

146 Rastet 1036/2024 dhe **303/2024.**

147 Rasti 1332/2024.

Në raportin e parë, IAP-ja hulumtoi dhe analizoi se sa janë përfshirë standardet e fushës së të drejtave të njeriut, në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë, në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës. Raporti është hartuar duke analizuar përmbajtjen e 19 teksteve shkollore të klasave 10, 11 dhe 12, të të gjitha drejtimeve të shkollave të mesme, si për gjimnaze shoqërore-gjuhësore, ashtu edhe për gjimnaze natyrore. Avokati i Popullit ka konstatuar se niveli i përgjithshëm i teksteve shkollore të këtij niveli shkollor në raport me fushën e të drejtave të njeriut është i kënaqshëm, si dhe ka identifikuar hapësirat për përmirësime dhe plotësime. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar MASHTI-t: 1) unifikimin e terminologjisë kyçe në fjalorët e sociologjisë, psikologjisë dhe edukatës qytetare, në raport me fushën e të drejtave të njeriut; 2) eliminimin e të gjithë termave dhe paragrafëve me përmbajtje të papërshtatshme të identifikuara, të cilat janë në kundërshtim me parimet dhe frymën e të drejtave të njeriut.

Rasti në lidhje me mohimin e së drejtës për arsimim

Avokati i Popullit ka hapur rast për hetim lidhur me ndërprerjen e mësimin alternativ të nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Fushë Kosovës. Ky mësim është ndërprerë pa paralajmërim, pa vendim dhe njoftim zyrtar, ndërsa komuna e ka arsytuar ndërprerjen për mungesë të mjeteve financiare dhe vërejtjes nga auditori. Avokati i Popullit ka gjetur se në rastin konkret ka shkelje të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse komunale nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, për realizimin e së drejtës për arsimim.

Rasti i qasjes së barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuar në edukimin parashkollor si dhe krijimin e mundësive të barabarta për ta në institucione parashkollore

Lidhur me gjithëpërfshirjen në edukimin në fëmijërinë e hershme, IAP-ja ka publikuar Raportin A. nr. 359/2023 duke ia tërhequr vëmendjen Komunës së Fushë Kosovës

për qasjen e barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuar në edukimin parashkollor si dhe krijimin e mundësive të barabarta për ta në institucione parashkollore. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se kujdesi i hershëm në fëmijëri është hapi i parë i shkallës së të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijës, e konsideron të domosdoshme që institucionet të krijojnë hapësira dhe kapacitete në mënyrë që fëmijët, pa dallim, të kenë qasje të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte. Për më gjerësisht lidhur me këtë raport do të flitet në pjesën e mëposhtme të raportit.

Rastet që janë në hetim

Avokati i Popullit nisi hetimet ex-officio referuar shkresës së pranuar nga Inspektorati i Arsimit, mbi trajtimin e rastit me rrezik të braktisjes së shkollës të nxënësit të një shkollë fillore në Prishtinë. Rasti ka të bëjë me trajtimin e nxënësit, i cili, si pasojë e divorcit të prindërve, është rrezik për braktisjen e shkollës. Inspektorati i Arsimit u ka rekomanduar institucioneve, si: shkollën fillore, Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë, QPS-në dhe MASHTI-n, që të ndërmarrin veprime në interesin më të mirë dhe për përmirësimin e vijueshmërisë së mësimin nga nxënësi. Gjatë hetimeve, fëmija është transferuar në një shkollë tjetër ku ka kaluar rrezikun e braktisjes së shkollës dhe institucionet përkatëse kishin zbatuar rekomandimet e dhëna.

Ngjashëm me rastin e mësipërm, është hapur rast ex-officio ndaj Komunës së Gjakovës pas publikimit të të dhënave nga një organizatë joqeveritare se rreth 169 fëmijë të një lagjeje të moshave 9-18 vjeçare e kanë braktisur mësimin. Braktisja e shkollës ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen e fëmijëve duke ua kufizuar atyre mundësitë për arsimim dhe zhvillim personal, profesional dhe social. Gjithashtu ajo kontribuon në rritjen e pabarazive shoqërore dhe ekonomike, duke e penguar integrimin e plotë të individëve në shoqëri.

Në përgjithësi, infrastruktura e dobët fizike në shkolla, si: mungesa e ambienteve

të sigurta dhe të pajisura mirë, ndikon negativisht në mirëqenien e nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve. Në mars IAP-ja, sipas detyrës zyrtare, ka hapur hetime lidhur me sigurinë në objektin e një shkolle fillore në një fshat në komunën e Gjilanit. Sipas informatave, në një klasë të kësaj shkolle, ku nxënësit mbanin mësim, kishin rënë pjesë të gëlqeres nga tavani, duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e nxënësve dhe të personelit të shkollës. Lidhur me këtë, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me drejtorin e shkollës, me ç’ rast është njoftuar se në ndërkohë tavani është rregulluar, mirëpo ai ka vlerësuar se edhe një pjesë e korridorit të shkollës është e rrezikshme. Drejtori i DKA-së ka pohuar se pritet të ndërtohet shkolla e re, mirëpo kjo mund të zgjasë. IAP-ja ka biseduar edhe me nënkryetaren e komunës së Gjilanit, lidhur me problemin e objektit të shkollës dhe i ka adresuar Komunës një *Letër me Rekomandime Rasti nr.292/2024*, duke i kërkuar t’i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për t’ua siguruar të gjithë fëmijëve një mjedis shkollor të shëndetshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm.

Gjendja e sigurisë në shkolla dhe mbrojtja nga dhuna

Lidhur me sigurinë në shkolla dhe mbrojtjen nga dhuna, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për 5 raste, prej të cilave 1 rast është iniciuar sipas ankesës së prindit dhe 4 raste sipas detyrës zyrtare.

Rastet kishin të bënin me kanosjen në prezencën e fëmijës¹⁴⁸, ngacmimin seksual të nxënëses nga profesori¹⁴⁹, raportimin në rastin e fëmijës viktimë e dhunës seksuale¹⁵⁰, dhunën fizike dhe psikike në shkolla¹⁵¹ dhe sulm fizik ndaj dy të miturave.¹⁵²

Në rastin e iniciuar nga ankuesja, ankesa është paraqitur kundër QPS-së për mospërgjigje. Ankuesja është kërcënuar nga ish-bashkëshorti në prezencën e vajzës së tyre në objektin e QPS-së. Ankuesja ka pohuar

se në datën e incidentit, si rezultat i kanosjes është kërkuar ndihmë edhe nga drejtori i QPS-së dhe nga policia. Ish-bashkëshorti, pas intervistimit nga policia, është liruar në procedurë të rregullt me leje të prokurorisë. Ankuesja gjithashtu ka pohuar se në QPS ka parashtruar kërkesë për një raport lidhur me ngjarjen e ndodhur, mirëpo nuk ka marrë përgjigje. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i është drejtuar edhe QPS-së për mospërgjigje në kërkesë të ankueses duke ia rikujtuar seriozitetin e situatës. Avokati i Popullit rithekson rëndësinë e zbatimit të nenit 31 të Konventës së Stambollit, i cili ka paraparë se shteti duhet të marrë masat e nevojshme për të garantuar që ushtrimi i vizitave ose i të drejtave të tjera të kujdestarisë të mos rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose të fëmijëve. Gjithashtu, neni 46 (d) i Konventës ka paraparë si rrethanë rënduese kur vepra kryhet kundër ose në prani të një fëmije duke theksuar cenueshmërinë e fëmijëve kur ekspozohen ndaj dhunës.

Avokati i Popullit, bazuar në informatat nga portali “Epoka e Re”, në shkrimin me titull: *“16 vjeçarja akuzon profesorin se e ngacmoi seksualisht prokuroria kerkon prova”*, i datës 12 mars 2024, ka nisur hetimet sipas detyrës zyrtare. Sipas mediave, pas raportimit të nxënëses, drejtori i shkollës ka lajmëruar policinë si dhe ia ka ndaluar profesorit që të japë mësim në klasën e vajzës. Për 16-vjeçaren kjo nuk është hera e parë që është ngacmuar nga i njëjti profesor. IAP-ja ka kontaktuar Komunën e Gjilanit. Pas hetimeve është informuar nga Komuna e Gjilanit për veprimet e ndërmarra lidhur me rastin, siç janë: krijimi i komisionit disiplinor dhe pezullimi i mësimit në shkollë.

Avokati i Popullit ka hapur rast sipas detyrës zyrtare lidhur me prononcimin e zyrtarit të QPS-së së Komunës së Malishevës, referuar shkrimin në portalin “Insajderi”, me titull: *“13-vjeçarja foli në TikTok me njërin nga dhunuesit”*. Avokati i Popullit ka kuptuar se përfaqësuesi i QPS-së është prononcuar

148 Rasti 762/2024.

149 Rasti 310/2024.

150 Rasti 270/2024.

151 Rasti 661/2024.

152 Rasti 1206/2024.

për një emision televiziv në TV “Klan Kosova” duke mos respektuar të drejtat e fëmijëve, edhe pse do të duhej ta dinte se kemi të bëjmë me një fëmijë të moshës 13-vjeçare si dhe viktimë të dhunës seksuale. Avokati i Popullit lidhur me këtë rast ka kërkuar informata nga kryetari i komunës së Malishevës: nëse organet përkatëse komunale i kishin vlerësuar deklaratimet e bëra nga zyrtari i QPS-së; ato deklarime a janë në pajtim me të drejtat e fëmijëve, përkatësisht me të drejtën e privatësisë dhe interesin më të mirë të fëmijës. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar të dinte nëse Komuna e Malishevës ka kod të etikës, apo ndonjë politikë që rregullon dhënien e informatave apo deklarimeve publike nga zyrtarët në Malishevë, në veçanti për rastet kur fëmijët janë viktima. Komuna ka njoftuar për ndërmarrjen e masave përkatëse ndaj zyrtarit dhe se ata janë në procedurë të hartimit të kodit të etikës.

Avokati i Popullit ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare përkitazi me përgjegjësitë dhe detyrimet e shtetit në raport me dhunën fizike dhe psikike në shkolla dhe është në proces të draftimit të një raporti gjithëpërfshirës.¹⁵³ Ky raport ka për qëllim të analizojë se sa është e përhapur dhuna në shkolla, të vlerësojë efikasitetin e masave parandaluese dhe t’u rekomandojë institucioneve përgjegjëse që të jenë proaktive në sigurimin e mjediseve pa dhunë për nxënësit. Të dhënat e siguruar deri më tani tregojnë prezencën e të gjitha formave të dhunës, si ajo psikologjike, fizike dhe seksuale të kryera nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit në shkolla. Të dhënat tregojnë se nxënësit dhe mësimdhënësit në raste kanë raportuar se janë viktima të dhunës në shkolla nga bashkëmoshatarët dhe nga stafi, duke treguar një mungesë të sigurisë fizike në këto mjedise. Po ashtu, mësimdhënësit përballen me vështirësi në menaxhimin e problemeve

disiplinore dhe shprehin nevojën për trajnim në metodat alternative të disiplinimit. Kjo situatë thekson urgjencën e ndërhyrjeve për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë. Në përgjithësi, Avokati i Popullit ka gjetur se sistemi aktual i raportimit të dhunës në shkolla është joefikas, gjë që po dëmton ndjeshëm përgjegjësinë dhe llogaridhënien ligjore lidhur me dhunën në këto institucione. Mungesa e raportimit efektiv mund të nënkuptojë që shumë raste të dhunës nuk janë adresuar fare ose nuk janë trajtuar në mënyrën e duhur nga autoritetet shkollore.

Dhuna seksuale paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të fëmijëve dhe shkakton dëme fizike, emocionale dhe psikologjike te viktimat. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, KDF-ja dhe Konventa e Stambollit parashohin masa për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi. Gjithashtu, korniza legjislative parasheh masa proaktive për parandalimin, hetimin dhe dënimin e këtyre krimeve për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Këto akte cenojnë të drejtat e fëmijëve për siguri, dinjitet dhe autonomi të trupave të tyre.

Sipas Raportit me rekomandime ex - officio nr. 567/2019 në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetë në rastin e K.V.¹⁵⁴, Raportit me rekomandime ex - officio nr. 468/2022 në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna¹⁵⁵, informatave nga Policia dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe raportimet në media, del se numri i rasteve të dhunës seksuale dhe veprimet institucionale në këtë aspekt janë mjaft shqetësuese. Në këtë kontekst, më 25 qershor 2024 IAP-ja organizoi një tryezë diskutimi me qëllim që të mblidhte të gjithë aktorët institucionalë për të diskutuar dhe ofruar rekomandime për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale me fokus në ngacmimin seksual, dhunimin, sulmin seksual dhe keqpërdorimin e fëmijëve në pornografi.

153 Rasti 661/2024.

154 <https://www.oik-rks.org/2019/12/09/raporti-me-rekomandime-ex-officio-567-2019-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-te-garantuara-me-ushtetuten-e-republikes-se-kosoves-si-dhe-me-nenin-2-te-konventes-evropjane-per-mbrojtjen-e-te-d/> .

155 <http://oik-rks.org/2023/04/03/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4682022-detyrimet-pozitive-te-shtetit-per-mbrojtjen-e-femijes-nga-dhuna/>

Tryeza ka për qëllim edhe përmirësimin e reagimit institucional në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësuesit e Policisë, Këshillit Prokurorial, Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave, Qendrave për Punë Sociale, strehimoreve dhe organizatave jo qeveritare që për fokus kanë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe adresimin e dhunës seksuale. Pjesëmarrësit ndanë përvojat, sfidat dhe shprehën përkushtimin e tyre për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimet seksuale.

Të drejtat e fëmijëve në procedurat gjyqësore dhe administrative

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar 14 ankesa kundër gjykatave dhe administratës, të cilat kryesisht kishin të bënin me: (mos) realizimin e kontaktit me fëmijët¹⁵⁶, besimin e kujdestarisë së fëmijëve¹⁵⁷ dhe caktimin e alimentacionit¹⁵⁸, regjistrimin civil të fëmijës¹⁵⁹, përshpejtimin e procedurës¹⁶⁰, punën e gjyqtarit¹⁶¹, vendimin për caktimin e masës së arrestit shtëpiak¹⁶², zvarritjen e procedurave për adoptimin e fëmijës¹⁶³ dhe zvarritjen e procedurave gjyqësore¹⁶⁴.

Me kërkesë të palëve, Avokati i Popullit ka vazhduar me monitorimin e seancave gjyqësore lidhur me besimin e fëmijëve dhe caktimin e alimentacionit.¹⁶⁵ Në këto raste, Avokati i Popullit u është drejtuar gjykatave përkatëse me shkresa për t'u informuar për veprimet e ndërmarra në drejtim të respektimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kur ka pasur pretendime për zvarritje, si dhe të së drejtës për mjete juridike.

Edhe këtë vit Avokati i Popullit ka pranuar ankesa për vështirësitë që kanë prindërit për

realizimin e kontaktit me fëmijët e tyre. Në njërin nga rastet, ankuesja ka parashtruar ankesë kundër Policisë dhe QPS-së për shkak të mos hapjes së rastit të parashtruar kundër ish-bashkëjetuesit të saj, i cili e ka marrë fëmijët pa pëlqimin e saj. Rrjedhimisht, pasi nuk ka arritur të ketë kontakt me fëmijët e saj, ka kërkuar nga QPS-ja që në bazë të mandatit dhe kompetencave t'ia mundësonte kontaktin. Pas ngritjes së shqetësimit nga ana e Avokatit të Popullit, QPS-ja ka mundësuar realizimin e kontaktit me fëmijët. Avokati i Popullit lidhur me këtë rast i është drejtuar kryetarit të gjykatës, nga i cili është informuar se lidhur me këtë lëndë është caktuar seancë gjyqësore dhe palëve u është dërguar thirrja, duke ia mundësuar palës një gjykim të drejtë dhe pa zvarritje.

Ngjashëm edhe në rastin tjetër, 166 ankuesja ka pohuar se edhe përkundër aktvendimit me të cilin nënës i është besuar fëmija për kujdes dhe edukim, vendimi nuk është zbatuar pasi babai, në vizitën e fundit me fëmijë, i ka marrë ata dhe nuk i ka kthyer më. Ankuesja gjithashtu ka parashtruar kërkesën për monitorimin e seancave gjyqësore në rastin e saj në Gjykatën Themelore në Prishtinë, të cilat Avokati i Popullit vazhdon t'i monitorojë.

Në një rast tjetër, nëna ka parashtruar ankesë kundër Komunës së Vitisë për shkak të mosregjistrimit të fëmijës së lindur në një qytet të shtetit fqinj. Ankuesja ka pohuar se edhe pse ajo është shtetase e Kosovës, me vendbanim në këtë komunë, nuk ka mundur të regjistronte fëmijën. Si pasojë e mosregjistrimit, fëmija nuk ka emër dhe nuk ka marrë asnjëherë vaksinë. Regjistrimi i lindjes dhe rrjedhimisht fitimi i shtetësisë si

156 Rastet 33/2024, 922/2024 dhe 560/2024.

157 Rasti 941/2024.

158 Rasti 144/2024.

159 Rasti 218/2024.

160 Rasti 192/2024.

161 Rasti 257/2024.

162 Rasti 1379/2024.

163 Rasti 1091/2024.

164 Rastet 104/2024, 110/2024, 228/2024 dhe 1329/2024.

165 Rasti 560/2024.

166 Rasti 560/2024.

dhe pajisja me dokumente personale nga regjistri civil është një e drejtë themelore e mbrojtur nga legjislacioni ndërkombëtar dhe vendor për të drejtat e njeriut. Kjo e drejtë shërben si parakusht për mundësinë e qasjes dhe gëzimit të të drejtave të tjera si shtetas i një vendi të caktuar, siç janë të drejtat politike dhe ato ekonomiko-sociale. Më specifikisht, KDF-ja ka paraparë detyrimin e shtetit për realizimin e së drejtës për regjistrim të fëmijës, të drejtën të ketë një emër dhe të drejtën për të fituar një shtetësi.¹⁶⁷ Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ka biseduar me Zyrën për Regjistrim Civil në Komunën e Vitisë, ku është informuar lidhur me procedurat dhe e ka udhëzuar ankuesen përgjatë këtij procesi. Pas ndjekjes së procedurave, ajo ka arritur ta regjistronte fëmijën dhe të nxirrte edhe certifikatën e lindjes së tij.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara ende përfutrojnë në vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara përbëjnë një prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve duke qenë se janë më të ndjeshëm ndaj përjashtimit shoqëror, diskriminimit, mungesës së informacionit dhe burimeve financiare, transportit dhe qasjes fizike në objektet arsimore dhe në ato të kujdesit shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, lidhur me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime për 11 raste, ku 10 janë iniciuar pas ankesave të prindërve dhe 1 sipas detyrës zyrtare. Këto ankesa kishin të bënin me mungesën e transportit shkollë-shtëpi¹⁶⁸, mohimin e së drejtës për qasje në edukimin në fëmijërinë e hershme¹⁶⁹, sigurimin e interpretuesit të gjuhës së shenjave¹⁷⁰, ndryshimin e Projektligjit për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet

dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara¹⁷¹, largim të asistentit mbështetës¹⁷², mohimin e shtesës për fëmijë¹⁷³, (mos) ndarjen e mjeteve financiare për OJQ-në e cila punon me fëmijë me aftësi të kufizuara¹⁷⁴ dhe orarin e punës për prindin me fëmijë me aftësi të kufizuara.¹⁷⁵

Avokati i Popullit ka nisur hetimet sipas detyrës zyrtare kundër Komunës së Prizrenit lidhur me vendimin e një institucioni parashkollor, i cili u ndalonte fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijëve të cilët janë me pelena të vijonin mësimin në këtë institucion. Më tutje, vendimi nuk përmbante as pjesën e arsytimit, vulën e institucionit dhe as numrin e protokollit. Ky vendim është përjashtues dhe diskriminues ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Neni 3 i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (LEFH) ka paraparë që edukimi në fëmijërinë e hershme, pra të moshës 6 muajshe deri në 5 vjeç, udhëhiqet nga parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe gjithëpërfshirjes. Për më tepër, nenet 37 dhe 46 (1, 3, 5) të LMF-së përcaktojnë se fëmija me aftësi të kufizuara jo vetëm mbrohet nga diskriminimi, por edhe gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojës. Mosdiskriminimi dhe qasja në arsim janë të përcaktuara edhe në nenet 2, 3 dhe 23 të KDF-së dhe në nenin 47 të Kushtetutës. Duke u thirrur në këtë kornizë ligjore, Avokati i Popullit i është drejtuar kryetarit të komunës së Prizrenit, të cilit i ka kërkuar informata lidhur me këtë rast dhe për veprimet që janë ndërmarrë nga Komuna, pasi një vendim i tillë mohon të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për edukim, kujdes dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme.

Lidhur me gjithëpërfshirjen në edukimin në fëmijërinë e hershme, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin A. nr. 359/2023, me të cilin ia ka tërhequr vëmendjen Komunës së Fushë

167 KDF, neni 7.

168 Rastet 1234/2024, 1103/2024 dhe 1308/2024.

169 Rastet 1036/2024 dhe 303/2024.

170 Rasti 45/2024.

171 Rasti 989/2024.

172 Rasti 194/2024.

173 Rasti 1374/2024.

174 Rasti 592/2024.

175 Rasti 780/2024.

Kosovës për detyrimin për të garantuar qasjen e barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuara në edukimin parashkollor si dhe krijimin e mundësive të barabarta për të në institucione parashkollore. Ky rast është iniciuar sipas ankesës nga nëna e një fëmije, fëmija i së cilës është larguar nga kopshti me arsyetimin se për shkak të tij do të ngecin edhe fëmijët e tjerë. Ankuesja vazhdimisht ka kërkuar regjistrimin e fëmijës së saj edhe në kopshte private dhe publike në këtë komunë, por asnjëri nuk i ka dhënë përgjigje. Ankuesja gjithashtu i është drejtuar DKA-së disa herë, por asnjëherë nuk ka marrë përgjigje.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se kujdesi i hershëm në fëmijëri është hapi i parë i shkallës së të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijës, e konsideron të domosdoshme që institucionet të krijojnë hapësira dhe kapacitete në mënyrë që fëmijët, pa dallim, të kenë qasje të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte. Studime të shumta mbështetin faktet se ky edukim i ndihmon fëmijët të zhvillojnë potencialin e aftësive të tyre më të mira dhe kontribuon në mirëqenien e tyre. Gjithëpërfshirjen e ulët në sistemin arsimor në Kosovë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit e ka konstatuar edhe në Raportin ex-officio nr.331/2022 lidhur me përfrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim.¹⁷⁶ Andaj, duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, KDF-në, LMF-në dhe LEFH-në, Avokati i Popullit ka vlerësuar se qasja në institucionet parashkollore e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara, pa diskriminim, është në interesin më të mirë të tyre. Rrjedhimisht, IAP-ja i ka rekomanduar Komunës së Fushë Kosovës që të ndërmarrë veprime për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës së institucioneve parashkollore në territorin e saj.

Ndërsa dy raste të tjera kishin të bënin me mungesën e transportit në shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara ndaj komunës së

Pejës, e që si detyrim është përcaktuar me nenet 13, 15 dhe 40 (4) të Ligjit për Arsimin Parauniversitar (LAP), të cilat obligojnë komunat t'u mundësojnë fëmijëve me aftësi të kufizuara qasje në transport falas, të sigurt dhe efikas për qasje në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Për këto dhe raste të tjera të ngjashme, Avokati i Popullit do të dalë me raport të veçantë.

Në rastin e ankesës së parashtruar nga ankuesja - nënë e një fëmije me aftësi të kufizuara, me vendbanim në Glllogvc, e cila është ankuar për shkak se punëdhënësi e ka njoftuar se do ta transferonin nga vendi i saj i punës, në punë me terren në vende rurale, e që ky transferim i saj nga ky repart do t'ia pamundësonte vazhdimin e punës për shkak të nevojës që ajo ka për t'u kujdesur për fëmijën së saj me aftësi të kufizuara, më saktësisht ushqyerjes së fëmijës me dëmtime të rënda. Avokati i Popullit ua ka rikujtuar autoriteteve përgjegjëse detyrimin që kanë në bazë të nenit 17 të Ligjit të Punës. Sipas kësaj dispozite ligjore, prindi i punësuar, me fëmijë me pengesa të rënda në zhvillim, nuk mund të sistemohet jashtë vendbanimit të tyre pa pëlqim. Për më tepër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe LMF-ja obligon që të gjitha veprimet e institucioneve duhet të kenë për konsideratë mbizotëruese interesin më të mirë të fëmijës. Në këtë rast kemi të bëjmë me të drejtën e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, e cila i mohohet nëse fëmija nuk mund të ushqehet. Për më tepër, KDF-ja dhe neni 35 (2) i LMF-së kërkon nga institucionet që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që prindërit ose kujdestari, që nuk kanë mundësi të kryerjes së përgjegjësive të tyre, të marrin ndihmën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë dhe sigurojnë infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme në këtë drejtim. Andaj, bazuar në legjislacionin në fuqi, IAP-ja ka vizituar punëdhënësin dhe, pas konsultimeve, vendimi është ndryshuar dhe ankuesja ka vazhduar të punonte brenda vendbanimit të saj.

176

<https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale e fëmijëve

Për sa i përket mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, këtë vit janë paraqitur 5 ankesa nga prindërit dhe janë hapur 2 raste sipas detyrës zyrtare. Dy raste kishin të bënin me neglizhencën dhe (mos) trajtimin e duhur nga personeli mjekësor¹⁷⁷, dy raste për sigurimin e banimit nga komuna¹⁷⁸, një rast për shtrenjtimin e shërbimet për fëmijë me autizëm¹⁷⁹ dhe rastet e hapura sipas detyrës zyrtare për kthimin e mjeteve financiare nga spitali jashtë Kosovës¹⁸⁰ dhe shëndetin mendor të fëmijëve.¹⁸¹

Në të dy rastet lidhur me banimin, ankesat ishin drejtuar kundër Komunës së Prishtinës. Në rastin e parë, prindi ka kërkuar ndërrimin e banimit për shkak se fëmija është viktimë e dhunës dhe nga institucionet i është premtuar një banesë për arsye sigurie për fëmijën e saj. Gjatë hetimeve është kuptuar se Komuna ka siguruar strehim tjetër. Për më tepër, QPS-ja ka njoftuar se rasti i fëmijës është nën përcjelljen e QPS-së dhe është duke u zbatuar plani i veprimit lidhur me ofrimin e shërbimeve të nevojshme për fëmijën dhe familjen duke synuar riintegrimin e fëmijës dhe monitorimin e gjendjes dhe nevojave të tyre në vazhdim.

Ndërsa në rastin e dytë, ankuesja - një nënë vetushqyese e katër fëmijëve - ka kërkuar ndihmë nga Komuna për banim, meqë jetonte me qira. Lidhur me këtë rast janë duke vazhduar hetimet. Avokati i Popullit thekson detyrimin që kanë autoritetet e pushtetit lokal në sigurimin e banimit të nevojshëm për kategoritë e ndjeshme.

Për sa u përket rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit ka nisur hetimet lidhur me humbjen e jetës së fëmijës katërvjeçar nga Gjakova, bazuar në informatat nga mediat, për shkak të dyshimit se fëmija nuk ka marrë trajtimin e

duhur mjekësor. Avokati i Popullit ka vizituar familjen, Spitalin e Përgjithshëm në Gjakovë dhe ka kontaktuar me të gjitha institucionet e përfshira: Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DShMS), Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Shëndetësisë dhe Odën e Mjekëve të Kosovës. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe hetimeve, Avokati i Popullit ka konstatuar se institucionet përkatëse kishin ndërmarë të gjitha veprimet e duhura të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për trajtimin e fëmijës dhe hetimin e rastit. Në rastin tjetër lidhur me ankesën për mostrajtim të duhur mjekësor, Avokati i Popullit ka gjetur se të gjitha veprimet e stafit mjekësor kishin qenë profesionale dhe në pajtim me ligjin.¹⁸²

Avokati i Popullit ka nisur hetimet sipas detyrës zyrtare lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet dhe mekanizmat relevantë shtetërorë në raport me shëndetin mendor të fëmijëve.¹⁸³ Në këtë drejtim, Avokati i Popullit është duke përgatitur një raport, i cili ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të shëndetit mendor të fëmijëve, problemet, pasojat, ndikimin dhe shërbimet e ofruara për trajtimin e fëmijëve. Avokati i Popullit ka vërejtur se ekziston mungesë e dispozitave specifike ligjore për intervenimin e hershëm dhe kujdesin parandalues për shëndetin mendor të fëmijëve. Më tutje, shkollat dhe institucionet shëndetësore të nivelit parësor nuk e kanë trajnimin dhe përgatitjen e nevojshme për të identifikuar shenjat e hershme të shqetësimit mendor, gjë që çon në vonesë të ndërhyrjeve psikologjike për fëmijë. Ngjashëm, edhe në nivelin dytësor ka shërbime të pamjaftueshme të shëndetit mendor për fëmijë, ku këto shërbime ofrohen vetëm në spitalet rajonale, përkatësisht në repartet përkatëse të psikiatrisë. Për më tepër, në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe

177 Rastet 133/2024 dhe 311/2024.

178 Rastet 464/2024 dhe 1085/2024.

179 Rasti 729/2024.

180 Rasti 967/2024.

181 Rasti 662/2024.

182 Rasti 311/2024.

183 Rasti 662/2024.

Adoleshentëve, numri i profesionistëve të angazhuar nuk mund të akomodojë kërkesat e pacientëve duke vështirësuar ndarjen e përgjegjësive sipas përgatitjeve profesionale. Kërkesa e madhe për vlerësime psikologjike nga pacientët dhe QPS-të, si dhe numri i ulët i profesionistëve në raport me kërkesat e bën të pamundur ofrimin e shërbimeve të psikoterapisë nga specialistët e psikologjisë klinike.

E Drejta për Arsimin

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dhe rregullon të drejtën për arsimim, në nenin 47, si e drejtë e cila ngërthen tri obligime kryesore: (i) ofrimin e arsimimit themelor të detyrueshëm dhe pa pagesë; (ii) krijimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili ofron mundësi të barabarta; dhe (iii) krijimin e një sistemi arsimor, i cili përmbush nevojat dhe aftësitë themelore e specifike të çdo fëmije.¹⁸⁴ Kjo e drejtë përcaktohet edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ) si dhe në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijës (KDF).¹⁸⁵

Gjatë vitit 2024 janë nxjerrë aktet nënligjore të cilat rregullojnë procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar¹⁸⁶, si dhe Udhëzuesi për Drejtoritë Komunale të Arsimit për zbatimin e rregullores. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet edhe nxjerrja e Udhëzuesit Nr.2-2531 për Zëvendësimin e Mësimdhënësve me Gjendje të Rëndë Shëndetësore, datë 27.8.2024, përmes të cilit rregullohen procedurat për kompensimin e tyre.

Me qëllim të përcaktimit të roleve, organizimit, funksionimit, bashkëpunimit si dhe detyrave dhe përgjegjësive për institucionet edukativo-

arsimore dhe aftësuese është nxjerrë Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.05/2024 Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës.¹⁸⁷

Në drejtim të mbrojtjes së këtyre të drejtave, në kuadër të aktiviteteve promovuese dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2024 zhvilloi fushata informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave filllore dhe të mesme të ulëta, për këtë qëllim u vizituan institucione arsimore parauniversitare, po ashtu Avokati i Popullit mori pjesë në takime të ndryshme.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar gjithsej 29 raste, të paraqitura sipas tabelës së mëposhtme:

Numri i ankesave të paraqitura për të drejtën në arsim	29
Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim	22
Numri i ankesave të papranueshme	7
Numri i rasteve të hapura me vetiniciativë	5

Ankesat e papranueshme, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit	Numri i ankesave të papranueshme
Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	5
S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	1
Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	1
Totali	7

Nga rastet që janë në hetim, 6 janë sipas ankesave individuale, ndërsa 4 raste janë të hapura sipas detyrës zyrtare. Prej ankesave individuale, dy ankesa janë për shkak të mospërgjigjes në ankesat e parashtruara, dy ankesa për shkak të pretendimit lidhur me mungesën e transportit për nxënës, përfshirë edhe fëmijë me nevoja të veçanta arsimore,

184 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47.

185 Protokoll nr. 1 i KEDNJ, neni 2 dhe Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 28.

186 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=95292>

187 <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-qrk-nr-05-2024-edukimi-permbrojtjen-e-femijes/>

një ankesë me pretendimin për trajtim joadekuat të nxënësve në një shkollë private dhe një ankesë lidhur me akomodimin në Konviktin e studentëve.

Rastet të cilat janë iniciuar sipas detyrës zyrtare trajtojnë çështjen e mosakreditimit të programeve studimore¹⁸⁸, braktisjen e mësimit nga nxënësit në komunën e Gjakovës¹⁸⁹, përdorimit të gjuhës së shenjave dhe kurrikulat¹⁹⁰ dhe përgjegjësitë e detyrimit e shtetit në raport me dhunën fizike dhe psikike në shkolla.¹⁹¹

Nga rastet e hapura për hetim (22 raste), 12 nga to janë mbyllur, prej tyre 6 raste janë zgjidhur sipas kërkesës së palëve, për 4 raste është konstatuar se nuk ka shkelje apo keqadministrim nga institucionet kundër të cilave ishin hapur hetimet dhe 2 raste janë mbyllur për shkak të dështimit të palëve ankuese për bashkëpunim me Avokatin e Popullit.

Gjatë vitit raportues, lidhur me të drejtën në arsim, Avokati i Popullit ka publikuar 3 raporte me rekomandime¹⁹² dhe 1 letër rekomandimi.¹⁹³ Po ashtu ka dhënë një Deklaratë në lidhje me raportimet e ngacmimeve seksuale, nëpërmjet së cilës ka shprehur shqetësimet në lidhje me deklaratimet për ngacmimet seksuale në Universitetin Publik të Prishtinës.¹⁹⁴

Për sa i përket arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, në vitin 2024 janë angazhuar një numër i asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, mirëpo edhe përkundër kësaj, ende kemi nxënës të cilëve nuk u sigurohet mbështetja e asistentëve, prandaj është e nevojshme që të vazhdohet me angazhimin e asistentëve sipas nevojave të nxënësve.

Avokati i Popullit vëren se lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme, numri i fëmijëve të cilët vijojnë në çerdhe vazhdon të jetë i vogël, prandaj është e nevojshme të shtohen kapacitetet për përfshirje të fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme.

Sistemi arsimor për fëmijët e komunitetit serb vazhdon të funksionojë me planprograme mësimore të sistemit arsimor të Republikës së Serbisë dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, pa e njoftuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.¹⁹⁵

Lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore për nxënësit e nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, edhe këtë vit shkollor është raportuar se procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore është përcjellë me probleme dhe vonesa. Lidhur me këtë çështje është raportuar se Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet Komisionit Hetimor Parlamentar, ka angazhuar ekspertë lidhur me procesin e subvencionimit të teksteve shkollore.¹⁹⁶ Prandaj Avokati i Popullit konsideron se është e nevojshme që procedurat e shpërndarjes së teksteve shkollore të fillohen në një periudhë të mjaftueshme kohore në mënyrë që nxënësit të furnizohen pa vonesa me tekste shkollore.

MASHTI, edhe përkundër shumë përpjekjeve, edhe këtë vit ka dështuar të përfundonte procedurat e rekrutimit të inspektorëve të arsimit. Mungesa e numrit të mjaftueshëm të inspektorëve arsimor krijon vonesa në procesin e vlerësimit të performancës së mësimeve dhe ndikon edhe në sigurimin e cilësisë së arsimit.

Duke u bazuar në rekomandimet e nxjerra

188 R/1204/2024

189 R/1178/2024

190 R/1128/2024

191 R/661/2024

192 Rastet nr.359/2023; 636/2023; 637/2023

193 Rasti nr.292/2024,

194 <https://oik-rks.org/2024/04/25/deklarate-e-avokatit-te-popullit-ne-lidhje-me-raportimin-e-ngacmimeve-seksuale/>

195 Neni 12, paragrafi 12.2, i Ligjit Nr.03/L-068 për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës

196 <https://www.youtube.com/watch?v=cLwk3uUjqA8> Lajmet e orës 20.00, Klan Kosova, 09.11.2024.

nga Avokati i Popullit, mund të përfundohet se në institucionet arsimore ende mbetet sfidë miratimi i Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi, të cilat do të mundësonin ngritjen e cilësisë në arsim. Përkundër disa përmirësimeve, mbetet sfidë gjithëpërfshirja në arsim, sidomos e grupeve të cënueshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve pjesëtarë të komuniteteve joshumicë. Po ashtu, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, mbetet sfidë edhe përkrahja më e madhe dhe sigurimi i transportit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, sidomos sigurimi i numrit të mjaftueshëm të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Në nëntor u zhvillua një debat publik në vend duke ngritur shqetësime lidhur me doracakët për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues, të cilët përdoren nga mësimdhënësit. Një nga një Komuna e Prishtinës, e Fushë Kosovës, e Lipjanit dhe e Gjilanit i kundërshtuan doracakët duke i larguar ata nga përdorimi. Pas këtyre reagimeve, më 15 nëntor MASHTI gjithashtu vendosi për largimin e doracakëve nga përdorimi në shkolla duke paralajmëruar themelimin e një komisioni për rishikimin e tyre.¹⁹⁷ IAP-ja mirëpret rishikimin dhe përmirësimin e pjesëve të caktuara të doracakëve për t'i bërë ata më të qartë dhe të kuptueshëm për mësimdhënësit, duke adresuar shqetësimet e ngritura. Për më tepër, në prill të vitit 2023 IAP-ja ka publikuar Raportin me rekomandime ex officio nr. 577/2021, përkitazi me “Të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues”, pas një hetimi të këtyre të drejtave bazuar në dëshmi të drejtpërdrejta të grave dhe vajzave. IAP-ja i ka rekomanduar MASHTI-t që të sigurojë se edukimi seksual është i përshtatshëm për moshën si dhe të ofrohet si lëndë e rregullt për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët në

shkollat e Kosovës.¹⁹⁸ Edukata seksuale është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve, sepse u jep atyre informata të sakta dhe mjetet për të marrë vendime rreth shëndetit, marrëdhënieve dhe identitetit të tyre. Për më tepër, edukata seksuale i ndihmon vajzat dhe djemtë të mbrohen nga dhuna duke promovuar marrëdhënie të bazuara në respekt, barazi, pajtim dhe vullnet të lirë duke zvogëluar rrezikun e abuzimeve dhe dhunës.

Liria e Artit dhe e Shkencës

Liria e artit dhe e shkencës, si një nga format më specifike të manifestimit të mendimit artistik dhe shkencor, përpos me instrumente ndërkombëtare, është e garantuar edhe me legjislacionin nacional, me Kushtetutë dhe me akte të tjera ligjore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 48 të saj, shprehimisht thekson: “1. *Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar.*”; “2. *Liria akademike është e garantuar.*”¹⁹⁹

Liria e artit dhe e shkencës nënkupton lirinë dhe të drejtën e secilit/ës që të marrë pjesë në krijimin e veprave shkencore dhe artistike dhe që si autor/e të gëzojë në mënyrë të patjetërsueshme mbrojtjen e interesave që rrjedhin nga veprat të cilat janë rezultat i krijimtarisë së tyre. Këto aspekte të lirisë së krijimtarisë artistike dhe shkencore si dhe të drejtave autoriale i përcakton decidivisht DUDNJ-ja në nenin 27 (paragrafët 1 dhe 2), për dallim nga KEDNJ-ja, e cila nuk e ka paraparë atë si një të drejtë specifike, mirëpo kjo nuk nënkupton se liria e artit dhe e shkencës është jashtë sferës së KEDNJ-së, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁰⁰ (GjEDNJ).

Avokati i Popullit e vlerëson si një hap tejet të rëndësishëm nxjerrjen e Ligji nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, si një ligj tejet

197 <https://kallxo.com/lajm/mashti-largon-nga-perdorimi-doracaket-per-edukimin-seksual-ne-shkolla/>

198 <https://oik-rks.org/2023/01/04/raport-ex-officio-nr-5772021-lidhur-me-te-drejtat-ne-shendetin-seksual-dhe-riprodhues-qasja-ne-informata-dhe-sherbime-kontracesioni-ne-abort-dhe-kujdes-pas-abortit-si-dhe-kujdesi-per-shendetin-e/>

199 Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

200 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

të rëndësishëm, por meqë ligji në fjalë parasheh edhe çështje të reja p.sh. Në nenin 27 flet për Statusin e artistit merit, kriteret dhe procedurat për gëzimin e së drejtës së këtij statusi, shkallën, kontributin si dhe modalitetet e beneficioneve që mund t'i gëzojë artisti që posedon këtë status, çka pa akt nënligjor kjo mbetet vetëm një e drejtë e paraparë në letër, për shkak se zbatimi i saj mund të specifikohet vetëm me akt nënligjor. Prandaj Avokati i Popullit i rekomandon MKRS-së që të ndër marrë hapa në drejtim të nxjerrjes së akteve normative, si një mundësi reale e jetësimit në praktikë të ligjit në fjalë.

E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës²⁰¹ dhe është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.²⁰² Gjithashtu kjo e drejtë është e rregulluar dhe mbrohet edhe me ligje bazike, të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.²⁰³

Avokati i Popullit vëren se realizimi i të drejtave të qytetarëve nga fusha e marrëdhënies së punës ka një rëndësi të posaçme për statusin e çdo qytetari dhe njëkohësisht është një indikator se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve. Garancitë kushtetuese për të drejtën e punës dhe për të drejtën për zgjedhjen e lirë të profesionit krijojnë obligim për institucionet që t'i mbrojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve dhe të sigurojnë respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.

Avokati i Popullit vazhdon t'i trajtojë marrëdhëniet e punës si një nga problematikat kryesore dhe të rëndësishme të shqyrtimit të ankesave të depozituara nga persona që

punojnë në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka pranuar 179 ankesa në lidhje me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit. Ankesat që ka pranuar Avokati i Popullit kanë trajtuar: ndërprerjen e marrëdhënies së punës, mosrealizimin e së drejtës në pagë dhe zvogëlimin të pagave, sistemimi i padrejtë në vendin e punës, heqjes së shtesave apo trajtimin joadekuat dhe jo të barabartë ndërmjet pozitive të përcaktuara me ligj. Ankesat që janë pranuar janë parashtruar nga subjekte të sektorit publik dhe privat, si: ankesa grupe²⁰⁴, individualisht si dhe nëpërmjet sindikatave.²⁰⁵

Viti 2024, po ashtu sikurse vitet e mëparshme, është karakterizuar me greva në disa sektorë për plotësimin kushteve të punës, siç janë: punëtorët e pastrimit në Kuvendin e Kosovës, punëtorët teknikë dhe sigurimit fizik në Universitetin e Prishtinës, sektori privat, minatorë të Kombinatit Trepça, etj., të gjithë këta sektorë kërkonin përmirësim të kushteve në punë dhe rritje të pagave.

Avokati i Popullit konstaton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese si në sektorin publik, e sidomos në sektorin privat, ka shkelje të ndryshme të së drejtës nga marrëdhënia e punës, përfshirë edhe diskriminimin, si: shkelje të procedurave të punësimit, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, si dhe shkelje lidhur me kohëzgjatjen e orarit të punës, kompensimin për punë jashtë orarit, mohimin e së drejtës për pushim vjetor dhe pushim të lehonisë dhe mosrealizimin e së drejtës në pagë.

Avokati i Popullit vlerëson se Inspektorati i Punës (IP), si mekanizëm parandalues dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit, duhet të kontrollojë në mënyrë unike dhe të vazhdueshme të gjitha vendet e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, duke përfshirë kushtet e punës, mbrojtjen në

201 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

202 Po aty, neni 22.

203 Ligji nr. 03/L-212 i Punës; Ligji nr.03/L-145 për Shërbimin Civil; Ligji nr.03/L- 147 për Pagat e Nëpunësve Civilë; Ligji nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

204 Ex-officio 1157/2024, lidhur me grevën e punëtorëve teknikë në Kuvendin e Republikës së Kosovës

205 R.nr. 59/2024, ankesë nga Sindikata e Pavarur e Administratës të Kosovës.

punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve në përgjithësi, sidomos të veprojë në mënyrë aktive për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit.

Avokati i Popullit po ashtu konstaton se mbrojtja gjyqësore në lidhje me ndonjë të drejtë të shkelur nga marrëdhënia e punës nuk është në nivelin e duhur, sepse një procedurë gjyqësore në kontestet e punës zgjat për afërsisht 6 deri 8 vjet deri në një vendim të plotfuqishëm nga gjykata, duke i vendosur punëtorët në një pozitë të vështirë për realizimin e të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se edhe gjatë periudhës raportuese vazhdon mosfunksionimi i Këshillit Ekonomiko-Social, duke sjellë pasoja të dukshme dhe të vazhdueshme, sepse vë në pikëpyetje qëllimin që ka themelimi i këtij këshilli dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishme të veçantë, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale, që realizohen përmes zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe apo trepalëshe.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se marrëveshjet kolektive të punës janë instrument për rregullimin e kushteve të punës dhe të punësimit si dhe realizimit të të drejtave për punë. Dispozitat e kontratës kolektive kanë efekt të përgjithshëm juridik dhe ato i plotësojnë apo i zëvendësojnë normat ligjore. Fakti se edhe gjatë vitit 2024 ka munguar vullneti i Qeverisë për të arritur marrëveshjen e përgjithshme kolektive (e cila ka skaduar në vitin 2018), kjo ka ndikuar në përkeqësimin e realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës në sektorin publik dhe privat.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen për rëndësinë e miratimit të kontratës kolektive të punës si instrument i rëndësishëm që garanton realizimin e të drejtave ligjore, përmirësimin e kushteve të punës dhe realizimin e të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka trajtuar disa çështje të cilat kanë të bëjnë me uljen e koeficienteve të pagave, të cilat fillimisht janë caktuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/

L-196 për Pagat në Sektorin Publik, por më vonë me rishikimin e koeficienteve janë ulur koeficientet dhe janë detyruar punonjësit që ta kthejnë diferencën e pagës.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit është në fazën e hetimeve, përkatësisht në vlerësimin e sigurisë juridike dhe pritshmërisë legjitime të punonjësve, pagat e të cilëve janë ulur pa një akt administrativ dhe pa dhënien e mundësisë për mjete juridike.

Po ashtu, Avokati i Popullit gjatë trajtimit të çështjeve ka vërejtur se akoma mbetet shqetësuese mungesa e sigurimeve shëndetësore dhe të jetës për punonjësit në Republikën e Kosovës, e aq më tepër për pozitat të cilat kanë rrezik për shëndetin apo jetën e punonjësve.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka hasur në një problematikë shumë serioze, e cila është përsëritur nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës në proceset legjislative, përkatësisht mosaplikimin e udhëzimeve dhe konstatimeve të nxjerra nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin KO 216/22 dhe 220/22 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në rastin e caktimit të mandatit për drejtuesit e mesëm dhe të ulët, të cilët e kanë fituar këtë të drejtë para hyrjes në fuqi të ligjit të theksuar më sipër. Avokati i Popullit ka vërejtur se edhe përkundër konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese se një normë e tillë është kundërkushtetuese, Qeveria dhe Kuvendi kanë vazhduar që normën e njëjtë ta vendosnin edhe në procedurën e Ndryshimit dhe Plotësimit të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e po ashtu edhe në Ligjin nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, si dhe Kodin nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se një praktikë e tillë përveçqë e minon parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërisë së ligjshme, bie në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 1, sipas të cilit përcaktohet: “*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*”

Mbrojtja dhe siguria në punë

Ligji nr. 03/L-212 i Punës, në nenin 42, paragrafi 1, ka përcaktuar: *“I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.”* Një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm është parakusht për parandalimin e rreziqeve në proces të punës, me qëllim ruajtjen e jetës, shëndetit dhe dinjitetit të punonjësve.

Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2024 ka përcjellë me shqetësim rastet e raportuara të aksidenteve në punë dhe rastet që punëtorët kanë pësuar me jetë. Sipas statistikave të IP-së, numri i aksidenteve në vendet e punës që përfundojnë me fatalitet mbetet i lartë dhe mjaft shqetësues. Gjatë vitit 2024, sipas të dhënave zyrtare në Kosovë, janë evidentuar 524 raste të aksidenteve në vendin e punës, nga të cilat 6 raste kanë rezultuar me fatalitet.²⁰⁶ Numri më i madh i këtyre rasteve të lëndimeve në vendin e punës janë evidentuar në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si: ndërtimtari, prodhimtari, elektricitet, shërbime etj.

Avokati i Popullit vëren mospërputhje në të dhënat statistikore, e që paraqet shqetësim, ngase nuk ka një sistem të integruar të mbledhjes së të dhënave për rastet e raportuara nga autoritetet përkatëse. Kjo kuptohet nga të dhënat që ka publikuar Sindikata e Punëtorëve të Sektorit Privat në Kosovë, që sipas tyre, gjatë vitit 2024, 12 persona kanë humbur jetën në vendin e punës, duke theksuar se shumica e rasteve me fatalitet kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit, ku shënohen më shumë vdekje në vendin e punës.²⁰⁷ Andaj edhe besueshmëria e këtyre të dhënave mbetet sfiduese dhe e diskutueshme.

Avokati i Popullit thekson se këto shifra mbeten edhe më sfiduese në Republikën e Kosovës, kur marrim parasysh zhvillimin e

përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor si dhe nivelin e zbatueshmërisë së legjislacionit të marrëdhënive të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në lidhje me këtë, pas hetimeve të bëra për sigurinë dhe shëndetin në punë, Avokati i Popullit gjatë këtij viti publikoi Raportin Ex-officio nr. 252/2021²⁰⁸ për të vlerësuar se sa autoritetet publike, përgjegjëse për zbatimin e ligjit, po i përmbushin detyrimet që kanë në marrjen e masave për parandalimin e aksidenteve në punë, sigurinë dhe ruajtjen e shëndetit në vendin e punës për të punësuarit, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik.

Përkitazi me të drejtat në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë në Republikën e Kosovës, pas hetimeve të bëra janë identifikuar një mori shkeljesh të të drejtave që ndërliken edhe me shkeljen e dinjitetit të punëtorëve, veçmas të punësuarit e sektorit privat.

Raporti në fjalë ka marrë për bazë fatkeqësitë dhe lëndimet në vendin e punës të ndodhura ndër vite 2004-2023. Përveç të tjerash, Avokati i Popullit ka konstatuar se humbjet e jetëve dhe lëndimet e dëmtimet e tjera shëndetësore në mjedise pune a të ndërliken me punën, në radhë të parë janë pasojë e mungesës së masave mbrojtëse dhe parandaluese, duke theksuar se vazhdon të mbetet shqetësim mungesa e kushteve të sigurta për punë, veçmas në ata sektorë që janë identifikuar në këtë Raport, si më të predispozuar për sa i përket rrezikut. Me këtë rast, Avokati i Popullit po ashtu ka konstatuar se shëndeti në punë është fushë ende e parregulluar juridikisht në shumë segmente dhe e patrajtuar në kuptim të organizmit të zinxhirit institucional, i cili do t'i jetësonte detyrimet e autoriteteve publike në mbrojtjen e shëndetit në punë. Prandaj, në kuptim të përgjithshëm, kjo gjë rëndohet

206 Përgjigje e datës 19 dhjetor 2024 nga Inspektorati i Punës.

207 Takim me kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, më 19 dhjetor 2024. Të dhënat për vitin 2024 i referohen periudhës janar - nëntor 2024.

208 <https://oik-rks.org/2024/02/22/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-2522021-lidhur-me-sigurine-dhe-shendetin-ne-pune/>

nga rastet e mungesës së kontratave të punës, mungesës së sigurimit shëndetësor, mosrespektimit të së drejtës për pushim (ditor, javor, vjetor, mjekësor, të lehonisë), mungesës së trajnimeve të punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë etj. Masat e ndërmarra deri më tani nga organet kompetente, lidhur me evitimin e shkeljeve, janë të mangëta e të pamjaftueshme.

Gjithnjë duke iu referuar raportit në fjalë, Avokati i Popullit ka konstatuar se Inspektorati i Punës nuk është duke arritur t'i përmbushë përgjegjësitë dhe detyrimet që ka sipas legjislacionit në fuqi dhe standardeve të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, duke çaluar për sa i përket aplikimit të saktë të mandatit që ka, kundrejt detyrimeve që kanë punëdhënësit, për të krijuar kushte të sigurta e të shëndetshme pune dhe respektim të legjislacionit të punës për sa i përket marrëdhënieve të punës me punonjësit. Bazuar në të gjeturat nga raporti, Avokati i Popullit u ka adresuar rekomandime autoriteteve kompetente, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Inspektoratit të Punës dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Avokati i Popullit, më 12 mars 2024, organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësuesit e sindikatave të vendit me qëllim që të adresoheshin çështjet e rëndësishme për të drejtat e punëtorëve dhe sigurinë e shëndetit në punë. Gjatë tryezës Avokati i Popullit ritheksoi nevojën për respektimin e të drejtave të të punësuarve, dialogun social dhe lirinë e organizimit sindikal, mbrojtjen shëndetit dhe sigurisë në punë etj. Nga tryeza dolën konkluzionet, si: nevoja për angazhim të institucioneve përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve për nënshkrimin e kontratës kolektive, zbatimin sa më parë të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, krijimin e gjykatës që merret me zgjidhjen e kontesteve të punës, funksionalizimit sa më shpejt të Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe të Këshillit Ekonomiko-Social etj.

Për Avokatin e Popullit shqetësuese mbetet veçanërisht mungesa e hetimit të rasteve të fatkeqësive në vendin e punës nga institucionet përgjegjëse dhe

organet hetuese, si dhe mosndëshkimi i punëdhënësve për shkak të mossigurimit të punëtorëve dhe të vendeve të punës.

Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

Neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në paragrafin 1 përcakton: *“Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.”* Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.”*

Gjatë vitit 2024, IAP-ja ka pranuar 211 ankesa përkitazi me cenimin e së drejtës shëndetësore dhe sociale. Vlen të theksohet se gjatë vitit raportues, në IAP janë hapur 69 raste për hetim, prej të cilave 5 raste janë hapur me vetiniciativë nga IAP-ja, gjegjësisht Ex officio. Kur jemi te ankesat e papranueshme, duhet theksuar se papranueshmëria e tyre ka të bëjë kryesisht me mosshkrimin e mjeteve juridike, me jokompetencën e Avokatit të Popullit në raport me kërkesat e ankuesve, kur procedurat ishin duke u zhvilluar te organet e tjera kompetente, etj.

Ndër sfidat kryesore me të cilat janë përballur qytetarët dhe institucionet shëndetësore gjatë vitit 2024, janë evidentuar: mungesa e barnave nga lista esenciale, pritja e gjatë e qytetarëve për të marrë disa lloje shërbimesh në institucionet shëndetësore, shpenzimet e larta nga xhepi i qytetarëve për mjekimin e tyre brenda dhe jashtë vendit, vdekshmëria e foshnjave, mungesa e sigurimit shëndetësor, buxheti i pamjaftueshëm për institucioneve shëndetësore etj.

Ndërsa nga fusha sociale, IAP-ja ka pranuar dhe trajtuar ankesa përkitazi me: ndërprerjen e pensioneve, mosnjohjen e të drejtave në pensione të dyfishta, ankesa për mospagim për trajtime shëndetësore jashtë vendit, ankesa përkitazi me bllokimin e xhirrologarive të pensionistëve nga përmbaruesit privatë, heshtje administrative në procedura të rishqyrtimit kur vendimet janë kthyer nga gjykatat, ankesa përkitazi me banimin dhe strehimin, kërkesa për vlerësimin e

përputhshmërisë me Kushtetutën nga Gjykata Kushtetuese të Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti etj.

E drejta e shëndetit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut rregullohet me akte të një karakteri universal, si dhe me konventat e Këshillit të Evropës.²⁰⁹ E drejta e shëndetit, respektivisht mbrojtja e kësaj të drejte nuk paraqitet si nen i veçantë i KEDNj-së, por shëndeti publik në tekstin e saj na shfaqet si një ndër interesat që mund të justifikojnë “ndërhyrjen” në të drejtat materiale/të drejtat e kualifikuara.²¹⁰

Të drejtat shëndetësore në Kosovë garantohen përmes ligjeve dhe akteve të tjera juridike, me ç’ rast aty përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësi. Ky legjislacion ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.

Por përkundër kësaj, numri i ankesave që ka pranuar IAP-ja gjatë vitit raportues na ka treguar se mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave deri më tash janë treguar të pamjaftueshëm dhe si rrjedhojë akoma nuk mund të flasim për një ofrim të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Si të arritura në fushën shëndetësore gjatë vitit 2024 janë proklamuar miratimi i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë për periudhën 2025-2030, miratimi i Planit të Veprimit të Sigurisë Shëndetësore 2024-2026, si dhe miratimi i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 5 dhjetor 2024.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit i ka hapur disa raste ex officio nga fushëveprimi i të drejtave shëndetësore, të cilat kryesisht kanë target mungesën e barnave nga lista esenciale, si dhe çështjen e vendosjes së protezave (në kërdhokull apo gjunjë) te personat e moshës mbi 65- vjeçare.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues i ka publikuar katër (4) raporte nga fusha e së drejtës shëndetësore, me gjithsej 20 rekomandime. Dy raporte janë rezultat i ankesave që ka pranuar nga qytetarët dhe shoqatat, ndërsa dy raportet të tjera janë iniciuar me vetiniciativë nga Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit ka hetuar ankesën e Shoqatës së të Plagosurve Civile nga Minat²¹¹, kundër Vendimit nr.43/III/2024 të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), të datës 22 mars 2024, përkitazi me mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së. Lidhur me këtë rast vërehet se më 20 mars 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë Vendimin nr.01/194, me ç’ rast ka aprovuar kërkesën e MSh-së për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave, jashtë institucioneve shëndetësore publike, kur këto të fundit nuk i ofrojnë këto shërbime. Avokati i Popullit pas hetimit të kësaj çështje, më 5 dhjetor 2024 ka publikuar Raportin R.nr. 522/2024. Me këtë rast Avokati i Popullit ka konstatuar se Vendimi nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga MSh-ja, përbën diskriminim, për arsye se vendimi në fjalë përcakton vetëm beneficionet për personat me statusin e invalidit të luftës së UÇK-së duke përjashtuar kategorinë e personave me status të invalidit civil të luftës. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta anulojë Vendimin nr.43/III/2024, të datës 22 mars 2024, të nxjerrë nga MSh-ja, ndërsa MSh-së i ka rekomanduar që të ndër marrë masa në përputhje me Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve,

209 Karta Sociale Evropiane (neni 11), Konventa për Përgatitjen e një Farmacopea Evropiane; Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësisë (Konventa Oviedo).

210 Shih paragrafët 2 të neneve 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së, si dhe nenin 2, paragrafi 3, i Protokollit nr.4, të KEDNj.

211 Rasti nr. 522/2024

Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, për ofrimin e beneficioneve të veçanta për invalidët civilë të luftës.

Avokati i Popullit ka hetuar edhe tri ankesa individuale²¹² me pretendim për cenim të të drejtave për shkak të mospërfshirjes së disa barnave, të cilat, sipas ankuesve, janë esenciale për shëndetin dhe jetën e tyre. *Ankuesi i parë* e përfaqëson Shoqatën për Mbështetje të Personave të Prekur nga Melanoma, dhe ankohej kundër MSh-së për mosvendosjen e terapisë “braf pozitiv” në Listën e Barnave Esenciale (LBE) për trajtimin e të sëmurëve nga Melanoma. *Ankuesi i dytë* ankohej kundër MSh-së për mosdhënien falas të imunoterapisë “pembrolizumab” për trajtimin e të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlçi. Sipas ankuesit, kjo terapi është në LBE, por u jepej falas vetëm pacientëve të sëmurë me melanomë dhe kancer të mushkërive, por jo edhe të sëmurëve me sëmundje të tjera. *Ankuesi i tretë* ka parashtruar ankesë kundër Komitetit Kyç për Listën e Produkteve Mjekësore dhe Materialit Shpenzues në MSh, lidhur me kërkesën që produkti mjekësor “Pirfenidone” të përfshihet në listën e barnave mjekësore për trajtimin e indikacionit fibroza e mushkërive idiopatike. Pas hetimit të këtyre rasteve, Avokati i Popullit e ka publikuar Raport me rekomandime në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda.

Avokati i Popullit sipas detyrës zyrtare ka hapur rast për hetim në lidhje me detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare.²¹³ Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, ka ndërmarrë veprime hetimore dhe në bazë të të gjeturave, të fakteve të mbledhura, si

dhe pas analizimit të ligjeve relevante si dhe bazuar nga praktika e rasteve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstatoi se zbatimi i kriterit të moshës për të refuzuar qasjen e personave mbi moshën 65-vjeçare në shërbimet spitalore të shëndetit mendor, shkel të drejtat e njeriut dhe përbën diskriminim të bazuar në moshë. Avokati i Popullit, pas hetimit të këtij rasti ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex officio nr 601/2023.²¹⁴

Avokati i Popullit në këtë raport ka konstatuar se kufizimi i moshës deri në 65-vjeçare, si kriter për t’u pranuar në institucione rezidenciale dhe mungesa e akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë përbën shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Avokati i Popullit, bazuar në konstatimet e raportit, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të ndërmarrin masa për hartimin e planit kombëtar mbi moshimin, të përfshijë shërbimet specifike të shëndetit mendor për moshat e shtyra dhe shërbimin geriatrik duke përcaktuar qartë detyrimin për nxjerrjen e akteve nënligjore në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm etj.

Avokati i Popullit ka hapur hetim sipas detyrës zyrtar²¹⁵, përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave shëndetësore në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex officio nr 241/2022. Avokati i Popullit në raport ka konstatuar se mbledhja dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor mbeten jo të integruara e të shpërndara në sisteme që nuk korrespondojnë, nuk ka një pasqyrë të integruar të të dhënave, të cilat do të shndërroheshin dhe do të shërbenin si evidencë dhe si indikatorë për ndërtimin e politikave dhe strategjive në sektorin shëndetësor dhe kjo gjithashtu ka për pasojë ngecje në ofrimin e shërbimeve shëndetësore

212 A. nr.526/2023, R.nr. 812/2024, R.nr.867/2024

213 Ex officio nr. 601/2023

214 <https://oik-rks.org/2024/09/10/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-601-2023-ne-lidhje-me-detyrimet-e-shtetit-per-mbeshtetjen-dhe-ofrimin-e-sherbimeve-te-shendetit-mendor-per-personat-e-moshes-mbi-65-vjecare-ne-republiken/>

215 R. nr 241/2022

dhe avancimin e mirëqenies sociale. Bazuar në të gjeturat e raportit, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë që t'i ushtrojë detyrimet dhe obligimet që ka sipas kornizës përkatëse normative, për ta funksionalizuar, me urgjencë dhe plotësisht, Sistemin Informativ Unik dhe të Integruar të Informimit Shëndetësor, në të gjitha nivelet dhe sektorët e sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Me ankesë të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë, përmes Avokatit të Popullit, Statuti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar më 3 korrik 2024 ka përfunduar në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vendosjen e masës së përkohshme dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së Statutit.

Bazuar në Raportin e Progresit për Kosovën përkitazi me shëndetin publik, i publikuar më 30 tetor 2024²¹⁶ në Bruksel, thuhet se cilësia e kujdesit shëndetësor mbetet një shqetësim. Raporti thotë se përkundër faktit se Kosova ka ndarë një rritje të buxhetit për kujdesin shëndetësor krahasuar me vitin 2023, ajo mbetet e dyta më e ulëta në rajon dhe dukshëm më e ulët se mesatarja e shteteve të BE-së, duke rezultuar me joefikasitet të konsiderueshëm dhe të dobët në rezultatet shëndetësore.

Raporti thekson se shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në Kosovë akoma mbetet shumë e lartë, ndërsa shpenzimet nga xhepi i qytetarëve për mjekimin e tyre po ashtu mbeten shumë të larta. Më tutje Raporti thekson mangësitë që ka Kosova në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave shëndetësore dhe thekson se legjislacioni për gjakun, indet, qelizat dhe organet nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së. Tutje thuhet se Kosova ka një program për skринingun e kancerit, por depistimi i kancerit nuk kryhet sistematikisht dhe nuk ka një regjistër funksional të kancerit. Raporti precizon se recetat e mjekut duhet të zbatohen nga farmacitë, në mënyrë që të ndalet praktika e zakonshme e shitjes së medikamenteve, gjegjësisht antibiotikëve

pa recetë. Në fund Raporti përkufizon se pabarazitë në shëndetësi mbeten një shqetësim serioz. Mungesa e financimit të duhur shëndetësor ka penguar progresin drejt mbulimit shëndetësor universal dhe ka kontribuar në pagesat e vazhdueshme të larta nga xhepi i qytetarit. Barra financiare ka qenë veçanërisht e rëndë për segmentet e cenueshme dhe të varfra të shoqërisë së Kosovës, duke përfshirë njerëzit me gjendje kronike, që kanë nevojë për mjekime në baza të rregullta.

Kur jemi te e drejta sociale, Avokati i Popullit ripërsërit se Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vazhdon të mos jetë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht Kosova legjislacionin në fushën sociale nuk e ka të rregulluar mjaftueshëm edhe pse ka ligje, siç është Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, apo ligjet specifike për disa nga grupet e ndjeshme shoqërore, siç janë personat e verbër apo personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, por Kosovës ende i mungon një legjislacion i mirëfilltë që bazohet në standardet ndërkombëtare që do ta rregullonte fushën e sigurimit social për qytetarët e saj.

Avokati i Popullit, duke u referuar ankesave që ka pranuar dhe hetimeve të zhvilluara në kuadër të çështjeve që ka trajtuar gjatë vitit raportues, konstaton se gjendja ekonomike dhe sociale e një pjese dërmuese të familjeve në Kosovë nuk është e mirë. Mungesa e kushteve të përshtatshme për jetesë, kushtet jo të mira për kategoritë e ndjeshme të shoqërisë, zvarritja e procedurave gjyqësore për rastet e pensioneve, si dhe te personat me aftësi të kufizuar janë disa nga grupet më të cenueshëm që në mungesë të masave sociale, mungesa e shërbimeve rehabilituese për këto grupe shoqërore shpesh ato i ballafaqon me kushte të padinjitetshme për jetë. Rritja e ankesave të pensionistëve gjatë këtij viti, siç duket, është indikator i rritjes së varfërisë në vend.

Avokati i Popullit vëren se gjatë vitit raportues, Qeveria ka ndërmarrë disa masa

216 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf

për përmirësimin e situatës sociale për grupet e ndjeshme të shoqërisë, duke rritur vlerën e pensioneve për 20%, apo vendimin për shtesat të njëhershme në dhjetor 2024 në shumën prej 100 eurosh për të gjithë pensionmarrësit, por për shkak të inflacionit, masat e ndërmarra kanë pasur ndikim afatshkurtër në përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike për familjet dhe individët përfitues.

Avokati i Popullit, në bazë të mandatit të tij kushtetues dhe sipas kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, ka hapur rast Ex officio²¹⁷ përkitazi me sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet dhe mekanizmat relevantë shtetërorë në raport me shëndetin mendor të fëmijëve deri moshën 18-vjeçare. Qëllimi i këtij hetimi është që të përgatitet një raport gjithëpërfshirës lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet dhe mekanizmat relevantë shtetërorë në raport me shëndetin mendor të fëmijëve deri moshën 18-vjeçare. Në këtë drejtim, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të gjendjes aktuale lidhur me çështjet e shëndetit mendor të fëmijëve deri moshën 18-vjeçare, shkaqet e problemeve, pasojat, ndikimin, shërbimet e ofruara për trajtimin e individëve të kësaj grup-moshe, si dhe masat në dispozicion ose që duhen ndërmarrë për të parandaluar zgjerimin e problemeve të shëndetit mendor të kësaj grup-moshe.

Po ashtu Avokati i Popullit ka hapur rast Ex officio²¹⁸ dhe është duke e trajtuar çështjen e zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës përkitazi me pensionet e dyfishta. Avokati i Popullit vëren se në Kosovë duhet të përmirësohen dhe të rriten kapacitetet për shërbimet rehabilituese fizike dhe psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara.

217 Rasti R.662/2024.

218 Rasti R.614/2024.

219 [R/1334/2024](#)

220 [R/995/2024](#), [R/683/2024](#)

221 R/ 823/2024

222 [R/721/2024](#), [R/527/2024](#)

223 [A/410/2024](#)

224 R.nr. 798/2024, [R/527/2024](#)

225 [A/1357/2024](#)

226 [R/1275/2024](#)

Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

Mjedisi dhe përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit jetësor, e përcaktuar si e drejtë dhe vlerë në të cilën bazohet rendi kushtetues, ia ka veshur Avokatit të Popullit mandatin për mbrojtjen, monitorimin dhe promovimin e kësaj të drejte. Neni 52 i Kushtetutës në mënyrë imperative ka përcaktuar që natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi për secilin dhe njëherësh ka angazhuar institucionet e pushtetit publik për t'ia garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

Nga analiza e rasteve dhe monitorimi i gjendjes së mjedisit dhe ndikimit në të drejtat e njeriut, mund të vlerësohet se edhe gjatë vitit raportues nuk janë marrë vendime që do të kishin ndikim të dukshëm në përmirësimin e problemeve mjedisore. Avokati i Popullit në vitin 2024 ka pranuar 15 ankesa, nga të cilat 4 të papranueshme. Rastet kanë të bëjnë me kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe kufizimin e të drejtave të tjera nga ndikimi i problemeve mjedisore. Rastet e pranuar kanë të bëjnë me ndotje të mjedisit, veprime në kundërshtim me Ligjin për Ujërat²¹⁹, probleme me infrastrukturën ujore²²⁰, ndërtime pa leje komunale mjedisore²²¹, ndotje nga mbeturinat²²², mjedis të pa sigurt²²³, mosveprim i autoriteteve në drejtim të problemeve mjedisore, probleme nga gurëthyesit²²⁴, zhurma²²⁵, konflikt të kompetencave mes nivelit komunal dhe qendror²²⁶, mospërfshirje të parimeve mjedisore në aktet nënligjore mjedisore etj.

Ndotja e ajrit vazhdon të jetë një ndër problemet me të mëdha mjedisore në vend

me ndikim serioz në shëndetin e qytetarëve, megjithatë ende nuk janë ndërmarrë masa dhe politika efektive për të përmirësuar gjendjen. Bazuar në raportet mujore për gjendjen e ajrit në vend,²²⁷ Avokati i Popullit vëren se s'ka asnjë përmirësim të kualitetit të ajrit, në veçanti në periudhat janar – mars dhe tetor – dhjetor. Janë regjistruar madje 10 ditë të tejkalimeve me PM10 dhe po ashtu ditë me tejkalime me PM2.5. Mbi bazën e të dhënave, kualiteti i ajrit në komunën e Prishtinës vazhdon të mbetet shqetësues. Nuk janë vërejtur veprime për zvogëlimin e përdorimit të linjitet për prodhimin e energjisë²²⁸, drurit për amvisëri²²⁹, masa stimuluese për transportin e qëndrueshëm, masa për zëvendësimin e veturave të vjetra me të reja²³⁰, si dhe masa efektive për zvogëlimin e ngarkesave në trafik.

Përkundër nevojave për t'u bashkëngjitur kërkesave globale për ndërmarrjen e masave preventive kundër ndryshimeve klimatike, vërehet se vazhdon shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore, dëmtimi i shtretërve të lumenjve, shkarkimet e ujërave të patrajtuara dhe ndotja e tyre me mbeturina. Mungojnë matjet e plota dhe nuk zbatohet monitorimi biologjik i ujërave për vlerësimin e cilësisë së ujërave në pellgjet lumore.

Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime përkitazi me ankesën që ka pranuar nga qytetarët e rrugës “Rexhep Krasniqi” të lagjes “Kalabria” në Prishtinë, lidhur me gjendjen e rëndë nga ndotja e shtratit të lumit/përroskës me ujëra të zeza, mbeturina, duke përfshirë ato inerte, lirim të kundërmimit dhe paraqitjes së vazhdueshme të brejtësve dhe insekteve. Avokati i Popullit, bazuar në gjendjen në terren, e në veçanti në Raportin e IShPK-së, sipas të cilit është vlerësuar se ekziston rrezik permanent për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje infektive dhe rrjedhimisht rrezik për shëndetin e qytetarëve në këtë zonë, ka vlerësuar se

gjendja e mjedisit e krijuar nga ndotja e lumit, duke e pamundësuar një jetë kualitative të banorëve, përbën rrezik për shëndetin e tyre. Avokati i Popullit ka konstatuar se niveli i lartë i ndotjes dhe mundësia e ndikimit të rëndë në të drejtat e njeriut dhe në shëndetin e banorëve kërkon veprime të urgjente nga autoritetet përgjegjëse për sanimin e gjendjes dhe pastrimin e lumit, deratizimin dhe dezinfektimin e hapësirave, në mënyrë që të parandalohet kufizimi i së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë dhe të familjes dhe të mundësisë serioze të cenimit të shëndetit të banorëve nga ndotja. Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore: t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me efekt të menjëhershëm për pastrimin e lumit dhe të hapësirave rreth tij, në lagjen në fjalë; të veprojë në pajtim me rekomandimet e IShPK-së, që urgjentisht të bëjë hulumtimin dhe eliminimin e derdhjeve të mundshme të ujërave të zeza dhe ndotësve të tjerë potencialë; inspektorët komunalë të mjedisit dhe ata sanitarë të marrin masa konkrete për zbulimin dhe zgjidhjen e këtij problemi; dhe deri në zgjidhjen përfundimtare, përroska që kalon në lagje, të mirëmbahet rregullisht nga strukturat relevante dhe nga vetë banorët (largimi i mbeturinave dhe i barishteve si dhe të ndalohet hedhja e mbeturinave në përroskë). Komuna e Prishtinës ka zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.²³¹

Sfidat me shkarkimet në mjedis për shkak të mungesës së shtrirjes së infrastrukturës ujore dhe ndikimi në cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe privatësisë janë reflektuar në Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, i cili është iniciuar në bazë të ankesës së një banori të fshatit Dujakë, të komunës e Gjakovës.²³² Raporti ka për qëllim t'i vlerësojë detyrimet e autoriteteve përgjegjëse përkitazi me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe

227 <https://www.ammk-rks.net/al/mjedisi/20/raportet-mujore>

228 Strategjia e Energjisë e Republikës-se-Kosoves-2022-2031

229 Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, rreth 57% e familjeve përdorin drurin si burim ngrohjeje.

230 Informatë e pranuar nga Qendra e Regjistrimit të Veturave.

231 R. nr. 683/2024

232 A. nr. 458/2022

të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, të së drejtës së jetës dhe të të drejtave të fëmijëve në një lagje të fshatit Dujakë të komunës së Gjakovës. Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave ka konstatuar se mosarritja e përmbushjes së përgjegjësisë nga Komuna e Gjakovës, si autoritet kompetent për infrastrukturë ujore dhe mjedis, nëpërmjet masave efektive në raport me nevojat e banorëve të fshatit Dujakë ka ndikuar në kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, me mundësi të cenimit të së drejtës për jetën, si dhe në cenimin e së drejtës së fëmijëve. Komuna e Gjakovës, rekomandimet e Avokatit i Popullit që pa vonesa të ndërmarrë masa për rregullimin e infrastrukturës ujore dhe të kanalizimeve në fshatin Dujakë, sipas rekomandimeve të raportit të IKShPK-së si dhe të ndërmarrë masa për ta mbuluar pjesën e hapur të kanalit, i cili paraqet rrezik për jetën dhe sigurinë e fëmijëve dhe të banorëve të tjerë, i ka zbatuar në tërësi.

Ende nuk ka veprime në përputhje me strategjinë minerare që do të tregonin hapa drejt mbajtjes nën kontroll të gurëthyesve dhe gurishtave. Operatorët në funksion vazhdojnë të mos u përmbahen rregullave për mbrojtjen e mjedisit. Avokati i Popullit ka iniciuar sipas detyrës zyrtare rastin që ka të bëjë me ndotjen e mjedisit dhe dëmtimit të infrastrukturës rrugore nga gurëthyesit lokalë të fshatit Stanishor të komunës së Novobërdës dhe vendeve të tjera përreth.²³³ Mosrehabilitimi i hapësirave ku ka përfunduar operimi i gurëthyesve, obligim ligjor, mbetet shqetësues. Avokati i Popullit ka hetuar rastin lidhur me mosrehabilitimin e hapësirave ku ka operuar një kompani gurëthyesi në fshatin Kmetoc të komunës së Gjilanit. Nga hapësirat jo vetëm që lirohet pluhur, por ka gropa të cilat jo vetëm që përbënin rrezik permanent për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, por ishin shndërruar në vende ku grumbulloheshin mbeturinat e të gjithave llojeve. Pas reagimit të IAP-së, problemet ishin mënjanuar.

233 R.nr.527/2024

Avokati i Popullit e vlerëson shqetësuese gjendjen e deponive. Të gjitha deponitë i kanë tejkaluar kapacitetet e tolerueshmes nga tejgrumbullimi dhe paraqesin kërcënim serioz për të drejtën për mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt të qytetarëve. Sistemet e funksionimit të pompimit të ujërave të deponisë nuk funksionojnë, po ashtu ka probleme me kompresimin dhe mbulimin e mbeturinave. Vazhdon mosndarja e mbeturinave në burim si dhe riciklim të mbeturinave. Një ndër rastet në hetim është edhe cenimi i së drejtës për mjedis të shëndetshëm dhe të privatësisë së qytetarëve nga deponia e Landovicës, nga grumbullimi i mbeturinave jashtë të gjitha standardeve dhe ndikimi në ajër, ujë dhe tokë. Sipas informatës që kemi pranuar nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, se është duke u implementuar një program i mbështetur nga fonde të huaja, i cili do ta transformojë tërësisht gjendjen e deponisë në Landovicë dhe pritet të përfundojnë në qershor të vitit 2026.

Për sa i përket respektimit të tri parimeve mjedisore: qasjes në informata, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, dhe qasjes në drejtësi, nuk është vërejtur ndonjë përmirësim. Në këtë drejtim Avokati i Popullit publikoi Opinionin, i cili është bazuar në ankesën e parashtruar nga një grup i qytetarëve nga fshatrat Dollc, Gremnik dhe Dresnik të komunës së Klinës, i cili është përcjellë me petitionin e nënshkruar nga 3901 qytetarë, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e fabrikës së çimentos në fshatin Dollc të Klinës, me pretendimin se ndikon negativisht në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Avokati i Popullit me qëllim që të sjellë në vëmendjen e autoriteteve kompetente, në këtë rast Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Klinës, për rëndësinë e respektimit të plotë të të drejtave të qytetarëve duke vënë në fokus balancimin e drejtë mes interesave të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e ekonomik të vendit në fushën e industrisë minerale, ka konstatuar se qytetarëve nuk u është ofruar një qasje e përshtatshme në informacion për qëllimin dhe kohën e debatit publik dhe, për pasojë,

jo të gjithë qytetarëve të interesuar u është krijuar mundësia të merrnin pjesë në debatin publik. Avokati i Popullit përmes Opinioni vlerësoi se organet shtetërore duhet ta kenë parasysh ruajtjen e vlerave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ruajtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj, ruajtjen e burimeve ujore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e florës dhe faunës, në mënyrë që të gjitha vendimet për proceset e zhvillimit ekonomik, të cilat mund t'i prekin këto dukuri natyrore, të jenë të qasshme për qytetarët e interesuar, të merren me shumë seriozitet, analizim dhe vlerësim të detajuar paraprak, në atë mënyrë që ndikimi negativ në pengimin e gëzimit të të drejtave të njeriut të jetë sa më i vogël i mundshëm, dhe në atë mënyrë që qytetarët të mos ndihen të rrezikuar për gëzimin e jetës dhe të shtëpisë së tyre në të ardhmen nga zhvillimet e industrisë minerale, nën hijen e territ informativ.²³⁴

Mosrespektimi i kushteve të ndërtimit²³⁵, si: përqindja e sipërfaqes së lejuar për ndërtim brenda parcelës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrorë dhe ruajtja e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike; masave për ekuilibër dhe stabilitet; mungesa e hapësirave të emergjencës; vendparkimet; hapësirat e sanitarisë; menaxhimi i mbeturinave ndërtimore; ndriçimi natyror dhe adekuat; ndotja mjedisore; ventilimi dhe zhurma, hapësirat e sanitarisë; kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike; kufizime për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore; masave për eficiencë dhe kursim të energjisë, sipas Avokatit të Popullit, përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të qytetarëve të vendit.

Në veçanti, sipas Avokatit të Popullit, mosrespektimi i kritereve të sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve të tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe krijimi i kushteve për zjarrfikës dhe i përgjegjësve të tjerë në raste të emergjencave, janë çështje që kërkojnë trajtim urgjent dhe vëmendje serioze nga shteti.

234 <https://oik-rks.org/2025/01/27/opinion-i-avokatit-te-popullit-a-nr-173-2021-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-per-respektimin-dhe-permbushjen-e-te-drejtave-te-njeriut-perkitazi-me-rastin-e-ndertimit-te-fabrikese-se-ciment/>

235 Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Sfidat për kapacitete të pamjaftueshme inspektuese, lëndë mjedisore në prokurori dhe gjykata nuk kanë shënuar ndonjë përmirësim. Edhe pse tashmë është i pakontestueshëm ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin publik, mungesa e funksionalizimit të SISH-it pamundëson nxjerrjen e statistikave të qarta lidhur me ndikim e ndotjes në shëndetin e qytetarëve. Po ashtu, ende vazhdon të mos ketë një hulumtim nga IShPK-ja lidhur me ndikimin e ajrit të ndotur në shëndetin publik.

Me qëllim të promovimit të së drejtës mjedisore, më 5 qershor 2024 Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare, që për fokus ka promovimin e mjedisit të shëndetshëm dhe të pastër, EcoZ dhe Save the Children Kosova/o, shënuan Ditën Botërore të Mjedisit. Qëllimi i këtij aktiviteti është diskutimi dhe edukimi mbi të drejtën mjedisore dhe mandatin e IAP-së, me fëmijë të grup-moshës 7-15 vjeçare, të grumbulluar në Asamblenë Mjedisore të Fëmijëve. Fëmijët me këtë rast kontribuan në aktivitetin, qëllimi i të cilit është promovimi përmes artit i së drejtës për mjedis të shëndetshëm jetësor, si e drejtë e njeriut. Fëmijët kishin mundësinë që nëpërmjet kreativitetit të tyre, pikturimit e vizatimit, të paraqisnin mjedisin jetësor të shëndetshëm dhe të drejtat e njeriut.

Përfaqësuesja e IAP-ja mori pjesë në panelin e diskutimit të ngjarjes së organizuar nga UNDP-ja me rastin e lansimit të Raportit të përbashkët mes UNDP-së në Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, lidhur me studimin e përbashkët mbi mundësitë dhe sfidat për përfshirjen gjinore në drejtësinë mjedisore. Me këtë rast u paraqitën qëndrimet e institucionit lidhur me këtë temë. Ndërsa qëndrimet e IAP-së lidhur me ndikimin e problemeve mjedisore në të drejtat e fëmijëve u dhanë në Konferencën e organizuar nga Eco Z: “Qëndrueshmëria mjedisore me fëmijët”.

Qëndrimet e Avokatit të Popullit në raport

me problemet mjedisore dhe ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre në të drejtat e njeriut dhe barazi në raport me të drejtat e njeriut, u paraqitën në Konferencën Regjionale lidhur me Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut, organizuar nga Ombudsmani i Maqedonisë së Veriut, GANHRI, ENNHRI, UNDP, dhe Seminar “Ndryshimet Klimatike dhe fokusi në ndikimin e saj në barazi “Mjete për organet e barazisë”.



Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), me mandat për të monitoruar të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si: stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, emigracionin, qendrat e kujdesit social, si dhe çdo vend tjetër, kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Vizitat e realizuara gjatë vitit 2024

Nr	Institucionet e monitoruara	Lloji i vizitës	Data e vizitës	
1	Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" - Prishtinë	Vizitë e përgjithshme dhe monitoruese	04.01.2024	1
		Vizitë përcjellëse	24.04.2024	2
		Vizitë monitoruese e kthimit me forcë	15.08.2024	3
			18.12.2024	4
2	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	24.01.2024	5
			27.02.2024	6
			05.03.2024	7
			17.05.2024	8
			07.06.2024	9
			20.08.2024	10
3	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	24.10.2024	11
			Vizitë e përgjithshme	22.05.2024
4	Qendra e Paraburgimit në Pejë	Vizitë e përgjithshme	02.10.2024	13
5	Burgu i Sigurisë së Lartë	Vizitë ad-hoc	04.11.2024	14
			08.02.2024	15
			05.12.2024	16
6	Qendra Korrektuese në Dubravë	Vizitë e përgjithshme	30.05.2024	17
			23-25.04.2024	18
			Vizitë përcjellëse	22.07.2024
		Vizitë ad-hoc	02.12.2024	20

7	Qendra Korrektuese për të Mitur - Lipjan	Vizitë përcjellëse	22.08.2024	21
8	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan	Vizitë përcjellëse	07.03.2024	22
9	Qendra Korrektuese për të Mitur dhe Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan	Vizitë e përgjithshme	15.05.2024	23
10	Qendra Korrektuese për të Mitur - Lipjan	Vizitë përcjellëse	22.08.2024	24
11	Stacioni Policor në Podujevë	Vizitë e përgjithshme	12.04.2024	25
12	Stacioni Policor në Istog	Vizitë e përgjithshme	25.04.2024	26
13	Stacioni Policor në Shtërpçë	Vizitë e përgjithshme	01.02.2024	27
14	Stacioni Policor në Drenas	Vizitë e përgjithshme	21.05.2024	28
15	Stacioni Policor në Skenderaj	Vizitë e përgjithshme	21.05.2024	29
16	Stacioni Policor në Mitrovicën Veriore	Vizitë e përgjithshme	21.05.2024	30
17	Stacioni Policor në Mitrovicën e Jugut	Vizitë e përgjithshme	21.05.2024	31
		Vizitë ad-hoc	11.09.2024	32
18	Stacioni Policor në Vushtrri	Vizitë ad-hoc	11.09.2024	33
19	Stacioni Policor në Graçanicë	Vizitë e përgjithshme	04.10.2024	34
20	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Leposaviq	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	23.07.2024	35
21	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Kllokot	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	24.07.2024	36
22	Pika e Kalimit Kufitar - Kulla	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	27.02.2024	37
23	Pika e Kalimit Kufitar - Merdare	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	20.03.2024	38
24	Pika e Kalimit Kufitar Kullë-Radac	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	17.04.2024	39
25	Pika e Kalimit Kufitar - Stanqiq - Bellanoc (RKS - Maqedoni e Veriut), Zhegër	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	25.07.2024	40
26	Pika e Kalimit Kufitar - Vërmicë	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	20.09.2024	41
27	Pika e Kalimit Kufitar -Dheu i Bardhë	Vizitë e përgjithshme, e përbashkët me CRPK-në	02.10.2024	42
28	Qendra e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll	Vizitë përcjellëse	16.02.2024	43
			21.08.2024	44
		Vizitë ad-hoc	24.12.2024	45

29	Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë - Vranidoll	Vizitë e përgjithshme	07.06.2024	46
30	Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	Vizitë ad-hoc	14.03.2024	47
		Vizitë përcjellëse	13.09.2024	48
31	Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	28.05.2024	49
		Vizitë ad-hoc	15.10.2024	50
32	Qendra e Shëndetit Mendor në Prishtinë	Vizitë e përgjithshme	06.11.2024	51
33	Qendra Integruese Rehabilituese e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime	Vizitë e përgjithshme	29.10.2024	52
34	Instituti Special i Shtimes	Vizitë e përgjithshme	29.10.2024	53
35	Shtëpia me Bazë në Komunitet në Shtime	Vizitë e përgjithshme	29.10.2024	54
36	Qendra e Shëndetit Mendor Gjilan	Vizitë ad-hoc	02.10.2024	55
37	Qendra e Ndalimit në Gjilan	Vizitë ad-hoc	02.10.2024	56
38	Shtëpia me Bazë në Komunitet - Ferizaj	Vizitë përcjellëse	18.04.2024	57
39	Shtëpia me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar Mendore në Prizren	Vizitë përcjellëse	13.09.2024	58
40	Shtëpia e Komunitetit për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc	Vizitë e përgjithshme	11.11.2024	59
41	Qendra e Azilit Magure	Vizitë e përgjithshme	19.03.2024	60
42	Klinika Psikiatrike	Vizitë ad-hoc	25.04.2024	61
43	Klinika Psikiatrike+UKIP	Vizitë ad-hoc	13.05.2024	62
44	Klinika Psikiatrike, UKIP, Klinika Psikiatrike për Fëmijë dhe Adoleshentë	Vizitë e përgjithshme	22.10.2024	63
45	Instituti i Psikiatrisë Forenzike	Vizitë e përgjithshme	25.10.2024	64
46	Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj	Vizitë e përgjithshme	11.11.2024	65
47	Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Novobërdë	Vizitë e përgjithshme	15.11.2024	66

48	Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Graçanicë	Vizitë e përgjithshme	15.11.2024	67
49	Qendra e Shëndetit Mendor Pejë	Vizitë e përgjithshme	04.11.2024	68
50	Shtëpia Integruese në Bashkësi - Fushë Kosovë	Vizitë e përgjithshme	06.11.2024	69
51	Shtëpia Integruese në Bashkësi - Pejë	Vizitë e përgjithshme	04.11.2024	70
52	Shtëpitë Integruese në Bashkësi - Mitrovicë	Vizitë përcjellëse	18.10.2024	71

Gjatë vitit që po raportohet, janë publikuar gjashtë (6) raporte me rekomandime dhe janë dhënë 35 rekomandime, prej tyre nëntë (9) rekomandime janë implementuar, pesë (5) janë implementuar pjesërisht, 21 në pritje për implementim. Ndërsa gjatë vizitave në vendet e privimit të lirisë janë realizuar mbi 330 intervista, si dhe janë pranuar mbi 303 thirrje telefonike, qoftë në numrin falas, i cili është i vendosur në kutitë e ankesave, në numrin fiks të IAP-së, apo edhe në numrat zyrtarë të ekipit të MKP-së.

Monitorimi i Qendrave të Mbajtjes dhe i Stacioneve Policore

Bazuar në mandatin e saj, MKP-ja gjatë vitit 2024 ka vizituar stacionet policore, si në vijim:

- Stacionin Policor në Shtërpçë,
- Stacionin Policor “Qendra” në Prishtinë,
- Stacionin Policor në Podujevë,
- Stacionin Policor në Istog,
- Stacionin Policor në Drenas,
- Stacionin Policor në Skenderaj,
- Stacionin Policor në Mitrovicë – Jug,
- Stacionin Policor në Mitrovicë – Veri,
- Stacionin Policor në Malishevë,
- Stacionin Policor në Rahovec,
- Stacionin Policor në Gjakovë,
- Stacionin Policor në Gjilan dhe
- Stacionin Policor në Graçanicë.

Avokati i Popullit, më 3 dhjetor 2024, ka publikuar Raportin me Rekomandime²³⁶ lidhur me stacionet policore të lartcekura. Sipas raportit, Avokati i Popullit i ka paraqitur të gjeturat nga monitorimi dhe ka vlerësuar se a janë respektuar tri të drejtat themelore të personave të arrestuar: E drejta për ta njoftuar anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për faktin e arrestimit; E drejta për avokat mbrojtës; E drejta për shërbime mjekësore si dhe kushtet e akomodimit në qendrat e ndalimit policor.

Në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtje të të arrestuarve, Avokati i Popullit ka vendosur kuti të ankesave, të cilat hapen vetëm nga personeli i caktuar i Avokatit të Popullit, mirëpo nuk është pranuar asnjë ankesë. Për më tepër, ka pasur disa pohime nga të ndaluarit se ndaj tyre zyrtarët policorë kanë pasur trajtim profesional dhe shumë korrekt në qendrat e ndalimit.

Avokati i Popullit ka pranuar 78 ankesa kundër Policisë së Kosovës, nga të cilat 19 ankesa janë shpallur të pranueshme për hetim, ndërsa gjashtë (6) raste kanë filluar të hetohen sipas detyrës zyrtare.²³⁷

Lidhur me ankesat e qytetarëve kundër Policisë së Kosovës, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë ndërmarrë veprimet adekuate duke kontaktuar Policinë e Kosovës, si dhe duke i përcjellë tek Inspektorati Policor i Kosovës, me të cilin ka komunikuar deri në përfundimin e hetimeve.

Avokati i Popullit, nga të gjeturat gjatë vizitave në stacionet e lartcekura, konstaton

²³⁶ <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2024/12/KPD-1178-2024-Raport-i-Avokatit-te-Popullit-MKP.pdf>

²³⁷ R.nr.1333/2024, R.nr.1430/2024, R.nr.299/2024, R.nr.563/2024, R.nr.661/2024, R.nr.1206/2024

se të gjitha qendrat e ndalimit, saktësisht në dhomat (qelitë) e ndalimit, nuk është i instaluar sistemi i thirrjes (zilja), në mungesë të të cilit ekziston një rrezik i konsiderueshëm se policia nuk mund të ndërhyjë në kohën e duhur në rast incidentesh të ndryshme.

Në disa qendra të ndalimit mungonin broshura me informata për të drejtat e njeriut. Pavarësisht se personat e ndaluar njoftohen për drejtat e tyre gjatë intervistimit, përmes formularit të nënshkruar, Avokati i Popullit konsideron se vendosja e broshurave dhe e kartave në dhoma do t'i mundësonte personit të ndaluar të njoftohet më saktë për të drejtat e tij.

Avokati i Popullit, për sa u përket kushteve materiale të qendrave të ndalimit, konstaton se qendrat e ndalimit në stacionet policore në: Prishtinë, Drenas, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Gjakovë dhe Malishevë, duhet t'i mënjanojnë të gjitha defektet, e po ashtu të rinovohen dhe të funksionalizohen për pranimin dhe mbajtjen e personave të ndaluar, sipas standardeve minimale të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.²³⁸ Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se zyrat e marrjes në pyetje në Stacionin Policor në Podujevë duhet të rregullohen dhe të rinovohen sipas këtyre standardeve.

Në të gjitha stacionet policore ka pasur mungesë të mjeteve higjienike.

Ushqimi për të ndaluarit është jocalësor, i thatë dhe i pamjaftueshëm për nga sasia në të gjitha qendrat e ndalimit që i kemi vizituar.

Avokati i Popullit vëren se në stacionet policore në Shtërpçë, në Gjilan dhe në Graçanicë, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale, andaj ka rekomanduar sa më shpejt të jetë e mundur të funksionalizohen kamerat e sigurisë në këto qendra të ndalimit, të cilat edhe janë garanci shtesë për zyrtarët policorë. Këta të fundit, problemin më të madh e kanë me personat që janë përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor, pasi janë vështirë të menaxhueshëm dhe duhet të vëzhgohen pandërprerë. Këta persona paraqesin rrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për t'i

trajtuar këto kategori të të ndaluarve.

Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha stacionet policore ka pranuar shqetësime dhe ka vërejtur se kushtet e punës për zyrtarët policorë, në shumicën e stacioneve të lartcekura, janë të pafavorshme për punë, pasi ka mungesë të inventarit, të printerëve, të mjeteve higjienike dhe të veturave.

Pikat e kalimit kufitar

MKP-ja në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit, UNHCR-së dhe Organizatës Joqeveritare – Programit për të Drejtat Civile në Kosovë CRP/K, gjatë vitit 2024 ka realizuar vizita të përbashkëta në pikat e kalimit kufitar, si:

- Pikëkalimi kufitar Kullë,
- Pikëkalimi kufitar Merdare,
- Pikëkalimin kufitar Jarine,
- Pikëkalimi kufitar Stanqiq-Bellanoc,
- Pikëkalimi kufitar Vërmicë,
- Pikëkalimin kufitar Dheu i Bardhë,
- Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit (SPMK) në Radac,
- Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Kllokot.

Avokati i Popullit, nga të gjeturat nga vizitat në pikat e kalimit kufitar konstaton se Pikëkalimet kufitare në Jarinë, Kullë dhe Dheu i Bardhë janë të vendosura në kontejnerë shumë të vjetër, të cilët mund të paraqesin rrezik për shëndetin e zyrtarëve policorë dhe nuk përmbushin kushtet minimale për kryerjen e detyrave të punës. Në shumicën e pikëkalimeve kufitare të lartcekura ekziston mungesë dhe defekte të vazhdueshme në sistemin e fotokopjeve, që çon në vonesën e procedimit të raporteve dhe të rasteve, si dhe vështirëson punën e zyrtarëve policorë.

Në Pikëkalimin kufitar në Merdare nuk është e angazhuar asnjë zyrtarë policore, që në rast të kontrollit të ndonjë qytetareje, obligon transportin e një zyrtareje policore nga Stacioni Policor i Podujevës. Moshë

238 <https://rm.coe.int/16806cd1d5>

mesatare e zyrtarëve policorë është e shtyrë, si dhe në shumicën e pikave kufitare nuk ka pasur furnizim të mjaftueshëm me uniforma të reja për zyrtarët policorë.

Në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër në Kllokot, dhomat e ndalimit janë jofunksionale, që paraqet shkelje të procedurave të duhura dhe një sfidë për zyrtarët policorë. Ky Stacion disponon vetëm dy automjete shumë të vjetra, të cilat janë të pamjaftueshme për nevojat operative. Kjo situatë e dëmton efikasitetin e operacioneve të policisë kufitare dhe rrit rrezikun për vonesa në proceset e kontrollit, por edhe rrezikon jetën e zyrtarëve policorë.

Avokati i Popullit, në pikat e kalimit kufitar në Vermicë dhe në Dheun e Bardhë ka pranuar shqetësime nga zyrtarët policorë në lidhje me problemet e transportit për vajtje-ardhje. Këto vështirësi në transport ndikojnë negativisht në disponueshmërinë e zyrtarëve për të kryer detyrat e punës, duke krijuar vonesa dhe pengesa në operacionet e përditshme.

Ndërsa në Qendrën e Mbajtjes, në Pikëkalimin kufitar në Vermicë, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Lidhur me të gjeturat, Avokati i Popullit do të publikojë raport me rekomandime gjatë vitit 2025.

Qendrat Korrektuese dhe të Paraburgimit

MKP-ja e Avokatit të Popullit ka vazhduar të bëjë pa paralajmërim monitorimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria, si në qendrat korrektuese edhe në ato të paraburgimit.

MKP-ja ka realizuar vizita të përgjithshme, përcjellëse dhe ad-hoc, në këto qendra korrektuese dhe të paraburgimit:

- Qendra e Paraburgimit në Prishtinë - 7 herë,
- Qendra e Paraburgimit në Gjilan - 2 herë,
- Qendra e Paraburgimit në Pejë - 1 herë,

- Burgu i Sigurisë së Lartë - 3 herë,
- Qendra Korrektuese në Dubravë - 3 herë,
- Qendra Korrektuese për Femra - 1 herë,
- Qendra Korrektuese për të Mitur - 2 herë,
- Qendra Korrektuese dhe Edukuese për të Mitur - 1 herë,
- Qendra Korrektuese Smrekonice - 1 herë.

Vizitat e realizuara pa paralajmërim në këto qendra korrektuese dhe të paraburgimit kishin për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e respektimit të të drejtave të njeriut, të integritetit fizik dhe mental të personave të privuar nga liria. Intervistimi i personave të privuar nga liria bëhet gjithmonë pa prezencën e zyrtarëve korrektues, ndërsa hapja e kutive të ankesave në këto qendra është bërë çdo muaj.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka pranuar 47 ankesa, prej të cilave 21 janë hapur raste dhe janë zhvilluar hetime të mëtejme.²³⁹ Natyra e ankesave ka pasur të bënte kryesisht kundër vendimeve të gjykatave, kundër vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht (PLK), përdorimit të forcës nga ana e zyrtarëve korrektues, humbjes së beneficioneve, transferimeve nga një qendër në tjetrën, vikendeve e vizitave humanitare etj.

Avokati i Popullit ka pranuar nga qytetarët kërkesa për ndihmë, në disa raste kur familjarët e tyre janë arrestuar nga autoritetet serbe dhe janë mbajtur në burg në Serbi. Për shkak të mosbashkëpunimit të autoriteteve serbe, Avokati i Popullit i është drejtuar Zyrës Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Serbi, e cila, pas vizitave që ka realizuar në burgje, e ka informuar Avokatin e Popullit për gjendjen e personave të arrestuar.

PLK-ja gjatë vitit 2024 ka pasur në punë 797 dosje, përkatësisht kërkesa për lirim me kusht, ku nga ky numër 57 prej tyre kanë qenë të bartura nga viti 2023, përkatësisht 56 kanë qenë kërkesa të pashqyrtuara, ndërsa 1 kërkesë ka qenë e shqyrtuar, mirëpo për arsye procedurale nuk

²³⁹ R.nr.1319/2024, R.nr.459/2024, R.nr.455/2024, R.nr.938/2024, R.nr.10/2024, R.nr.1340/2024, R.nr.631/2024, R.nr.616/2024, R.nr.1418/2024, R.nr.638/2024, R.nr.192/2024, R.nr.251/2024, R.nr.945/2024, R.nr.584/2024, R.nr.1319/2024, R.nr.1298/2024, R.nr.1071/2024, R.nr.1940/2024, R.nr.968/2024, R.nr.835/2024, R.nr.327/2024

është vendosur në vitin 2023 dhe është bartur në vitin 2024. Ndërsa gjatë vitit 2024, PLK-ja ka pranuar 740 kërkesa të reja, përkatësisht dosje për lirim me kusht. Dosjet e të dënuarve janë pranuar nga 10 institucionet korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës, nga të cilat janë 361 të aprovuar, 380 të refuzuara, 34 është pushuar procedura, 6 janë hedhur dhe 16 të bartura.

Shërbimi Sprovues i Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor vitit 2024 ka pasur në mbikëqyrje 794 persona të liruar me kusht nga burgju. Gjatë kësaj periudhe, nga burgju janë liruar 372 persona, kurse 377 rastet e tjera janë bartur nga vitet paraprake. Gjatë periudhës raportuese, mbikëqyrjen e kanë përfunduar 356 persona të liruar me kusht, kurse 393 të tjerë janë ende në mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues. Prej numrit të përgjithshëm të rasteve të reja, 369 raste janë të moshës madhore, kurse të mitur janë vetëm 3 raste. Gjithashtu, prej numrit të përgjithshëm të rasteve që kanë ardhur në këtë periudhë, 365 raste janë meshkuj, kurs femra të liruar me kusht nga burgju janë vetëm 7 raste.

Avokati i Popullit pas vizitave të realizuara në qendrat e lartpërmendura, konstaton se trajtimi i të burgosurve ka qenë i mirë dhe nuk ka keqtrajtim apo torturë, pavarësisht se ka pranuar disa pohime për përdorim të forcës në disa raste, të cilat pastaj edhe janë hetuar nga ekipi i MKP-së se a janë proceduar rastet me rregull, duke shikuar dosjet mjekësore dhe raportet e komisioneve të hetimit dhe deri në marrjen e vendimit lidhur me pohimet dhe nuk ka gjetur shkelje.

Kushtet e banimit janë të kënaqshme, në shumicën e institucioneve korrektues. Por kushtet ndryshojnë nga qendra në qendër edhe për shkak të infrastrukturës, por edhe vjetërsisë së objekteve, si: Qendra e Paraburgimit në Pejë, në Prizren, në Mitrovicë, Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, Shtëpia e Nënës dhe Foshnjës në Lipjan, si dhe disa pavijone në Qendrën Korrektuese në Dubravë, të cilat kanë nevojë të vazhdueshme për rinovime. Për disa qendra edhe janë ndarë mjetet dhe ka filluar planifikimi për ndërtimin e qendrave të reja,

si: Lipjan, Prizren dhe Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.

Avokati i Popullit konstaton se shërbimet shëndetësore në burgje u ofrohen personave të privuar nga liria, bazuar në Procedurat Standarde të Operimit të Drejtorisë Shëndetësore në Burgje, legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare. Ndërsa, për sa i përket konfidencialitetit të ofrimit të shërbimeve mjekësore, Avokati i Popullit konstaton se në Qendrat e Paraburgimit në Pejë, në Mitrovicë dhe në Prizren nuk ka konfidencialitet të mjaftueshëm mjekësor, për shkak të kushteve dhe hapësirës së punës.

Edhe pse shërbimet sociale ofrohen, ato nuk mund të jenë efektive për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve socialë dhe për shkak se ata nuk janë të vendosur nëpër pavijone.

Avokati i Popullit konstaton se Shërbimi Korrektues, me qëllim të risocializimit dhe rehabilitimit të të dënuarve, ofron trajnime profesionale, si: saldim, ndërtimtari, axhustator, zdrukthëtari, mirëmbajtje teknike për instalim të ujit dhe instalim të rrymës, rrobaqepësi dhe trajnimin për prodhimin e bizhuterive të filigranit etj. Në kuadër të risocializimit dhe rehabilitimit, ofrohet edhe shkollimi i mesëm dhe universitar për të dënuarit, mirëpo, Avokati i Popullit inkurajon Shërbimin Korrektues që të ndërmarrë veprime adekuate për t'i motivuar të burgosurit të marrin pjesë në këto aktivitete.

Avokati i Popullit e vlerëson hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ MD - 14/2023 për Funksonimin e Njësisë Ekonomike.²⁴⁰ Kjo Njësi Ekonomike zhvillon aktivitete ekonomike, prodhuese, ofron shërbime, punëson të burgosurit bazuar në planin individual të dënimit, me qëllim të risocializimit dhe riintegritimit, krijon të hyra për nevojat e të burgosurve dhe të ShKK-së. Andaj duhen bërë përpjekje që kjo Njësi të funksionalizohet plotësisht.

Për sa i përket kontaktit me botën e jashtme, Avokati i Popullit konstaton se kjo e drejtë respektohet plotësisht nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

240 https://shkk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/UA-GZ-MD-NR-14_2023-NJEK-03.01.24.pdf

Institucionet e Shëndetit Mendor dhe ato të Kujdesit Social

MKP-ja ka vizituar të gjitha repartet në:

- Klinikën Psikiatrike (Reparti i Sëmundjeve të Varësisë, Urgjenca dhe Kujdesi Intensiv Psikiatrik dhe Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshentë),
- Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK),
- Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë, në Shtime
- Qendrën e Shëndetit Mendor në Prishtinë
- Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan,
- Qendrën e Shëndetit Mendor në Pejë,
- Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Bresje,
- Dy Shtëpitë Integruese në Bashkësi në Mitrovicë,
- Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Pejë,

Gjithashtu MKP-ja ka vizituar edhe institucionet e kujdesit social:

- Institutin Special në Shtime (ISSh),
- Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK) në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren.

Trajtimi për personat me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor, ofrohet gjatë 24 orëve në Institutin Special në Shtime dhe në 9 Shtëpi me Bazë në Komunitet.

Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë është njësi organizative e ShSKUK-së, e cila ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë) dhe, në mungesë të një spitali të përgjithshëm regjional, është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës.

Reparti i Sëmundjeve të Varësisë (RSV) - ku trajtohen të gjitha rastet e varësisë nga alkooli, barnat e përshkruara, substancave narkotike (kokaina, heroin etj.); reparti i mbyllur i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv

Psikiatrik (në tekstin e mëtejshëm: UKIP) - ku trajtohen rastet në mënyrë të pavullnetshme; Psikiatria për Fëmijë dhe Adoleshentë - që funksionon si pjesë e Klinikës Psikiatrike, me objekt ndaras, e cila ka 7 shtretër për hospitalizim të fëmijëve si dhe ofrohen shërbime ambulatorë ditore për moshat nën 18-vjeçare. RSV-ja, gjatë kohës së vizitës më 22 tetor ishte duke u rinovuar.

Të gjitha repartet (përveç repartit të Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik - UKIP) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe në raste të caktuara edhe pa vullnetin e tyre, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente. Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime për vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – Urgjenca dhe Kujdesi Intensiv Psikiatrik, më 3 tetor 2023.²⁴¹ Përmes këtij Raporti janë përcjellë 6 rekomandime dhe gjatë vitit 2024 MKP-ja ka bërë vizitë të përgjithshme në Klinikën Psikiatrike për të parë se a janë implementuar rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe është njoftuar se 4 rekomandime janë implementuar dhe 2 janë në pritje.

Në Klinikën Psikiatrike për Fëmijë dhe Adoleshentë, bazuar në të gjeturat nga vizita në institucion, MKP-ja konstaton se mungojnë hapësirat adekuate për pacientët e hospitalizuar, meqenëse hapësira për shërbime ambulatorë dhe ato të hospitalizimit nuk janë krejtësisht të ndara. Mungon rregullorja për kriteret e pranimit për hospitalizim të fëmijëve, mungon rregullorja në lidhje me procedurën e vlerësimit të parë, përcjelljes dhe lirimit të pacientëve nga spitali, nuk është e rregulluar çështja e marrjes së pëlqimit nga prindërit për trajtim të fëmijëve, p.sh. në praktikë është vërejtur se në rast të hospitalizimit, klinika e ka një formular ku merret pëlqimi nga prindi i cili do të qëndrojë me fëmijën në spital, si dhe në rastet kur fëmija merr trajtim/këshillim në klinikë, merret vetëm pëlqimi gojor nga prindi i cili e ka sjellë për trajtim, jodomosdoshmërisht pëlqimi nga të dy prindërit. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit do të publikojë Raport me rekomandime për autoritetet përgjegjëse.

241 <https://oik-rks.org/2023/10/04/raport-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-te-qendres-klinike-universitare-te-kosoves-urgjenca-dhe-kujdesi-intensiv-psikiatrik/>

Në Repartin e mbyllur të *Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik* (UKIP) janë gëlqerosur korridoret, dhomat, janë funksionalizuar banjat për femra, si dhe janë vendosur kamerat në korridore. Gjithashtu janë ndarë mjetet nga Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Shëndetësisë për rinovim dhe zgjerim të kapaciteteve. Gjatë vizitës, ekipi ka vërejtur se dosjet e pacientëve përmbanin vlerësimin e tre mjekëve neutralë (jo nga mjekët e Repartit UKIP) për vazhdimin e trajtimit të pavullnetshëm, anamnezën, historinë e sëmundjes, formularin për vendosjen në dhoma të izolimit, kërkesën për praninë në spital, por nuk ka pëlqim për trajtim dhe nuk ka miratim të informuar. Avokati i Popullit në Raportin me rekomandime për Klinikën e Psikiatrisë²⁴², për masën e izolimit ka rekomanduar që të krijohet protokoll specifik për përdorimin e mjeteve të kufizimit për institucionet psikiatrike, siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili rekomandim ende nuk është implementuar.

MKP-ja pas vizitës në *Institutin e Psikiatrisë Forenzike* (IPFK), vlereson se janë kryer disa renovime të domosdoshme dhe i është ndarë buxheti për zgjerimin e hapësirave. IPFK-ja vazhdon të ballafaqohet me moszgjidhjen e statusit të saj ligjor, për çka Avokati i Popullit, në raportin e fundit me rekomandime²⁴³ e ka ripërsëritur rekomandimin për MD-në dhe MSh-në. IPFK-ja ka 36 shtretër, prej të cilëve 12 janë të ndarë për Shërbimin Korrektues, por mungojnë hapësirat për femra dhe të mitur. Konstatohet se nuk ka shtretër të mjaftueshëm, bazuar në kërkesat e shumta si dhe për shkak të infrastrukturës joadekuate, nuk ka konfidencialitet gjatë vizitave familjare.

Vlen të theksohet si pozitive se përmes projektit të Këshillit të Evropës, IPFK-ja ka krijuar dokumentin *Procedurat Standarde të Veprimit* (PSV), i cili u aprovua edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe do të fillojë trajnimi për gjithë stafin shëndetësor dhe atë korrektues.

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP) është institucion i tipit të hapur dhe ka kapacitet për akomodim të 60 deri në 65 personave. Heqja e zotësisë së përhershme të veprimit është një shqetësim i evidentuar në këtë Qendër, që e ngriti edhe drejtori, sipas të cilit, në 10 raste është aplikuar marrja e zotësisë së përhershme të veprimit, gjë që është veprim i padrejtë dhe i motivuar për marrjen e pronës, siç është rasti i B.R., që është ende në procedura gjyqësore.

Avokati i Popullit konstaton se në QIRSKP, gjendja e përgjithshme për sa i përket trajtimit dhe kushteve në këtë Institucion është e mirë, përveçse mungon Njësia për Terapi Vokacionale.²⁴⁴

Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi

Shërbimi Komunitar dhe Rezidencial në Republikën e Kosovës ofrohet përmes shërbimit profesional të shëndetit mendor. Në Kosovë funksionojnë gjithsej nëntë (9) Qendra të Shëndetit Mendor (QShM), ndërsa në vitin 2024 është hapur edhe Qendra e Shëndetit Mendor në Deçan. Gjithashtu janë edhe nëntë (9) Shtëpi për Integrim në Bashkësi (ShIB), që ofrojnë shërbime rezidenciale të shëndetit mendor, në të gjitha regjionet e Kosovës.

Gjatë vitit 2024, ekipi i MKP-së ka vizituar 3 Qendra të Shëndetit Mendor:

- Qendra e Shëndetit Mendor në Prishtinë,
- Qendra e Shëndetit Mendor në Pejë,
- Qendra e Shëndetit Mendor në Gjilan, si dhe katër (4),
- Shtëpitë Integruese në Bashkësi në Mitrovicë (2),
- Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Pejë,
- Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Fushë Kosovë.

242 <https://oik-rks.org/2023/10/04/raport-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-klubin-psikiatrike-te-qendres-klubin-universitare-te-kosoves-urgjenca-dhe-kujdesi-intensiv-psikiatrik/>

243 <https://oik-rks.org/2022/11/30/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike/>

244 Terapi Vokacionale është proces i cili synon të ndihmojë individët të zhvillojnë aftësi, njohuri dhe qëndrime që i përgatisin ata për të hyrë, rikthyer ose ruajtur një punësim të përshtatshëm.

Qendrat e Shëndetit Mendor janë të organizuara mirë duke u ofruar shërbime ditore, trajtim me medikamente dhe ofrojnë aktivitete psiko-sociale. Sipas protokollit të regjistrimit, në këto shtëpi marrin shërbime mbi 600 persona.

Shtëpitë Integruese në Bashkësi - ofrojnë kujdes shëndetësor 24 orë në funksion të rehabilitimit dhe riintegrimin social të klientëve me çrregullime kronike psikotike në remision.²⁴⁵ Në ShIB nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, as me demencat e të gjitha llojeve, as me sëmundjet e vartësisë dhe as rastet sociale.

MKP-ja ka vërejtur një qasje të afërt nga personeli ndaj rezidentëve dhe kryesisht një klimë pozitive brenda shtëpive të vizituara. Rezidentët dukeshin mirë për nga veshja dhe higjiena. Nuk janë hasur në shenja të lëndimeve trupore te rezidentët. Ekipi monitorues i ka intervistuar rezidentët dhe nuk ka marrë ankesa për ndonjë formë të keqtrajtit.

Në përgjithësi realizohen aktivitete, siç janë: shëtitjet në natyrë dy herë në vit, ping-pongu, dëgjim muzike, angazhohen në punë të shtëpisë, si: në pastrim, kuzhinë, mirëmbajtje të oborrit, për aq sa munden. Nuk kishte mbipopullim.

Institucionet e Kujdesit Social

Trajtimi për personat me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor ofrohet gjatë 24 orëve në Institutin Special në Shtime dhe në nëntë [9] Shtëpi me Bazë në Komunitet.

Gjendja e përgjithshme në Institutin Special në Shtime (ISSh) është shumë e mirë për sa i përket trajtimit dhe kushteve që ofrohen.

Përmes projektit të Këshillit të Evropës, ISSh-ja i ka ndërtuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), si dhe janë trajnuar i gjithë stafi për Terapi Okupacionale.

Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK) funksionojnë në tetë (8) komuna, në: Kamenicë, Deçan, Ferizaj, Vushtrri, Lipjan,

Graçanicë, Shtime dhe Prizren. Shtëpitë kanë kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShBK-së në Shtime me kapacitet prej 12 shtretërisht. MKP-ja ka vizituar ShBK-në në Ferizaj dhe në Prizren dhe të gjeturat nga vizita i janë përcjellë institucionit të vizituar. ShBK-të nuk kanë Plan individual të trajtimit për rezidentët, nuk kanë Rregullore për organizimin e brendshëm të punës, ndërsa punëtorët ballafaqohen me mospagimin e kujdestarisë. ShBK-ja në Ferizaj ka nevojë për renovime, përderisa ShBK-ja në Prizren ka pasur renovime duke përfshirë edhe sanitarinë.

Shtëpitë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare

Avokati i Popullit, përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka realizuar vizitë në:

- Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë (SHPMPF),
- Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj,
- Shtëpinë e Komunitetit për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc,
- Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Novobërdë,
- Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Graçanicë.

Qëllimi i vizitave është vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të këtyre shtëpive, sfidat me të cilat ballafaqohen, kushtet e banimit, bisedat me të moshuarit për sa i përket trajtimit, ushqimit, shëndetësisë, higjienës, si dhe zbatimi i rekomandimeve të IAP-së, të dërguara përmes raporteve me rekomandime në vitet e mëhershme.

Për sa u përket kushteve të akomodimit, në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë është funksionalizuar lifti, është rinovuar dhoma e vizitave familjare (janë

²⁴⁵ Remision është term mjekësor që përdoret për të përshkruar një periudhë gjatë së cilës simptomat e një sëmundjeje zvogëlohen apo zhduken plotësisht.

në pritje që të pajiset me inventar), dhoma e sigurimit, dy banja në katin e parë, një banjë në katin e dytë, salla e ushqimit komplet, ku është ndërruar laminati dhe sanitaria. Komuna e Prishtinës ka ndihmuar në rregullimin e ndriçimit në oborr. Po ashtu është vërejtur se higjiena është në nivelin e duhur, ku 4 (katër) persona çdo ditë angazhohen në pastrim me kompaninë e kontraktuar. Ekipi u njoftua se Banka NLB ka sjellë perde për kuzhinë dhe një frigorifer si donacion, pesë (5) aparate të oksigjenit dhe disa puls-oksimetra. Gjithashtu, nëpër salla u vendos interneti dhe kabllori që është donacion.

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare “Zaim Bajrami” në Skenderaj ka nevojë për renovime, si: gëlqerosje, sigurim të inventarit, rregullim të dyshemesë, rregullim të banjave, sigurim të lavatriçeve industriale, vendosje të kamerave, ventilim dhe rregullim i ashensorit, që është shqetësimi më i madh për rezidentët, pasi ka kaluar një vit që është prishur dhe akoma nuk është funksional. Përveç kësaj, ka mungesë të një dhome ambulatore për stafin, pasi i nevojitet për pastrimin e plagëve, dhënien e ndonjë infuzioni apo injeksioni për rezidentët.

Në Shtëpinë e Komunitetit për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc është vërejtur se ka nevojë për renovime dhe, sipas informatave që kemi marrë gjatë vizitës, punimet do të fillojnë së shpejti, i cili premtim do të përcillet nga MKP-ja. Po ashtu, më 1 tetor 2024 është funksionalizuar parku që gjendet në oborrin e Shtëpisë, me investime të Komunës se Istogut.

Në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Novobërdë, kushtet e banimit në përgjithësi janë të mira dhe plotësojnë standardet minimale. Pavarësisht kësaj, Komuna planifikon që edhe në vitin 2025 të vazhdojë me renovime sipas nevojës.

Në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Graçanicë, kushtet

e akomodimit ishin të mira. Renovime ka pasur vitin e kaluar (2023), dyshemeja është ndërruar në tërësi. Dhomat ishin të ndritshme dhe të pajisura me shtretër, dyshekë dhe dollapë të rinj, donacion nga kisha e Graçanicës. Në këtë Shtëpi vetëm një dhomë nuk është funksionale, për shkak se ka lagështi.

Avokati i Popullit, nga vizitat e realizuara në shtëpitë e lartpërmendura, konstaton se në përgjithësi të moshuarit në këto Shtëpi trajtohen shumë mirë dhe me dinjitet.

Për sa u përket kushteve të akomodimit, në përgjithësi janë të mira, përveç në Shtëpinë për të Moshuar në Skenderaj, e cila ka nevojë për renovime dhe rregullimin e ashensorit. Të gjeturat nga vizitat janë diskutuar me udhëheqësit e institucioneve, të cilët janë njoftuar se Avokati i Popullit do të përcjellë raport me rekomandime.

Të Drejtat e të Huajve

Avokati i Popullit gjatë vitit 2024 ka pranuar gjithsej dhjetë (10) ankesa nga të huajt, prej të cilave tri (3) janë hapur për hetim dhe janë proceduar tutje, ndërsa dhjetë (10) prej tyre janë të papranueshme. Të huajt, në kuadër të garancive kundër keqtrajtimit, kanë të drejta të njëjta si të gjitha kategoritë e personave të tjerë të ndaluar, gjë që edhe janë trajtuar, në rastet e lartpërmendura. Ankesat e pranuar nuk kanë pasur të bënin me trajtimin në qendrat e mbajtjes, por kanë qenë të natyrave të tjera. Një ankues ka parashtruar ankesë për shkak të mostrajtimin adekuat të fëmijëve të tij nga shkolla “ILG SCHOOL” në Prishtinë, e cila lëndë është mbyllur për shkak të mosbashkëpunimit të palës me IAP-në;²⁴⁶ ose rasti i një të huaje, e cila ka kërkuar që të ndërmjetësohet në gjykatë për zgjidhjen e rastit të saj, i cili po ashtu ka përfunduar, pas veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit²⁴⁷; apo kur një i huaj është ankuar kundër gjykatës për mossaigurimin e përkthimit në gjuhën që ai e kupton (gjuhës greke)²⁴⁸ etj.

246 R.nr.888/2024

247 R.nr. 250/2024

248 R.nr.526/2024

Avokati i Popullit ka realizuar vizita në qendrat për të huaj, si në:

- Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë - 1 herë,
- Qendrën e Mbjajtjes për të Huaj - 3 herë,
- Qendrën e Azilit - 1 herë.

Qendra e Pritjes shërben për pritjen dhe akomodimin e migrantëve (24 orë në ditë, 7 ditë në javë), të personave me status të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës; si dhe përkujdeset për kushtet, mbrojtjen dhe mirëqenien e migrantëve sipas legjislacionit në fuqi.

MKP-ja nuk ka marrë ankesa për sa i përket trajtimit apo kushteve që ofrohen, nga personat e vendosur në këtë qendër.

Avokati i Popullit ka konstatuar se ka mungesë stafi si dhe të paktën një infermieri, të cilat shqetësime i janë përcjellë udhëheqësit të Qendrës, si dhe pas publikimit të raportit do t'i rekomandohet MPB-së për ndërmarrjen e veprimeve.

Qendra e Mbjajtjes për të Huajt, në Vranidoll (QMH) - Më 15 nëntor 2024 Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime²⁴⁹ për vizitën në këtë qendër. Qëllimi i kësaj vizite është monitorimi i respektimit të të drejtave të të huajve që mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës së Mbjajtjes për të Huajt dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë nga kjo qendër, e cila pas shqyrtimit nga Avokati i Popullit është shpallur e papranueshme, për shkak se pala ka qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike (pritje të përgjigjes në kërkesën për azil), ndërsa nuk ka pasur ankesa për sa i përket trajtimit në Qendër.

Avokati i Popullit konstaton se në mungesë të personelit të kualifikuar mjekësor, personeli i Qendrës ua shpërndanë terapinë të huajve

në mbajtje, duke u bazuar në raportin e shkruar nga mjeku kompetent, e që është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës së Mbjajtjes për të Huajt dhe me standardet ndërkombëtare të përcaktuara për paraburgimin për shkak të imigrimit. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe vitet e mëparshme që: “QMH-ja duhet ta ketë në dispozicion së paku një infermier, e cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.” Avokati i Popullit është në pritje për implementim.

Avokati i Popullit konstaton se për shkak të mungesës së personelit të kualifikuar mjekësor, raportet shëndetësore mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit, e cila e cenon konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore dhe është në kundërshtim me Rregulloren nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës së Mbjajtjes për të Huajt, me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me standardet ndërkombëtare. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe në vitet e mëparshme, megjithatë këto rekomandime janë ende në pritje për implementim.

Avokati i Popullit ka konstatuar se kamerat, të cilat janë garanci shtesë si për personat që punojnë, ashtu edhe për personat që mbahen në qendër, nuk kanë pamje të qartë, disa edhe nuk funksionojnë fare si dhe ndriçimi mbrapa objektit është shumë i dobët. Për këtë gjetje, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raportin me Rekomandime gjatë vitit 2022²⁵⁰, i cili është në pritje për implementim.

Duke pasur parasysh se ndalimi për shkak të imigrimit është formë e ndalimit administrativ të personave dhe jo paraburgim klasik, MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se Rregullorja nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës së Mbjajtjes për të Huajt ka kufizime për sa u përket kontakteve me botën e jashtme, si p.sh. qasje në internet, Skype, dhe ka mungesë të aktiviteteve rekreative,

249 <https://oik-rks.org/2024/11/18/avokati-i-popullit-raport-i-mekanizmit-kombetar-kunder-tortures-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-mbjajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/>

250 <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbjajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/>

sidomos për personat që qëndrojnë gjatë.

Lidhur me gjetjet për komunikim me botën e jashtme, Avokati i Popullit ka rekomanduar në Raport me Rekomandime edhe gjatë vitit 2022²⁵¹: “Të huajve të ndaluar t’u mundësohet komunikimi online me familjet e tyre.” Avokati i Popullit është në pritje për implementim e këtij rekomandimi.

MKP-ja ka realizuar vizitë të përgjithshme në Qendrën për Azilkërkues në Magure, me qëllim të vlerësimit të respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve.

Kapaciteti i Qendrës për Azilkërkues në Magurë është 100 persona. Gjatë vizitës, në qendër ishin të vendosur 32 persona, të cilët kishin aplikuar, prej këtyre dy familje me fëmijë, ndërsa në banim privat ishin 28 persona. Azilkërkuesit ishin kryesisht nga Siria, Jordania, Maroku, Afrika e Jugut etj. Në qendër ishin të vendosur 2 fëmijë të pashoqëruar.

Avokati i Popullit pas vizitës ka konstatuar se gjendja e përgjithshme në Qendrën e Azilit është e mirë dhe se qendra ofron kushte të mira për jetesë. MKP-ja nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim apo shkelje të tjera të të drejtave të njeriut. Në Qendrën e Azilit janë të angazhuara edhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat ofrojnë mbështetje në fushat specifike, si: ofrim i shërbimeve shëndetësore, psikologjike, edukim, përkthim, ndihmë juridike etj.

Sfidë mbetet Ligji për të Huajt, i cili gati mbi 2 vjet është në plotësim-ndryshim dhe nuk ka arritur të finalizohet.

Monitorimi i operacioneve të kthimit me forcë

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me Komisionin Nacional Zvicëran për Parandalim të Torturës, gjatë vitit 2024 ka monitoruar tri (3) operacione të kthimit me forcë të shtetasve të Republikës së Kosovës nga autoritetet zvicëra në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

²⁵¹ Po aty.

Gjatë monitorimit të operacioneve, ekipi i MKP-së të kthyerit me forcë i ka intervistuar, mirëpo nuk marrë ndonjë ankesë për sa i përket trajtimit nga autoritetet zvicëra dhe nga Policia e Kosovës. Të kthyerit janë njoftuar me mandatin e MKP-së dhe të IAP-së, si dhe mundësinë që t’i drejtohen Avokatit të Popullit në zyrën qendrore dhe në zyrat regjionale, anembanë Kosovës.

MKP-ja, pas çdo monitorimi të kthimit me forcë nga Zvicra, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit, ka përpiluar raport njoftues për palën zvicëra. Po ashtu, gjatë monitorimit të këtyre operacioneve, MKP-ja ka pasur bashkëpunim të plotë me Policinë e Kosovës, duke monitoruar që nga momenti i aterimit të aeroplanit.

Gjithashtu, MKP-ja ka realizuar një vizitë të përgjithshme dhe ka njoftuar autoritetet e aeroportit, respektivisht Policinë e Kosovës, se ende nuk janë implementuar Rekomandimet e Avokatit të Popullit për pajisjen me material promovues dhe njoftues për të drejtat dhe obligimet e të ndaluarve. Nga përgjigjja që ka pranuar nga Policia e Kosovës, Avokati i Popullit është njoftuar se këto rekomandime janë implementuar.

Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Bazuar në rolin e kompetencat që i përshkruan Kushtetuta, roli dhe kompetencat mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit në Kosovë shtrihen edhe në Sektorin e Sigurisë. Është qenësore të theksohet se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e saktëson qartë: *“Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohet.”* (Kapitulli XI [Sektori i Sigurisë], Neni 125, paragrafi 4).

Institucionet Nacionale të të Drejtave të Njeriut (IKDNj), që funksionojnë në pajtueshmëri me Parimet e Parisit, konsiderohen institucione efektive dhe kredibile, që mund të ushtrojnë rolin mbikëqyrës edhe në sektorë të ndjeshëm e kompleks çfarë janë strukturat e sektorit të sigurisë. Vendi ynë ka respektuar standardet më të mira në rendin kushtetues dhe ligjor të vendit kur e ka veshur Institucionin e Avokatit të Popullit me atributet e institucionit kushtetues të pavarur në ushtrimin e detyrës dhe që nuk pranon udhëzime a ndërhyrje nga autoritetet e tjera në vend, të cilat ushtrojnë pushtet (Kapitulli XII [Institucionet e pavarura], Neni 132, paragrafi 2).

Megjithatë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me legjislacionin në fuqi, vendosi që në zinxhirin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, të ketë si një organ të veçantë edhe Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë.²⁵² Në shkurt të këtij viti, Parlamenti i vendit, nëpërmjet votimit të fshehtë, zgjodhi znj. Remzije Zeqiraj, Komisionare për Forcat

e Sigurisë, për një mandat 5-vjeçar.

Komisionarja është mirëpritur²⁵³ nga Avokati i Popullit në një takim njohës, përderisa në proces të konsolidimit të Zyrës së Komisionarit, IAP-ja i është përgjigjur pozitivisht ftesës së Komisionares për të kontribuar në fazën fillestare të ngritjes së kapaciteteve për realizimin e mandatit të përcaktuar ligjor, respektivisht ka marrë pjesë në punëtorinë për hartimin e Rregullores së Punës së Komisionarit.²⁵⁴ Rregullorja e Punës së Komisionarit Parlamentar për FSK-në ka marrë miratimin e Kuvendit dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare, në dhjetor 2024, duke i hapur kështu rrugë organizimit të Zyrës së Komisionarit dhe përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisive të përcaktuara me aktet normative përkatëse.

Në kontekst të zhvillimeve që kanë të bëjnë me FSK-në dhe kushtet e shërbimit për personelin ushtarak, Avokati i Popullit ka përcjellë me shqetësim çështjet e ngritura publikisht për sa i përket furnizimit me ushqim dhe cilësisë së ushqimit, si dhe heqjes dorë nga ana e pjesëtarëve të uniformuar nga shërbimi në Forcën e Sigurisë. Edhe pse Avokati i Popullit nuk është përfshirë në diskutimin publik lidhur me këto çështje dhe as nuk ka pranuar ndonjë ankesë që specifikisht lidhet me këto aspekte, e konsideron të rëndësishme të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së se duhet të maksimizojnë përpjekjet për mirëqeverisje dhe miradministrim të proceseve që kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e tyre, në mënyrë që të mundësohet ruajtja dhe fuqizimi i besimit në FSK.

Avokati i Popullit ka marrë pjesë²⁵⁵ në Konferencën Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombuds-ve për Forcat e Armatosura.²⁵⁶ Konferenca e këtij viti, e 16-ta me radhë²⁵⁷, i zhvilloi punimet në Berlin, Gjermani, si organizim i përbashkët i Komisionarit Parlamentar Gjerman për

252 gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61417

253 <https://oik-rks.org/2024/05/10/avokati-i-popullit-priti-ne-takim-komisioneren-e-fsk-se/>

254 Punëtorja e realizuar më 1 dhe 2 korrik 2024, në Prishtinë.

255 <https://oik-rks.org/2024/10/01/avokati-i-popullit-po-merr-pjese-ne-konferencen-e-16-te-nderkombetare-te-institucioneve-te-ombuds-ve-te-forcave-te-armatosura/>

256 <https://www.dcaf.ch/ombuds-institutions-armed-forces>

257 <https://euromil.org/16icoaf-meeting-in-berlin/>

Forcat e Armatosura dhe DCAF – Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë. Konferenca konsiderohet si një platformë për promovimin e kontrollit demokratik të forcave të armatosura dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Ombuds-ve që kanë mandat mbikëqyrës kundrejt forcave të armatosura të shteteve përkatëse. Qëllimi kryesor i Konferencës së këtij viti është bashkëbisedimi dhe artikulimi i politikave për të ardhmen ndërmjet ombuds-ve, për të adresuar sfidat që lindin nga tensionet dhe pasiguria në rritje në gjithë botën e për rrjedhojë shtimin e kërkesave dhe sfidave për personelin ushtarak. Në kuadër të punimeve të Konferencës është i pashmangshëm reflektimi mbi mësimet e nxjerra nga takimet e tilla të mëparshme dhe përvojat e krijuara. Në përfundim të ngjarjes u nxor deklarata e saj përfundimtare, si një përmbledhje e praktikave të mira dhe reflektimeve kyçe të diskutuara gjatë punimeve të Konferencës. Konferenca e 17-të do të mbahet në vitin 2025, nikoqir i së cilës do të jetë Afrika e Jugut.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në takimin me temën “Roli dhe funksionet e IKDNj-ve, që veprojnë në konflikte të armatosura”, një takim i veçantë në vazhdimësi të punimeve të Takimit Vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian të IKDNj-ve (ENNHRI).²⁵⁸ Takimi është projektuar vetëm për një rreth të zgjedhur të përfaqësuesve nga 16 IKDNj. Në fokus të takimit është të kuptuarit e sfidave me të cilat përballen IKDNj-të gjatë situatave aktive të konfliktit, apo në periudhat para e pas tij, si dhe mënyrat e adresimit të tyre. Takimi gjithashtu shqyrtoi rolin dhe rëndësinë e standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për IKDNj: ndikimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare në punën e IKDNj-ve në konfliktet e armatosura dhe bashkëpunimin e tyre me entitete dhe institucione të tjera.²⁵⁹

Po ashtu Avokati i Popullit mori pjesë edhe në Akademinë Kombëtare të Institucioneve të Drejtave të Njeriut (NHRI), e cila për fokus ka forcimin e kapaciteteve të IKDNj-ve për të adresuar sfidat që lidhen me sigurimin duke u mundësuar IKDNj-ve, që përmes mandatit të tyre, të adresojnë çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Akademia u organizua në Bratisllavë, Sllovaki, dhe temat kryesore që u trajtuan ishin: Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet kryesore të sigurisë, se si ato lidhen me të drejtat e njeriut dhe demokracinë; përdorimi i mandatit të gjerë të IKDNj-ve për të adresuar sfidat e sigurisë dhe të drejtave të njeriut, si dhe angazhimi i mekanizmeve rajonale për të adresuar këto sfida në nivel kombëtar.

²⁵⁸ <https://ennhri.org/news-and-blog/ennhri-members-elect-new-governance-positions-at-general-assembly/>

²⁵⁹ <https://ennhri.org/news-and-blog/nhris-come-together-to-consider-their-role-and-functions-in-situations-of-armed-conflict/>

Të drejtat e personave në kuptim të “Drejtësisë Tranzicionale”

Drejtësia Tranzicionale është fushë e drejtësisë, e cila ka të bëjë me të gjitha masat që ndërmerren nga shtetet në tranzicion, për të kërkuar llogaridhënie dhe për t'i adresuar pasojat e shkaktuara nga lufta dhe shkeljet e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Drejtësia Tranzicionale synon të ndihmojë një shoqëri pas konfliktit që të sigurojë drejtësi për viktimat dhe njohjen e tyre, ta rrisë besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit, ta sigurojë respektimin e të drejtëve të njeriut, ta promovojë sundimin e ligjit, t'i parandalojë shkeljet e të drejtave të njeriut në të ardhmen dhe ta nxisë pajtimin. Ekzistojnë katër mekanizma kryesorë, të cilët mundësojnë arritjen e këtyre objektivave të Drejtësisë Tranzicionale:

E drejta për drejtësi përfshin të drejtën e viktimave për të marrë drejtësi përmes një mjeti juridik të drejtë dhe efektiv. E drejta për drejtësi gjithashtu i detyron shtetet të hetojnë shkeljet dhe të ndjekin penalisht personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të marrë veprimet ndëshkuese nëse vërtetohet fajësia.

E drejta për të ditur përfshin të drejtat e viktimave dhe familjeve të tyre për të mësuar të vërtetën mbi atë çfarë u ka ndodhur atyre personalisht apo familjarëve dhe njerëzve të tyre të dashur. Kjo e drejtë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shoqërisë për të ditur cilat rrethana rezultuan në kryerjen e krimeve dhe shkeljeve, ashtu që të parandalohet përsëritja e tyre në të ardhmen.

Përtej kësaj, kjo e drejtë ofron një detyrim të shtetit për të ndërmarrë masa, si sigurimi i arkivave dhe dëshmive të tjera, duke ruajtur dhe mirëmbajtur kujtesën kolektive.

E drejta për reparacion përfshin masat të cilat shteti obligohet t'i aplikojë për viktimat, familjet e tyre dhe komunitetet, ashtu që t'i kontribuojnë një forme të njohjes simbolike të ndjenjës së humbjes së tyre, e cila është e nevojshme si pjesë e shërimit nga traumat e luftës dhe të ofrojë drejtësi dhe kompensim për humbjet që janë shkaktuar.

E drejta për garanci për mospërsëritje nënkupton obligimin e shtetit për të siguruar qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit, ashtu që të sigurojë që krimet që kanë ndodhur në të kaluarën të mos përsëriten. Reformat institucionale paraqesin procesin e rishikimit dhe të ristrukturimit të institucioneve shtetërore në mënyrë që ato të respektojnë të drejtat e njeriut, të ruajnë shtetin e së drejtës dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj publikut.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2023 ka publikuar Raportin Ex officio nr. 422/2021 lidhur me Drejtësinë Tranzicionale dhe zbatimin e mekanizmave të saj²⁶⁰, me qëllim që t'i identifikojë të gjitha nismat, qofshin institucionale apo të shoqërisë civile, në fushën e Drejtësisë Tranzicionale dhe ta analizojë zbatimin e këtyre nismave dhe në bazë të analizës ta bëjë vlerësimin nëse institucionet e shtetit kanë bërë mjaftueshëm dhe e kanë përmbushur obligimin e tyre në realizimin e të drejtave të njeriut për shkeljet masive të tyre në periudhën e luftës në Kosovë.

Me këtë raport Avokati i Popullit ka konstatuar se institucionet nuk i kanë përmbushur obligimet e veta karshi viktimave në ofrimin e drejtësisë për krimet e luftës kundër njerëzimit, me përmasa të gjenocidit, që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se shteti nuk i ka përmbushur obligimet e veta ndaj viktimave kur bëhet fjalë për mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve mbi krimet e luftës. Në anën tjetër vlerësohet se Kosova, në masë të

260 <https://oik-rks.org/2023/06/05/rraporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4222021-drejtësia-tranzicionale-dhe-zbatimi-i-mekanizmave-te-saj/>

madhe, i ka përmbushur detyrimet në ofrimin e reparacioneve materiale ndaj viktimave dhe ndërmarrjen e reformave institucionale, me qëllim të garantimit të mospërsëritjes. Po ashtu janë ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale për t'i zbatuar mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, mirëpo këto nisma, duke mos qenë gjithmonë në harmoni dhe në bashkërenditje me njëra-tjetrën, si të tilla, nuk i kanë dhënë rezultatet e dëshiruara.

Përmes këtij raporti, Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime konkrete autoriteteve përgjegjëse për politika dhe nisma të reja, si dhe rekomandime për përmirësimin e funksionimit të nismave ekzistuese në fushën e Drejtësisë Tranzicionale, në përmirësimin e gjendjes për sa i përket realizimit të të drejtave të viktimave për drejtësi dhe reparacion, si dhe të së drejtës për të ditur dhe garantimit për mospërsëritje.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 13 qershor 2024, ka miratuar Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale.²⁶¹ Parimet kryesore që i prijnë Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034 dhe Planit të Veprimit 2024-2026 janë: Qasja e përqendruar te viktimat; Qasja gjithëpërfshirëse; Ndjeshmëria gjinore; Pajtueshmëria me normat dhe standardet ndërkombëtare; Integriteti dhe paanshmëria etj. Synimi i kësaj strategjie është që të mundësojë dialogun social për të kaluarën, të sigurojë kushtet e nevojshme për arritjen e drejtësisë për të gjitha viktimat, të sigurojë zbatimin e një procesi gjithëpërfshirës, transparent të mbështetjes materiale, simbolike dhe psiko-sociale për të gjitha viktimat etj. Gjithashtu, në kuadër të objektivave strategjike, të cilat përfshijnë mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, janë paraparë objektiva të ndryshme specifike për secilin objektiv strategjik.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues organizoi tryezë diskutimi me qëllim të shënimit të Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur dhe diskutimit me aktorët relevantë

lidhur me fatin e personave të pagjetur dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit në Raportin për Drejtësinë Tranzicionale. Gjatë tryezës u diskutua me aktorët relevantë lidhur me fatin e personave të pagjetur si dhe me masat që shteti ka ndërmarrë për sa u përket krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe adresimit të fatit të personave të pagjetur, duke shtruar për diskutim dhe adresim edhe sfidat aktuale të këtij procesi. Gjatë tryezës u prezantua shkurtimisht Raporti i Avokatit të Popullit për Drejtësinë Tranzicionale dhe rekomandimet e tij, ndërsa Avokati i Popullit, me qëllim të shënimit të Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur, përmes një Deklarate lidhur me Personat e Pagjetur²⁶², rikujtoi detyrimet që ka shteti për t'u garantuar viktimave dhe familjeve të personave të zhdukur të drejtën për të ditur të vërtetën për fatin e familjarëve të zhdukur me forcë dhe për të garantuar drejtësi për viktimat, ashtu që krimet e luftës të mos mbesin të pandëshkuara. Avokati i Popullit gjithashtu theksoi se do të vazhdojë të jetë zë i fuqishëm në mbështetje të kërkesave të familjeve të personave të zhdukur, duke mbështetur secilën iniciativë institucionale që kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që ka shteti në raport me mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale dhe do të vazhdojë të ketë bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, që në shumë raste ka qenë zëri i vetëm që ka ndikuar që padrejtësitë me viktimat i kanë vendosur në vëmendjen e institucioneve, duke ua rikujtuar detyrimet që kanë.

Të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

Një nga dimensionet më të ndjeshme të drejtësisë tranzicionale është edhe adresimi i reparacionit për viktimat e dhunës seksuale gjatë periudhës së konfliktit të armatosur apo luftës. Dhuna seksuale gjatë luftës, si një nga format më të rënda të dhunës, ka lënë pasojë të thella dhe traumatike në jetët e të mbijetuarve, duke përfshirë trauma fizike, psikologjike dhe stigma në shoqëri.

261 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/STRATEGJIA-PER-DREJTESI-TRANZICIONALE-E-REPUBLIKES-SE-KOSOVES-2024-2034.pdf>

262 <https://oik-rks.org/2024/04/26/deklarata-e-avokatit-te-popullit-ne-shenim-te-dites-kombetare-per-personat-e-pagjetur/>

Plotësim – ndryshimi i Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, në vitin 2014 ka hapur rrugë për fillimin e procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ndërkaq procesi ka filluar të zhvillohej me themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës (në vijim Komisioni), në prill të vitit 2017.

Avokati i Popullit në vitin 2023 ka iniciuar sipas detyrës zyrtare hetime ²⁶³ mbi vlerësimin e respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut, përkatësisht të viktimave, në procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të tyre. Ky hetim ka ardhur si rezultat i ankesave që ka pranuar IAP-ja dhe shqetësimeve të vazhdueshme të ngritura nga të mbijetuarat/it dhe nga organizatat joqeveritare, mbi sfidat dhe vështirësitë që ndërlidhen me procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale të luftës. Problemet e ngritura në vazhdimësi ishin: zvarritjet procedurale në zhvillimin e procedurës së verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës; mungesa e arsytimeve në vendimet e Komisionit dhe arsytimet e mangëta; kufizimi në afat kohor i dorëzimit të aplikacioneve për njohje të statusit; mungesa e shërbimeve shëndetësore pa kompensim; zgjatja e procedurave në gjykatë; vështirësi në realizim të beneficioneve; mënyra e organizimit të procesit të intervistimit dhe nevoja për luftimin e stigmatizimit në shoqëri.

Më 22 tetor 2024, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin ex-officio nr. 436/2023²⁶⁴ lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat për realizimin e beneficioneve

të përcaktuara me ligj. Avokati i Popullit, pas analizimit të çështjes dhe kornizës ligjore në fuqi, ka gjetur se Rregullorja nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ka disa zbrazëtira ligjore dhe nuk arrin të rregullojë në hollësi procedurën që duhet ndjekur nga palët me rastin e aplikimit për njohje të statusit.

Të tilla zbrazëtira konsistojnë në: mosparashikimin e afatit kohor për zhvillimin dhe përfundimin e procedurës administrative, në shkallë të parë dhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës; nevojën për qartësimin e terminologjisë juridike të përdorur lidhur me mjetet juridike në dispozicion të palëve në procedurë si dhe mungesën e përfshirjes së parimit të dyshkallshmërisë dhe kontrollit administrativ në procedurë. Prandaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ndër marrë veprimet konkrete me qëllim të plotësim-ndryshimit të rregullores në fjalë, ashtu që të caktohen afatet kohore dhe të definohen mjetet juridike në dispozicion të palëve në procedurë si dhe të përfshihet parimi i dyshkallshmërisë, ashtu që i njëjti organ të mos vendosë edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës.

Avokati i Popullit po ashtu ka konstatuar se me kornizën ligjore aktuale në fuqi nuk parashihen masa rehabilituese për viktimat, përkatësisht nuk është paraparë ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale, po ashtu nuk ofrohen shërbime shëndetësore pa kompensim në nivelin primar, sekondar dhe terciar në institucione publike shëndetësore për këtë kategori të qytetarëve, prandaj i ka rekomanduar Qeverisë ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të plotësim-ndryshimit të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve

263 R. Anr. 436/2023

264 <https://oik-rks.org/2024/10/31/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-436-2023-lidhur-me-respektimin-e-te-drejtave-te-njeriut-gjate-zhvillimit-te-procesit-te-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-viktimes-se-dhunes-seksuale/>

të tyre, në mënyrë që këto të drejta t'u garantohen edhe për të mbijetuarat/it.

Për sa i përket afatit kohor të kufizuar për dorëzimin e aplikacioneve për njohje dhe verifikim të statusit, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës që afati për dorëzimin e aplikacioneve për verifikimin dhe njohjen e statusit të mos kufizohet, duke marrë parasysh edhe faktin se afatet e parashkrimit nuk aplikohen ndaj krimeve të luftës. Kjo do t'u mundësojë viktimave dhe të mbijetuarve që të fillojnë procesin e aplikimit për njohjen e statusit në çdo moment, kurdo që të krijohen rrethanat e përshtatshme për ta, qofshin ato rrethana familjare apo shoqërore.

Në anën tjetër, edhe vendimet e Komisionit për njohjen ose refuzimin e statusit duhet të përmbushin kërkesat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, veçanërisht për sa i përket strukturës dhe elementeve të detyrueshme të aktit administrativ. Prandaj Komisionit Qeveritar i është rekomanduar që me rastin e përpilimit të vendimeve, përbrenda kornizave të ruajtjes së konfidencialitetit të palëve, vendimet të përmbajnë të gjitha elementet e arsyetimit, përfshirë faktet dhe provat e shtjelluara në procedurë, ashtu siç është paraparë me nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mënyrë që edhe palët të kenë të qartë arsyet e refuzimit të kërkesave të tyre. Njëkohësisht i ka rekomanduar Komisionit që gjatë zhvillimit të procedurës të respektojë afatet e caktuara ligjore e po ashtu të kushtojë vëmendje të shtuar në organizimin më të mirë të procesit të intervistimit të palëve, ashtu që viktimave t'u sigurohet mbrojtja e identitetit dhe shmangia nga ballafaqimi/takimi me viktimat e tjerë gjatë pritjes për intervistim.

Meqë një e gjetur tjetër e dalë nga ky raport është edhe fakti se ndërtesa ku Komisioni vepron dhe i realizohen intervistat me palë nuk është i qasshëm në aspektin infrastrukturor, Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu që këto hapësira të jenë të qasshëm për të gjithë, e veçanërisht për persona me

aftësi të kufizuara dhe po ashtu qasja të jetë e përshtatshme për ta mbrojtur zbulimin e identitetit të palëve me rastin e qasjes/hyrjes në ndërtesë.

Edhe pse ligji në fuqi u garanton të mbijetuarve gëzimin e disa beneficioneve, realizimi i tyre ka qenë i pamundur në mungesë të pajisjes së të mbijetuarve me kartela identifikuese, prandaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që të zhvillojë procedurat relevante për pajisjen e viktimave me kartela identifikuese, ashtu siç është paraparë me nenin 37 të Rregullores 22/2015. Po ashtu në rekomandimin drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës është kërkuar që trajtimi i lëndëve të iniciuara në gjykatë të bëhet me prioritet.

Më 19 nëntor 2024, Avokati i Popullit organizoi një tryezë²⁶⁵ diskutimi, ku u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet e dala nga raporti i publikuar në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat për realizimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj. Presidentja e Kosovës, e cila mori pjesë në këtë tryezë, ndër të tjerash theksoi nevojën për ofrimin e mbështetjes shëndetësore për viktimat; nevojën për lënien të pakufizuar të afatit kohor për dorëzimin e aplikacioneve për njohje të statusit si dhe nevojën për adresimin e proceseve të zgjatura në gjykata në kontestet e iniciuara për njohje të statusit. Ndërkaq ministrja e Drejtësisë, duke u pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet e dala në këtë raport, shprehu angazhimin e Qeverisë së Kosovës për të adresuar nevojat e viktimave, duke folur për veprimet e parashikuara në Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale për ofrimin e mbështetjes për të mbijetuarat/it.

265 <https://oik-rks.org/2024/11/19/u-prezantua-raporti-i-avokatit-te-popullit-per-viktimat-e-dhunes-seksuale/>

Shërbimet digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe të Drejtat e Njeriut

Zhvillimi i shërbimeve digjitale është duke vazhduar të ndikojë thellësisht në shoqërinë tonë duke sjellë mundësi të jashtëzakonshme për përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve në aspektin e zhvillimit social dhe të zhvillimit ekonomik. Megjithatë, zhvillime të tilla kanë ngjallur shqetësime lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si shkak i rreziqeve që shërbimet digjitale mund të paraqesin në relacion me të drejtën e privatësisë, lirinë e shprehjes dhe qasjen e barabartë të qytetarëve.

Një ndër hapat pozitivë në këtë aspekt është miratimi i Agjendës Digjitale të Kosovës 2030, nga Qeveria e Kosovës, si një dokument strategjik me të cilin synohet zhvillimi i vendit drejt një shoqërie të zhvilluar digjitale, si dhe Strategjia e Kosovës për Teknologjinë Informativë (TI). Po ashtu, një tjetër hap pozitiv është ofrimi i shërbimeve publike online për qytetarët, nëpërmjet platformës shtetërore “eKosova”, e cila ka vazhduar t’i zgjerojë shërbimet dhe informatat publike që ofron.

Megjithatë, në rrafshin e zhvillimeve digjitale, respektimi i të drejtave të njeriut është thelbësore dhe kjo kërkon një balancë të kujdesshme ndërmjet mundësive dhe rreziqeve, siç praktikohet me standardet ndërkombëtare. Kjo qasje nuk është përfshirë tek Agjenda Digjitale e Kosovës 2030, prandaj duke e vënë në pah rëndësinë e saj, është e nevojshme të theksohet se qasja në të drejtat e njeriut duhet të jetë e integruar në dokumentet strategjike për zhvillimin e digjitalizimit në vend.

Në këtë aspekt, Bashkimi Evropian e ka miratuar rregulloren të quajtur Akti i Shërbimeve Digjitale (Digital Services Act,

DSA), qëllimi i së cilës është të përmirësojë sigurinë dhe përgjegjshmërinë e shërbimeve digjitale duke krijuar një mjedis më të sigurt për përdoruesit, përfshirë mbrojtjen e të drejtave themelore të tyre. Prandaj, autoritetet relevante të Republikës së Kosovës është rëndësishme të ndërmarrin masa të përshtatshme dhe efektive për parandalimin e rreziqeve të shkaktuara nga shërbimet digjitale, në aspektin e të drejtave të njeriut.

Po ashtu, zhvillimi i Inteligjencës Artificiale (IA) ka bërë hapa të mëdhenj në vitet e fundit dhe vazhdon të rritet me shpejtësi. Zhvillimi i hovshëm i IA-së ka potencialin të sjellë ndryshime të mëdha dhe transformuese në shumë fusha, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit, produktivitetit dhe mundësi të reja për individët dhe shoqëritë. Për përdorimin e sigurt dhe etik të shërbimeve digjitale dhe të IA-së, BE-ja është fokusuar në krijimin e një kuadri ligjor dhe rregullator duke mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe nxitur inovacionin. Një ndër iniciativat kryesore të BE-së është miratimi i *Aktit të BE-së për Inteligjencën Artificiale*, qëllimi i të cilit është të sigurohet që IA-ja të përdoret në mënyrë të sigurt, transparente dhe të përgjegjshme duke i mbrojtur të drejtat e njeriut.

Po ashtu, hap shumë i rëndësishëm është ndërmarrë nga Këshilli i Evropës, i cili ka miratuar *Konventën Kornizë për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit*. Parimet themelore që siguron kjo konvente janë që në kuadër të aktiviteteve të sistemeve të Inteligjencës Artificiale duhet të respektohen: Dinjiteti njerëzor dhe autonomia individuale; Barazia dhe mosdiskriminimi; Respektimi i privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale; Transparenca dhe mbikëqyrja etj.

Duke marrë parasysh se BE-ja dhe Këshilli i Evropës kanë krijuar standarde ndërkombëtare për mbrojtjen e qytetarëve nga rreziqet e IA-së për nga aspekti i të drejtave themelore, këto parime duhet të integrohen në rendin juridik të Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, të drejtat e njeriut në epokën e IA-së janë një çështje kritike

dhe shumëdimensionale, pasi zhvillimet e teknologjisë prekin drejtpërdrejt jetën e individëve dhe shoqërive në përgjithësi. IA-ja ka potencialin të mbështesë ose të kërcënojë të drejtat e njeriut, varësisht se si zbatohet dhe menaxhohet ajo. Në mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ndikimet negative të IA-së, rol shumë të rëndësishëm kanë Institucionet Kombëtarë të të Drejtave të Njeriut (IKDNj) dhe Organet e Barazisë, siç është Avokati i Popullit. Në nivel evropian këto institucione në vazhdimësi janë duke i ngritur kapacitetet funksionale dhe profesionale për parandalimin e cenimit të të drejtave të njeriut nga sistemet e IA-së përmes promovimit dhe edukimit, për mbrojtjen e të drejtave sipas ankesave të pranura në mënyrë individuale apo kolektive, për mbrojtje nga diskriminimi si dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga sistemet e IA-së. Roli i këtyre institucioneve është përcaktuar me nenin 77, paragrafi 1, të Aktit të BE-së për Inteligjencën Artificiale.

Avokati i Popullit i ka vëzhguar me vëmendje zhvillimet periodike përkitazi me IA-në si dhe diskutimet në nivel ndërkombëtar mbi rolin e IKDNj-ve dhe Organeve të Barazisë në relacion me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga ndikimi negativ i inteligjencës artificiale. Stafi i IAP-së, i angazhuar në këtë fushë, në cilësinë e anëtarëve të grupeve punuese të ENNHRI-së dhe EQUINET-it i kanë përcjellë vazhdimisht zhvillimet në këtë drejtim dhe praktikën e mira për avancimin e punës në të ardhmen.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka hapur hetime me vetiniciativë (ex-officio) me qëllim të hulumtimit rreth ndikimit të AI-së në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës. Të gjeturat përkitazi me këtë rast do të publikohen nëpërmjet një raporti, qëllimi kryesor i të cilit konsiston në analizimin për mënyrën se si përdorimi i IA-së mund të ndikojë në mbrojtjen e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë parasysh rreziqet që mund të dalin nga përdorimi i teknologjisë së IA-së.

Më 10 dhjetor 2024, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën “Të Drejtat e Njeriut në Epokën e Inteligjencës Artificiale”, e organizuar nga Agjencia për Informim dhe

Privatësi, në bashkëpunim me Institutin për Teknologji dhe Shoqëri. Në këtë konferencë u diskutua në përgjithësi për ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të drejtat e njeriut, me theks të veçantë për të dhënat personale dhe privatësinë. Konferenca u përmbyll duke e theksuar rolin e institucioneve publike në përshtatjen me teknologjitë moderne për qeverisje transparente dhe të përgjegjshme, ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të drejtat digjitale dhe sfidat që lidhen me keqinformimin dhe rreziqet e të dhënave të pasakta në sistemet e IA-së. Po ashtu u theksua nevoja për të integruar parimet e privatësisë që në fazat e hershme të zhvillimit të teknologjive, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë për sfidat dhe mundësitë që sjell IA-ja.

Duke qenë se fusha e Inteligjencës Artificiale është një inovacion i ri dhe po ashtu ndikimi i saj në të drejtat e njeriut është një fenomen që ka filluar së trajtuari në vitet e fundit, në këtë fazë IAP-ja ka ndërmarrë iniciativa për ngritjen e kapaciteteve të stafit të IAP-së, për avancimin e njohurive në këtë fushë me qëllim të përgatitjes profesionale për trajtimin e rasteve në të ardhmen.

Çështjet e iniciuara në Gjykatën Kushtetuese

Avokati i Popullit në kuadër të mandatit kushtetues, gjatë vitit raportues i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në 5 raste dhe ka kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të akteve të kontestuara. Këto veprime Avokati i Popullit i ka realizuar pas pranimit të ankesave individuale, e po ashtu pas hapjes së rasteve sipas detyrës zyrtare.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues, në Gjykatën Kushtetuese ka dërguar:

- Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 4 të Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.
- Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Statutit (QRK) 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
- Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12, të Ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore.
- Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 331 (paragrafët 2, 4, 5, 6 dhe 7) të Kodit nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese tri komente për rastet e iniciuara nga subjektet e tjera. Komentet e dërguara në Gjykatën Kushtetuese janë si në vijim:

- Komente të Avokatit të Popullit lidhur me nenin 55 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e kërkesës KO 96/24, të datës 3 maj 2024.
- Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 152/24 dhe KO 158/24, të datës 29 korrik 2024.
- Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 153/24 dhe KO 156/24, të datës 26 korrik 2024.

Mbikëqyrja e legjislacionit në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me standardet ndërkombëtare

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka përcjellë procesin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Qeveria) dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kuvendi). Në këtë drejtim Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria ka miratuar programin legjislativ²⁶⁶, përmes të cilit ka planifikuar miratimin e 113 projektligjeve, sipas afateve të përcaktuara në program dhe përcjelljen e tyre për miratim në Kuvend.

Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë vitit raportues Kuvendi ka miratuar 63 ligje, ndërsa 45 projektligje kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit.²⁶⁷

Ndër ligjet me fokus më të madh publik ka qenë miratimi i Ligjit nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ky ligj është referuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese dhe Avokati i Popullit ka dërguar opinionin e tij në formë të komenteve rreth çështjes në fjalë.

Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ky ligj është referuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese dhe Avokati i Popullit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese opinionin në formë të komenteve duke dhënë mendim

lidhur me çështjet në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë vitit raportues Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave. Ky ligj është referuar në Gjykatën Kushtetuese dhe Avokati i Popullit ka dërguar opinionin në formë të komenteve dhe ka dhënë mendim lidhur me çështjen në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Kodin nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave, të cilin Avokati i Popullit e ka referuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se i njëjti nuk i ka marrë parasysht gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa i përket çështjes së pozitive drejtues të mesëm dhe të ulët, të cilët e kanë fituar të drejtën para hyrjes në fuqi të ligjit të kontestuar (Aktgjykimi KO 216/22 dhe KO 220/22 lidhur me vlerësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë).

Kuvendi po ashtu ka miratuar Ligjin nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, të cilin Avokati i Popullit e ka referuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se i njëjti, përveç çështjeve të ngritura nga Avokati i Popullit, nuk i ka marrë parasysht as gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa i përket çështjes së pozitive drejtues të mesëm dhe të ulët, të cilët e kanë fituar të drejtën para hyrjes në fuqi të ligjit të kontestuar (Aktgjykimi KO 216/22 dhe KO 220/22 lidhur me vlerësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë).

266 Programi Legjislativ për vitin 2024 është miratuar në mbledhjen e 186-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 01/186, i datës 24.1.2024, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 17/198 të datës 2.4.2024, dhe plotësuar i ndryshuar me Vendimin Nr. 02/212, të datës 10.7.2024.

267 Kuvendi i Republikës së Kosovës – Evidenca e Ligjeve - <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet-dhe-ligjet/>

**Kërkesat dhe
komentet e Avokatit
të Popullit dërguara
në Gjykatën
Kushtetuese**

Kërkesat dhe komentet e Avokatit të Popullit dërguara në Gjykatën Kushtetuese

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, neni 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili e përcakton kuotën gjinore të përfaqësimit në zgjedhje, ngre pyetje kushtetuese e që si të tilla duhet të kenë vlerësimin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese.

Elementi i parë i sundimit të ligjit është ligjshmëria që, mes të tjerash, e përfshin një proces transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik për nxjerrjen e ligjit. Avokati i Popullit e vëren që ligji i kontestuar është miratuar në procedurë të përshpejtuar. Ndonëse procedura e përshpejtuar e miratimit të ligjeve përcaktohet me Rregulloren e Kuvendit (neni 123), megjithatë kjo shmangie nga procedura e rregullt e miratimit të ligjit e ka pamundësuar pjesëmarrjen aktive në ofrimin e komenteve eventuale të Avokatit të Popullit dhe subjekteve me interes në çështjet e barazisë gjinore.

Avokati i Popullit e vlerëson se miratimi në procedurë të përshpejtuar i ligjit të kontestuar nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit, përkatësisht transparencën, ndërsa përcaktimi i kuotës gjinore prej 30% në ligjin e kontestuar nuk është në pajtim me vlerat kushtetuese në kuptimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Përcaktimi i kuotës (së paku 30%) për secilën gjini, në dukje nuk paraqet trajtim të pabarabartë në aspektin gjinor, megjithatë në praktikë nuk ka pasur raste kur subjektet politike i kanë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me 50% femra dhe 50% meshkuj. Vendosja e kriterit prej 30% e përlligj trajtimin e pabarabartë, sepse subjektet politike e plotësojnë kriterin ligjor për të garuar në zgjedhje me dërgimin e listës së kandidatëve me 30% femra në listat zgjedhore, ndërsa pjesa tjetër u lihet në vullnetin e tyre, rrjedhimisht në praktikë femrat në vazhdimësi mbeten të nënpërfaqësuar.

Avokati i Popullit e vlerëson se vendosja me ligj e kuotës (së paku 30%) për secilën gjini paraqet një lloj paragjykimi të pajustificuar, duke marrë parasysh se përqindja gjinore mes gjinive është pothuajse 50% me 50%, me dallime të vogla. Avokati i Popullit bazohet në të dhënat e *World Population Prospects* të vitit 2022, sipas të cilave, përqindja në nivelin botëror mes gjinive është 50.3% për meshkuj dhe 49.7% për femra.²⁶⁸ Po ashtu, referencë u është bërë edhe të dhënave të EUROSTAT-it, sipas të cilave, në Bashkimin Evropian ka pothuajse 5% më shumë gra se burra. Më 1 janar 2022, në BE ka 228 milionë gra dhe 218 milionë burra. Kjo korrespondon me një raport prej 104.6 gra për 100 burra, që do të thotë se ka pasur 4.6% më shumë gra se burra.²⁶⁹ Ndërsa, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2011, raporti gjinor rezulton të jetë 50.34% meshkuj dhe 49.66% femra.²⁷⁰ Vërehet se trendi i përqindjes mes meshkujve dhe femrave është pothuajse i barabartë, andaj vendosja e kuotës prej 30%, siç është bërë në ligjin e shfuqizuar e po ashtu edhe në ligjin e kontestuar, është në kundërshtim me barazinë para ligjit praktikisht dhe me ligj, për nga aspekti i barazisë gjinore.

268 <https://population.un.org/wpp/Download/Standard/MostUsed/>

269 <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2023>

270 <https://ask.rks-gov.net/PopulationStats/PopulationByRegion>

Duke e pasur parasysh definicionin në paragrafin 1, të nenit 28, me të cilin përcaktohet pragu minimal prej 30%, vërehet se kjo dispozitë është në kundërshtim me frymën e barazisë mes gjinive dhe në kundërshtim me Ligjin për Barazinë Gjinore, neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, sipas të cilit përcaktohet:

“Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative dhe masat tjera duke përfshirë:

1.3. përfshirjen e integritimit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion.”

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë shqyrtimit dhe miratimit të ligjit të kontestuar nuk i ka marrë parasysh obligimet që rrjedhin nga Ligji për Barazi Gjinore, si ligj special në lidhje me barazinë gjinore, e konsideron se në këtë rast janë shkelur dispozitat kushtetuese lidhur me barazinë para ligjit.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se shumica e listave të subjekteve politike që kanë garuar në zgjedhjet e përgjithshme të 14 shkurtit 2021, kanë qenë të përfaqësuara me 30% femra dhe me 70% meshkuj,²⁷¹ ku edhe atëherë kriter ligjor për kuotën gjinore ka qenë që në listat e subjekteve politike secila gjini të jetë e përfaqësuar me jo më pak se 30%. Në praktikë vërehet se femrat kanë qenë të përfaqësuara me 30%, ndërsa meshkujt me 70%. Ndërsa është vërejtur se pothuajse në të gjitha listat me kandidatët e subjekteve politike çdo i treti kandidat ka qenë grua, ndërsa dy kandidatët e parë kanë qenë burra.

Një përcaktim i tillë ligjor prej së paku 30% (neni 28), sipas Avokatit të Popullit, nuk e promovon barazinë para ligjit, ndërsa në praktikë ka rezultuar se u ka pamundësuar femrave që të jenë të pranishme në listat zgjedhore me pjesëmarrje të barabartë me meshkujt.

Avokati i Popullit vlerëson se, megjithëse kuota e përcaktuar në ligjin e kontestuar nuk paraqet kufizim të së drejtës, paraqitja e saj si limit minimal i pjesëmarrjes në rastin konkret nuk është proporcionale dhe nuk pasqyron barazinë gjinore dhe si e tillë nuk është në përputhje as me parimin mosdiskriminimit. Gjithashtu, një vendosje e tillë është në kundërshtim me qëllimin legjitim të ndjekur për arritjen e barazisë gjinore, siç kërkohet me Kushtetutë “*Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*” Përveç kësaj, një përcaktim i tillë e cenon esencën e së drejtës së garantuar, që në rastin konkret është e drejta për t’u zgjedhur, e drejta e pjesëmarrjes dhe e drejta e barazisë para ligjit.

Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse neni 28 i Ligjit të kontestuar është në pajtim me nenin 7, nenin 24 dhe nenin 45, paragrafin 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

271 <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/5.Rezultatet-e-te-gjithe-kandidateve-sipas-subjekteve-renditja-si-ne-fletevotim-1.pdf>

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, Ligji nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në nenin 4 ngre pyetje kushtetuese e që si të tilla duhet të kenë vlerësimin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese.

Ligji në fjalë përcakton si në vijim:

“Pas nenit 8, shtohet dispozita ligjore 8/A në Ligjin Bazik me tekstin si në vijim:

Neni 8/A

Pensioni parcial kontributpagues i moshës

1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim:

2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;

2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme;

2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri.

4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.”

Çështjet që Avokati i Popullit ngre në këtë rast në Gjykatën Kushtetuese, që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar, janë: nëse Ligji i kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit nr. KO 190/19, në kuptim të barazisë para ligjit; nëse Ligji i kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehur nëpërmjet Aktgjykimit nr. KO 190/19, për sa i përket ndalimit të diskriminimit, sipas nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj); nëse Ligji i kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehur nëpërmjet Aktgjykimit nr. KO 190/19, në kuptim të ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, sipas nenit 1 të Protokollit 12 të KEDNj-së.

Gjykata Kushtetuese, më 16 janar 2023, ka nxjerrë Aktgjykimin KO 190/19, duke konstatuar se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në lidhje me nënparagrafin 2.3, të paragrafit 2, të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, shfuqizohen më 15 korrik 2023.

Me këtë rast Gjykata ka urdhëruar Kuvendin dhe Qeverinë që jo më larg se deri më 15 korrik 2023, t'i ndërmerrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë Aktgjykim.

Megjithëse Kuvendi më 27 korrik 2023 e miratoi Ligjin e kontestuar, për vlerësimin e Avokatit të Popullit, Kuvendi i Kosovës nuk i ka marrë parasysh të gjitha kërkesat e Gjykatës Kushtetuese të dhëna me Aktgjykimin KO 190/19.

Avokati i Popullit konsideron se ruajtja e kriterit të stazhit kontributpagues prej 15 vjetësh vazhdon t'ua mohojë realizimin e së drejtës qytetarëve që kanë paguar kontribute, por që nuk e arrijnë kriterin prej 15 vjetësh. Në këtë mënyrë atyre u mohohet trajtimi i barabartë para ligjit, ashtu siç është përcaktuar edhe në Aktgjykimin KO 190/19.

Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin KO 190/19 u është referuar argumenteve të Avokatit të Popullit të dhëna në Raportin me Rekomandime *ex officio* 235/2018, për sa i përket kufizimit me kriterin prej 15 vjet stazh pune për të përfituar nga skema e pensionit kontributpagues. Avokati i Popullit, për sa i përket Ligjit të kontestuar, mban qëndrim të njëjtë duke vlerësuar se kufizimi me 15 vjet stazh pune, i përcaktuar me Ligjin e kontestuar, vazhdon të prodhojë shkelje të barazisë para ligjit.

Kufizimi me 15 vjet stazh pune, i vendosur me Ligjin e kontestuar, ka ndikim jo vetëm te pensionet kontributpaguese të moshës, por edhe në skemat e tjera të trashëguara sipas ligjit federativ, përkatësisht te pensionet familjare që trashëgohen nga familjarët e të punësuarit, i cili po ashtu duhet t'i ketë pasur 15 vjet stazh kontributpagues, në mënyrë që familjarët e tij/saj të përfitojnë nga kjo skemë pensionale (Ligji bazë, neni 12, paragrafi 2).

Avokati i Popullit konsideron se kufizimi me 15 vjet stazh pune, i përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, është bartur në Ligjin e kontestuar, e që në të vërtetë do të duhej të largohej plotësisht nga aktet normative. Vendosja e këtij kufizimi në Ligjin e kontestuar përbën praktikë diskriminuese dhe shkelje të barazisë para ligjit.

Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se kufizimi prej 15 vjetësh pagesë të kontributeve, si kusht për përfitim të pensionit kontributpagues, për një kategori të qytetarëve është mohim i së drejtës për pension kontributpagues të moshës dhe, përveçse përbën shkelje të barazisë para ligjit dhe diskriminim, cenon edhe dinjitetin e tyre, që sipas Kushtetutës duhet të jetë bazë e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut. Ky standard përcaktohet në Nenin 23 të Kushtetutës, ku theksohet: "*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*" (Raporti me rekomandime *ex officio* 235/2018).

Çfarë duhet të theksohet është fakti se autoritetet e Kosovës në vitin 2007 kishin marrë përsipër t'i kategorizonin pensionet sipas kohëzgjatjes së stazhit kontributpagues dhe kualifikimit, nëpërmjet Vendimit 13/2007 të Qeverisë dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2007, që kishin të bënin me stazhin kontributpagues në Fondin Pensional, të cilin nuk e posedonte dhe i cili akoma mbahet nga Republika e Serbisë. Pabarazia dhe shkelja e dinjitetit konsiston në faktin se të gjithë pensionistët të cilët kanë arritur të kontribuojnë në këtë fond për minimum 15 vjet, shteti i Kosovës ka marrë përsipër t'i kualifikojë si pensionistë kontributpagues, duke ruajtur kriteret e ligjit federativ. Ndërsa të tjerët, të cilët pa vullnetin e tyre nuk kanë arritur stazhin kontributpagues prej minimum 15 vjetësh në fondin i cili mbahet nga Republika e Serbisë, nuk kualifikohen si pensionistë kontributpagues nga shteti i Kosovës. Sipas një logjike, kjo mund të interpretohet në atë mënyrë që shteti i Kosovës ka marrë përsipër që vullnetarisht, madje akoma pa pasur një ligj të vetin në vitin 2007, t'ua paguante pensionet të gjithë atyre që kanë kontribuar në Fondin Pensional, të cilin nuk e ka dhe i cili mbahet nga Republika e Serbisë, ndërsa të tjerët që ishin dëbuar nga puna si pasojë e masave represive të shtetit

serb gjatë viteve 90-të, shteti i Kosovës, që nga viti 2007, fillimisht nëpërmes një vendimi të qeverisë, ndërsa në vitin 2014 edhe me ligj i ka përjashtuar nga skema pensionale duke mos ua njohur as edhe një ditë stazh pune.

Si përfundim, Avokati i Popullit konsideron se kufizimi i përcaktuar në nenin 4 të Ligjit të kontestuar shpie në shkelje kushtetuese, përkatësisht nuk e eviton dallimin në trajtim mes dy grupeve të qytetarëve të cilët janë në situata të ngjashme dhe/ose analoge përkitazi me fushëveprimin e kategorisë së pensioneve kontributpaguese dhe se ky dallim në trajtim vazhdon të jetë “i përcaktuar me ligj.”

Avokati i Popullit konsideron se Ligji i kontestuar nuk e bart frymën e Aktgjykimit nr. KO 190/19, për sa i përket parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë para ligjit.

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Statutit (QRK) nr. 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

Statuti (QRK) nr. 01/2023 i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në nenin 11, paragrafi 1, përcakton:

“1. Spitalet e përgjithshme si në nenin 9, paragrafi 1 i këtij Statuti, ofrojnë shërbimet shëndetësore si në vijim:

- 1.1. Kirurgji e përgjithshme;*
- 1.2. Interno;*
- 1.3. Pediatri;*
- 1.4. Gjinekologji dhe Obstetrikë;*
- 1.5. Emergjenca mjekësore.”*

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit nuk ka aspak rëndësi emërtimi për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar. Rëndësi ka vetëm që akti në fjalë: (1) është akt i përgjithshëm, që zbatohet për institucionet shtetërore në përgjithësi, jo vetëm për një person fizik ose juridik, dhe (2) është akt juridik që buron nga autoriteti i Qeverisë.

Avokati i Popullit thekson se akti i kontestuar është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 29/180, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2023. Më tej Avokati i Popullit konsideron se akti i kontestuar, për nga përmbajtja është akt normativ i karakterit të përgjithshëm dhe me efekt të përgjithshëm.

Gjykata Kushtetuese në rastin KO 73/16 e ka shpallur të pranueshme kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike e Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016. Gjykata Kushtetuese me këtë Aktgjykimin vlerësoi:

“Kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Kërkesa, prandaj, nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores, dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (Shih, për shembull, rasti i A dhe B kundër Norvegjisë [Ge], kërkesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykimi i 25 nëntorit 2016, paragrafi 55 dhe gjithashtu shih, mutatis mutandis, rastin nr. K1132/15 Manastiri i Deçanit, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).” (Paragrafi 49).

Lidhur me juridiksionin kohor, Avokati i Popullit konsideron se kërkesa në fjalë parashtrohet brenda juridiksionit kohor të kësaj gjykate: *“Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi*

2 të Kushtetutës do të parashtrohet [...] nga ana e Avokatit të Popullit [...] brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29, par. 1, dhe neni 30). Akti i kontestuar ka hyrë në fuqi më 5 janar 2024, përkatësisht në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 5 janar 2024 (*shih* aktin e kontestuar, nenin 33). Prandaj kërkesa e Avokatit të Popullit parashtrohet brenda afatit gjashtëmuor, i cili është përcaktuar nga Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Për më tepër, Avokati i Popullit duke konsultuar instrumentet ndërkombëtare, konsideron se Pakti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është ndër instrumentet kryesore ku flitet për të drejta socio-ekonomike. Mirëpo ky i fundit nuk është instrument i përfshirë në Nenin 22 të Kushtetutës. Për sa u përket *instrumenteve të tjera ndërkombëtare*, e posaçërisht Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), Avokati i Popullit thekson se kjo e fundit nuk përfshin “Të drejtën për shëndet”, megjithatë, në një numër të rasteve, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar një interpretim për një të drejtë të tillë duke u bazuar në *Të drejtën për jetë*, sipas nenit 2 KEDNj-së, *Ndalimi i torturës*, neni 3 i KEDNj-së, *Të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare*, sipas nenit 8 KEDNj-së, dhe të nenit 14 të KEDNj-së që ndalon diskriminimin. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh ndërlidhjen e shëndetit me të drejtat e lartpërmendura, Avokati konsideron se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese përbën një çështje të rëndësishme për të drejtat e njeriut.

Një iniciativë e tillë për të kontestuar aktin në Gjykatë Kushtetuese vjen edhe bazuar në ankesën e pranuar nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës dhe nga mjekët psikiatër të spitaleve të përgjithshme të Gjilanit, të Prizrenit, të Gjakovës dhe të Pejës, kundër aktit të kontestuar. Ankuesit pretendojnë se akti i kontestuar, në nenin 11, do të rezultojë me reduktimin e shërbimeve shëndetësore në spitalet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ankuesit gjithashtu pretendojnë se neni 11 i aktit të kontestuar, përveçse do të ketë reflektim te qytetarët që do të mbesin pa shërbime të caktuara shëndetësore, ai do të ketë reflektim edhe te stafi i punonjësve shëndetësorë dhe administrativë, sepse me reduktimin e atyre shërbimeve shëndetësore, shumë punëtorë shëndetësorë do mbesin pa punë.

Avokati i Popullit konsideron se heqja e disa llojeve të shërbimeve shëndetësore në spitalet e përgjithshme i vë në pozitë të pabarabartë qytetarët, në zonat e të cilëve ndodhen spitalet e përgjithshme. Me fjalë të tjera, qytetarëve të zonave ku ndodhen spitalet e përgjithshme u mohohet qasja në shërbimet shëndetësore, e që rrjedhimisht prodhon situatë të pabarazisë në kuptimin e shfrytëzimit dhe qasjes në shërbimet shëndetësore.

Rregullimi i llojeve të shërbimeve shëndetësore, që ofrohen në spitalet e përgjithshme, duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin për Shëndetësi, i cili në këtë kuptim është ligj bazik, dhe me Ligjin për Shëndetin Mendor, të cilat ligje bartin frymën e nenit 51 të Kushtetutës.

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit, përcaktimi i shërbimeve shëndetësore duhet të bëhet me ligj, ose në rastin tjetër, akti i cili përcakton shërbimet shëndetësore duhet ta bartë krejtësisht ngjashëm përcaktimin e ligjit. Në rastin konkret, akti i kontestuar është dashur ta bartte plotësisht frymën e nenit 19 të Ligjit për Shëndetësi dhe të nenit 12 të Ligjit për Shëndetin Mendor, në të kundërtën, përcaktimet e nenit 11 të aktit të kontestuar bien ndesh me nenin 51, paragrafi 1, të Kushtetutës.

Avokati i Popullit vlerëson se përcaktimet e nenit 11 të aktit të kontestuar nuk janë në pajtim me nenin 55, ndërlidhur me nenin 51, paragrafi 1, të Kushtetutës, sepse ndryshimet janë bërë me akt i cili nuk është ligj.

Kërkesë për Masë të Përkohshme

Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitës së kontestuar, përkatësisht nenin 11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës duke konsideruar se në këtë rast *prima facie* janë përmbushur kushtet sipas Rregullit 55, paragrafi 4, i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të rekomandohet masa e përkohshme:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësohen dëme të riparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.”

Këto tri kushte, për vlerësimin e Avokatit të Popullit, janë përmbushur në rastin konkret.

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12, të Ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore

Ligji nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës, që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i kontestuar), si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të Administratës Tatimore të Kosovës (më tej: ATK).

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës kërkon vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26 (paragrafi 1), nenit 79 (paragrafi 4), nenit 89 (paragrafët 1, 7, 8 9,10, 11 dhe 12), nenit 91 të Ligjit të kontestuar.

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga disa zyrtarë të ATK-së, të cilët kanë shfaqur pakënaqësinë e tyre karshi përcaktimeve në Ligjin e kontestuar, përkatësisht kanë pretenduar se me nenin 79, paragrafi 4, atyre po u cenohet e drejta e pronës, e garantuar me Kushtetutë. Po ashtu, ankuesit kanë pretenduar se përcaktimet në nenin 89 dhe në nenin 91 ua cenojnë atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Lidhur me këtë çështje, ankuesit kanë kërkuar nga Avokati i Popullit që ta referojë Ligjin e kontestuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

Po ashtu edhe përfaqësues të komunitetit të bizneseve në Republikën e Kosovës kanë paraqitur dilemat e tyre lidhur me disa dispozita të Ligjit të kontestuar. Dilemat janë ngritur rreth përmbajtjes së neneve 6, 9, 16 dhe 26, si dhe është diskutuar nëse nenet e theksuara janë në pajtim me Kushtetutën.

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, Ligji i kontestuar në përgjithësi konsiderohet progresiv, sepse e ka ngritur standardin normues në disa çështje, megjithatë Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme që për disa çështje t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për vlerësim nëse nenet e theksuara më sipër janë në pajtim me Kushtetutën.

Periodha kohore kur tatimpaguesi mund të kthehet prapa për korigjimin e një vetë deklarimi dhe të paraqesë një kërkesë për rimbursim/kreditim, me Ligjin e kontestuar është shkurtuar në 3 vjet, ndërsa me ligjin paraprak kjo periudhë ishte 6 vjet. Pra, tatimpaguesi mund të korigjojë një deklaratë që ka dorëzuar vetë vetëm për 3 vjet prapa nga data kur është e obligueshme për deklaratën tatimore (Neni 14) si dhe mund të kërkojë rimbursim/kreditim për

3 vjetët prapa nga data kur është paguar tatimi (Neni 26). Në anën tjetër, sipas nenit 16 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit ka vërejtur se ATK-së nuk i është ndryshuar afati kohor, brenda të cilit ka të drejtë të bëjë vlerësim tatimor. Edhe me ligjin paraparak, por edhe me Ligjin e kontestuar, afati kohor që ATK-ja të mund të bëjë vlerësimin tatimor është 6 vjet.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se shkurtimi i afatit karshi bizneseve tatimpaguese, ndërsa lënia e afatit të njëjtë për ATK-në, i vendos në pozicion të pabarabartë bizneset përballë ATK-së, e njëkohësisht i vendos në pozicion të pafavorshëm. Shkurtimi i afatit do t'ua pakësojë atyre bizneseve kohën brenda së cilës mund të korrigjojnë veprimet e tyre dhe njëkohësisht do t'ua vështirësojë atyre mundësinë e korrigjimit të gabimeve, për të cilat Ligji i kontestuar e ka lënë mundësinë e korrigjimit.

Avokati i Popullit, duke iu referuar praktikës së GjEDNj-së, vëren se në rastin *Dakir kundër Belgjikës*, § 65. GjEDNj-ja rithekson se një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese joproporcionale ndaj një grupi individësh mund të konsiderohet si diskriminuese edhe nëse nuk e synon në mënyrë specifike grupin dhe nuk ka qëllim diskriminues. Megjithatë ky është vetëm rasti nëse një politikë ose masë e tillë nuk ka justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm”, domethënë nëse nuk ndjek një “qëllim legjitim” ose nëse nuk ka një “marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti” ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që kërkohet të arrihet (shih po ashtu *S.A.S. kundër Francës*, § 161).

Me Ligjin e kontestuar është përjashtuar krejtësisht mundësia e inicimit të procedurave në KPMSHCK, nga punonjësit e ATK-së. Duke pasur parasysh përcaktimet e Ligjit për Zyrtarët Publikë (nenet 6 dhe 27) dhe të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (neni 2), Avokati i Popullit konsideron se përderisa punonjësit e ATK-së bëjnë pjesë në kategorinë e nëpunësve civilë me status të veçantë, ata u binden rregullave të përgjithshme për shërbimin civil.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se paragrafi 12 i nenit 89 të Ligjit të kontestuar, i cili i udhëzon palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave që t'i drejtohen gjykatës kompetente, ua mohon punonjësve të ATK-së të drejtën për mjete juridike, përkatësisht shfrytëzimin e mjeteve juridike për inicimin e procedurës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit konsideron se punonjësit e ATK-së trajtohen ndryshe nga punonjësit e institucioneve të tjera, pa pasur ndonjë arsye të dukshme apo një qëllim legjitim të dukshëm, e që rrjedhimisht përcaktime të tilla bien ndesh edhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Megjithatë në këtë rast Avokati i Popullit është fokusuar vetëm te neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës.

Dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk paraqesin qartë një qëllim legjitim, përmes të cilit do të arsyetohej veprimtaria e institucioneve financiare dhe noterëve në drejtim të dhënies së informatave të caktuara ATK-së. Si rezultat i kësaj paqartësie, Avokati i Popullit konsideron se veprimet e tilla mund të bien ndesh me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës.

Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret, me përcaktimin e nenit 9 [Mbledhja e informatave ose provave], paragrafët 5, 6 dhe 7, të Ligjit të kontestuar, në kuptim të ligjshmërisë dhe të qëllimit legjitim nuk vihet mjaftueshëm në dukje nëse kërkesa për transaksionet është proporcionale për qëllimin që synohet t'i shërbejë. Pra, kërkesa e ATK-së për qasje në transaksione ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, në parim duket se ka qëllim legjitim, por duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar për shmangie apo keqpërdorim për një kërkesë të tillë, dhe kjo mund të arsyetohet për raste të caktuara individuale, por jo të kërkohen transaksionet “përse”.

Duke pasur parasysh përcaktimet në dispozitat e theksuara më sipër të Ligjit të kontestuar, konsideron se obligimi i institucioneve financiare që t'i dorëzojnë në ATK informatat për

të gjitha transaksionet vendore dhe ndërkombëtare, e po ashtu obligimi i noterëve që t'i dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridikë, nga personat fizikë afaristë dhe nga personat fizikë jo afaristë, pa një qëllim legjitim të caktuar, bien në kundërshtim me nenin 36 [E Drejt e Privatësisë] të Kushtetutës.

Lidhur me këtë përcaktim në Ligjin e kontestuar (neni 79, paragrafi 4), Avokati i Popullit konsideron se as Qeveria e Republikës së Kosovës dhe as Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i kanë marrë parasysh gjetjet dhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, me të cilin është vlerësuar përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë. Në lidhje edhe me këtë çështje Avokati i Popullit konsideron se përcaktimet në paragrafin 4 të nenit 79 të Ligjit të kontestuar mund të mos jenë në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe e konsideron të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë këtë çështje, nëse dispozita e theksuar më sipër është në përputhshmëri me nenin 46, paragrafët 1 dhe 2.

Kërkesë për Masë të Përkohshme

Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara duke konsideruar se në këtë rast *prima facie* janë përmbushur kushtet sipas Rregullit 55, paragrafi 4, i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që të rekomandohet masa e përkohshme:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësohen dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.”

Këto tri kushte, për vlerësimin e Avokatit të Popullit, janë përmbushur në rastin konkret.

Së pari, Avokati i Popullit konsideron se argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin bazë më shumë se *prima facie* për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara, duke pasur parasysh faktin se te neni 26, paragrafi 3, pas kalimit të afatit 3-vjeçar, tatimpaguesit i humb mundësia dhe e drejta që të kërkojë rimbursimin për pagesat e tepërta, ndërsa lidhur me nenin 79, paragrafi 4, përveç argumenteve të paraqitura nga Avokati i Popullit, për çështje krejtësisht të ngjashme edhe Gjykata Kushtetuese ka vendosur me Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22.

Së dyti, në mungesën e miratimit të masës së përkohshme, mund të realizohen ndryshime sipas përcaktimeve të nenit 26, paragrafi 3, dhe të nenit 79, paragrafi 4, të Ligjit të kontestuar, përkatësisht mund të humbë e drejta e kërkesës për rimbursimin, për shkak të pagesave të tepërta (neni 26, paragrafi 3), si dhe mund të fillojnë procedurat e rekrutimit (neni 79, paragrafi 4), dhe si pasojë e atyre procedurave të shkaktohen pasoja të pariparueshme të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit konsideron se për Ligjin e kontestuar është interes publik që sundimi i ligjit të jetë funksional dhe efikas deri në nxjerrjen e një qëndrimi nga Gjykata Kushtetuese lidhur me dispozitat e kontestuara.

Kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 331 (paragrafët 2, 4, 5, 6 dhe 7) të Kodit nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave

Kodit nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave përcakton rregullat e përgjithshme dhe procedurave të zbatueshme për mallrat që hyjnë ose largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës. Ndër të tjerash, Kodi i kontestuar përcakton edhe dispozita përmes të cilave rregullohen çështjet e marrëdhënies së punës për të punësuarit në Doganë (Kapitulli VII i Kodit).

Çështjet të cilat Avokati i Popullit ngre para Gjykatës Kushtetuese, e të cilat kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e Kodit të kontestuar, janë si në vijim: nëse neni 331, paragrafët 2, 4, 5, 6 dhe 7, të Kodit të kontestuar është në përputhshme me nenin 7 [Vlerat], dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; dhe nëse i ka marrë parasysht gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit në rastet nr. KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa u përket emërimit dhe mandatit të pozitave drejtuese në Doganën e Kosovës.

Avokati i Popullit thekson se përmbajtja e nenit 331 të Kodit të kontestuar, për pozitat e punës Drejtorë të Drejtorive; Drejtorë të Departamenteve Qendrore; Drejtorë të Departamenteve Rajonale, në Doganën e Kosovës, sipas të cilit, pozitat e theksuara më sipër i zhvendos nga të punësuar me afat të pacaktuar në të punësuar me afat të caktuar, e cenon sigurinë juridike dhe pritshmërinë e ligjshme dhe të arsyeshme si dhe të drejtat dhe interesat e fituara tashmë, sipas parimit të “së drejtës së fituar”, për faktin se personave të emëruar në këto pozita me kontratë pune me periudhë të pacaktuar kohore ua cenon edhe pritjet legjitime dhe rrjedhimisht prek edhe të drejtën e tyre në pronë, të garantuar me Kushtetutë. Pra, të punësuarit në këto pozita, që nga rasti i krijimit të marrëdhënies së punës kanë pasur pritshmërinë e tyre se marrëdhënia e punës është në periudhë të pacaktuar.

Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (*shih rastet Kopecky v. Slovakia, aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, § 73, GjEDNj 2002-VII*), “pritshmëria legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e të punësuarve në pozita drejtuese, për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, bazohet në të drejtën e fituar nga dispozitat e Kodit Doganor të mëparshëm dhe legjislacionit në fuqi.

Lidhur me përcaktimin në Kodin e kontestuar (neni 79, paragrafi 4), Avokati i Popullit konsideron se as Qeveria e Republikës së Kosovës dhe as Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i kanë marrë parasysht gjetjet dhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, me të cilin është vlerësuar përputhshmëria me Kushtetutë e me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, për sa i përket mandatit të pozitave *drejtues i mesëm dhe drejtues i ulët*.

Gjykata Kushtetuese qartë ka theksuar se neni 46 [Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues] i Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë nuk vlen, ose thënë ndryshe, nuk i afekton të drejtat e zyrtarëve publikë, të drejta këto që janë fituar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas këtij përcaktimi vërehet se ky rregullim vlen vetëm për pozitat që krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (Ligji për Zyrarët Publikë), e që në rastin konkret, neni 331 i Kodit të kontestuar do duhej të vlente vetëm për pozitat që themelohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, por jo edhe për pozitat të cilat marrëdhënien e punës e kanë themeluar para hyrjes në fuqi të Kodit të kontestuar.

Avokati i Popullit vëren se neni 331 të Kodit të kontestuar është i ngjashëm me paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, paragraf ky i shfuqizuar me Aktgjykimin

KO 216/22 dhe KO 220/22 (e cila tashmë konsiderohet çështje e gjykuar nga Gjykata Kushtetuese), për shkak të konstatimit se paragrafi në fjalë nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [E Drejta e Pronës] të Kushtetutës.

Duke pasur parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, e po ashtu duke pasur parasysh përcaktimet e Kushtetutës në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 1, konsideron se Qeveria dhe Kuvendi është dashur t'i merrnin parasysh konstatimet Gjykatës Kushtetuese. Avokati i Popullit konsideron se përcaktimet në nenin 331 të Kodit të kontestuar mund të mos jenë në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe e konsideron të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë këtë çështje nëse dispozita e theksuar më sipër është në përputhshmëri me nenin 46, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës.

Kërkesë për Masë të Përkohshme

Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara duke vlerësuar se në këtë rast *prima facie* janë përmbushur kushtet sipas Rregullit 55, paragrafi 4, i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të rekomandohet masa e përkohshme:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësohen dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.”

Në këtë rast janë përmbushur të tria këto kushte dhe nisur nga kjo Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë nëse neni 331, paragrafët 2, 4, 5, 6 dhe 7, i Kodit të kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit në rastet nr. KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa u përket emërimit dhe mandatit të pozitave drejtuese në Doganën e Kosovës, si dhe nëse është në përputhshmëri me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 1, të Kushtetutës.

Komentet e Avokatit të Popullit lidhur me nenin 55 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e Kërkesës KO 96/24, të datës 3 maj 2024

Avokati i Popullit, më 3 maj 2024, pranoi nga Gjykata Kushtetuese njoftim për regjistrimin e Kërkesës KO 96/24. Përmes këtij njoftimi u është mundësuar palëve të interesuara që t'i jepnin komentet e tyre lidhur me nenin 55, të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, deri më 17 maj 2024.

Avokati i Popullit ka analizuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjin nr. 04/L-193 për Avokatinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatinë), përkatësisht nenin 55 të këtij ligji, si dhe kërkesën e Gjykatës Supreme drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Neni 55 [Apelimi në gjykatën kompetente] i Ligjit për Avokatinë përcakton: *“Kundër vendimit të shkallës së dytë përkatësisht përfundimtar, me të cilin është shqiptuar masa disiplinore – humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet, humbjes së të drejtës së ushtrimit të avokatisë prej pesë (5) vjet gjer në dhjetë (10) vjet apo të humbjes së përhershme të së drejtës për ushtrim të avokatisë apo shlyerje nga regjistri i*

praktikantëve prej gjashtë (6) muajsh gjer në tre (3) vjet, si dhe shlyerja e përhershme nga regjistri i praktikantëve, mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.”

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se përmbajtja e nenit 55 të Ligjit për Avokatinë ua pamundëson avokatëve që të përdorin mjetet juridike në çdo rast që ata pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur me vendimin përfundimtar sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se e drejta kushtetuese për përdorimin e mjeteve juridike nuk mund të kufizohet në formën sikurse është vendosur në nenin 55 të Ligjit për Avokatinë, sepse i vë palët në pamundësi të realizimit të së drejtës së garantuar me Kushtetutë për përdorimin e mjeteve juridike. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se kjo e drejtë duhet të jetë lehtë e qasshme dhe e realizueshme për avokatët, kur konsiderojnë se të drejtat e tyre janë cenuar me ndonjë vendim përfundimtar.

Avokati i Popullit nuk vëren të ketë ndonjë qëllim legjitim, të vendosur në nenin 55, të Ligjit për Avokatinë, sipas të cilit, avokatëve do të mund t'u kufizohet mundësia e inicimit të konfliktit administrativ, në rastet kur konsiderojnë se të drejtat e tyre janë cenuar me ndonjë akt përfundimtar, sipas përcaktimeve të Ligjit për Avokatinë.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen te KEDNj-ja, fryma e së cilës ia njuh të drejtën çdo personi që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se edhe fryma e nenit 55 të Ligjit për Avokatinë nuk duhet të përmbajë asnjë kufizim, sipas të cilit do t'u pamundësohet avokatëve që çështjet e tyre të shqyrtohen nga gjykata, kur ata konsiderojnë se të drejtat e tyre janë cenuar nga një vendim përfundimtar.

Avokati i Popullit, bazuar në të gjitha që u theksuan më sipër, vlerëson se përmbajtja aktuale e nenit 55 të Ligjit për Avokatinë nuk ua mundëson avokatëve që t'i shfrytëzojnë mjetet juridike, në çdo rast kur ata konsiderojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga një vendim përfundimtar, e rrjedhimisht ua mohon atyre të drejtën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Për këtë Avokati i Popullit e konsideron shumë të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse neni 55 i Ligjit për Avokatinë është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nëse është në pajtim me Nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 153/24 dhe KO 156/24, të datës 26 korrik 2024

Avokati i Popullit nga Gjykata Kushtetuese pranoi njoftimin për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave për rastet KO 153/24 dhe KO 156/24. Përmes këtij njoftimi u është mundësuar palëve të interesuara të jepnin komentet e tyre lidhur me Ligjin nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i ri për KPK-në), deri më 9 gusht 2024.

Avokati i Popullit vëren se në Ligjin e ri për KPK-në pragu i kuorumit në 5 nga 7 anëtarë, varet nga njëri nga anëtarët joprokurorë. Në situata të mospjesëmarrjes së vazhdueshme të anëtarëve jo prokurorë, kjo do të mund të rezultonte me bllokimin e punës së Këshillit, marrë parasysh përgjegjësinë e drejtpërdrejt dhe rolin e anëtarit jo prokurorë. Prandaj Avokati i

Popullit vlerëson se kjo do ta cenonte funksionimin në mënyrë të pavarur të KPK-së. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se mungesa e cilitdo anëtar të Këshillit, që rezulton me mungesën e kuorumit prej 5 anëtarësh, ndikon në cenimin e funksionimit në mënyrë të pavarur të Këshillit.

Kontrulli *check and balance* është i rëndësishëm, megjithatë KPK-ja është institucion i pavarur kushtetues dhe kuorumi me 5 nga 7 anëtarët e Këshillit i cenon garancitë kushtetuese të përcaktuara në nenin 110 të Kushtetutës. Për më tepër, përcaktimi i kuorumit për vendimet për çështje disiplinore, në rastet e mospjesëmarrjes së vazhdueshme të anëtarit në takimet e Këshillit, me më së paku 4 anëtarë dhe që vendimet të merren me votat e katër (4) anëtarëve, përveç cenimit të pavarësisë së KPK-së, mund të shkaktojë edhe bllokimin e proceseve në sistemin prokurorial. Në kuptim të cenimit të pavarësisë së Këshillit, Avokati i Popullit vëren se duke pasur parasysh garancinë kushtetuese që KPK-ja është plotësisht e pavarur në kryerjen e funksioneve të saj, konsideron se kuorumi për vendime disiplinore (me më së paku 4 anëtarë dhe që vendimet të merren me votat e katër (4) anëtarëve) mund të rezultojë me bllokimin e proceseve dhe të shkaktojë mosfunksionimin e KPK-së.

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit duke iu referuar tekstit të aktit të kontestuar, përkatësisht teksti: “[...] *kuorumi i Këshillit, në këto raste dhe rastet tjera në vijim të mos pjesëmarrjes së vazhdueshme të disa anëtarëve të Këshillit [...]*”, në vete sjell paqartësi të normës. Formulimi në këtë mënyrë e bën normën e paqartë, sepse ngre dyshimet se cilët anëtarë të Këshillit i nënshtrohen një rregulle të tillë. Parimisht norma duhet të vlejë për secilin anëtar të Këshillit, pa dallim, mirëpo formulimi “*të disa anëtarëve të Këshillit*”, mund të rezultojë me paqartësi dhe me probleme në zbatimin praktik të normës së theksuar më sipër.

Edhe Komisioni i Venedikut në mendimin e dhënë në mars 2022, ka konsideruar se ekziston rreziku që një formë e tillë e votimit të rezultojë me bllokime (paragrafi 15 i Opinioneve të Komisionit të Venedikut për Draft-Amendamentet e rishikuara për Ligjin për KPK-në, 23 mars 2022). Më tej Komisioni i Venedikut ka këshilluar që për raste të tilla të gjendet një alternativë kundër bllokimit, në mënyrë që kjo çështje të mos e bllokojë funksionimin e KPK-së.

Avokati i Popullit konsideron se në rastet e theksuara më sipër ekziston rreziku real që vendosja e tillë e normës të prodhojë joefikasitet të Këshillit në kuorumin e përgjithshëm, të vendosur në nenin 13, e po ashtu kuorumin për çështjet disiplinore të përcaktuara në nenin 16.

Komente të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 152/24 dhe KO 158/24, të datës 29 korrik 2024

Avokati i Popullit pranoi nga Gjykata Kushtetuese njoftimin për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KO 152/24 dhe KO 158/24. Përmes këtij njoftimi u është mundësuar palëve të interesuara që t'i jepnin komentet e tyre lidhur me Ligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i kontestuar).

Avokati i Popullit vlerëson se çështja e lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes janë ngushtë të lidhura ndërmjet tyre, dhe duke pasur parasysh këtë fakt konsideron se është shumë e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese t'i vlerësojë çështjet kontestuese të ngritura në rastet KO 152/24 dhe KO 158/24, lidhur me ligjin e theksuar më sipër.

Ligji i kontestuar është analizuar në frymën e respektimit të lirisë së mediave sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe lirisë së shprehjes sipas nenit 40 të Kushtetutës, si dhe në frymën e Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit nuk e konteston kompetencën e Kuvendit për shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të KPM-së, sepse ashtu siç edhe e ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese në disa nga rastet e saj, Kuvendi ka kompetencë mbikëqyrëse ndaj institucioneve publike, megjithatë në rastin konkret duhet pasur kujdes te procedurat e shkarkimit përkatësisht te shumica e cila kërkohet nga Kuvendi për shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të KPM-së, si dhe te rrethanat për të cilat mund të kërkohet shkarkimi i kryetarit apo anëtarit të KPM-së.

Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Kushtetuese në rastin KO134/21, paragrafi 114, *inter alia*, ka përcaktuar: “[...]Jushtrimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit është i rëndësishëm të posaçme veçanërisht në fushën e lirisë së medias marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e saj në një shoqëri demokratike. [...]Praktika gjyqësore e GJEDNj-së përcakton jo vetëm detyrimin e shtetit për të mos ndërhyre në vlerat e lirisë dhe pluralizmit të mediave dhe në lirinë e shprehjes, por edhe detyrimet pozitive të shtetit [...]”

Në këtë linjë, Avokati i Popullit, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara për lirinë e medieve, përmes së cilave garantohet liria dhe pluralizmi i medieve, dhe lirinë e shprehjes si liri që përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush, në lidhshmëri me KPM-në si institucion i pavarur kushtetues që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj, vlerëson se është i nevojshëm vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me pajtueshmërinë e nenit 18 të ligjit të kontestuar, që ka të bëjë me çështjen e procedurës së shkarkimit dhe rrethanave për të cilat shkarkohet kryetari apo anëtari i KPM-së.

Avokati i Popullit konsideron se mundësia e shkarkimit të kryetarit apo e anëtarit të KPM-së me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, në dukje shpërfaq mundësi shumë më të lehtë të ndikimit politik te kryetari apo anëtari i KPM-së. Prandaj në rastin konkret, Avokati i Popullit thekson se shkarkimi i tyre me shumicë të thjeshtë mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e pavarur të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Vendosja e mënyrës së shkarkimit të kryetarit apo anëtarit të KPM-së, me një shumicë më të lartë sesa shumica e thjeshtë, do të sillte siguri më të madhe te kryetari apo anëtari i KPM-së, në ushtrimin e funksioneve të tyre. Megjithatë, shkarkimi me 2/3 e të gjithë deputetëve nuk duhet të shihet si garanci, përmes së cilës kryetari apo anëtari i KPM-së mund të abuzojë me detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat janë të ngarkuara.

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit, shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së me shumicë prej 2/3 është zgjidhje më e sigurt për funksionimin e pavarur të KPM-së.

Sa i përket çështjes së rrethanave për të cilat mund të kërkohet shkarkimi i anëtarit të KPM-së, është: “*Paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t’i përmbushë detyrat e Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së.*” Avokati i Popullit vlerëson se mospërcaktimi i rrethanave për të cilat mund të shkarkohet kryetari i KPM-së, ndërsa përcaktimi i rrethanave shprehimisht, me të cilat mund të kërkohet shkarkimi i anëtarit të KPM-së, i trajton në mënyrë të pabarabartë të kryetarin dhe anëtarët e KPM-së, e që rrjedhimisht mund të bien ndesh me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Mospërcaktimi i rrethanave të tjera, përmes të cilave mund të kërkohet shkarkimi i kryetarit të KPM-së, në praktikë mund të rezultojë me mundësinë e abuzimit me detyrën e kryetarit, sepse me ligjin e kontestuar, përveç nënparagrafit 3.1 (paaftësisë profesionale), ligji i kontestuar nuk ka paraparë rrethanë tjetër përmes të cilës mund të shkarkohet kryetari i KPM-së. Në raste të tilla Avokati i Popullit konsideron se duhet të ekzistojë përcaktueshmëria e normës për secilin institucion të pavarur, përmes të cilës mund të kërkohet shkarkimi i udhëheqësve apo i anëtarëve, sepse përcaktimet e tilla e rrisin përgjegjësinë e udhëheqësve dhe të anëtarëve të institucioneve të pavarura kushtetuese në kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Vendosja e paragrafit 3, nënparagrafit 3.1, sipas të cilëve mund të kërkohet shkarkimi i anëtarit të KPM-së, për shkak të paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbushë detyrat e kryetarit dhe të anëtarit të KPM-së, në praktikë sjell paqartësi dhe pasaktësi. Avokati i Popullit duke iu referuar paragrafit 3 të nenit 18, ka vënë re se në paragrafin 3 shprehimisht theksohet se shkarkimi i anëtarit të KPM-së bëhet si rezultat i këtyre rrethanave, ndërsa në paragrafin 3.1 theksohet se në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi dështon t'i përmbushë detyrat e kryetarit dhe të anëtarit të KPM-së. Sipas këtij formulimi, bëhet i pakuptueshëm se a vlen paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, edhe për kryetarin e KPM-së, apo vetëm për anëtarin, sipas emërimit në paragrafin 3.

Pasiguria juridike e anëtarëve të KPM-së rezulton edhe në faktin se norma nuk e ka sqaruar se cili institucion apo organ e vlerëson paaftësinë profesionale në të cilën dështojnë ta kryejnë anëtarët e KPM-së. Duke pasur parasysh faktin se kërkesë për shkarkim bën komisioni parlamentar, është e rrezikshme që vlerësimi i paaftësisë profesionale t'i lihet në diskrecion komisionit parlamentar, sepse një normë e tillë do të rriste rrezikun e ndikimit politik në funksionimin e pavarur të KPM-së.

Avokati i Popullit konsideron se lënia në diskrecion të komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e punës së KPM-së, përkatësisht (i) vlerësimin të paaftësisë profesionale, dështimit të realizimit të detyrave për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muaj, pa aprovim nga KPM-ja, (ii) marrje pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërës prej grupeve shoqërore që me këtë ligj, KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje apo (iii) humbje e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM, i vë kryetarin dhe anëtarët e KPM-së në një situatë të pasigurisë juridike, sepse përcaktimet e përgjithshme ligjore nuk e qartësojnë se në cilat raste mund të konsiderohet përmbushja e ndonjëres nga rrethanat e listuara më sipër, përkatësisht të listuara në nenin 18, paragrafi 3. Për më tepër, të njëjtat bien ndesh me parimin e pavarësisë dhe mosndërhyrjes në vendimmarrje të KPM-së, që është një ndër parakushtet për institucionet e tilla të parashikuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.

Duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, Avokati i Popullit e konsideron shumë të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse neni 18, paragrafët 2 dhe 3, janë në pajtim me nenin 7 [Vlerat], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

**Raportet e
hartuara përgjatë
vitit 2024 që
ndërlidhen me të
drejta kushtetuese**

Raportet e hartuara përgjatë vitit 2024 që ndërlidhen me të drejta kushtetuese

Dinjiteti i Njeriut dhe Barazia para Ligjit

Zbatimi e masave të veçanta të parapara me nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore, nga organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, në të gjitha nivelet, si dhe nga institucionet e tjera publike në Kosovë

Në cilësinë e organit të barazisë, Avokati i Popullit, nëpërmjet këtij raporti ka për qëllim të pasqyrojë gjendjen për sa i përket përfaqësimit gjinor në institucionet e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në pozita të larta drejtuese dhe vendimmarrëse, si dhe të vlerësojë zbatimin e nenit 6 [Masat e veçanta] të Ligjit për Barazi Gjinore, nga institucionet e Republikës së Kosovës, në kontekst të detyrimeve lidhur me ndërmarrjen e masave të veçanta, me qëllim të adresimit të pabarazisë mes burrave dhe grave.

Me qëllim të vlerësimit të përpjekjeve për arritje të barazisë gjinore, në kontekst të përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në kuadër të institucioneve publike, Avokati i Popullit ua ka përcjellë një pyetësor të gjitha autoriteteve publike – pjesë e pushtetit legjislativ, atij ekzekutiv, si dhe gjyqësor, ndërsa mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave të pasqyruara në këtë raport janë bërë me përkrahjen e Programit të USAID-it “Drejtësia Komerciale”.

Synimi i pyetësorit të shpërndarë tek institucionet është që të mësohet gjendja faktike për sa i përket përfaqësimit gjinor në nivele të ndryshme të hierarkisë institucionale, si dhe ndërmarrjes së masave të veçanta me qëllim të përsheptimit të përfaqësimit të barabartë mes burrave dhe grave në institucionet e Republikës së Kosovës.

Pyetësorit i janë përgjigjur vetëm 50 autoritete publike, përfshirë këtu institucionet në nivel qendror dhe ato lokal. Vlen të theksohet se shifrat e raportuara për nivelin e mesëm drejtues, për qëllim të këtij raporti, përfshijnë edhe shifrat e raportuara për nivelin e ulët drejtues. Ndërkaq shifrat e raportuara për stafin mbështetës përfshijë si atë profesional, ashtu edhe atë administrativ.

Ligji për Barazi Gjinore përbën një nga ligjet në kuadër të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, i cili bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit si dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë miratuar në vitin 2015. Hyrja në fuqi e këtyre tri ligjeve njëherësh ka rezultuar në avancimin e kornizës ligjore për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës. Fillimisht, duke ofruar garanci më të mëdha ligjore për qytetarët dhe subjektet e tjera, në kontekst të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të tyre, por njëherësh duke ua mundësuar edhe institucioneve një fushëveprim më të gjerë, në kuadër të përpjekjeve të tyre për të luftuar diskriminimin gjinor dhe për rrjedhojë arritjen e një barazie faktike mes burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës.

Ligji për Barazi Gjinore kërkon saktësisht: “(...) institucionet e tjera publike janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.” duke theksuar se: “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”

Sipas të dhënave dhe shifrave të mbledhura dhe të analizuar për qëllime të këtij raporti, nëse të njëjtat merren si mostër për të pasqyruar trendin e përgjithshëm të (pa)barazisë gjinore në kuadër të institucioneve të të gjitha niveleve dhe pushteteve në Republikën e Kosovës, statistikat tregojnë për një përfaqësim më të ulët të grave sesa të burrave. Të ndara në tre nivele kryesore të hierarkive institucionale – niveli i lartë drejtues, niveli i mesëm drejtues, si dhe stafi mbështetës, shifrat tregojnë për një përfaqësim të pabarabartë gjinor.

Mesatarisht, pozicionet e larta drejtuese vazhdojnë të jenë dukshëm më të përfaqësuara nga burrat me 77.1%, dhe me vetëm 22.9% nga gratë. Ndërkaq në dy nivelet e tjera, në bazë të të dhënave, gratë përbëjnë rreth 31% të tyre, dhe burrat rreth 69%. Për rrjedhojë, mund të konstatohet se administrata shtetërore është më e dominuar nga gjinia mashkullore, e aq më shumë në pozicione të larta vendimmarrëse. Sipas analizës së të dhënave të pranuar, vihet re se edhe nga radhët e pakicave etnike, gratë janë të nënpërfaqësuara në raport me burrat.

Përgjigjet më të shpeshta të hasura gjatë analizimit të përgjigjeve të institucioneve, në pyetjen për ndërmarrjen e masave të veçanta, ishin përgjigjet si: “*Procedurat e zgjedhjes së rekrutimit të stafit e bëhen bazuar në shpalljet publike, bazuar në procedurat ligjore në fuqi, ku të drejtë konkurrimi kanë të gjithë pa dallime me të drejta të barabarta.*” Kjo ndonëse konfirmon se institucionet janë në zbatim të detyrimeve të tyre ligjore relevante për procedurat e rekrutimit, e njëjta njëkohësisht konfirmon mungesën e njohurive në raport me konceptin e trajtimit të ndryshëm të përligjur.

Për rrjedhojë, koncepti i trajtimit të ndryshëm të përligjur, si koncept ligjor, por edhe kushtetues, si dhe masat e veçanta, të njohura ndryshe edhe si *veprime afirmative*, duken të jenë kryesisht të panjohura për shumicën e institucioneve. Ndërkohë që ato vazhdojnë të mos kuptohen drejt, të njëjtat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara. Për rrjedhojë, situata të tilla ndikojnë në thellimin e perceptimit se Republika e Kosovës ka një kornizë të avancuar ligjore, por e cila nuk arrin të jetësohet në praktikë.

Ligji për Barazi Gjinore ndërkaq gëzon statusin e *lex specialis* dhe si i tillë duhet të trajtohet për çështje të barazisë gjinore, duke pasur prioritet në zbatim në raport me legjislacionin e përgjithshëm që rregullon procedurat e rekrutimit në kuadër të institucioneve shtetërore.

Institucionet apo organet në të gjitha nivelet, të cilat hartojnë dhe miratojnë politika publike, janë të obliguara të transpozojnë dhe reflektojnë parimet e Ligjit për Barazi Gjinore, në kuadër të iniciativave të reja ligjore, apo edhe në kuadër të akteve nënligjore, duke realizuar kështu adresimin e pabarazive gjinore në fushat përkatëse.

Nëpërmjet këtij raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit që të harmonizojë Rregulloren e Punës dhe Procedurat e Përzgjedhjes në Pozitat të Larta Drejtuese në kuadër të Institucioneve të Pavarura dhe Agjencive të Pavarura, me Ligjin për Barazi Gjinore, si dhe të sigurojë vendosjen e një procedure standarde për Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, që të shqyrtojë integrimin e perspektivës gjinore në iniciativat ligjore të dorëzuara në Kuvend.

Qeverisë së Republikës së Kosovës i rekomandoi që: të sigurojë që legjislacioni relevant për nëpunësit e administratës shtetërore është në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore; të adresojë mospërputhjen gjinore në pozita të larta drejtuese përmes nxjerrjes së masave të veçanta deri në arritjen e një përfaqësimi të barabartë të burrave dhe grave në pozita vendimmarrëse; të hartojë një qarkore për ministritë dhe institucionet e tjera vartëse, në lidhje me adresimin e pabarazisë gjinore në nivele të ndryshme brenda organeve të brendshme dhe atyre vartëse, përmes ndërmarrjes së masave të veçanta; të sigurojë raportimin e masave të veçanta të ndërmarra nga institucionet e Qeverisë qendrore dhe asaj lokale, tek Agjencia për Barazi Gjinore.

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal i rekomandoi që të hartojë një qarkore për nivelin

lokal, në lidhje me adresimin e pabarazisë gjinore në nivele të ndryshme brenda organeve përkatëse lokale, përmes ndërmarrjes së masave të veçanta.

Agjencisë për Barazi Gjinore i rekomandoi që të udhëzojë zyrtarët për barazi gjinore, në nivel qendror dhe lokal, që të organizojnë sesione informuese/trajnime për institucionet përkatëse, në lidhje me detyrimet e institucioneve që burojnë nga Ligji për Barazi Gjinore, përfshirë masat e veçanta.

Këshillit Gjyqësor i rekomandoi që: të sigurojë përfshirjen e garancive juridike për përfaqësimin e barabartë gjinor në kuadër të kornizës së brendshme rregullative, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore; të sigurojë rekrutimin apo caktimin e një zyrtari/eje për çështje të barazisë gjinore; të sigurojë që të gjitha të dhënat të cilat mblidhen, raportohen dhe analizohen nga ana e të gjitha gjykatave, të jenë të ndara sipas gjinisë, përfshirë Gjykatën Komerciale.

Këshillit Prokurorial i rekomandoi që: të sigurojë zbatimin e garancive juridike për përfaqësimin e barabartë gjinor në kuadër të kornizës së brendshme rregullative, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore; të sigurojë rekrutimin/caktimin e një zyrtari/eje për çështje të barazisë gjinore.

Respektimi i të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat për realizimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj

Raporti është hartuar mbi bazën e hetimit të iniciuar sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në informatat që Avokati i Popullit ka pranuar në vazhdimësi përkritazi me sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë, në procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale, si dhe pengesat për realizimin e beneficioneve që i takojnë kësaj kategorie mbi bazën e ligjit, ka iniciuar hetimet sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Raporti ka për qëllim të analizojë bazën ligjore që rregullon procedurat që duhet të ndiqen në procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe të adresojë tek organet përgjegjëse dhe kompetente nevojën e ndërmarrjes së veprimeve me qëllim të përmirësimit dhe të rregullimit më të hollësishëm të procedurës dhe organizimit më të mirë të procesit të verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore të personave në procedurë. Raporti po ashtu ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve me qëllim që viktimave të cilave u është njohur statusi t'u mundësohet gëzimi i beneficioneve të përcaktuara me ligj, në mënyrë të barabartë me kategoritë e tjera të parapara në ligj dhe pa pengesa procedurale.

Raporti fokusohet në disa pika kyçe, të cilat, për vlerësimin e Avokatit të Popullit, kërkojnë vëmendje të shtuar të autoriteteve.

Afatet kohore të aplikueshme në procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës

Ndonëse Rregullorja 22/2015 përcakton procedurat që duhen ndjekur nga palët dhe Komisioni në procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës, e njëjta rregullore nuk përcakton afatin kohor brenda të cilit Komisioni duhet të nxjerrë vendimin për njohje apo refuzim të statusit të viktimës së dhunës seksuale.

Avokati i Popullit vlerëson se Rregullorja nr. 22/2015 ka zbrazëtur ligjore rreth afatit kohor për nxjerrjen e vendimit të Komisionit për njohjen apo refuzimin e statusit. Mossaktësimi i afatit të mundësinë e pasigurisë juridike për palët në procedurë për orientimin në afate të zhvillimit dhe përfundimit të procedurës administrative dhe mundësisë për shfrytëzimin e mjeteve

juridike, meqenëse në disa raste rregullorja cakton afatet dhe në disa raste të tjera Komisioni i referohet LPPA-së. Përveç kësaj vlen të theksohet se dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ligj ky i hyrë në fuqi në vitin 2016, përcaktojnë afatin prej 45 ditësh për përfundimin e procedurës administrative (me mundësi të vazhdimit për rrethanat e potencuara si më lart). Ndërkaq Udhëzuesi për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, i vitit 2018, përcakton afatin 30-ditor për vendimmarrjen e Komisionit.

Mjetet juridike në dispozicion të palëve gjatë zhvillimit të procedurës

Rregullorja nr. 22/2015, në nenin 30, paragrafi 3, parasheh mundësinë e rishqyrtimit të kërkesës pas përfundimit të procedurës me vendim për refuzim të njohjes së statusit, duke përcaktuar si në vijim: “Në refuzim pala duhet të udhëzohet për mundësinë e rishqyrtimit të kërkesës dhe ka të drejtë 15 ditë ankesë në vendimin e marrë.”

Sipas Avokatit të Popullit, neni 30, paragrafi 3, i Rregullores mund të krijojë konfuzion në aspektin e terminologjisë juridike të përdorur lidhur me mjetin juridik në dispozicion të palëve, ngase në njërin anë parasheh rishqyrtimin e kërkesës, ndërsa në anën tjetër potencon afatin 15-ditor për mundësinë e paraqitjes së ankesës.

Avokati i Popullit vëren se neni 31 i Rregullores nr. 22/2015 përcakton se rishqyrtimi i kërkesës së aplikuesve bëhet nga Komisioni, mirëpo nuk e qartëson përbërjen e Komisionit për të vepruar si shkallë e parë dhe si shkallë e dytë, pra nuk e përcakton se Komisioni në rastin e rishqyrtimit të kërkesës a vepron në përbërje të njëjtë sikurse ka vepruar dhe vendosur në procesin e vendimmarrjes paraprake, apo vepron ndryshe.

Gjatë analizës së çështjes është gjetur se Rregullorja 22/2015 po ashtu nuk përcakton një afat kohor për nxjerrjen e aktit administrativ që zgjidh ankesën apo kërkesën për rishqyrtim. Prandaj është më se e nevojshme që Rregullorja 22/2015 t'i konkretizojë dhe t'i qartësojë mjetet juridike në dispozicion të palëve dhe afatin kohor të shfrytëzimit të tyre. Situata në të cilën në disa raste afatet janë të përcaktuara në këtë rregullore dhe në disa jo mund të krijojë paqartësi për palën në procedurë, së cilës këto akte do t'i referohen, përkatësisht dispozitave të Rregullores 22/2015 apo dispozitave të Ligjit 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Përkitazi me mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike, inicimit të procedurës gjyqësore ndaj vendimit të Komisionit në procedurë të rishqyrtimit, neni 31, paragrafi 3, i Rregullores 22/2015 parasheh: “Kundër Vendimit të Komisionit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën kompetente.” Në këtë drejtim Avokati i Popullit gjen se terminologjia e përdorur lidhur me mjetin juridik nuk është e saktë, duke marrë parasysh se në vend të termit *padë* është përdorur termi *ankesë*. Është fakt notor që fillimi i konfliktit administrativ në gjykatë bëhet përmes paraqitjes së padisë.

Avokati i Popullit gjen se Rregullorja nuk përcakton afat kohor për paraqitjen e padisë në gjykatë, pas vendimit të Komisionit në procedurë të rishqyrtimit, ndonëse një afat i tillë është i përcaktuar me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Struktura e vendimeve të Komisionit në procesin e njohjes apo refuzimit të statusit

Çështje tjetër me rëndësi, sipas Avokatit të Popullit, është edhe mungesa e arsytimeve të individualizuara të vendimeve të Komisionit, me fakte dhe prova të shtjelluara, që kanë ndikuar në marrjen e vendimit kur refuzohet njohja e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës. Sipas informatave që i kemi siguruar nga palët, mungesa e shtjellimit të fakteve dhe provave që kanë determinuar marrjen e vendimit refuzues, arsytimet e mangëta dhe të pakuptueshme krijojnë situata paqartësie për palët se për cilat arsye konkrete është refuzuar njohja e statusit të tyre.

Edhe pse Komisioni në përgjigjen e ofruar për këtë pikë ka theksuar se fokusi i Komisionit është i orientuar në përfshirjen e elementeve të detyrueshme të aktit administrativ, duke mosekspozuar detaje rreth rastit dhe fakteve, me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale, Avokati i Popullit vlerëson se gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës është më se e nevojshme ruajtja e konfidencialitetit dhe e identitetit të palëve në procedurë, megjithatë vendimi përmes të cilit refuzohet njohja e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës, përtej kërkesës që duhet të përmbajë elementet e detyrueshme të një akti administrativ, Komisioni po ashtu duhet që secilën pjesë të vendimit ta përpunojë ashtu siç përcakton ligji dhe pala duhet të jetë e njoftuar për *shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e saj dhe shkaqet që kanë rezultuar në marrjen e vendimit refuzues*. Pra, me qëllim që palës në procedurë të mos i kufizohet mundësia që ta shfrytëzojë mjetin juridik në mënyrë efektive, është e nevojshme që të informohet se cilat fakte dhe prova konkrete nuk kanë arritur ta krijojnë bindjen dhe besimin e Komisionit për njohjen e statusit të viktimës.

Në ndërlidhje të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të të dhënave të palëve në procedurë, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje se sipas Rregullores nr. 22/2015, përkatësisht nenit 22, përcaktohet se të gjithë të autorizuarit që kanë qasje në dokumentacion dhe në informata rreth procedurës kanë për obligim ta ruajnë sekretin zyrtar, andaj kjo lë për të nënkuptuar se cilado informatë që paraqitet në vendim apo në shkresa të lëndës, po ashtu edhe po që se vendimi përmban arsyetimin e individualizuar rreth çështjes, ajo ngërthen në vete obligimin për ruajtjen e konfidencialitetit për të gjitha palët dhe zyrtarët e përfshirë në proces dhe që kanë qasje në dokumentacion.

Procesi i intervistimit të palëve

Gjatë trajtimit të këtij rasti Avokati i Popullit po ashtu ka pranuar ankesë edhe lidhur me mënyrën e realizimit të procesit të intervistimit, përkatësisht për mundësinë e takimit të të mbijetuarave/ve me njëra/i tjetrën/in gjatë pritjes për intervistim. Po ashtu shqetësime janë ngritur edhe rreth mënyrës së qasjes dhe mënyrës së parashtrimit të pyetjeve në procesin e intervistimit dhe përshtatshmërisë së pyetjeve të parashtruara nga Komisioni drejtuar të mbijetuarave/ve.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në përcaktimet e Rezolutës nr. 60/147 mbi Parimet dhe Udhëzimet Themelore mbi të Drejtën për një Mjet Juridik dhe Dëmshpërblim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 2005. Rezoluta, në Kapitullin VI, pika 10, përcakton: *“Viktimat duhet të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e tyre dhe të drejtat e njeriut dhe duhet të merren masat e duhura për të garantuar sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe privatësinë e tyre, si dhe të familjeve të tyre. Shteti duhet të sigurojë që ligjet në fuqi, për aq sa është e mundur, të sigurojë që një viktimë që ka pësuar dhunë ose traumë duhet të përfitojë vëmendje dhe kujdes të veçantë për të shmangur ri-traumatizimin e tij/saj gjatë rrjedhës së procedurave ligjore dhe administrative të krijuar për të ofruar drejtësi dhe dëmshpërblim.”*

Avokati i Popullit përmes këtij raporti sjell në vëmendje të Komisionit nevojën e adresimit të shqetësimeve të ngritura nga shoqëria civile dhe nga organizatat joqeveritare të autorizuara në këtë proces, lidhur me realizimin e intervistimit të palëve, mënyrën e parashtrimit të pyetjeve dhe kontekstin e pyetjeve të parashtruara, në kontribut të ruajtjes së komunikimit zyrtar të ndërsjellë dhe me qëllim të ruajtjes së qasjes së ndjeshme ndaj viktimave të ndjeshme dhe respektimit të dinjitetit të të mbijetuarave/ve që janë palë në procedurë.

Në kuptim të mbrojtjes së jetës private dhe identitetit të të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës, Avokati i Popullit sjell në vëmendje nevojën për ndërmarrjen e masave

adekuate me qëllim të parandalimit të zbulimit të identitetit të tyre në procesin e ardhjes për intervistim, duke qenë se në objektin ku Komisioni vepron dhe realizon intervistat janë të vendosura edhe departamente të tjera që trajtojnë çështje pensionale, sociale dhe të tjera. Në një situatë të tillë, duke qenë se edhe nga katër organizatat joqeveritare të licencuara nga Qeveria është konfirmuar se palët përdorin të njëjtën hyrje në ndërtesë dhe ka pasur raste kur edhe kanë mundur të takoheshin me familjarë që nuk kanë qenë në dijeni rreth procesit dhe statusit të tyre, mund të shpie në një situatë ku vihet në rrezik zbulimi i identitetit të tyre apo identifikimi i tyre nga publiku i gjerë. Prandaj, në këtë drejtim Avokati i Popullit konsideron se duhet të gjenden mundësitë dhe modalitetet e nevojshme për organizimin e procesit të intervistimit dhe qasjes në objekt ku realizohet intervistimi i palëve, që me rastin e ardhjes për intervistim dhe realizim të intervistimit, palëve t'u sigurohet mbrojtja nga identifikimi dhe privatësia e palëve në procedurë nga publiku i gjerë.

Qasja fizike në ambientet ku vepron Komisioni

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është evidentuar se objekti ku gjenden zyrat e Komisionit dhe ku realizohet edhe intervistimi i palëve, nuk ofron qasje fizike dhe infrastrukturore të përshtatshme në objekt për personat me aftësi të kufizuara apo për personat e shtyrë në moshë, të cilët mund të jenë palë në procedurën e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës. Prandaj Avokati i Popullit ka kërkuar informata nga Komisioni nëse çështja e mungesës për qasje të personave me aftësi të kufizuara, në objektin ku ushtron punën Komisioni, është ngritur ndonjëherë si shqetësim me nevojë për adresim. Për më tepër, lidhur me këtë fakt Komisioni ka potencuar se objekti ku qëndron Komisioni është nën menaxhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili i është ofruar si hapësirë e shfrytëzueshme për Komisionin dhe më tutje Komisioni nuk ka kompetencë për menaxhimin e ndërtesave publike.

Megjithatë, në cilindo rast konkret kur paraqitet nevoja për intervistimin e ndonjërës palë në procedurë, që mund të ketë aftësi të kufizuara apo gjendje shëndetësore të përkeqësuar të momentit, për shkak të moshës së shtyrë apo edhe si pasojë e dhunimit, do t'ia pamundësojë realizimin e së drejtës për deklaram apo dëgjim në procedurën administrative, ashtu siç është përcaktuar në nenin 95 të LPPA-së, ku thuhet: "*Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar.*"

Realizimi i obliguar i elementeve qasëse në ndërtesat publike është i detyrueshëm sipas nenit 44 të Udhëzimit Administrativ 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuara, përkatësisht pika 4 - Ndërtimet për qëllime administrative dhe të ngjashme, dhe pika 5 - Ndërtimet për qëllime sociale, shëndetësore dhe rehabilituese.

Ndonëse Avokati i Popullit edhe më parë nëpërmjet raporteve të tjera ka konstatuar se ndërtesa në fjalë është e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara dhe ka adresuar rekomandimet relevante në institucionet përgjegjëse, duke marrë parasysh se institucionet kompetente nuk kanë ndërmarrë veprime për të vepruar në përputhje me rekomandimet e raportit, përsëri e rithekson nevojën për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme që të sigurohet qasja e pavarur dhe e papenguar për të gjithë personat në pjesën e objektit ku gjenden zyrat e DFDIL-së dhe zyrat e Komisionit.²⁷²

Realizimi i beneficioneve të parapara me ligj

Ligji nr. 04/L-172, i vitit 2014, nuk parasheh edhe gëzimin e shërbimeve shëndetësore primare, sekondare dhe terciare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike për viktimat e dhunës seksuale të luftës, sikurse parashihet në Ligjin nr. 04/L-054, të vitit 2011,

²⁷² <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/12/Raporti-AP-Ex-officio-nr-262-2018.pdf>

për kategoritë e tjera të luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre. Po ashtu ligji nuk parasheh me asnjë dispozitë të drejtën për rehabilitim psiko-social për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, përderisa parasheh rehabilitim mjekësor dhe fizik për kategoritë e tjera, sipas shkallës së invaliditetit.

Është e rëndësishme të theksohet se rehabilitimi, sipas pikës 21 të Rezolutës nr. 60/147 të Kombeve të Bashkuara, përfshin: kujdesin shëndetësor dhe psiko-social e po ashtu edhe shërbimet ligjore dhe sociale. Megjithatë korniza ligjore e aplikueshme momentalisht në vend nuk parasheh asnjë dispozitë që garanton rehabilitimin psiko-social të viktimave e po ashtu nuk siguron kujdes shëndetësor pa kompensim në nivelin primar, sekondar dhe terciar në institucionet publike shëndetësore.

Megjithatë, ndonëse pajisja me kartela identifikuese është e paraparë me rregulloren në fjalë, nga fillimi i procesit e deri më tani viktimat të cilave/ëve u është njohur statusi nuk janë pajisur me kartela identifikuese. Mungesa e kartelës identifikuese e bën të parealizueshme apo e pamundëson realizimin e shërbimeve dhe beneficioneve të ndryshme, meqë e njëjta do të shërbente si dëshmi për realizim të beneficioneve të përcaktuara me ligj. Prandaj Avokati i Popullit e konsideron më se të nevojshëm adresimin me urgjencë nga institucionet kompetente çështjen e pajisjes me kartelë të viktimave që u është njohur statusi.

Afati përfundimtar kohor për paraqitjen e aplikacioneve

Megjithatë, sipas informatave që Avokati i Popullit ka pranuar nga organizatat joqeveritare të autorizuar nga Qeveria, për pranimin dhe dorëzimin e aplikacioneve, nga ana e tyre është kërkuar që ky afat të jetë i pakufizuar për dy arsye: për faktin se krimet e luftës dhe kundër njerëzimit nuk parashkruhen; e po ashtu, përveç kësaj edhe për dhënien e mundësisë viktimave që ta paraqesin aplikacionin e tyre për njohje të statusit kurdo që krijohen kushtet dhe rrethanat e përshtatshme qoftë familjare apo sociale, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të vijojnë procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të të mbijetuarës/it të dhunës seksuale të luftës së Kosovës.

Disa shembuj nga mënyra e rregullimit të çështjes në vendet e rajonit dhe më gjerë

Shikuar nga analiza e rregullimit të çështjes në vende e tjera të rajonit, po ashtu të dala nga lufta, vërehet se, për shembull në Bosnje dhe Hercegovinë, njohja e statusit të viktimës rregullohet në tri nivele të ndryshme të qeverisjes: në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, në Republikën Serbe (Republika Srpska) dhe në distriktin e Brčko. Në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës ekziston Ligji për Mbrojtjen Sociale, Mbrojtjen e Viktimave Civile të Luftës dhe Mbrojtjen e Familjeve me Fëmijët e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, ndërsa në Distriktin e Brčko ekziston Vendimi për mbrojtjen e viktimave civile të luftës. Ndërkaq në Republikën Serbe ekziston Ligji për Mbrojtjen e Viktimave të Torturës.

Sipas Ligjit nr. 90/18 për Mbrojtjen e Viktimave të Torturave të Luftës, i vitit 2018, i Bosnje dhe Hercegovinës, ndër të drejtat kryesore apo beneficione që u njihen viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës janë edhe: e drejta për kujdes shëndetësor pa shpenzime; e drejta për rehabilitim shëndetësor; si dhe e drejta e lirit nga taksat gjyqësore dhe administrative (nenet 7 dhe 8 të ligjit). Më tej ky ligj parasheh edhe dyshkallshmërinë në procesin administrativ për njohjen dhe verifikimin e statusit, ku parashihet se vendimi për njohjen dhe verifikimin e statusit merret nga autoriteti i shkallës së parë/niveli lokal dhe i njëjti parasheh të drejtën e ankesës në ministrinë përkatëse (nenet 17 dhe 18 të ligjit).

Ndërkaq shikuar edhe nga perspektiva e rregullimit të çështjes në Republikën e Kroacisë, po ashtu vend i dalë nga lufta, vërehet se Ligji për të Drejtat e Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Agresionit të Armatosur kundër Republikës së Kroacisë, i vitit 2015, si beneficione dhe të drejta të njohura për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës parasheh sigurimin e detyrueshëm shëndetësor; mbështetjen psiko-sociale; rehabilitimin mjekësor; asistencën mjekësore etj.

Disa nga konstatimet e Avokatit të Popullit të nxjerra në këtë raport janë se Rregullorja nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ka disa zbrazëtira ligjore dhe nuk arrin të rregullojë në hollësi procedurën që duhet ta ndjekin palët me rastin e aplikimit për njohje të statusit dhe zhvillimit të procesit të verifikimit. Rregullorja ka zbrazëtira ligjore rreth saktësisë së afateve kohore si edhe paqartësi në terminologjinë juridike të përdorur në lidhje me mjetet juridike në dispozicion në procedurë dhe jo vetëm.

Mosparashikimi i një afati të caktuar për zhvillimin e procedurës së verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimës dhe nxjerrjes së vendimit të Komisionit dhe në mungesë të këtij afati të përcaktuar në këtë rregullore, referimi në dispozita të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas Avokatit të Popullit, krijon pasiguri në pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të palëve në proces, si dhe konfuzion nëse duhet të aplikohet afati 30-ditor i përcaktuar me Udhëzuesin për Procesin e Njohjes dhe Verifikimit të Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës apo referim në afatin 45-ditor të përcaktuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me mundësi të vazhdimit.

Për sa i përket terminologjisë së përdorur dhe të referuar për mjetet juridike në dispozicion, në këtë drejtim duhet të sqarohet dhe të saktësohet se cili është mjeti juridik që palët e kanë në dispozicion në shkallë të parë, se a është kërkesë për rishqyrtim apo ankesë. Ngase Neni 30, paragrafi 3, i Rregullores 22/2015, përcakton: *“Në refuzim pala duhet të udhëzohet për mundësinë e rishqyrtimit të kërkesës dhe ka të drejtë 15 ditë ankesë në vendimin e marrë.”* Rrjedhimisht ky paragraf në njërin anë parasheh rishqyrtimin e kërkesës, ndërsa në anën tjetër potencon afatin 15-ditor për paraqitjen e ankesës. Me këtë rast vlen të theksohet se Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative njih vetëm ankesën dhe kundërshtimin, si mjet juridik të rregullt në procedurën administrative.

Avokati i Popullit thekson se qartësimi dhe saktësia i Rregullores nr.22/2015 rreth mjeteve juridike në dispozicion dhe afateve kohore të aplikueshme kontribuon në sigurimin e respektimit dhe garantimit të shfrytëzimit efektiv të së drejtës për mjet juridik për palët në procedurë.

Rregullorja nr. 22/2015 nuk e përfshin parimin e pavarësisë dhe të paanësisë në vendimmarrje, parimin e objektivitetit dhe parimin e dyshkallshmërisë dhe as atë të kontrollit administrativ në momentin e zhvillimit të procedurës së rishqyrtimit të vendimit të Komisionit për refuzim të njohjes së statusit. Po ashtu Rregullorja nuk përcakton se si vepron Komisioni në procesin e rishqyrtimit; a ka trupë të veçantë që merret me rishqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim përbrenda Komisionit; apo e njëjta përbërje vepron edhe në rishqyrtim. Prandaj është e nevojshme që rregullorja të përcaktojë se Komisioni në çfarë përbërje vepron si shkallë e parë dhe në çfarë përbërje vepron si shkallë e dytë. Dyshkallshmëria është parim i njohur në procedurën administrative, ku është praktikë që vendimi për mjetin juridik të merret nga organi epror.

Shikuar nga aspekti formal i aktit administrativ me të cilin vendoset refuzimi i njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale të luftës, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje nevojën për ndërmarrjen e veprimeve konkrete që gjatë zhvillimit të procedurës administrative vendimmarrëse, arsyetimet e vendimeve të individualizohen për secilin rast veç e veç dhe të përmbajnë shtjellimin e fakteve dhe provave të administruara, që kanë ndikuar në vendimmarrje, gjithnjë duke respektuar format dhe modalitetet e ruajtjes së konfidencialitetit të procedurës dhe identitetit të palëve. Avokati i Popullit vlerëson se Komisioni, përbrenda kompetencave të veta dhe nën korniza të ruajtjes së parimit të konfidencialitetit të të dhënave të procedurës, nevojitet t'i gjejë format dhe modalitetet e përshtatshme të individualizimit të arsyetimit të vendimeve, duke u shmangur arsyetimeve shabllone apo të ngjashme në raste të ndryshme.

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, është i nevojshëm organizimi i orarit të intervistave në atë mënyrë që të shmanget çdo ballafaqim i mundshëm i viktimave me njëra/i-tjetrën/in

gjatë pritjes për intervistim si dhe gjatë hyrjes në objektin ku vepron Komisioni, duke qenë të vetëdijshëm se në objektin në fjalë operojnë edhe departamentet e tjera të shërbimit social dhe pensional.

Avokati i Popullit rithekson se mospërshtatja e qasjes fizike e objektit ku realizohet intervistimi, në aspektin infrastrukturor, në mënyrë që ajo të jetë e qasshme për të gjithë, pa dallim, pra për persona të moshuar me vështirësi në lëvizje, por edhe për persona me aftësi të kufizuara, cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe pa diskriminim. Ajo gjithashtu mund të cenojë edhe të drejtën e deklarimit dhe të dëgjimit të palëve në procedurë, ngase si rezultat i paqasshmërisë fizike në objekt, realizimi i intervistimit bëhet i pamundur.

Lidhur me çështjen e afatit të pakufizuar kohor për aplikim në këtë proces, duke pasur parasysh faktin se krimet e luftës nuk parashkruhen, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje nevojën e të shqyrtuarit të mundësisë së lënies në afat të pakufizuar kohor procesin e aplikimit dhe realizimit të të drejtave që rrjedhin nga njohja e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, në mënyrë që viktimat/të mbijetuarit/at të kenë mundësi që ta fillojnë procesin e aplikimit për njohje të statusit kurdo që krijohen situatat apo rrethanat e përshtatshme për ata për fillim të kësaj procedure, qofshin ato rrethana familjare apo edhe shoqërore.

Avokati i Popullit konsideron se institucionet përgjegjëse duhet t'i gjejnë modalitetet formale të nevojshme në mënyrë që personat të cilëve u është njohur statusi, të pajisen me kartela identifikuese, me qëllim që palët të kenë mundësi t'i realizojnë beneficionet e përcaktuara me ligj për këtë kategori, si: shërbime shëndetësore, banim, punësim, lirim nga tatimi në pronë etj.

Avokati i Popullit për më tepër gjen se as ligji dhe as rregullorja nuk përmbajnë asnjë dispozitë ligjore që do të referonin mbështetje psik-sociale për viktimat të cilave u është verifikuar dhe njohur statusi i viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës, me qëllim të rikuperimit të tyre dhe mundësimit të riintegritimit më të lehtë në familje dhe në shoqëri.

Avokati i Popullit po ashtu e konsideron si të nevojshëm shqyrtimin brenda instancave kompetente të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkitazi me mundësimin e trajtimit me prioritet në gjykatë të lëndëve të kësaj natyre.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës: *Të plotësojë/ndryshojë Rregulloren 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës: në lidhje me saktësimin/parashikimin e afatit kohor për përfundimin e procedurës administrative dhe nxjerrjen e vendimit të Komisionit, për njohje apo refuzim të njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë; në lidhje me saktësimin/parashikimin e mjetit juridik në dispozicion të palëve, në procesin e rivlerësimit të aplikacionit dhe në procesin e inicimit të procedurave gjyqësore të konfliktit administrativ në gjykatë; në lidhje me saktësimin/parashikimin e afatit kohor për nxjerrje të vendimit në procedurën e rishqyrtimit të aplikacionit, sipas kërkesës për rishqyrtim apo rivlerësim të aplikacionit; sigurimin e respektimit të parimit të dyshkallshmërisë dhe kontrollit administrativ në procesin e rishqyrtimit apo rivlerësimit të aplikacionit në lidhje me refuzimin e njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale të luftës.*

Të plotësojë/ndryshojë rregullativën ligjore në fuqi, ashtu që ofrimi i shërbimeve psiko-sociale të parashihet edhe për viktimat, të cilave/ëve u njihet statusi.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve për njohjen dhe verifikimin e statusit të mos kufizohet. Plotësojë/ndryshojë Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, ashtu që viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës t'u njihet e drejta për shërbime shëndetësore primare, sekondare dhe terciare pa

pagesë në institucionet publike shëndetësore.

Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës:

Të shqyrtojë, të trajtojë dhe të nxjerrë vendim mbi aplikacionet për njohje apo refuzim të statusit të viktimës së dhunës seksuale, në përputhje me afatet e caktuara kohore.

Me rastin e përpilimit të vendimeve, përbrenda kornizave të ruajtjes së konfidencialitetit të palëve, të respektohen kërkesat ligjore të dala nga nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht lidhur me strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe të arsyetimit.

Në procesin e zhvillimit të intervistimit të të mbijetuarave/ve të gjenden mundësitë dhe modalitetet e nevojshme për organizimin më të mirë të kohës së intervistimit, në mënyrë që viktimave t'u sigurohet ruajtja e identitetit të tyre nga zbulimi dhe ruajtja e konfidencialitetit të procedurës dhe të të dhënave të palëve me rastin e pritjes për intervistim.

Në procesin e intervistimit të të mbijetuarave/ve të sigurohet respektimi i dinjitetit të tyre, i të drejtave të njeriut, i mirëqenies fizike, psiko-sociale dhe i privatësisë së tyre.

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

Të sigurojë që ambientet/objekti ku vepron Komisioni dhe ku bëhet realizimi i intervistimit të viktimave të jenë në aspektin fizik dhe infrastrukturor të qasshme për të gjithë, e në veçanti për persona me aftësi të kufizuara.

Të sigurojë që ambientet ku Komisioni vepron dhe ku palët i procedojnë aplikacionet e tyre, me rastin e qasjes në ndërtesë, të jenë të përshtatshme me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të identitetit të viktimave/palëve dhe mbrojtjen nga çfarëdo mundësie të zbulimit të identitetit të tyre në publik dhe më gjerë.

Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve:

Të zhvillojë procedurat relevante për pajisjen e viktimave me kartela identifikuese, në përputhje me nenin 37 të Rregullores nr. 22/2015.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës:

Trajtimin e lëndëve të iniciuara në gjykatë, me prioritet.

Diskriminim mbi baza gjinore me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës

Raporti bazohet në ankesë individuale dhe ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) përkitazi me çështjen e procedurës së përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të përgjithshëm të RTK-së dhe zbatimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor me rastin e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së në konkursin e datës 22 nëntor 2022.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin për pozitën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të RTK-së dhe i është nënshtruar intervistimit për këtë pozitë. Më pas ajo nga Administrata e RTK-së nëpërmjet e-mailit zyrtar është njoftuar se në bazë të rezultatit përfundimtar ka arritur 82.6 pikë dhe është njoftuar nga Komisioni Përzgjedhës se pas kalimit të afatit të ankesave, kandidatin më të suksesshëm do t'ia propozonte drejtorit të përgjithshëm të RTK-së. Pas kësaj, më 30 dhjetor 2022, pas orarit të rregullt të punës, ajo është njoftuar nga Administrata e RTK-së se më 6 janar 2023 ftohet për riintervistim nga i njëjti Komision Përzgjedhës.

Ankuesja njoftoi se pas dy kërkesave që i ka dërguar në Administratën e RTK-së nuk është qartësuar se mbi çfarë baze do të bëhej riintervistimi për pozitën e zëvendës drejtorit të RTK-

së dhe për këtë ajo ka njoftuar Administratën e RTK-së se ka vendosur të mos paraqitej në riintervistimin dhe pas kësaj, më 11 janar 2023, parashtrori ankesë në Komisionin e Ankesave kundër Vendimit të Komisionit Përzgjedhës, e cila u refuzua nga Komisioni i Ankesave.

Në kërkesën e Avokatit të Popullit që të informohet nga RTK-ja në lidhje me ankesën, në përgjigjen e pranuar u njoftua se procesi i përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së është kthyer në rishqyrtim në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë të RTK-së, i cili përcakton se Komisioni i Ankesave mund: *“Të kthejë çështjen në rishqyrtim duke përshkruar lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni Përzgjedhës.”* Më tej në përgjigje thuhej se nuk ka pasur një praktikë që çështja të kthehej në rishqyrtim te Komisioni Përzgjedhës, pasi ka pak muaj nga hyrja në fuqi e *Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të Lartë*. Përgjigjja më tej sqaronte se Komisioni i Ankesave, për shqyrtimin e vendimit të Komisionit Përzgjedhës ka vepruar sipas ankesës së palës së pakënaqur, me ç’ rast ka konstatuar shkelje, por shkelja nuk është e asaj natyre që do ta dëmtonte në tërësi procesin, prandaj ankesën e palës ankuese e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim, duke i rekomanduar Komisionit Përzgjedhës që t’i evitonte shkeljet e evidentuara.

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit në këtë raport, duke u nisur nga rrethanat e rastit, vlerëson se procedura e përzgjedhjes së zëvendës drejtorit të RTK-së është zhvilluar në atë mënyrë që lë mundësinë për të ngritur çështje substanciale përkitazi me rregullsinë e këtij procesi, për arsyet të cilat do të sqarohen në vijim. Përkundër faktit që ka pasur një ankesë të suksesshme lidhur me shkeljet në procedurë me rastin e vlerësimit të kandidatëve, kthimi i çështjes në rishqyrtim nga ana e Komisionit të Ankesave te i njëjti Komision Përzgjedhës, për të cilin është konstatuar se ka kryer shkelje procedurale, e komprometon këtë proces të rekrutimit. Për më tepër, mospërcaktimi në mënyrë të qartë i rrethanave se cilat çështje mund t’i kthehen Komisionit Përzgjedhës për rishqyrtim, lë hapësirë të gjerë diskrecionale për të dy komisionet, të cilat mund të shpijnë edhe në arbitraritet.

Avokati i Popullit vlerëson se procesi i rregullt dhe i drejtë nga ana e RTK-së në rastin konkret është vënë në pyetje. Kjo jo vetëm për faktin se çështja i kthehet në rishqyrtim të njëjtit komision përzgjedhës, i cili me lëshimet që janë evidentuar nga Komisioni i Ankesave ka dëmtuar një proces rekrutues, por edhe për faktin se paqartësia dhe jotransparenca e rregulloreve të brendshme të punësimit ka ndikime negative të shumta në të drejtat e kandidatëve dhe punonjësve. Aspekti procedural i rekrutimit është një parakusht thelbësor për të siguruar një proces të rregullt dhe të drejtë. Kjo është e rëndësishme për të garantuar që procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është i strukturuar, i drejtë dhe i paanshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se në këtë rast është shkelur edhe parimi i barazisë duke marrë parasysh faktin se nga katër kandidatët, të cilët u janë nënshtruar proceduarave të rekrutimit, ankuesja ka qenë e vetmja kandidate femër.

Të dhënat që Avokati i Popullit i ka siguruar nga RTK-ja, si pjesë e një hulumtimi gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore nga ana e institucioneve publike, rezultoi se RTK-ja nuk ka arritur ta zbatonte obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, duke siguruar përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, në të gjitha pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse, me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor.

Sipas të dhënave, në nivelin e lartë drejtues në RTK janë 4 meshkuj e një femër; në nivelin e mesëm drejtues janë 9 meshkuj e 7 femra; dhe në nivelin administrativ janë 36 meshkuj dhe 29 femra.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Radiotelevizionit të Kosovës që të bëjë plotësim-ndryshimin e Rregullores për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK, në atë mënyrë që të hiqet paragrafi 3.3 i nenit 38, ku thuhet: *“Ta kthejë çështjen në rishqyrtim*

duke përshkruar lëshimet të cilat duhet të evitohen nga Komisioni Përzgjedhës.”, ose t'i përcaktojë në mënyrë të qartë rrethanat mbi bazën e të cilave çështja kthehet në rishqyrtim, si dhe ta zbatojë obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, duke siguruar përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, në të gjitha pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse, me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor.

Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për ndërrimin, mirëmbajtjen apo vendosjen e protezave vetëm për personat që kanë status të invalidit të luftës së UÇK-së duke i përjashtuar invalidët civilë të luftës konsiderohet diskriminues

Raporti është hartuar duke u bazuar në ankesë individuale dhe qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me zbatimin e Vendimit Nr.01/194, të datës 20 mars 2024, për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin Nr. 01/194, me ç' rast e aprovoi kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me *status të invalidit të luftës* për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave, jashtë institucioneve shëndetësore publike, kur këto të fundit nuk i ofrojnë këto shërbime. Vendimi përcakton se mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi shfrytëzohen nga buxheti i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike. Për më tepër, vendimi obligon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurisë Shëndetësore për zbatimin e këtij vendimi sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë Vendimin Nr. 43/III/2024, me të cilin e obligon Bordin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, që t'i mbulojë financiarisht ndërrimin, mirëmbajtjen apo vendosjen e protezave sipas kërkesës së përzgjedhur nga aplikuesi me rastin e aplikimit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, vetëm për personat që kanë status të invalidit të luftës së UÇK-së. Sipas ministrisë, duke marrë parasysh se Udhëzimi Administrativ nr. 03/2023 për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike nuk përcakton kategorinë e personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së dhe se në zbatim të Vendimit nr.01/194, të datës 20 mars 2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi (Vendimi Nr. 43/III/2024).

Ankuesi, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së të Plagosurve Civile nga Minat, ka parashtruar ankesë në Zyrën e Kryeministrit si dhe në Fondin e Sigurimit Shëndetësor kundër vendimeve të Bordit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i cili, duke u bazuar në Vendimi nr. 01/194 të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk i ka marrë për bazë kërkesat e invalidëve civilë të luftës, për trajtimin shëndetësor dhe sigurimin e mjeteve të mjaftueshme për proteza, mirëpo ankuesi ka pohuar se nuk ka marrë përgjigje.

Ankuesi theksoi se invalidët civilë të luftës janë duke u ndier të diskriminuar nga MSh-ja, pasi Qeveria Republikës së Kosovës ka marrë vendim duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i cili përcakton benificionet e veçanta edhe për invalidët civilë të luftës, ndërsa vendimi i MSh-së i ka paraparë këto benificione vetëm për personat me *status të invalidit të luftës së UÇK-së*, duke i përjashtuar kështu *invalidët civilë të luftës*.

Avokati i Popullit konstaton se Vendimi nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga MSh-ja, përbën qasje diskriminuese për arsye se vendimi në fjalë përcakton vetëm benificionet për

personat me statusin e invalidit të luftës së UÇK-së duke përjashtuar kategorinë e personave me status të invalidit civil të luftës edhe pse këto dy kategori i gëzojnë benificonet e njëjtat, të cilat shprehimisht përcaktohen në nenin 6, paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Për këtë arsye Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë që ta anulojë Vendimin nr.43/III/2024, të datës 22 mars 2024, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa Ministrisë së Shëndetësisë i rekomandoi që të ndërmarrë masa në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, për ofrimin e benificoneve të veçanta për invalidët civilë të luftës.

Opinion në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nëpërmjet këtij opinionit Avokati i Popullit ofroi qëndrimin lidhur me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të veprave në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi. Opinioni është hartuar duke u bazuar në një ankesë të parashtruar kundër Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (më tej referuar si: UP), lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe për trajtim të pabarabartë dhe diskriminim në procesin e themelimit të marrëdhënies së punës.

Universiteti i Prishtinës në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 173, paragrafi 4, të Statutit të UP-së, e në përputhje me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë, si dhe me Rregulloren nr. 886 për Procedurat Përzgjedhëse lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, më 31 maj 2023 shpalli Konkurs publik nr.1/331, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e UP-së. Ankuesi, duke u bazuar në pikën 1 të konkursit, ka aplikuar për pozitën nr.13: *“Një asistent për lëndët: Histori e Evropës Juglindore II (O), Historia publike, menaxhimi i programeve për ruajtjen e historisë (O), Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore(O), Arkivistikë-teori dhe praktikë(O), Legjislacion arkivor (Z), Histori e qytetërimit (O), Metodologji e historisë(O) dhe Histori e qytetërimit modern (O), për të cilën pozitë kishin aplikuar edhe 4 kandidatë të tjerë.*

Në këtë drejtim, Fakulteti Filozofik, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit e ka publikuar Raportin në buletin e UP-së, në të cilin ankuesi është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm dhe atë së bashku me propozimet me kandidatët e përzgjedhur e ka dërguar në Zyrën për Çështje Akademike në Rektoratin e UP-së, e cila zyrë nuk ka gjetur shkelje në pozitën për të cilën ankuesi është përzgjedhur.

Më pas ankuesi njoftoi se Rektori i është drejtuar Këshillit të Etikës me kërkesë për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit, duke pretenduar se një kërkesë e tillë është bërë vetëm për atë dhe jo edhe për dhjetëra kandidatë të tjerë, të cilët ishin përzgjedhur në këtë procedurë rekrutuese. Këshilli i Etikës nëpërmjet Vendim nr.159, i rekomandoi Senatit : *“Të ketë në konsideratë faktin se reputacioni dhe kredibiliteti i Universitetit do të rrezikohet seriozisht, nëse në procesin e rekrutimit të stafit akademik abstrahohet në tërësi përshtatshmëria etike dhe e kaluara e dyshimtë e kandidatëve, sidomos nëse kjo e kaluar konsiderohet në raport me Universitetin.”*

Senati i Universitetit nxori Vendimin nr. 647, me të cilin e refuzoi emërimin e ankuesit/kandidatit në thirrjen akademike për të cilën ka aplikuar.

Avokati i Popullit duke pasur parasysh faktin se procedura e përzgjedhjes lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personeli akademik në UP është qartë e përcaktuar me Rregulloren 886, ndërsa emërimi i personelit akademik përcaktohet edhe me nenin 171

të Statutit të UP-së, konsideron se Rektori në rastin kur i është drejtuar Këshillit të Etikës me kërkesë për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit, ka vepruar jashtë kompetencave të përcaktuara me Statutin e UP-së dhe në kundërshtim me Rregulloren nr.886. Për më tepër, një kërkesë e tillë është bërë vetëm për ankuesin dhe jo edhe për dhjetëra kandidatë të tjerë të cilët ishin përzgjedhur në këtë procedurë rekrutuese.

Bazuar në nenin 173 të Statutit të UP-së, personeli akademik do të emërohet nga Rektori sipas vendimit të Senatit, i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike. Ndërsa, nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit e sjell të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar. Të gjitha emërimet bëhen pasi të shqyrtohet dokumentacioni i aplikimit nga komisioni vlerësues i formuar nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e degës – departamentit.

Duke marrë parasysh faktin se ankuesi nuk ka qenë dhe nuk është i punësuar në UP dhe nuk është student, vlerëson se kërkesa e Rektorit drejtuar Këshillit të Etikës përbën shkelje të procedurave të përcaktuara me Rregulloren 886. Këtë vlerësim Avokati i Popullit e mbështet në përcaktimet e Kodit të Etikës (nr.prot.1/751, datë 19.7.2013), i cili në nenin 3 e përcakton fushëveprimin e këtij kodi dhe i cili zbatohet për gjithë stafin akademik të punësuar në UP, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, niveli i emërimit, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, edhe për pozitën *lektor, asistent, profesor asistent, profesor i asociuar dhe profesor i rregullt*. Pra nuk aplikohen dispozitat e Kodit të Etikës së UP-së për kandidatët në procedurën e përzgjedhjes/rekrutimit të stafit akademik.

Avokati i Popullit thekson se as Rregullorja nr. 886 nuk përmban asnjë dispozitë që e rregullon çështjen e kredibilitetit apo të integritetit të personave pjesëmarrës në procedurën e përzgjedhjes për staf të UP-së. Megjithatë, çështja e integritetit për kandidatët në procedurë të përzgjedhjes, e të cilët nuk janë të punësuar në UP, vlerësohet me paraqitjen e dëshmisë nga gjykata kompetente se kandidati nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar. Një dëshmi e tillë është e renditur te Kushtet e përgjithshme të konkursit të shpallur, pika II. - Dokumentet e nevojshme për aplikim, pika j), të përcaktuara në Konkursin publik nr.1/331, më 31 maj 2023, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e UP-së.

Veprimet e Rektorit, vendimi i Këshillit të Etikës dhe përfundimisht vendimi i Senatit, përveçse e vendosin ankuesin në pozitë të pabarabartë, ato përbëjnë edhe diskriminim sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi: “[*]uftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, [...] ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*

Kërkesa e Rektorit drejtuar Këshillit të Etikës, për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit dhe jo të kandidatëve të tjerë të përzgjedhur në të njëjtën procedurë rekrutuese, është kërkesë arbitrare dhe e vendos ankuesin në pozitë të pabarabartë në raport me kandidatët e tjerë, rrjedhimisht një veprim i tillë përbën diskriminim.

Universiteti i Prishtinës përveç zbatimit të legjislacionit në përgjithësi që është në fuqi dhe që i zbaton në veprimtarinë e përditshme, e ka obligim të veprojë në përputhje të plotë edhe me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Mosrespektimi i akteve të brendshme sipas qëllimit dhe fushëveprimit të tyre, e po ashtu moszbatimi i parimeve të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, shpie në shkelje të të drejtave të njeriut, respektivisht në diskriminim.

Opinion në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me detyrimet e organeve shtetërore që gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësisë të tyre të veprojnë në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi. Opinioni është ndërtuar mbi bazën e një ankese individuale të parashtruar kundër

Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale, me pretendime për diskriminim në bazë të moshës me rastin e marrjes së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës si kryesuese e Bordit të KPMM-së.

Ankuesja nuk ka arritur ta përfundonte mandatin si kryesuese e Bordit prej pesë vjetësh, ashtu siç është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Me arsyetimin se kryesuesja ka arritur moshën e pensionimit, tre anëtarët e tjerë të Bordit morën vendim për pensionimin e ankueses. Vendimi është mbështetur në nenin 59, pika 3, të Ligjit për MM-në. Avokati i Popullit vlerëson se Bordi i KPMM-së i ka tejkualuar kompetencat e veta sipas ligjit në fjalë, meqë kjo kompetencë është ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës.²⁷³

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk reagoi për një veprim të tillë të tre anëtarëve të Bordit. Përkundrazi, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas disa muajsh i ftoi në një takim anëtarët e Bordit të KPMM-së për çështje që ndërlidheshin me punën dhe përgjegjësinë e tyre si Bord, ku e pranishme në takim ishte edhe ankuesja, edhe pse më vonë Kuvendi i Republikës së Kosovës shkarkoi gjithë Bordin, përfshirë edhe ankuesen.

Avokati i Popullit vlerëson se marrja e një vendimi të tillë për pensionim të ankueses, nga një organ jokompetent, është në kundërshtim edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht me nenin 4, paragrafi 1, të tij, i cili ka përcaktuar parimin e ligjshmërisë.²⁷⁴ Një vendim i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të po këtij ligji, i cili përcakton paligjshmërinë e aktit administrativ nëse “është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1); dhe organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë.” (nënparagfi 1.2).

Avokati i Popullit, nga përgjigjja dhe dokumentet që pranoi nga KPMM-ja, vëren se nuk është ndjekur një praktikë e tillë në të kaluarën nga KPMM-ja me njërin nga anëtarët e Bordit (mashkull), në një rast të njëjtë sikurse i ankueses, ku njëri nga anëtarët e Bordit gjatë ushtrimit të mandatit e arriti moshën e pensionimit, por ai e vazhdoi mandatin deri në përfundimin e tij.

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se KPMM-ja jo vetëm që ka tejkualuar kompetencat ligjore që ka, por ka vepruar edhe në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit, një qasje e tillë përbën diskriminim të shumëfishtë sipas përcaktimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, i cili ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj.

Avokati i Popullit vlerëson se, përpos zbatimit të të gjitha ligjeve të tjera të cilat janë në fuqi, KPMM-ja e ka për obligim që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet të veprojë në përputhje të plotë me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Moszbatimi i parimeve të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi shpie në shkelje të së drejtës së njeriut, respektivisht në diskriminim, sikurse në rastin e ankueses.

273 **Ligji** nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, përkatësisht neni 60 [Shkarkimi i anëtarëve të bordit].

274 Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 4, paragrafi 1: “Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjisllacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”

E Drejta për Jetën

Vlerësimi i trajtimit dhe i respektimit të të drejtave të pacientit në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë

Raporti është iniciuar sipas detyrës zyrtare bazuar në raportimet e portalit “KOHA”, me titull: *“Vdiq një pacient në Repartin e Psikiatrisë, ia vuri flaken dhomës”²⁷⁵*, se në një prej dhomave në Repartin e Urgjencës Intensive Psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është kapluar nga zjarri të mërkurën mbrëma (24 gusht 2023). Ndërsa në të njëjtën ditë (24 gusht 2023) në komunikatën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës lidhur me rastin potencohej si në vijim: *“Qendra Universitare e Kosovës (QKUK), njofton se mbrëmë rreth orës 23:00, në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike ka ndodhur një zjarr, në njërën nga dhomat e tipit të mbyllur, ku qëndrojnë pacientët përkohësisht, pacientë në gjendje të agresivitetit dhe agjitimit të theksuar psikomotor, jo koshient për gjendjen mendore. Në të njëjtin Repart, në të njëjtën kohë, dyshohet se një pacient i ka vënë zjarrin në rrethana të panjohura dhomës së tipit të mbyllur, me ç’rast si pasojë e ngulfatjes nga tymi (asfiksioni) ai ka humbur jetën, përkundër përpjekjeve maksimale të stafit shëndetësor për ta shpëtuar pacientin.”²⁷⁶*

Qëllimi i raportit është vlerësimi trajtimit dhe i respektimit të të drejtave të pacientit I. S. (tani i ndjerë), me trajtim të pavullnetshëm, i vendosur në Institucionin e Shëndetit Mendor, në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike (me tej: UKIP), të drejta të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet në fuqi dhe me aktet ndërkombëtare, pasi për shkak të cenueshmësisë së tyre, të sëmurët mendorë kërkojnë mjaft vëmendje për të parandaluar çdo formë sjelljeje ose për të mënjanuar ndonjë mosveprim kundër mirëqenies së tyre.

Në këtë raport Avokati i Popullit në bazë të të gjeturave nga vizitat e realizuara në Repartin UKIP, vlerësimi të dokumentacionit, ndër të tjerash konstaton se pacienti pavarësisht se është vizituar çdo 30 minuta, do të duhej t’i nënshtrohej mbikëqyrjes së vazhdueshme më të shpeshtë se 30 minuta nga stafi mjekësor, pasi pacienti ka qenë në gjendje të rënduar mendore. Vizitat më të shpeshta do ta parandalonin çdo formë të vetëlëndimit të pacientit në fjalë dhe të pacientëve të tjerë.

Bazuar në standardet e KPT-së, në rastet e izolimit të pacientëve, një infermier duhet të jetë i pranishëm në mënyrë të përhershme në Dhomën e Izolimit, në mënyrë që të ruajë një aleancë terapeutike me pacientin dhe t’i ofrojë atij ndihmë, apo infermieri mund të qëndrojë jashtë dhomës së pacientit (ose në një dhomë ngjitur që ka një dritare që komunikon me dhomën e pacientit), me kusht që pacienti të mund ta shohë plotësisht anëtarin e stafit dhe ky i fundit të mund ta vëzhgojë dhe ta dëgjojë vazhdimisht pacientin.

Pacienti, tani i ndjeri I. S., me rastin e pranimit nuk është kontrolluar siç duhet nga stafi i pranimit. Pasi kontrollimi i duhur i pacientit në pranim do të parandalonte çdo formë të vetëlëndimit, po ashtu do ta parandalonte lëndimin e pacientëve të tjerë të vendosur në repartin UKIP. Me qëllim të garancisë së pacientit të pranuar, në parim, pacienti duhet të kontrollohet në mënyrë të detajuar si dhe të vihet në pozitë ta japë miratimin e tij të lirë dhe të jetë i informuar, për aq sa ka mundësi, për trajtimin e pavullnetshëm dhe vendosjen e tij në izolim. Po ashtu, vendimi lidhur me vendosjen e pavullnetshme duhet të merret nga një autoritet gjyqësor ose të konfirmohet nga një autoritet i tillë brenda një afati të shkurtër, pasi në rastin në fjalë nuk është njoftuar gjykata kompetente fare.

Avokati i Popullit po ashtu konstaton se alarmi i tymit nuk është funksional në kohën e

275 <https://www.koha.net/kronike-e-zeze/389595/vdiq-nje-pacient-ne-repartin-e-psikiatrise-ia-vuri-flaken-dhomes>

276 <https://shskuk.rks-gov.net/News/SingleNews/17790>

ndodhjes së rastit, po ashtu, edhe në vizitën e fundit ka vërejtur se alarmi i tymit ende nuk është funksionalizuar. Reparti UKIP nuk vëzhgohet nga kamerat e sigurisë, përveç pjesës në Zyrën e Pranimit të pacientëve.

Dhoma e Izolimit, në të cilën ishte vendosur pacienti I. S. (tani i ndjerë), nuk përbente një ambient qetësues dhe të sigurt. Po ashtu, gjatë vizitës së fundit në UKIP, Avokati i Popullit vërejtë se Dhoma e Izolimit ku ka ndodhur rasti ende nuk është rinovuar. Andaj Avokati i Populli konstaton se Dhoma e Izolimit ku vendosen pacientët duhet të jetë e posaçme për këtë qëllim. Në veçanti, ambienti duhet të garantojë sigurinë e pacientit të kufizuar dhe të ofrojë një ambient qetësues për të.

Formulari i Dhomës së Izolimit është i mangët dhe nuk ofron shumë informata për pacientin e vendosur në izolim. Mungesa e informatave sjell deri te mosdëshmia për shërbimet e ofruara nga stafi. Avokati i Popullit konstaton se është përgjegjësi e autoriteteve shtetërore për përmbushjen e obligimeve pozitive për mbrojtjen dhe respektimin e personit të sëmurë mendor. Të sëmurët mendorë kërkojnë vëmendje të shtuar për të parandaluar çdo formë sjelljeje të rrezikshme për vete apo për të tjerët. Ushtrimi i masës së izolimit duhet të bëhet për një kohë sa më të shkurtër të mundshme (zakonisht në minuta, jo orë) dhe gjithmonë duhet të përfundojë në çastin e përfundimit të shkaqeve të kufizimit. Pasi në rastin konkret të të ndjerit I. S., masa e izolimit është zbatuar për ditë të tëra, për çka nuk mund të ketë asnjë justifikim dhe, sipas Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT), mund të çojë në keqtrajtim.

Nëpërmjet këtij raporti i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë që në rastet kur aplikohet masa e izolimit, pacientët të vizitohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpeshtë. Po ashtu, dhoma e infermierëve të vendoset afër Dhomës së Izolimit në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike; kontrollet e pacientëve të jenë më të detajuara, si dhe të shikohen praktikat e shteteve të tjera për përdorimin e detektorit për kontrolle trupore para pranimit; të funksionalizohet alarmi i tymit në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike; të vendosen kamerat e sigurisë në gjithë Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike; të rinovohen dhomat e izolimit, sipas standardeve ndërkombëtare, duke krijuar një ambient të sigurt dhe qetësues për pacientin në Repartin e Urgjencës dhe Intensives Psikiatrike; të krijohen formularë për dhomat e izolimit, në të cilët përfshihen orët kur ka filluar dhe mbaruar masa, rrethanat e rastit, arsytet për përdorimin e saj, emri i mjekut që e urdhëroi ose miratoi dhe një tregim i çdo dëmtimi që ka pësuar pacienti ose personeli si dhe çdo veprim të infermierit gjatë mbikëqyrjes (vëzhgimit).

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

Raportet që i referohen zvarritjes së procedurave gjyqësore në të gjitha nivelet e gjykatave

Sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zvarritja e procedurave gjyqësore i referohet periudhës kohore nga momenti i fillimit të procedurës deri në momentin e përfundimit të asaj çështjeje gjyqësore. Edhe gjatë këtij viti raportues janë pranuar një numër relativisht i madh i ankesave dhe po ashtu janë identifikuar një numër rastesh në të cilat nëpërmjet raporteve është konstatuar se ka pasur vonesa përtej afateve të arsyeshme e që domosdo ndikojnë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Si rregull, Avokati i Popullit jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura të tjera ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç kur evidentohet zvarritje e procedurave. Në këtë kuptim, qëllimi i adresimit të raporteve në gjykata është tërheqja e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për t'i shqyrtuar dhe për të vendosur në lëndët pa

vonesa të mëtutjeshme, duke marrë parasysh faktin se zvarritjet e procedurave gjyqësore ndikojnë në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme gjatë hartimit të këtyre raporteve, janë marrë parasysh faktorët si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit; sjellja e parashtruesit të kërkesës, sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore, dhe rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

Bazuar në këta faktorë është bërë vlerësimi i përgjithshëm i rrethanave të çështjeve të parashtruara në institucion në 50 raporte, nëpërmjet të cilave është konstatuar se zvarritjet e tilla, pa vendime përfundimtare, shkelin:

- të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuara dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;
- të drejtën për mjete efektive juridike, e mbrojtur me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;
- të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Raportet drejtuar gjykatave gjatë këtij viti janë si në vijim:

Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ia kemi adresuar katërmbëdhjetë raporte me rekomandime. Për këto rekomandime ka kthyer përgjigje për dhjetë raste, nga të cilat tri rekomandime i ka zbatuar, derisa në pritje për zbatim janë shtatë rekomandime, përderisa në katër raporte me rekomandime nuk ka ofruar përgjigje.

Gjykatës së Apelit ia kemi adresuar shtatë raporte. Përgjigje ka ofruar në tri raste, nga të cilat tri rekomandime janë zbatuar, derisa në pritje për zbatim është një rekomandim, përderisa në tri raporte nuk ka ofruar përgjigje.

Gjykatës Komerciale ia kemi adresuar një raport me rekomandim, në të cilin gjykata nuk ka ofruar përgjigje në lidhje me zbatimin e tij.

Gjykatave themelore ua kemi adresuar njëzet e gjashtë raporte. Në njëzet e një raporte kanë ofruar përgjigje, nga të cilat katër rekomandime i kanë zbatuar, përderisa në pritje për zbatim janë shtatëmbëdhjetë rekomandime, përderisa në pesë raporte nuk kanë ofruar përgjigje.

Mosndërmarrja e veprime nga Inspektorati Policor i Kosovës për përfundimin e procedurës hetimore ndaj parashtruesit të ankesës

Qëllim i këtij raporti është identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe tërheqja e vëmendjes për ndërmarrjen e veprime përkatëse në drejtim të përfundimit të procedurës hetimore ndaj ankuesit, si dhe sigurimin e llogaridhënies për zyrtarët përgjegjës në IPK, të përfshirë në rast.

Ankuesi pretendon se IPK-ja ka shkelur procedurat ligjore me rastin e dhënies së rekomandimit për PK-në për suspendimin e tij nga puna e pasojat e një veprimi të tillë ende vazhdon t'i ketë. Sipas të dhënave, kryeshefi ekzekutiv i IPK-së i ka rekomanduar drejtorit të PK-së, mes të tjerash, suspendimin e ankuesit nga puna deri në përfundim të hetimeve. Po në të njëjtën ditë, drejtori i përgjithshëm i PK-së, me Vendimin nr. 01/0929 e ka suspenduar nga puna ankuesin përkohësisht, me 50% të pagës, megjithëse sipas ankuesit, ai nuk ka qenë i informuar zyrtarisht për arsyet e suspendimit, përveç informatës se IPK-ja ka rekomanduar suspendimin e tij, edhe pse ai asnjëherë nuk është intervistuar nga IPK-ja në cilësinë e të dyshuarit.

Për suspendimin e tij, ankuesi pohoi se është raportuar në media, duke e paraqitur atë si keqpërdorues të detyrës zyrtare, gjë që ankuesi ka thënë se kjo ka ndikuar që ai të ndihej i

linçuar publikisht e që për pasojë ka përjetimin e ankthit dhe ndjenjës së turpfit nga ana e tij.

Më pas drejtori i përgjithshëm i PK-së ka nxjerrë Vendimin 01/0006/19, me të cilin ankuesit i është ndërprerë suspendimi pas rekomandimit të dhënë nga IPK-ja, megjithëse ankuesi përsëri nuk është njoftuar as për arsyet e suspendimit dhe as për arsyet e ndërprerjes së suspendimit.

Ai pohoi se ende vazhdon të ketë pasoja në lidhje me suspendimin, edhe pasi është marrë vendimi nga PK-ja për ndërprerjen e suspendimit kundër tij, ende nuk i është kompensuar 50% e pagave për periudhën sa ka qenë i suspenduar dhe se në IPK figuron se ka lëndë të hapura për të cilat nuk dihet se kur do të përfundojë hetimi.

Në komunikim me autoritete përgjegjëse, Avokati i Popullit u njoftua nga Prokuroria Themelore në Prishtinë se ata këtë rast e kanë mbyllur me raport më datë 12 prill 2023.

Nëpërmjet këtij raporti, Avokati i Popullit vlerëson se ky proces edhe pse është zhvilluar vetëm në fazën parapenale, rezulton se zgjati për gati gjashtë vjet, ndonëse nga Prokurori i Shtetit rasti vetëm se është mbyllur me raport, ndërsa zvarritja e paarsyeshme e IPK-së për ta përfunduar procedurën shkel të drejtën e ankuesit për mjete efektive juridike. Për më tepër, ankuesi po përballej me pasoja për karrierën e tij nga këto raste që vazhdonin të evidentoheshin si të hapura në IPK.

Sipas GjEDNj-së, kohëzgjatja “e arsyeshme” e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret: e kompleksitetit të çështjes, të qëndrimit të ankuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe interesat e ankuesit në mosmarrëveshje.²⁷⁷ Gjykata ka theksuar se neni 6 gjen zbatim ndaj tërësisë të procedurave në lidhje me “bazueshmërinë e çdo akuze penale”²⁷⁸, duke filluar që nga faza e hetimeve të kryera nga ana e policisë²⁷⁹, deri tek ajo e caktimit të dënimit.

Avokati i Popullit vlerëson se procesi në çështjen e ankuesit nuk mund të konsiderohet kompleks dhe vëren se IPK-ja, duke luajtur rolin pasiv për të trajtuar rastin e ankuesit në mënyrë efikase dhe të bazuar në ligje të aplikueshme, ka shfaqur një mangësi të veprimit, respektivisht të funksionimit të saj dhe dyshime për arbitraritet.

Avokati i Popullit në këtë rast vlerëson se viktimizimi nuk mund të interpretohet në kuptim të ngushtë, por gjithsesi duhet të shihet në dritën e rrethanave të rastit e që kanë të bëjnë me veprimet që ankuesi i ka ndërmarrë në raportimin e rastit për të cilin ai ka vlerësuar së mund të përbente shkelje të ligjit. Ndërsa një ndër kuptimet e ngushta të konceptit të viktimizimit paraqitet situata kur personi vendoset në pozitën e viktimës për shkak të raportimit apo ngritjes së çështjeve për rastet që ndërlidhen me trajtimin e pafavorshëm në gëzimin e të drejtave të tij/saj.

Avokati i Popullit në këtë raport konstaton se IPK-ja nuk e ka trajtuar rastin në mënyrë efikase dhe nuk ka vepruar sipas legjislacionit të aplikueshëm. Ky proces, edhe pse është zhvilluar vetëm në fazën parapenale, rezulton se po zgjat për gati gjashtë vjet, ndonëse nga Prokurori i Shtetit rasti vetëm se është mbyllur me raport, ndërsa zvarritja e paarsyeshme e IPK-së për ta përfunduar procedurën shkel të drejtën e ankuesit për mjete efektive juridike.

Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se ankuesit i është shkelur e drejta për një proces të rregullt, respektivisht e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Për sa i përket kësaj të drejte, Avokati i Popullit konstaton se ka shkelje të tri aspekteve të një procesi të rregullt: së pari, zgjatja e një procedure hetimore penale nga IPK-ja, prej vitit 2018, përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt; së dyti, fakti që ankuesi nuk është njoftuar brenda një afati

277 Rasti Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë, sidomos paragrafët 91 dhe 95.

278 Rasti Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar, 5.6.2001, nr. 41087/98, § 39.

279 Rasti Imbroscia k. Zvicrës.

sa më të shkurtër për natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; dhe së treti, linçimi publik nëpërmes mediave përbën shkelje të prezumimit të pafajësisë.

Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Inspektoratit Policor të Kosovës që pa vonesa të mëtejme të ndërmarrë veprime përkatëse në drejtim të përfundimit të procedurës hetimore ndaj ankuesit dhe evitimin e mëtejme të viktimizimit të tij, si dhe ndërmarrjen e masave për sigurimin e llogaridhënies për zyrtarët përgjegjës në IPK të përfshirë në rast, për shkak të shkeljeve ligjore, si dhe mospërfundimin e procedurës hetimore ndaj ankuesit, sipas legjislacionit në fuqi.

E Drejta për Mjete Juridike

Opinion lidhur me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet, rregullat e përgjithshme, kushtet e pranueshmërisë si dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Opinion mbështetet në një ankesë individuale dhe ka për qëllim të shprehë qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me detyrimet e organeve shtetërore që gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësive të tyre të veprojnë në përputhje me parimet, rregullat e përgjithshme, kushtet e pranueshmërisë si dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Ankuesja pohoi se ka aplikuar për pozitën stomatologe në QKMF në Fushë Kosovë, në Konkursin Nr. 686, shpallur më 7 korrik 2022, nga Komuna e Fushë Kosovës/Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. I është nënshtruar testit me shkrim më 29 korrik 2022, sipas njoftimit të Komisionit për Përzgjedhje të Komunës, për mbajtjen e testit.

Në QKMF në Fushë Kosovë ankuesja kuptoi se është publikuar lista me emrat e kandidatëve dhe pikët e fituara në testin me shkrim dhe në intervistë. Ankuesja ka shtuar se në listën e publikuar, tek emri i saj ishin dhënë pikët në testin me shkrim, ndërsa në rubrikën e pikëve të intervistës ishte vendosur shënimi “*ska ardh*”. Ajo theksoi se për intervistën me gojë nuk është njoftuar fare, megjithëse e ka kaluar testin me shkrim. Prandaj kundër listës së publikuar, më 29 gusht 2022, nëpërmjet shërbimit postar ajo parashtrou ankesë në Komisionin e Ankesave në Komunën e Fushë Kosovës, por asnjëherë nuk mori përgjigje.

Komuna e Fushë Kosovës në dy kërkesa të parashtruar për informacion rreth ankesës nuk dha përgjigje.

Mospërgjigja në ankesë, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, bien ndesh me parimet e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e objektivitetit dhe paanësisë dhe me parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, nga i cili rrjedh obligimi për organet e administratës publike që të veprojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme²⁸⁰ dhe se veprimet e tyre duhet të jenë të parashikueshme dhe ta respektojnë pritshmërinë legjitime dhe të arsyeshme të personave.

Organi publik, e që në këtë rast është Komuna e Fushë Kosovës (Komisioni i Ankesave), nuk e ka aplikuar procedurën administrative, e që është bazë për veprimtarinë e organeve publike në çështjet administrative dhe, rrjedhimisht, mosdhënia e përgjigjes në ankesën e ankueses nga Komuna e Fushë Kosovës përbën shkelje të së drejtës së ankueses për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e përcaktuar me nenin 31, paragrafi 1, të Kushtetutës dhe me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, që përcakton të drejtën për një proces të rregullt.

Avokati i Popullit sjell në vëmendje se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës

²⁸⁰ Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 7 dhe neni 8.

publike, ndër të tjerash, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët.²⁸¹ Pa i paragjykuar proceset e tjera që ndërlihen me çështjen e ankueses, nga analiza e çështjes vlerëson se Komuna e Fushë Kosovës (Komisioni i Ankesave) nuk e ka aplikuar procedurën administrative, që është bazë për veprimtarinë e organeve publike në çështjet administrative. Nuk janë respektuar parimet, rregullat e përgjithshme, kushtet e pranueshmërisë si dhe trajtimin të ankesave të qytetarëve, rrjedhimisht nuk ka vepruar sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe mosveprimi sipas përcaktimeve ligjore shpie në shkelje të së drejtës së njeriut, në rastin konkret të ankueses.

Nëpërmjet këtij opinioni Avokati i Popullit sjell në vëmendje obligimet kushtetuese dhe ligjore për autoritetet që ushtrojnë pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, se janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin, brenda kohës së arsyeshme.

Liria e Shprehjes

Gjuha në diskursin publik në raport me detyrimet që ka shteti për garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen për ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve lidhur me standardet ndërkombëtare dhe vendore, me të drejtën e lirisë së shprehjes, si dhe me konceptin e gjuhës së urrejtjes. Po ashtu ka për qëllim të kontribuojë në kuptimin e modeleve të diskursit të gjuhës së përdorur në mediet sociale dhe komunikimin publik në vend, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, fyese e retorikën që përfshin mospajtime me ide apo mendime të caktuara, sfidimin e ideve apo besimeve, retorikë që përfshin veprime negative jo të dhunshme apo karakterizime dhe ofendime dhe specifikime të karakterizimeve çnjerëzore të individit apo grupit/eve të prekur/a, si edhe të rrisë aftësinë e shoqërisë për të reaguar dhe për të zhvilluar narrativë që promovon të drejtat e njeriut, diversitetin dhe tolerancën.

Raporti bazohet në monitorimin, hulumtimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura nga seancat parlamentare, debatet televizive dhe komentet në mediat sociale, për periudhën kohore nga viti 2020 deri në vitin 2022 dhe synon ta pasqyrojë gjendjen e gjuhës së përdorur në diskursin e komunikimit publik në Kosovë. Dizajni i grupeve të të dhënave dhe zgjedhja e kornizës kohore u përcaktua nga qëllimi përfundimtar i hulumtimit: *ofrimi jo vetëm i një pasqyre të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse mbi instancat dhe grupet e ndryshme të cilat mund të jenë cak i gjuhës së urrejtjes në diskursin publik në Kosovë, por edhe i nxitësve të mundshëm të urrejtjes (me apo pa qëllim).*

Raporti jep një pasqyrë të analizës së diskursit publik e mediatik, duke ndërthurur qasje sasiore dhe cilësore, pas shqyrtimit të transkripteve të: 8 seancave parlamentare (janar 2022– mars 2022); 23 emisione - debate televizive të transmetuara online; 4 platforma të mediave sociale; 43.511 komente dhe 313 postime lajmesh në rrjetet sociale. Hulumtimi ka gjetur modele të përsëritura, siç janë arsyet dhe caqet e gjuhës së përdorur (besimi politik dhe përkatësia politike; përkatësia etnike; feja; seksi, gjinia dhe orientimi seksual), forma të shprehjes (kërcënime dhe mallkime; fyerje në baza racore dhe etnike; metafora çnjerëzore); si dhe diskursi mediatik që shkakton edhe komente urrejtjeje nga përdoruesit e mediave sociale; mungesa e moderimit në media që ekspozojnë opinionin publik ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes.

Vëmendje i është kushtuar edhe diskursit retorik dhe gjuhës së përdorur ndaj personave LGBTI, ndikimin e diskursit publik, agjendës në mediumet kryesore dhe atyre sociale, si dhe reagimet e opinionit publik ndaj tyre.

281 Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative, i miratuar nga Parlamenti Evropian më 2001.

Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes paraqesin çështje komplekse për sa i përket mënyrës se si autoritetet shtetërore mund dhe duhet të ekuilibrojnë përgjegjësinë e tyre për të reaguar me shpejtësi dhe efektivitet në rastet kur identifikohet se një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime. Gjuha e urrejtjes në diskursin publik, në përgjithësi në Evropë, është theksuar më shumë në kohën e pandemisë COVID-19 dhe ngre nevojën për punë të pandërprerë në monitorimin, parandalimin dhe luftimin e saj, gjuhës së urrejtjes dhe format e tjera të shprehjes si në internet dhe jashtë tij.²⁸² Puna e pandërprerë në këtë kuptim ndërthet në vete një sërë veprimesh dhe aktiviteteve, duke nisur nga fushatat vetëdijesuese në institucionet parashkollore e tutje, efikasiteti i reagimit nga organet e drejtësisë si dhe një varg veprimesh e masash konkrete në luftën kundër diskriminimit në cilëndo bazë, e të gjitha këto veprime e masa do të duhej të ndërmerreshin nga institucionet publike në partneritet dhe koordinim me shoqërinë civile në vend.

Është e rëndësishme të theksohet ndjeshmëria dhe sfida komplekse që paraqet vendosja e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes, si e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike, si dhe përcaktimit të kufijve të saj në raport me të drejtat e tjera. Vendosja e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes dhe kufijve të saj paraqet sfidë të vazhdueshme edhe në institucionet me të larta ndërkombëtare, siç është edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj). Megjithatë, përcaktimet në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe sidomos jurisprudenca e GjEDNj-së kanë ndërtuar një standard mbi garantimin e lirisë së shprehjes dhe përcaktimin e kufijve të nevojshëm.²⁸³

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNj), në nenin 10, e përcakton mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirisë së mendimit dhe shprehjes së qëndrimit (paragrafi 1), por përcaktohen edhe kushtet për kufizimin e saj (paragrafi 2). Pra, liria e shprehjes si koncept nënkupton një kornizë më të gjerë të të drejtave që përfshinë brenda saj, siç janë: liria për mbajtjen e opinioneve pa ndërhyrje (liria e opinionit), liria për të kërkuar, marrë dhe ndarë informatat dhe idetë (gojarisht, me shkrim, në formë të artit, përmes mediave, përfshin jo vetëm përmbajtjen, por edhe mjetet e shprehjes etj.²⁸⁴). Liria e shprehjes është liria e të gjithëve për t'u shprehur, është e drejta për të folur, për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike, artistike dhe shoqërore.

Një mendim unik dhe përgjithësisht i pranuar për përkufizimin e gjuhës së urrejtjes nuk ekziston, megjithatë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, gjuhën e urrejtjes e përcakton: *"...të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë dhe arsyetojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin apo format e tjera të urrejtjes në bazë të jotolerancës..."* Ndërsa Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) i përcakton format e gjuhës së urrejtjes kështu: *"Të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuuar si raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual."*

Përkundër mungesës së një përkufizimi unik dhe të pranuar nga të gjithë, hasim në dy elemente që e dallojnë gjuhën e urrejtjes:

- shenjëstrimi i një grupi apo individit si pjesëtar i grupit të caktuar në bazë të tipareve fizike, shoqërore e kulturore kundër të cilit drejtohet ajo gjuhë;

282 KERI, Raporti vjetor mbi aktivitetet e KERI-t, që mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2017, <https://rm.coe.int/annual-report-on-ecri-s-activities-covering-the-period-from-1-january-/16808c168b>.

283 Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit të Kosovës, Ex officio 707/2017, lidhur me lirinë e shprehjes (medieve) dhe sigurinë e gazetareve, shih në <https://bit.ly/3RL8gDR>

284 Raport i Avokatit të Popullit Ex officio nr.707/2017, 2 nëntor 2017, para. 24, fq. 5., shih në: <https://oik-rks.org/2017/11/02/raport-ex-officio-lidhur-me-lirine-e-shprehjes-dhe-sigurine-e-gazetareve/>

- prania e një shkaku përcaktues që e karakterizon një grup të synuar, si: raca, feja, etnia, shtetësia, orientimi seksual, gjinia dhe baza të tjera të mbrojtura, me përmbajtje që shpreh urrejtje, qëllim për të lënduar ose ofenduar, si dhe natyra publike e gjuhës.

Plani i Veprimit të Rabatit²⁸⁵ ndihmon në përcaktimin e kufijve të lirisë së shprehjes, duke vlerësuar secilin rast veç e veç në meritat e tij dhe duke pasur parasysh :1) *Kontekstin social dhe politik*, 2) *Statusin e folësit*, 3) *Qëllimin*, 4) *Përmbajtja dhe forma e gjuhës*, 5) *Shtrirja e përhapjes së saj*, 6) *Gjasat e dëmit, përfshirë afërsinë*.

Po ashtu është e nevojshme që të vlerësohet edhe nga perspektiva e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëse kufizimet e lirisë së shprehjes janë të përcaktuara me ligj, ndjekin një qëllim legjitim si dhe nëse janë të nevojshme dhe proporcionale për qëllimin e ndjekur.²⁸⁶ Liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të justifikuar gjuhën e urrejtjes. Diskurset, të cilat mund të jenë ofenduese, duhet të dallohen nga gjuha e urrejtjes. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e ka përshkruar “gjuhën e urrejtjes” si “forma të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes në bazë të intolerancës.”²⁸⁷

Pra, gjuha e urrejtjes lidhet ngushtë me diskriminimin, si një shprehje drejtuar një grupi apo individ, i cili ka një karakteristikë që përfshihet në bazat që mbrohen në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi. Në shumë raste, gjuha e urrejtjes është një formë e diskriminimit dhe në këto raste duhet merret parasysh detyrimi pozitiv i shtetit për parandalimin e saj me qëllim mbrojtjen e së drejtës për trajtim të barabartë e pa diskriminim.

Avokati i Popullit, nga monitorimi i 9 seancave parlamentare në Kuvendin e Kosovës, brenda periudhës kohore janar 2020 – mars 2022, gjen se nuk është hasur nxitje e drejtpërdrejtë e urrejtjes. Megjithatë, në këto seanca parlamentare është hasur në shprehje të tjera të gjuhës së përdorur, ajo që te të gjeturat e këtij raporti është vlerësuar si *gjuhë e butë e urrejtjes*. Po ashtu, Avokati i Popullit gjen se rastet e gjuhës së urrejtjes që janë hasur në analizimin e seancave parlamentare nuk thonë thjesht se dikush duhet të urrehet, por ofron mbështetje të urrejtjes së supozuar diskriminuese. Pra, gjuha e urrejtjes nuk manifestohet domosdoshmërisht përmes shprehjeve të urrejtjes, por mund të fshihet në deklarata që në shikim të parë mund të duken të arsyeshme ose normale.

Të gjeturat nga monitorimi i mediave dhe ndikimi në gjuhën e përdorur nga ndjekësit në rrjetin social

Nga monitorimi i 23 emisioneve të debateve televizive të transmetuara edhe në mediat online, në tri media të ndryshme, dhe nga komentet që ato kanë prodhuar nga ndjekësit në rrjetet sociale, Avokati i Popullit gjen se gjuha e urrejtjes është mjaft e shprehur. Avokati i Popullit thekson se komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve të tjera nuk janë vetëm rezultat i komenteve të tjera në transmetimin e drejtpërdrejtë të debatit në Facebook, ato lidhen drejtpërdrejt me temën që debatohet nga të ftuarit në emisionet e debateve televizive.

Po ashtu, bazuar në emrat e përdoruesve dhe fotot e profilit në Facebook, marrë parasysh se profilet nuk janë vërtetuar për sa i përket përcaktimit të gjinisë dhe faktin nëse profilet ishin të rreme apo të vërteta, hulumtimi gjen se 86% e komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve të tjera janë postuar nga burrat, ndërsa 9.3% e tyre janë postuar nga femrat, përderisa 5% e profileve nuk u identifikuan.

285 https://www.ohchr.org/sites/default/files/Rabat_draft_outcome.pdf

286 <https://rm.coe.int/handbook-2/16806fc139>

287 <https://rm.coe.int/1680505d5b>

Ndërsa, për sa u përket shënjestrave se kë sinonin në mënyrë specifike komentet me gjuhën e urrejtjes, hulumtimi gjen se tendenca më e madhe e këtyre komenteve sinonin kryesisht personat publikë (liderë politikë, politikanë në përgjithësi, apo analistë të ftuar në debate televizive). Në përgjithësi, gjuha e urrejtjes sinon persona të caktuar në 8 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.

Për sa i përket relevancës sasiore brenda korpusit të të dhënave, shumica e komenteve ishin ato që sinonin besimet politike, pasojnë komentet në lidhje me profesionet dhe tiparet morale të konotuara negativisht, të kategorizuara si të tjera, pastaj aftësinë e kufizuar, metaforat çnjerezore, përkatësia etnike, seksualiteti, mallkimi dhe besimi fetar.

Po ashtu, nëse në debatet televizive përdoret gjuhë e ashpër/papërshtatshme, shikuesit kanë më shumë gjasa të postojnë komente urrejtjeje në faqet e Facebook-ut, kur debati transmetohet drejtpërdrejt. Ndërsa kur në debatin televiziv temë kryesore ishte diskutimi në seancë parlamentare, datë 16 mars 2022, lidhur me Projektkodin Civil (ky diskutim parlamentar ishte tema kryesore në debatin televiziv *Debat Plus*, ndërsa në *Pressing* nuk është debatuar, dhe *Rubikon* nuk u transmetua në atë datë), komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes lidhur me temën e debatit në këtë emision në shumicën e rasteve kishin të bënin me gjininë dhe orientimin seksual. Shumica e komenteve u drejtuan mysafirëve të debateve televizive, të cilët ishin në favor të modifikimit të Kodit Civil dhe përmbanin raste të gjuhës me përmbajtje të emrave me konotacione pezhorative.

Të gjeturat lidhur me gjuhën e përdorur në platformat e mediave sociale

Për të eksploruar shembuj të komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në platformat e mediave sociale, janë mbledhur komentet nga faqet në Facebook të katër mediave online, - "Gazeta Express", "Telegrafi", "IndeksOnline", dhe "Kosovo Online". Përzgjedhja e këtyre katër mediave online është bërë në bazë të numrit të ndjekësve.

Hulumtimi gjen se 1 (një) koment në çdo 15 (pesëmbëdhjetë) komente përmban gjuhë të urrejtjes. Shumica e komenteve hyjnë në tri kategori: metafora çnjerezore, bindje politike dhe aftësi të kufizuara. Ka pasur komente në të cilat përdoruesit kanë përdorur metafora të lidhura me kafshët, metaforat bimore etj. Bindjet politike dhe aftësia e kufizuar janë në shënjestër të barabartë dhe gjerësisht. Seksualiteti dhe përkatësia etnike janë shenjësuar shpesh, ndërsa mallkimi ose feja mezi mund të kategorizohen. Gjuha e urrejtjes në lidhje me seksualitetin është gjetur në 10% të komenteve. Kjo e dhënë është veçanërisht e dukshme në komentet pas seancës parlamentare të 16 marsit 2022, kur u diskutua për çështjen e martesave të të njëjtit seks. Në përgjithësi, komentet me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes sinonin persona të caktuar në 6 nga 10 raste dhe grupe njerëzish në 3 nga 10 raste.

Nëse krahasojmë faqet (portalet) e përzgjedhura të katër mediave online në Facebook, vërehet një ndryshim i dukshëm në objektivat e komenteve të faqes në Facebook të mediumit online në gjuhën serbe në krahasim me tri portalet e tjera. Në portalin në gjuhën serbe, pothuajse 40% e komenteve sinonin një grup, që është pothuajse dyfishi në krahasim me shifrat e treguara nga analiza e 3 mediave në shqip. Ky rezultat mund të shpjegohet me faktin se tema kryesore e komenteve në faqen e Facebook-ut të mediumit në gjuhën serbe ka të bëjë me marrëdhëniet etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve

Numri më i madh i komenteve me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, e që si kategori dominuese ka seksualitetin, është evidentuar në komentet e qytetarëve në lajmet e mediave, më 16 mars 2022, që për temë kishin martesat e të njëjtit seks (25% e komenteve të gjuhës së urrejtjes).

Të gjeturat lidhur me diskutimet për çështjen e Veriut dhe marrëdhëniet ndëretnike

Kur në Kuvend u diskutua çështja e Veriut (shtrirja e legjitimitetit të shtetit të Kosovës në komunat veriore - tetor 2021), reflektoi edhe në gjuhën e komenteve në faqet e Facebook-ut të mediave. U vërejtën disa komente etnike si nga komuniteti shqiptar, ashtu edhe nga ai serb, dhe veçanërisht

në faqen e Facebook-ut të mediumit online në gjuhën serbe, ku rreth 20% e komenteve të gjuhës së urrejtjes kishin të bënin me marrëdhëniet ndëretnike. Shumica e këtyre komenteve të gjuhës së urrejtjes përmbanin terma nënçmues për shqiptarët e Kosovës.

Ndryshe nga vrojtimi i gjuhës së urrejtjes për përkatësinë etnike që shihen në faqet e Facebook-ut të mediave online shqipfolëse, ku mbiemra nënçmues për serbët përdoren edhe nga personat e përkatësisë etnike shqiptare kur synonin të ofendonin një person tjetër nga i njëjti grup etnik, kjo nuk është gjetur në faqet e Facebook-ut të mediave online serbishtfolëse, ku komentet e gjuhës së urrejtjes me konotacion etnik kanë për qëllim vetëm shqiptarët.

Avokati i Popullit, nga të gjeturat e këtij hulumtimi dhe bazuar në kërkesat që dalin nga *Rekomandimi CM/Rec(2022)161 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes*, vlerëson se duhet të punohet më shumë në iniciativat bashkëpunuese, të cilat duhet të përfshijnë më gjerësisht sektorin e tretë, duke përfshirë institucionet e pavarura, OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile; organet profesionale; platformat e mediave sociale të cilat mund të kenë nevojë të sfidohen në mënyrë më efektive për angazhimin e tyre aktiv në tregjet dytësore dhe duhet të synohet në luftimin më të mirë të gjuhës së urrejtjes dhe fenomeneve të krimit të urrejtjes duke përforcuar legjislacionin antidiskriminues, duke siguruar kod efektiv të sjelljes dhe duke nxitur parandalimin përmes fushatave solide të vazhdueshme ndërgjegjësuere në arsim, si dhe në sektorët publikë dhe të mediave, duke konstatuar si në vijim:

Avokati i Popullit vëren se Kuvendi i Kosovës nuk e ka nxjerrë Kodin e Sjelljes për deputetët, siç kërkohet me Rregulloren Kuvendit të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit konstaton se është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë Kodin e Sjelljes për deputetët, në mënyrë që të sanksionohet përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme, ofenduese, denigruese, poshtëruese dhe i gjuhës së urrejtjes.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e tematikës dhe qasjen gjithëpërfshirëse për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes, si dhe nisur nga rëndësia e Lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj në rastet kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime, Avokati i Popullit vëren se është i domosdoshëm angazhimi i institucioneve edukative e arsimore në mënyrë që të krijohen programe arsimore për nxënësit dhe studentët për të mësuar për pasoja e përdorimit të gjuhës së urrejtjes si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të përdorimit të gjerë të mediave sociale dhe mungesës së të kuptuarit se veprimet dhe gjuha e përdorur në rrjetet social mund të jetë po aq e përgjegjshme sa edhe fizikisht. Me qëllim të edukimit mediatik të shoqërisë, është e rëndësishme që nxënësit të mësojnë për dhe rreth mediave, si audiencë dhe si përdorues, duke përfshirë diversitetin, tolerancën shoqërore, jodiskriminimin në të gjitha nivelet e shkollimit.

Po ashtu, marrë parasysh kompleksitetin e tematikës dhe qasjen gjithëpërfshirëse për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes, si dhe rëndësinë e Lirisë së shprehjes dhe kufizimit të saj në rastet kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime, përcjella e jurisprudencës që prokurorët dhe gjyqtarët të jenë në hap dhe të përcjellin zhvillimet në jurisprudencën e GjEDNj-së kur përballen me trajtimin (ndjekjen/mbrojtjen/gjykimin) e rasteve të krimeve të urrejtjes për të siguruar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit konstaton se në programet trajnuese të Akademisë së Drejtësisë nuk ka module të veçanta apo të përfshira në programin e trajnimit të vazhdueshëm që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me këtë tematikë.

Avokati i Popullit vëren se gjuha e përdorur në debatet publike dhe në ligjërime politike nga politikanët ndikon në masë të madhe te publiku i gjerë dhe se kjo e përcakton tematikën dhe tonin e diskutimit publik. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishëm rolin

aktiv dhe përgjegjësini e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në mënyrë që të respektohet në mënyrë specifike ndalimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Për qarkun kohor që shqyrton ky raport, Avokati i Popullit konstaton se mungon moderimi në media që ekspozojnë opinionin publik ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se KPM-ja nuk ka treguar reagim në kohë reale në monitorimin e vazhdueshëm për gjuhën e urrejtjes. Avokati i Popullit e vlerëson të rëndësishëm angazhimin e KPM-së për fushata të vazhdueshme kundër gjuhës së urrejtjes duke përfshirë mënyrën se si mund të bëhen ankesat, si dhe të bashkëpunojë me media dhe gazetarë për parandalimin e gjuhën e urrejtjes dhe reagimit në kohë reale dhe të shpejtë kundër gjuhës së urrejtjes.

Avokati i Popullit vëren se publiku i gjerë duhet të jetë më i vetëdijshëm për pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe ndikimin e saj në shoqëri. Prandaj, Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishme që të gjitha shtyllat e pushtetit në vend të punojnë së bashku, duke përfshirë organizatat profesionale, si dhe organizatat joqeveritare, për të rritur ndërgjegjësimin, për të identifikuar praktikat më të mira, për të dënuar aktet e gjuhës së urrejtjes ose krimin e urrejtjes dhe për të riafirmuar parimet e demokracisë, sundimit të ligjit, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe angazhimin e vazhdueshëm të Organeve Vetërregulluese si KMSH-ja, në kuptim të fushatave për edukimin lidhur me ankesat në raport me gjuhën e urrejtjes, bashkëpunimin me OShC për të mbështetur ankuesit për paraqitjen e ankesave kundër gjuhës së urrejtjes, të punojnë me organet e mediave për të lejuar komentet në ueb-faqet e tyre, por të kërkojë që ato të filtrojnë komente të tilla në vend që t'i ndalojnë ato krejtësisht. Mediat dhe platformat e mediave sociale duhet të angazhohen në rishikimin e kodeve të tyre të sjelljes për të nxitur moderimin e përmbajtjes dhe, kur është e nevojshme, për të hequr përmbajtjen me urrejtje, në krijimin e proceseve për ndjekjen e menjëhershme të ankesave të përdoruesve kur shënjohej përmbajtja e gjuhës së urrejtjes, duke mos lënë anash ofrimin e trajnimeve profesionale për gjuhën e urrejtjes për punonjësit e tyre, si dhe të lehtësojnë shpërndarjen e fushatave ndërgjegjësuese për të parandaluar gjuhën e urrejtjes.

Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Kuvendit të Republikës së Kosovës që të nxjerrë Kodin e Sjelljes, siç parashihet me nenin 129 të Rregullores së Kuvendit, me të cilin ndër të tjerash do të përcaktojë vendosjen e masave ndaj deputetëve që nuk i përmbahen Kodit të Sjelljes në raport me gjuhën e përdorur gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit, si dhe të krijojë një mekanizëm për hetimin e ankesave ndaj deputetëve që nuk i përmbahen Kodit të Sjelljes.

Qeverisë së Republikës së Kosovës i rekomandoi që të hartojë program të veçantë për publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes dhe për pasojat e tyre dhe përmes mekanizmave të saj të organizojë në vazhdimësi fushata vetëdijësuese për publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes, sipas programit të hartuar.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i rekomandoi që të zhvillojë një strategji kombëtare për edukimin mediatik në nivelin e shkollimit parauniversitar dhe universitar, si dhe të përfshihet në kurrikulat shkollore Edukimi Mediatik në lëndët e detyrueshme në arsimin parauniversitar.

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i rekomandoi që në pajtim me detyrimet ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: të miratojë udhëzues për subjektet politike, me qëllim të parandalimit të gjuhës së urrejtjes; të krijojë mekanizëm të brendshëm dhe efikas të monitorimit dhe mbikëqyrjes së respektimit të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në mënyrë specifike për ndalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes; të harmonizojë përmbajtjen e formularit për regjistrimin e partive politike, njëjtë

siç është miratuar formulari për Certifikimin e Subjekteve Politike, kjo në pajtim me detyrimet e përcaktuara edhe në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, në zbatim të Kodit të Mirësjelljes dhe ndalimit të gjuhës që nxit urrejtje dhe diskriminim.

Akademisë së Drejtësisë i rekomandoi që të përfshijë trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, përkritazi me këtë tematikë, në modul të veçantë në programin e trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të Republikës së Kosovës.

Odës së Avokatëve të Kosovës i rekomandoi që të ofrojë trajnime për ndalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes si dhe të trajnohen për ndjekjen/mbrojtjen/gjykimin e rasteve të krimeve të urrejtjes, në mënyrë që ata të jenë në gjendje ta zbatojnë jurisprudencën e GjEDNj-së.

Komisionit të Pavarur për Media i rekomandoi që: të krijojë mekanizma për monitorimin dhe reagimin në kohë reale ndaj medieve audio-vizuale në vend, me qëllim të parandalimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes; të organizojë në vazhdimësi fushata vetëdijesuese për punëtorët e mediave dhe publikun e gjerë në edukimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme dhe të urrejtjes.

Liria e Asociimit

Opinion në lidhje me pretendimet për cenim të lirisë së asociimit dhe ushtrimin të aktivitetit sindikal si dhe diskriminim për shkak të angazhimit sindikal

Ky opinion pasqyron qëndrimet Avokatit të Popullit lidhur me cenimin e lirisë së asociimit dhe të organizimit të aktivitetit sindikal të të punësuarve të Limak Kosovo International Airport J.S.C. “Adem Jashari” (Limak - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – më tej referuar si: ANP).

Opinionin bazohet në ankesën që ka pranuar nga kryetari i Shoqatës Sindikale Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, me pretendimet: për largim nga puna të 51 punëtorëve të ANP-së pas grevës së mbajtur në vitin 2019, e organizuar me kërkesë për kushte më të mira të punës, moslejimin e kryetarit të sindikatës për qasje në zyrat, në dosjet e sindikatës dhe ushtrimin e aktivitetit sindikal si dhe pretendimet për shkeljen e vazhdueshme të të drejtave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të ANP-së.

Opinionin sjell në vëmendjen e autoriteteve kompetente nevojën për ndërmarrjen e masave për sigurimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi, e veçanërisht të Ligjit të Punës dhe të Ligjit për Organizimin Sindikal, garantimin e mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe ndalimin e diskriminimit të punëtorëve të ANP-së mbi bazën e anëtarësimit në sindikatë dhe angazhimit në aktivitete sindikale.

Pas analizimit të bazës ligjore, të fakteve dhe të pretendimeve të paraqitura në këtë rast, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se liria e asociimit është një e drejtë e njeriut e mbrojtur dhe e garantuar me akte ndërkombëtare dhe vendore dhe njëherësh është tregues për nivelin e funksionimit të demokracisë në shoqërinë bashkëkohore. Kjo për faktin se shoqatat sindikale kanë një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e të drejtave të punëtorëve, dëgjimin e kërkesave të tyre dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave themelore nga marrëdhënia e punës.

Anëtarësimi në sindikatë dhe angazhimi në aktivitete sindikale nuk do të duhej të ndikonin apo ta zvogëlonin nivelin e gëzimit të të drejtave themelore nga marrëdhënia e punës, e po ashtu nuk mund të jenë faktorë për trajtim të pabarabartë në raport me të tjerët. Sikurse është paraqitur edhe më lart, korniza ligjore në fuqi u jep hapësirë të mjaftueshme dhe të drejta të garantuara punëtorëve për ushtrimin e aktiviteteve sindikale. Gjithashtu dispozitat ligjore obligojnë punëdhënësin për krijimin e kushteve për ushtrim të aktiviteteve sindikale dhe njëkohësisht ndalojnë cenimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës apo çfarëdo diskriminimi mbi bazën e asociimit në sindikatë.

GjEDNj-ja nëpërmjet praktikës së saj, duke proklamuar rëndësinë e garantimit dhe respektimit të lirisë së asociimit, ka theksuar ndalimin e çfarëdo diskriminimi në gëzimin e të drejtave themelore, mbi këtë bazë. GjEDNj-ja, në rastin *Sanchez Navajas v. Spain*, theksoi se përfaqësuesit e punëtorëve duhet, si rregull dhe brenda disa kufijve, të gëzojnë lehtësira të përshtatshme për t'u mundësuar atyre t'i kryejnë funksionet e tyre sindikale me shpejtësi dhe në mënyrë efektive.

Sipas Udhëzuesit të Komisionit të Venecias, përkitazi me lirinë e asociimit: *“Liria e organizimit është një e drejtë themelore e njeriut që është thelbësore për funksionimin e një demokracie. Ai përbën një kusht thelbësor për ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut.”*

Avokati i Popullit vlerëson se institucionet përgjegjëse duhet t'i japin vëmendjen e duhur mbikëqyrjes së respektimit të plotë të dispozitave të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Organizim Sindikal, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe organizimit të aktivitetit sindikal, të punëtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet duhet t'i ndërmarrin masat e nevojshme që garantojnë ushtrimin e aktivitetit sindikal të kryetarit të Shoqatës Sindikale të ANP-së dhe të punëtorëve të aeroportit, pa ndonjë ndikim në trajtimin e pabarabartë në raport me punëtorët joanëtarë të sindikatës. Gjithashtu e vlerëson si të nevojshme gjetjen e modaliteteve të komunikimit dhe të lejimit të ushtrimit të aktivitetit sindikal në hapësirat e rezervuara për Sindikatën nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.

Mbrojta e Pronës

Opinion për procesin e shpronësimit në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok të Republikës së Kosovës

Nëpërmjet këtij Opinioni Avokati i Popullit do të ofrojë qëndrimin e tij lidhur me procesin e shpronësimit, në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore, për sa i përket mbrojtjes të së drejtës së pronës. Opinioni ka për qëllim pasqyrimin e çështjes së shpronësimit të pronave të paluajtshme në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok, në vështrim të përcaktimeve ligjore rreth procedurave të shpronësimit dhe shpalljes me interes të veçantë publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit lidhur me “Projektet Infrastrukturore për Interes Publik” dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Duke pasur parasysh faktin se për këtë çështje është iniciuar procedurë gjyqësore, Avokati i Popullit nuk do të lëshohet në vlerësim meritor, por do t'i paraqesë vetëm pikëpamjet e tij në vështrim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit vlerëson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar dispozita, sipas të cilave prona është e garantuar dhe se shpronësimi mund të realizohet nëse është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik, ose përkrahjen e interesit publik.

Qeveria dhe MMPHI-ja zhvilluan veprime procedurale për shpronësim në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok, duke nxjerrë vendime për shpalljen e atyre zonave me interes të veçantë, miratimin e vendimeve të tjera përcjellëse, mbajtjen e dëgjimeve publike dhe nxjerrjen e vendimit preliminar dhe përfundimtar.

Avokati i Popullit e vlerëson të rëndësishme që zhvillimi i procedurave të shpronësimit të bëhet në pajtim me dispozitat e përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mënyrë që pronarët e pronave që shpronësohen të kenë mundësi që ta realizojnë kompensimin real sipas vlerësimeve të organeve kompetente të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh përcaktimet në nenin 4, paragrafi 1, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, konsideron se për realizimin me sukses të një procesi të shpronësimit, është e nevojshme që të plotësohen kushtet, siç janë: qëllim i ligjshëm publik,

domosdoshmëria, mosdiskriminimi dhe organi shpronësues. Në vendimet e miratuara nga Qeveria nuk është qartësuar mjaftueshëm, në mënyrë që të kuptohet saktësisht se çka do të ndërtohet në kuadër të projekteve infrastrukturore me interes publik, për të cilat kërkohet të bëhet shpronësimi.

Mossqarimi i mjaftueshëm e bën të paqartë edhe qëllimin e ligjshëm publik, i cili është kushti i parë i cili duhet të plotësohet në një situatë shpronësimi. Si rezultat i paqartësisë së qëllimit të ligjshëm publik është i paqartë edhe vlerësimi i përmbushjes së kushtit të domosdoshmërisë dhe mosdiskriminimit në procesin e shpronësimit. Prandaj në këtë rast Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e institucioneve të Republikës së Kosovës se është obligim i organeve shtetërore që krahas projekteve të planifikuara, të zbatohen procedurat sipas përcaktimeve ligjore, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me instrumentet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e brendshëm, që rregullon të drejtat e njeriut përgjatë procesit të shpronësimit.

Lidhur me kundërshtimin e procesit të shpronësimit nga ankuesit, Avokati i Popullit konsideron se në asnjë rast nuk mund të kontestohet autorizimi i institucioneve për realizimin e shpronësimit, sepse një autorizim i tillë është i përcaktuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e po ashtu realizimi i këtij procesi është i përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Bazuar në pohimet e ankuesve se, edhe pse përfaqësuesit e institucioneve nuk e kanë bërë krejt të qartë qëllimin legjitim të shpronësimit, ata e kanë kuptuar se bëhet fjalë për ndërtimin e një baze të policisë, konsideron se në rrethanat kur bëhet fjalë për sigurinë e përgjithshme, ekzistenca e qëllimit legjitim nuk mund të jetë kontestuese. Prandaj në rastin konkret, Avokati i Popullit thekson se veprimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, kur kanë qëllim forcimin e sigurisë së përgjithshme, e konsumojnë qëllimin legjitim të shpronësimit, i cili në këtë rast nuk është bërë mjaftueshëm i qartë në vendimet e Qeverisë për shpronësim.

Avokati i Popullit konsideron se institucionet e Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë autorizime në realizimin e procesit të shpronësimit, nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se nuk mund të kontestohet shpronësimi, por mund të kontestohen veprimet procedurale, të cilat duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Avokati i Popullit konsideron se institucionet e Republikës së Kosovës kanë obligim pozitiv që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet në drejtim të qartësisë së qëllimit të ligjshëm publik, në mënyrë që ndërhyrja në pronat e pronarëve, për qëllimet e shpronësimit, të jetë qartë e dukshme dhe e lejueshme. Po ashtu është obligim i institucioneve të Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet procedurale në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mënyrë që krahas zhvillimit të projekteve të Qeverisë, të mbrohet edhe e drejta e pronës, e pronarëve, pronat e të cilëve shpronësohen. Vetëm në këtë mënyrë institucionet e vendit e përmbushin misionin në ushtrimin e autorizimeve publike në drejtim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët, duke i ruajtur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me instrumentet ndërkombëtare si dhe me legjislacionin në fuqi.

E Drejta për Arsimin

Ofrimi i sigurisë në mbarëvajtjen e mësimin në shkollën fillore të mesme të ulët në fshatin Livoç

Rasti është hetuar sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në informatat e pranuar se në një klasë të objektit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët (ShFMU) “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoç i Ulët, komuna e Gjilanit, kanë rënë pjesë të gëlqeres nga tavani duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e nxënësve dhe të personelit të shkollës.

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se secili individ gëzon të drejtën për jetën (neni 25, paragrafi 1), po ashtu garantohet se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre (neni 50, paragrafi 1), si dhe të drejtën e shkollimit të detyrueshëm pa pagesë, të financuar nga fondet publike (neni 47, paragrafi 1), prandaj Kushtetuta shprehimisht garanton të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për institucionet shtetërore për t’i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila është pjesë përbërëse e Kushtetutës së vendit, në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”* Gjithashtu sipas Konventës përcaktohet se shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë [...] (neni 24).

Duke pasur parasysh se deri në ndërtimin e objektit të ri të shkollës, është e nevojshme një periudhë më e gjatë kohore, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta dhe shëndeti i fëmijëve dhe i personelit të shkollës gjatë kësaj periudhe, autoritetet përgjegjëse duhet të gjejnë një zgjidhje, në mënyrë që të garantojnë një ambient të sigurt për nxënësit dhe për personelin gjatë qëndrimit në shkollë, po ashtu të garantojnë përkujdesjen efektive për fëmijët, shëndeti dhe mirëqenia e të cilëve janë në rrezik.

Për vlerësimin e Avokatit të Popullit, vazhdimi i mësimin në objektin e ShFMU-së “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoç i Ulët, në këto kushte, paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe të personelit të shkollës, prandaj institucionet përgjegjëse duhet ta trajtojnë me prioritet çështjen në fjalë. Vonesat për gjetjen e një zgjidhjeje janë në kundërshtim me frymën e dispozitave të lartcekura, të cilat garantojnë të drejtat e fëmijëve dhe detyrimet e shtetit për t’i ofruar dhe mbrojtur ato. Për këtë nëpërmjet këtij raporti iu rekomandua kryetarit të komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë Komonale të Arsimin në Gjilan që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për t’ua siguruar të gjithë fëmijëve një mjedis shkollor të shëndetshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm, sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor.

Përfshirja e standardeve të zbatueshme të fushës së të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë

Duke qenë se sistemi arsimor në përgjithësi, specifikisht arsimit të mesëm të lartë, është mekanizmi më gjithëpërfshirës dhe më përcaktues në edukimin e nxënësve, përfillja e standardeve të fushës së të drejtave të njeriut dhe përfshirja e tyre në tekstet shkollore janë dy elemente shumë përcaktuese për edukimin e nxënësve mbi të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, ajo çfarë mësojnë dhe si mësojnë nxënësit në shkollë për të drejtat e njeriut përmes teksteve shkollore janë përcaktuese për atë se çfarë do të mendojnë nxënësit edhe në vitet në vijim për të drejtat e njeriut.

Raporti është hartuar duke analizuar përmbajtjen e 19 teksteve shkollore të klasave 10, 11 dhe 12, të të gjitha drejtimeve të shkollave të mesme, si për gjimnaze shoqërore-gjuhësore,

ashtu edhe për gjimnaze natyrore. Duke qenë se qëllimi i raportit është i fokusuar ekskluzivisht në fushën e të drejtave të njeriut, rrjedhimisht hetimi është zhvilluar për tekstet e lëndëve shkollore nga shkencat shoqërore dhe fushat humane në përgjithësi, të tilla si: lënda për gjuhën amtare, për letërsinë, për historinë, për filozofinë, logjikën, psikologjinë, sociologjinë dhe edukatën qytetare.

Raporti ka për qëllim vlerësimin e nivelit të përfshirjes së standardeve që janë në zbatim në fushën e të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në sistemin arsimor në Republikën e Kosovës.

Në sistemet publike të edukimit, tekstet shkollore janë librat me ndikimin më të madh dhe më të gjerë në shoqërinë e një vendi. Ato përcjellin frymën e sistemeve të vlerave dhe të traditave kulturore të një shoqërie, por edhe vizionin e shtetit përkatës për qytetarët e tij. Si gjatë shkollimit formal të fëmijëve në shkollimin fillor, ashtu edhe të fëmijëve në shkollimin e mesëm të lartë, roli arsimor dhe ndikimi edukues i teksteve shkollore është gjithëpërfshirës dhe tejet përcaktues në formësimin kulturor të të rinjve përgjatë gjithë jetës. Duke përjashtuar njohuritë profesionale të marra më pastaj dhe ato mbi fushat e studimit të ata që ndjekin studimet universitare, shumica e nxënësve përgjithësisht nuk i tejkalojnë ose nuk i zëvendësojnë apo nuk i plotësojnë njohuritë e tyre bazike përtej atyre të marra gjatë shkollimit të ciklit fillor dhe të mesëm. Ato çfarë lexojnë, ato çfarë mësojnë dhe ato për çfarë u kërkohet nxënësve të mendojnë në shkollë janë përcaktuese për formimin kulturor dhe formësimin qytetar të tyre. Për këtë arsye, hartimi i programeve dhe i kurrikulave prej nga përpilohen tekstet shkollore, shpërfaq edhe përfytyrimin e institucioneve shtetërore për shoqërinë e tyre. Tekstet shkollore në përgjithësi, veçanërisht ato të fushave shoqërore, e reflektojnë perceptimin e komunitetit për veten dhe hierarkinë e vlerave kulturore dhe humane të tij. Rrjedhimisht, tekstet shkollore gjithmonë janë edhe një korpus unik librash, përmes të cilave autoritetet shtetërore i konstruktojnë identitetet kolektive të shoqërisë dhe shtrojnë rrugë nga sugjerohet ecja e njerëzve. Disa nga mitet më të ngulitura në vetëdijen kolektive të komuniteteve dhe shoqërive janë konstrukte të prodhuara dhe të kultivuara pikërisht nga tekstet shkollore.²⁸⁸

Ky raport është vazhdimësi e raportit të ngjashëm paraprak të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është fokusuar te prania dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes në tekstet shkollore të ciklit të ulët në Kosovë.²⁸⁹ Ndryshe prej tij, ky raport është hartuar duke hulumtuar përfshirjen e standardeve të aplikueshme në fushën e të drejtave të njeriut në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë. Më tutje, ky raport është i përqendruar te kërkimi i nivelit të përfshirjes së standardeve për fushën e të drejtave të njeriut në librat shkollor të arsimit të mesëm të lartë në sistemin shkollor publik në Republikën e Kosovës.

Duke u nisur nga ideja fillestare se të drejtat e njeriut janë të trajtuara si fushë, por edhe të cenueshme në aspektin se si njerëzit flasin dhe shkruajnë për to, kryesisht në kuadër të lëndëve shkollore nga fushat e shkencave shoqërore, gjuhësore dhe humane, mostra e përzgjedhur e teksteve nëpërmjet të cilave është hartuar ky raport është pothuajse totale. Për formimin e kësaj mostre janë përfshirë të gjitha lëndët shkollore të fushave shoqërore, gjuhësore dhe humane, që gjithsej janë tetë: Gjuha shqipe, Letërsia, Historia, Filozofia, Logjika, Sociologjia, Psikologjia dhe Edukata qytetare. Së këndejmi, mostra e teksteve shkollore prej të cilave është hartuar ky raport, përbëhet prej tri tekstesh nga Gjuha shqipe, katër nga Letërsia, tri nga Historia, dy nga lënda Filozofi dhe logjikë, dy nga Sociologjia, dy nga Psikologjia dhe tri tekste nga lënda Edukatë qytetare.

288 Durim Abdullahu, Myths in Kosovar Textbooks: History in the Service of Identity Construction, in c. Lichnofsky, E. Pndelejmoni, D. Stojanov, Myths and Mythical Spaces: Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe, Gottingen: V&R Press, 2018, ff. 34-55.

289 <https://oik-rks.org/2023/08/11/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-1472021-gjuha-e-urrejtjes-ne-tekstet-shkollore-te-ciklit-te-ulet-ne-kosove/>

Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit dhe analizimit të teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, konstaton se niveli i përgjithshëm i teksteve shkollore në sistemin arsimor të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë, në raport me fushën e të drejtave të njeriut, është i kënaqshëm, por ka mjaft hapësirë për përmirësime dhe për plotësime e të cilat duhet të nisin nga kurrikulat e pastaj të reflektojnë te njësitë mësimore brenda teksteve. Në bazë të vlerësimit dhe analizimit të teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, konstaton se tekstet mësimore të lëndës Gjuhë shqipe dhe ato të lëndës Letërsi, për klasat 10, 11 dhe 12, nuk kanë përmbajtje që specifiku janë problematike në raport me fushën e të drejtave të njeriut.

Shumica e gjetjeve të këtij raporti, pra pjesët tekstuale të problematizuara në lidhje me të drejtat e njeriut, janë evidentuar në tekstet shkollore të lëndëve Edukatë qytetare, Histori, Sociologji dhe Psikologji, meqë ato kanë më shumë njësi mësimore me përmbajtje nga fusha e të drejtave të njeriut. Bazuar në të gjeturat nga analizimi i teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë, rezulton se e përbashkëta e gjetjeve të këtij raporti, që është nxjerrë nga rastet e listuara në të, mund të përmbledhet në dy pika, që mund të lexohen edhe si dy vërejtje: përdorimi joadekuat i nocioneve profesionale nga fushat e të drejtave të njeriut, përkatësisht mosunifikimi i terminologjisë, gjegjësisht përdorimet me disa kuptime dhe nënkuptime të ndryshme të fjalorit profesional të fushës së të drejtave të njeriut; dhe shtjellimi i pamjaftueshëm si dhe shembujt e paktë ilustrues për format e shkeljeve dhe mbrojtjeve të të drejtave të njeriut.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të unifikohet gjuha terminologjike, përkatësisht përdorimi i termave dhe i koncepteve kyçe, me të cilat operohet në fjalorët e sociologjisë, psikologjisë dhe edukatës qytetare, në raport me fushën e të drejtave të njeriut. Të shtjellohen sa më qartë, me shembujt dhe me shpjegime shtesë edhe në formë fjalorthësh specifikë me fjalë të reja për nxënësit, si dhe të përshtaten shembujt me kontekstet sociale dhe kulturore të shoqërisë në Kosovë, ashtu që fenomenet dhe termat të jenë të qartë, të kuptueshëm dhe pa lënë hapësirë keqkuptimesh për nxënësit; Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, të ndërmerren masa për eliminimin e të gjitha fjalëve apo termave, fjalive apo paragrafëve me përmbajtje të papërshtatshme që përmbajnë ide apo që nxisin dhe kultivojnë ide që shkojnë kundër frymës së njohjes dhe respektimit të fushave të të drejtave të njeriut. Në kurrikulën për tekstin e lëndës së Historisë, për klasën e 12-të, ku janë përfshirë mësimet nga historia moderne dhe bashkëkohore, të përcaktohen njësi të veçanta mësimore për historinë e të drejtave të njeriut; për lëvizjet shoqërore të sindikatave që kanë avokuar për të drejtat e punëtorëve; për valët e feminizmit që janë angazhuar për të drejtat e grave dhe për barazi gjinore; për konventat ndërkombëtare, rezolutat dhe dokumentet e tjera relevante për të drejtat e njeriut; Është me rëndësi që shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë luftës në Kosovë, që u referohen krimeve të kryera gjatë saj, krimeve kundër njerëzimit dhe akteve gjenocidale, të pasqyrohen në lëndët Histori dhe Edukatë qytetare. Kjo pasi një nga fushat kyçe për të drejtat e njeriut është ajo që lidhet me Krimet e Luftës dhe Krimet Kundër Njerëzimit, duke përfshirë Gjenocidin, të normuara veçanërisht me Konventën mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve të Gjenocidit (1948) dhe Konventën Relative të Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Luftë (1949).

E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

Opinion në lidhje me largimin nga puna të disa zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Nëpërmjet këtij opinioni Avokati i Popullit ofron qëndrimin e tij lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës të disa zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore për sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Duke pasur parasysh faktin se për çështjet e ngritura parashtruesit e ankesave veçse janë në shfrytëzim të mjeteve juridike, përkatësisht janë duke u zhvilluar procedura gjyqësore, nuk lëshohet në vlerësim meritore të vendimeve me të cilat ankuesve u është ndërprerë marrëdhënia e punës, por jep vlerësimin e tij lidhur me aspektet e lirive dhe të drejtave të garantuara, siç janë: e drejta e ushtrimit të profesionit, sigurinë juridike, si element i rëndësishëm i sundimit të ligjit, pritshmërinë legjitime dhe respektimin e procedurave ligjore në çdo rast që prek, kufizon apo mohon të drejtat e garantuara me Kushtetutë apo me akte të tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit vlerëson se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (*shih rastet Kopecky v. Slovakia, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, § 73, GjEDNj 2002-VII*), "pritshmëria legjitime" duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime reflektohet në faktin se për largimin nga puna në shërbimin civil duhet të vepohet sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil dhe sipas rrethanave të përcaktuara në këtë ligj. Veprimi pa u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil dhe pa u plotësuar rrethanat e përcaktuara në këtë ligj bien ndesh me konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe me konceptin e sigurisë juridike.

Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se pritshmëria e ligjshme dhe e arsyeshme është e pandashme me konceptin e sigurisë juridike dhe se të dyja konceptet nuk mund të interpretohen ndaras njëra nga tjetra. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se koncepti i sigurisë juridike në këtë rast nënkupton faktin se institucioni duhet t'i ndërmarrë veprimet konkrete të bazuara në dispozita ligjore, të cilat në mënyrë të qartë kanë rregulluar çështjen në fjalë.

Avokati i Popullit konsideron se nxjerrja e vendimeve për largimin e zyrtarëve nga marrëdhënia e punës duhet të bartë në vete frymën e sundimit të ligjit si dhe të jenë në pajtim me konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike. Prandaj Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret vendimet e MPJD-së nuk duket se në vete bartin frymën e sundimit të ligjit e po ashtu nuk janë në harmoni me konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike.

Të Drejtat e Fëmijës

Trajtim jo i barabartë i fëmijës me aftësi të kufizuara në të drejtën për arsim parashkollor

Raporti është hartuar duke u bazuar në një ankesë individuale dhe ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Komunës së Fushë Kosovës, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, përkatësisht trajtimin jo të barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuara për të pasur qasje në edukimin parashkollor dhe nëpërmjet rekomandimeve kërkohet nga Komuna e Fushë Kosovës që të krijojë mundësi të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara në sigurimin e një vendi në institucionin parashkollor.

Në ankesën e saj ankuesja pohoi se djali i saj për dy muaj ka qenë pjesë e kopshtit A-Z, derisa është larguar me arsyetimin se për shkak të tij do të ngecnin edhe fëmijët e tjerë.

Ajo pohoi se vazhdimisht kërkoi regjistrimin e fëmijës së saj në disa nga kopshtet private dhe publike në komunën e Fushë Kosovës, por nga asnjëri nuk i është dhënë përgjigje. Madje në disa nga ato i është kërkuar të angazhonte asistente me pagesë, me arsyetimin se puna me fëmijën e saj mernte kohë dhe energji më shumë sesa me fëmijët e tjerë. Po ashtu ajo disa herë i është drejtuar Komunës së Fushë Kosovës – DKA-së, por asnjëherë nuk ka marrë përgjigje.

Në komunikimin me Avokatin e Popullit, kryetari i komunës së Fushë Kosovës njoftoi se Institucioni Parashkollor “Gëzimi Ynë” është i vetmi kopsht publik në komunën e Fushë Kosovës. Më tej në përgjigje ka theksuar se numri i madh i fëmijëve në grup-moshën e fëmijës së ankueses (4-5 vjeç), përfshirë edhe aftësinë e kufizuar të fëmijës, e ka pamundësuar pranimin e fëmijës në kopsht. Në përgjigje gjithashtu është sqaruar se duke u bazuar në trendin e rritjes së banorëve dhe kërkesave për regjistrim në institucionin parashkollor, Komuna ka hapur konkurs për vende të lira, por për grup-moshën 4-5 dhe 5-6-vjeçare nuk ka pasur vende të lira në kopsht.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se kujdesi i hershëm në fëmijëri është hapi i parë i shkallës së të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijës, e konsideron të domosdoshme që institucionet të krijojnë hapësira dhe kapacitete në mënyrë që fëmijët, pa dallim, të kenë qasje të lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte. Studime të shumta mbështetin faktet se ky edukim i ndihmon fëmijët të zhvillojnë potencialin e aftësive të tyre më të mira dhe kontribuon në mirëqenien e tyre.²⁹⁰ Po ashtu, zhvillimi i shëndetshëm në vitet e para u mundëson fëmijëve, përveç të tjerash, edhe ndërtimin e blloqeve të trurit për arritje akademike, qytetari përgjegjëse, jetë të shëndetshme dhe prindërim të suksesshëm edhe për gjeneratën tjetër.

Bashkimi Evropian (BE) gjithashtu vëren se pjesëmarrja në edukimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme ka përfitime të shumta individuale dhe kolektive meqë ndikon në rezultate më të mira në arsim dhe në tregun e punës dhe në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse. Fëmijët që ndoqën arsimin e fëmijërisë së hershme për më shumë se një vit, treguan rezultate më të mira në gjuhë dhe matematikë në testime si dhe testimet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Studentit (ang. PISA). Pjesëmarrja në arsimimin dhe kujdesin cilësor të fëmijërisë së hershme është treguar gjithashtu të jetë një faktor i rëndësishëm për ta parandaluar braktisjen e shkollës.²⁹¹

Komisioni i BE-së ka miratuar një rekomandim të rëndësishëm lidhur me sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve me synimin të zhvillojë dhe forcojë qasjet e përgjithshme për mbrojtjen e fëmijëve. Përveç të tjerash, ky rekomandim u bën thirrje shteteve anëtare që të krijojnë një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës në arsim, duke përfshirë edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, dhe në trajnim, duke luftuar diskriminimin dhe duke u përgjigjur cenimit specifik të grupeve të ndryshme të fëmijëve.²⁹²

Gjithëpërfshirjen e ulët në sistemin arsimor në Kosovë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit e ka konstatuar edhe në Raportin ex officio lidhur me përfrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim.²⁹³ Lidhur me këtë, Avokati i Popullit u ka rekomanduar të gjitha komunave të Republikës

290 <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/16274-20201022.pdf> .

291 Rekomandim i Këshillit i 22 majit 2019 mbi sistemet e arsimit dhe kujdesit të hershëm me cilësi të lartë.

292 [Commission Recommendation \(EU\) 2024/1238 of 23 April 2024 on developing and strengthening integrated child protection systems in the best interests of the child \(europa.eu\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32024R1238)

293 <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

së Kosovës, përfshirë komunën e Fushë Kosovës, që ta kenë prioritet dhe ta rrisin financimin për ofrimin e edukimit parashkollor/parafillor në komunë, për t'i shtrirë shërbimet parashkollore edhe në zona rurale.

Avokati i Popullit vlerëson se në këtë rast e drejta e fëmijës për përfshirje në institucion parashkollor, si e drejtë fillestare e arsimimit të fëmijëve, duhet të mundësohet nga institucionet relevante, në mënyrë që fëmijëve me aftësi të kufizuara t'u mundësohet qasje sa më e lehtë dhe efektive në realizimin e kësaj të drejte.

Avokati i Popullit vëren se me gjithë faktin se Komuna e Fushë Kosovës aktualisht nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të përfshirë në institucionet parashkollore fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo përbën bazë të diskriminimit në të drejtën për arsimin parafillor, duke shkelur kështu të drejtën që fëmijët me aftësi të kufizuara duke u mohuar atyre të gëzojnë të drejta të njëjta sikur të gjithë fëmijët e tjerë.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Fushë Kosovës që duke pasur parasysh se edukimi parashkollor është hallka e parë e sistemit të arsimit dhe realizohet në institucionet parashkollore, të ndërmarrë veprime për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës së institucioneve parashkollore në territorin e komunës, në mënyrë që të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse, që do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë dhe do t'i përmbushë nevojat dhe aftësinë specifike të çdo fëmije.

Mohimi i së drejtës për arsimim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë

Raporti është hartuar bazuar në ankesën e parashtruar nga Grupi Teknik i Punës për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian (në tekstin e mëtejme: Grupi Teknik). Sipas kësaj ankese, përveç të tjerash theksohej në tetor të vitit 2020, në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Selman Riza" në Fushë Kosovë ka filluar të organizohej mësimi alternativ plotësues për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali. Mësimi alternativ i filluar në tetor 2020 është ndërprerë pa paralajmërim, pa vendim dhe njoftim zyrtar dhe pa e realizuar qëllimin. Arsyetimi i dhënë është se nuk ka mjete për mbulim të stafit mësimor dhe se kanë marrë vërejtje nga auditori përkitazi me këto çështje. Më datë 26.2.2021, drejtori për Arsim në Komunën e Fushë Kosovës, përmes e-mailit të dërguar ka theksuar se nuk mund të vazhdohet me mësimin intensiv/alternativ, për shkak të buxhetit. Përgjatë kohës sa është mbajtur mësimi alternativ, nga periudha tetor 2020 deri në fillim të vitit 2021, mësimin e kanë ndjekur rreth 25 nxënës të moshës 9-13-vjeçar, pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijëve, ka rekomanduar ushtrimin e së drejtës së arsimit "*në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta*".²⁹⁴ E drejta për arsimim karakterizohet si një "*e drejtë e aftësim-it-fuqizimit*". Një e drejtë e tillë i ofron individit më shumë kontroll për drejtimin e jetës së tij apo saj, në veçanti kontrollin mbi veprimet e shtetit kundrejt individit. Me fjalë të tjera, ushtrimi i së drejtës për arsimim i ndihmon fëmijët në zhvillimin e plotë të personalitetit, të talenteve dhe të aftësive të tyre mendore e fizike²⁹⁵, në mënyrë që t'i përjetojnë të mirat e të drejtave të tjera.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës²⁹⁶ rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. Për më tepër, neni 1, paragrafi 2, i LAPRK-së i referohet dispozitës kushtetuese për të drejtën për arsimim duke thënë se qëllimi i arsimit dhe i aftësimit parauniversitar përfshin zhvillimin e plotë të

294 KDF, neni 28

295 KDF, neni 29.

296 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

personalitetit, dhuntisë dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësit. I njëjti parim përsëritet në nenin 3, paragrafi 3, duke theksuar: “Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera [...] për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre *specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.*” Neni 9 i këtij ligji po ashtu parasheh që arsimit fillor dhe i mesëm i ulët (niveli ISCED 1 dhe 2) janë arsim i detyrueshëm për fëmijët në Kosovë. Për më tepër, neni 22, paragrafi 4, i këtij ligji ka përcaktuar: “*Komuna siguron mësimin alternativ, për nxënësit që janë larguar nga shkolla, në shkollën në të cilën nxënësit janë transferuar, në bazë të dispozitave të këtij ligji.*”

Referuar nenit 22, paragrafi 4, të LAPRK-së del se Komuna e Fushë Kosovës, në rastin dhe në rrethanat konkrete, duhet të sigurojnë dhe është kompetencë e saj ligjore që të sigurojnë mësim alternativ për fëmijët e komunitetit ashkali, të cilët nuk janë duke e vijuar procesin mësimor. Andaj në rrethana të tilla, DKA-ja në Komunën e Fushë Kosovës ka dështuar të ofronte mësim alternativ për fëmijët në fjalë.

Avokati i Popullit konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse komunale nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, në lidhje me realizimin e së drejtës për arsimim të komunitetit ashkali në Fushë Kosovë. Autoritetet publike janë të obliguar të sigurojnë për secilin fëmijë mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta.

Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Fushë Kosovës që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore që t’ua mundësojnë këtyre fëmijëve arsimin në bazë të nevojave të tyre që kanë, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijëve, si dhe të organizoi plane mësimore të veçanta për fëmijë që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë shkollën, apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit, sipas nenit 22, paragrafi 4, të LAPRK-së dhe të nenit 37, paragrafi 5, nënparagrafi 5.6, të LMF-së.

Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

Mbledhja dhe raportimi i të dhënave shëndetësore në Republikën e Kosovës

Raporti është iniciuar bazuar në diskutimet dhe informatat e pranuar në tryezën e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përkitazi me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në sektorin shëndetësor. Diskutimet e zhvilluara nga pjesëmarrësit e tryezës në fjalë nxorën në pah se mbledhja dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor është i mangët, përderisa në rastet ku mbledhen të dhëna, shpeshherë nuk janë të plota, janë të pamjaftueshme, herë-herë gjysmake apo edhe të paqarta, një pjesë prej tyre janë jokompatibile me metodologjinë dhe kriteret që përdor ASK-ja (e që është e nevojshme të jenë), në mënyrë që të dhënat të konsiderohen valide, të besueshme dhe të krahasueshme.

Qëllimi i këtij Raporti është të tërheqë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse përkitazi me problemet ekzistuese për sa i përket mbledhjes dhe raportimit të të dhënave në sektorin shëndetësor (publik dhe privat), si dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e funksionalizimit të Sistemit Informativ Unik dhe të Integruar Shëndetësor (SISh). Trajtimi dhe shpërfaqja e problematikës që ka në fokus ky Raport, është bërë nga perspektiva e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në funksion të përmbushjes së rolit dhe mandatit mbikëqyrës që ka Avokati i Popullit.

Adresimi i kësaj çështjeje është po ashtu në linjë me përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe Agjendës 2030, me theks në përmbushjen e caqeve të Objektivit

3 - Shëndet i mirë dhe mirëqenie, si dhe caqeve relevante në Objektiva të tjera, për të cilat është i rëndësishëm raportimi dhe mbledhja e të dhënave në sektorin shëndetësor.

Bazuar në Rezolutën për Agjendën 2030, mbledhja e të dhënave dhe e të dhënat e disagreguara, kualitative, të qasshme, të besueshme dhe në kohë janë thelbësore për vlerësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut dhe progresit të shënuar. Ato shërbejnë për të nxjerrë në pah pabarazitë, për të ofruar informacionin e nevojshëm për vendimmarrësit, për të promovuar dhe zbatuar ligje dhe politika mosdiskriminuese, për të parandaluar keqmenaxhimin dhe shkelje të tjera ligjore, si dhe për siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Ndërlidhja e të dhënave shëndetësore me të drejtat e njeriut përfshin të kuptuarit se si grumbullimi, përdorimi dhe mbrojtja e të dhënave shëndetësore ndikojnë në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

E drejta në shëndet, mosdiskriminimi, barazia, qasja në informata, mirëqeverisja, transparenca, llogaridhënia, siguria publike, privatësia, konfidencialiteti etj. janë thelbësore për të siguruar që grumbullimi dhe raportimi i të dhënave shëndetësore ndërthuren me parimet e të drejtave të njeriut dhe promovojnë një sistem të drejtë, etik dhe efektiv të kujdesit shëndetësor.

Për shkak se e drejta në shëndet është një koncept i gjerë e shumëdimensional, edhe vlerësimi për përmbushjen e detyrimeve të shtetit është i tillë dhe merr parasysh aspekte që konsiderohen si parakushte dhe kritere të garantimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtës në shëndet. Të dhënat shëndetësore janë një komponentë nëpërmjet së cilës mbahen përgjegjëse institucionet e linjës, lidhur me angazhimin në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin. Pasqyra e rezultateve shëndetësore dhe qasjes në shërbime mundëson që palët e interesuara të identifikojnë boshllëqet, barrierat, pabarazitë, si dhe nivelin e përmbushjes së detyrimeve për sa i përket të drejtave të njeriut.

Për më tepër, mbledhja dhe raportimi i të dhënave shëndetësore mundësojnë që autoritetet përgjegjëse të marrin vendime të bazuara në evidencë. Po ashtu, krijojnë mbështetje për krijimin e politikave dhe programeve që adresojnë nevojat e shëndetit publik, zvogëlojnë pabarazitë shëndetësore dhe sigurojnë që burimet të ndahen në mënyrë efektive, për të përfituar të gjitha segmentet e popullsisë.

Nëpërmjet të të dhënave gjithëpërfshirëse shëndetësore krijohet mundësia e monitorimit në shërbime apo në rezultatet e kujdesit shëndetësor. Përveç të tjerash, të dhënat shëndetësore mund të nxjerrin në pah nevojat dhe sfidat specifike, me të cilat përballen grupet e cënueshme ose të margjinalizuara (personat me aftësi të kufizuara, ata që jetojnë në varfëri etj.), ashtu siç edhe mundësojnë të vërehen pabarazitë apo diskriminimi eventual. Kjo është thelbësore për adresimin e çështjeve lidhur me funksionimin efektiv të sistemit dhe për t'u siguruar që të gjithë individët, pavarësisht nga karakteristikat që kanë, të trajtohen drejt dhe në mënyrë të barabartë, duke përmbushur kështu të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm në shëndet. Në kontekstin e emergjencave të shëndetit publik, të dhënat shëndetësore në kohë dhe të sakta janë jetike për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së sëmundjeve. Të njëjtat kontribuojnë dhe mbështesin përpjekjet për të mbrojtur të drejtën për shëndet, për të gjithë.

Janë disa komponentë që shtetet duhet pasur parasysh për të realizuar të drejtën në shëndet: Organizata Botërore e Shëndetësisë përmbledh katër komponentë thelbësorë²⁹⁷ të ndërlidhura me të drejtën në shëndet:

- disponueshmërinë (*i referohet nevojës për një sasi të mjaftueshme objektesh shëndetësore,*

297 <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/human-rights-and-health>

mallrash dhe shërbimesh funksionale për të gjithë dhe mund të matet nëpërmjet analizës së të dhënave të ndara për shtresues të ndryshëm, duke përfshirë sipas moshës, gjinisë, vendndodhjes dhe statusit socio-ekonomik dhe anketave cilësore për të kuptuar boshllëqet e mbulimit.).

- *qasshmërinë (objektet shëndetësore, mallrat dhe shërbimet duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë. Qasshmëria ka katër dimensione: mosdiskriminimin, qasshmërinë fizike, qasshmërinë ekonomike (përbalueshmëria) dhe qasshmërinë në informacion. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara të cilët shpesh hasin barriera domethënëse për shëndetin në lidhje me paqasshmërinë e shërbimeve, objekteve dhe informacionit shëndetësor).*
- *pranueshmërinë (lidhet me respektimin e etikës mjekësore, të përshtatshme kulturore dhe ndjeshmërinë ndaj gjinisë. Pranueshmëria kërkon që objektet shëndetësore, mallrat, shërbimet dhe programet të jenë të përqendruara te njerëzit dhe të kujdesen për nevojat specifike të grupeve të ndryshme të popullsisë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të etikës mjekësore për konfidencialitet dhe pëlqim të informuar).*
- *cilësinë (si komponent kyçe e mbulimit shëndetësor universal (UHC), njëjtësohet me përcaktuesit themelorë të shëndetit (p.sh.: uji dhe kanalizimi i sigurt dhe i pijshëm), si dhe kërkon që objektet, mallrat dhe shërbimet shëndetësore të miratohen shkencërisht dhe mjekësisht. Shërbimet shëndetësore cilësore duhet të jenë: të sigurta, efektive, të kenë në qendër njerëzit, të ofrohen në kohë, të jenë të integruara dhe efikase, të barabarta (që nuk ndryshojnë për shkak të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe statusit socio-ekonomik).*

Për t'i monitoruar komponentët e sipërpërmendur dhe për rrjedhojë realizimin në thelb të së drejtës për shëndet, është e domosdoshme që shteti të ketë një sistem për mbledhjen e të dhënave shëndetësore, që i përshtatet karakteristikave të sistemit shëndetësor të vendosur dhe specifikave demografike, socio-ekonomike që ka vendi.

Të dhënat shëndetësore nuk japin vetëm pasqyrën për shëndetin në vetvete, por po ashtu ofrojnë indikacione për aspekte sociale dhe ekonomike brenda një konteksti gjeografik e demografik, që në një mënyrë a tjetrën, ndikojnë në gëzimin dhe respektimin e së drejtës për shëndet. Si një proces sistematik i vazhdueshëm, mbledhja e të dhënave mundëson analiza dhe interpretime të llojeve të ndryshme të informacionit, nga burime të besueshme, duke ndërtuar në këtë mënyrë bazën për vendimmarrje të qëndrueshme dhe në pajtim me nevojat dhe synimet për standarde më të mira, për të gjithë.

Në këtë kuptim, të dhënat duhet të jenë të sakta e të plota, të mblidhen e të raportohen si të tilla në afatet e përcaktuara kohore. Të dhënat, me theks ato nga burime administrative në sektorin shëndetësor, duhet të jenë të disagreguara, sipas bazave të përgjithshme të krahasueshme, si gjinia, moshë, vendbanimi dhe të tjera karakteristika kontekstuale, në funksion të shëndetit publik, si e mirë e përgjithshme, e për rrjedhojë një parakusht edhe për shëndetin individual.

Të dhënat e disagreguara, kualitative, të qasshme, të besueshme dhe në kohë janë thelbësore për vlerësimin e ngecjeve ose progresit në të drejta të njeriut, e specifikisht ndërlidhur me çka trajton ky Raport, të dhëna të tilla mundësojnë vlerësimin e ngecjeve a progresit për sa i përket sigurimit të jetës së shëndetshme dhe mirëqenies për të gjithë.

Në kontekst të përgjithshëm, të dhënat shëndetësore janë të domosdoshme për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke siguruar që sistemet shëndetësore të jenë të drejta, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të çdo individi.

Nga ky Raport kuptohet se SISH-i është shtyllë qenësore që lidh komponentët e sektorit të

shëndetësisë. Megjithatë, të dhënat shëndetësore që nuk mblidhen sipas standardeve të parapara janë pothuajse të pashfrytëzueshme. Mbledhja dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor mbeten jo të integruara e të shpërndara në sisteme që nuk korrespondojnë. Funksionimi në mënyrë të shkëputur, pa një pasqyrë të integruar të të dhënave, të cilat do të shndërroheshin dhe do të shërbenin si evidencë dhe si indikatorë për ndërtimin e politikave dhe strategjive në sektorin shëndetësor, ka për pasojë ngecje në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të avancimit të mirëqenies sociale.

Ky sistem që aktualisht vazhdon të funksionojë në mënyrë fragmentare është i domosdoshëm të vihet në rend dhe të ofrojë pasqyrë të integruar të të dhënave, të cilat do të shndërroheshin dhe do të shërbenin si informata dhe si indikatorë për ndërtimin e politikave dhe strategjive në sektorin shëndetësor. Një sistem i integruar i informimit shëndetësor është thelbësor për ofrimin e kujdesit cilësor, të koordinuar, etik dhe të efektshëm ndaj pacientëve.

Avokati i Popullit rikujton me shqetësim konstatimet në Raportin për vendin, të viteve 2023 dhe 2024, për pabarazi shëndetësore, jetëgjatësisë në lindje, si më e ulëta në rajon; sëmundjet jongjitëse (si ato kardiovaskulare dhe kanceri), si shkak kryesor i vdekjeve; rreth 33% të shkaqeve të vdekjeve të raportuara gabimisht; moskryerjen sistematike të depistimit për gjendje kronike (si diabeti dhe hipertensioni); [...]vdekshmërinë e fëmijëve (16 fëmijë nga 1000 lindje të gjalla - tri herë më i lartë se mesatarja e BE-së; pagesat e larta nga xhepi (ndërmjet 30%-40%), në mungesë të vënies në funksion të skemës së sigurimeve shëndetësore. Po ashtu janë shqetësuese pohimet se *vetëm statistikat demografike janë gjerësisht në përputhje me aktet e BE-së, përderisa veçon se statistikat e shëndetit publik dhe krimi nuk janë ende në përputhje me standardet e BE-së.*

Mungesa e një sistemi të integruar, me të dhëna të sakta dhe të përditësuara, afekton komunikimin midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor, shkakton gabime në dokumentimin dhe përpunimin e informacionit të pacientëve dhe ndikon negativisht në vendimet klinike, e si pasojë çon në diagnoza e trajtime të gabuara për pacientët. Për më tepër, Avokati i Popullit duke rikujtuar se ka mandat të mbikëqyrjes edhe mbi komponentë administrative të funksionimit të autoriteteve publike, sjell në vëmendje se SISH-i jofunksional dhe jo i integruar jo vetëm cenon gëzimin e së drejtës për shëndet, por cungon edhe mbikëqyrjen e performancës së punonjësve në sektorin shëndetësor, të kapaciteteve që kanë, të cilësisë e sasisë së punës. Po ashtu vështirëson njohjen e vështirësive dhe kërkesave të personelit shëndetësor. Kjo shkakton pasoja negative zinxhirore në efikasitetin dhe efektivitetin e sektorit shëndetësor, si dhe lë hapësirë për keqadministrimin, keqmenaxhimin, shkelje të kodit etik e protokolleve profesionale e shëndetësore. Për rrjedhojë, problemet në sistemin shëndetësor shpesh sillen në një rreth vicioz pa adresë përgjegjësie, duke krijuar pasiguri juridike dhe mungesë të mirëfilltë llogaridhënieje në sektorin shëndetësor.

Për sa i përket procesit të mbledhjes së të dhënave shëndetësore, Avokati i Popullit ndan shqetësimin e ASK-së lidhur me sfidat që paraqiten në raportimin e të dhënave nga MSh-ja dhe IKShPK-ja, për sa i përket: kodifikimit të shkakut të vdekjeve; regjistrimit të rasteve të lindjeve dhe vdekjeve; si dhe sigurimeve shëndetësore në vend. Vonesat e pohuara në publikimin e të dhënave nga ana e ASK-së, për shkak të vonesave nga ana e IKShPK-së, e shpërfaqin qartazi problemin e madh të mungesës së sistemit të integruar të informimit shëndetësor dhe humbjes në kohë kur të dhënat vazhdojnë e plotësohen e barten manualisht nga formularët zyrtarë sipas UA-së (fletëzat përkatëse).

Mungesa e sistemit që do të integronte të dhënat e lindjeve dhe vdekjeve të lidhura me databazën e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), po ashtu konstatohet nga Avokati i Popullit si sfidë dhe pengesë në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të plota, të sakta e në kohë. Për pasojë, shtohen pengesat në funksionalizimin e sigurimit shëndetësor dhe gjithashtu afektohet edhe segmenti që ka të bëjë me skemat sociale dhe mirëqenien e përfituesve prej tyre.

Avokati i Popullit thekson se pa sistem të informimit shëndetësor funksional nuk ka pasqyrë të saktë faktike të shëndetit të popullatës, nuk ka parandalim dhe nuk mund të ketë trajtim të duhur, ashtu siç nuk mund të arrihet kontroll mbi sëmundjet. Po ashtu, mungesa e të dhënave krijon barriera për qasshmëri, për cilësi dhe për efikasitet të shërbimeve, pamundëson pasqyrimin e progresit a të ngecjeve, duke shkaktuar kështu shtresim të problemeve dhe mosfunksionim të zinxhirit të aktorëve përgjegjës në sektorin shëndetësor.

Po ashtu nuk mund të shmangët konstatimi se ka ngecje evidente në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave shëndetësore, të dhëna të mangëta e me vonesë, herë-herë të paqarta e një pjesë prej tyre jocompatibile me metodologjinë dhe kriteret që kërkohen, për t'u konsideruar valide, të besueshme dhe të krahasueshme.

Mungesa e SISh-it:

- pengon realizmin e së drejtës për shëndet dhe mirëqenie, duke lënë hapësirë për cenueshmëri, trajtim të pabarabartë dhe diskriminim;
- vështirëson pasqyrimin e vlerësimit të ndikimit të së drejtës për shëndet dhe për pasojë pamundëson mbikëqyrjen e mirëfilltë mbi sektorin shëndetësor;
- pamundëson zbatimin e Ligjit përkatës për Sigurimin Shëndetësor;
- komplikon procesin e hartimit të politikave adekuate në lidhje me shëndetin, si dhe mirëqeverisjen e sektorit shëndetësor;
- komplikon vlerësimin e performancës dhe të kapaciteteve të punonjësve shëndetësorë, si dhe kushteve të punës për ta;
- bëhet barrierë për efektivitet dhe efikasitet të sistemit shëndetësor, si dhe menaxhimin e tij;
- pengon transparencën dhe pamundëson llogaridhënien e plotë të autoriteteve e mekanizmave në sektorin shëndetësor dhe atyre që mbikëqyrin këtë sektor.

Si konkludim në këtë raport Avokati i Popullit rikujton se mbrojtja shëndetësore dhe sociale kualifikohet si e drejtë pozitive, që nënkupton se shteti ka detyrimin për ta garantuar atë në kuadër të maksimumit të resurseve që ka, brenda kontekstit zhvillimor. Në këtë kontekst, e drejta për tregues dhe standarde shëndetësore²⁹⁸ është një mjet që mbështet të drejtën për shëndet dhe krijon parakusht për gëzimin e të drejtave të tjera që pikëtakohen me këtë të drejtë. Konfuzioni dhe mospërmbushja e detyrimeve ligjore të mekanizmave që duhet të mundësojnë funksionimin e një Sistemi të Integruar Shëndetësor, qëndrojnë në thelb të një zinxhiri çështjesh që kërkojnë me prioritet vëmendje dhe veprime të autoriteteve përgjegjëse, prandaj Avokati i Popullit edhe i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë që të ushtrojë detyrimet dhe obligimet që ka sipas kornizës përkatëse normative, për ta funksionalizuar, me urgjencë dhe plotësisht, Sistemin Informativ Unik dhe të Integruar të Informimit Shëndetësor, në të gjitha nivelet dhe sektorët e sistemit shëndetësor.

Raport lidhur me ndryshimin e Rregullores nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës

Qëllimi i këtij raporti është t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejshëm: MFPT) ndryshimin e Rregullores (MFRT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, me qëllim të harmonizimit të kushteve dhe kufizimeve për përfitime shtesë, të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 4.3, dhe në nenin 7, me parimet dhe kompetencat themelore që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

298 <https://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler.ashx>

Rregullorja (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja) përcakton profesionet, kushtet dhe procedurat e përdorimit të shtesës për kushtet e tregut të punës. Sipas nenit 2: *“Kjo Rregullore zbatohet për të punësuarit në sektorin publik, pagat e të cilëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit dhe të cilët i plotësojnë kriteret për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.”*

Neni 4 i Rregullores i përcakton pesë kategori të profesioneve dhe profesioneve deficitare, për të cilat mund të merret kompensim për kushtet e tregut të punës, ndërsa paragrafi 4.3 i këtij neni përcakton edhe një kategori shtesë *“profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës”*, kategori për të cilën, përveç kushteve të përgjithshme, neni 7 i Rregullores përcakton kushte të veçanta për përfitime shtesë, të cilat punonjësit duhet t'i plotësojnë kumulativisht, përkatësisht (7.2.1) *“programi i studimeve të nivelit të dytë të arsimit të lartë të jetë i financiar ose bashkë-financuar nga Qeveria e Kosovës.”* dhe 7.2.2 *“të kenë të përfunduar studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në universitete jashtë vendit.”*

Avokati i Popullit thekson se me rastin e përcaktimit të diskriminimit, është e rëndësishme që trajtimi i pafavorshëm i një personi/disa personave të caktuar të krahasohet me trajtimin e një personi tjetër në situatë të ngjashme që do të trajtohej në mënyrë më të favorshme dhe se dallimi i vetëm ndërmjet tyre të jetë *“baza e mbrojtur ligjërish”*. Prandaj është evidente se në rastin që trajton ky raport është krijuar një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe bazës së mbrojtur ligjërish. Për ta përmbushur këtë kriter, mjafton të shtrohet pyetja: A do të ishte trajtuar në mënyrë më pak të favorshme një person i caktuar nëse do të kishte qenë në një pozicion tjetër sipas çfarëdo baze tjetër? Dispozita e cila zbatohet nuk duhet domosdoshmërisht t'i referohet në mënyrë specifike një *“baze të mbrojtur”*. Mjafton që i referohet një lloj shkak që nuk mund të ndahet nga baza e mbrojtur.

Nga ajo që u tha rezulton se përfituesit e skemave të bursave nga programet e studimit të financuara ose të bashkëfinancuara nga Qeveria janë në një situatë të krahasueshme me nëpunësit e tjerë publikë, që u përkasin të njëjtave profesione përkatëse dhe kanë të njëjtin nivel arsimor dhe të cilët perfeksionimin e vet të shkallës së dytë e kanë financiar vetë dhe i kanë përfunduar studimet në të njëjtin universitet ose në universitete të tjera jashtë vendit ose në universitete brenda vendit.

Avokati i Popullit thekson se aktet nënligjore, në të cilat bëjnë pjesë edhe rregulloret, janë akte juridike me fuqi më të ulëta juridike dhe duhet të jenë në përputhje me një akt me fuqi më të lartë juridik, përkatësisht me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë kuptim, Rregullorja në fjalë duhet të jetë në përputhje me synimin dhe qëllimin e ligjit dhe të specifikojë vetëm dispozitat e ligjit nga i cili buron. Ai duhet të përfaqësojë një akt të derivuar dhe jo të pavarur, prandaj nuk mund të dalë përtej dispozitave të ligjit, por vetëm mund ta shtjellojë më hollësisht në përputhje me synimin dhe qëllimin e tij. Prandaj futja e *“profesioneve nga programet e studimit të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës”*, të përcaktuara në nenin 4.4.3 të Rregullores, konsiderohet në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit përkatës dhe nuk mund të përshkruhet si e tillë, sepse është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë.

Sipas praktikës së GjEDNj-së: *“Trajtimi i ndryshëm i personave në situata përkatësisht të ngjashme ... është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të; me fjalë të tjera, nëse me këtë nuk arrihet një qëllim legjitim ose nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme proporcionale midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.”* / GjEDNj, Burden kundër MB [GC] (nr. 13378/05), 29 prill 2008, f. 60. Që do të thotë se, me qëllim që të justifikohet një trajtim i ndryshëm, duhet të dëshmohet: se një rregull ose praktikë e caktuar e ka një qëllim legjitim dhe se mjetet për ta arritur atë qëllim (d.m.th. masa që ka sjellë deri te trajtimi i ndryshëm) janë proporcionale dhe të domosdoshme. Për t'u konfirmuar se a është

trajtimi i ndryshëm proporcional, duhet të ekzistojë një bindje: se nuk ekziston mënyrë tjetër për t'u arritur qëllimi që do të ndërhynte më pak në të drejtën për trajtim të barabartë. Me fjalë të tjera, vënia e një individi në pozitë të pafavorshme është dëmi më i vogël i mundshëm i domosdoshëm për ta arritur qëllimin e dëshiruar dhe se qëllimi që dëshirohet të arrihet është mjaft i rëndësishëm për ta justifikuar një shkelje të tillë.

Avokati i Popullit nuk e konteston nevojën për reformë dhe ngritjen e cilësisë së administratës publike, në kuptimin e përpjekjes për një shkallë të lartë të formimit akademik të stafit dhe financimit të trajnimit të tyre me qasje në arsim cilësor, gjë që mund të konsiderohet si synimi legjitim, megjithatë, në këtë rast të veçantë, MFPT-ja nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm, i cili mundëson trajtim të ndryshëm të zyrtarëve publikë të të njëjtit profesion dhe nivel arsimor, i cili *a priori* bazohet në mënyrën e financimit të trajnimit të tyre dhe selisë së universitetit, në të cilin janë kryer studimet e shkallës së dytë, sepse këto kritere nuk kanë bazë dhe nuk lidhen drejtpërdrejt me përshtatshmërinë apo ekspertizën për të kryer një punë të caktuar. Prandaj kriteri i vendosur në paragrafin 4.3 të nenit 4 dhe kushtet e përcaktuara në nenet 7.2.1 dhe 7.2.2 të Rregullores nuk mund të konsiderohet një qëllim i justifikuar, i domosdoshëm dhe proporcional.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit nënvizon faktin se përvetësimi i njohurive gjatë studimeve varet kryesisht nga aftësitë personale, aftësitë dhe përpjekjet e individëve dhe jo nga mënyra e financimit të studimeve apo nga supozimi nëse ata kanë marrë njohuri dhe kualifikime në universitetet në vend ose jashtë vendit. Ky lloj favorizimi nuk mund të konsiderohet si masë proporcionale me qëllimin që dëshirohet të arrihet, sepse rrënon drejtpërdrejt dhe ndikon në besueshmërinë e universiteteve në vend dhe vë në dyshim cilësinë e njohurive të marra në programet arsimore të Kosovës. Ky lloj favorizimi nuk ka bazë në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (neni 7), i cili, me themelimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit, siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë i përmbushin kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Avokati i Popullit konsideron se diplomat e fituara në institucionet e arsimit të lartë të lëshuara nga universitetet publike në Republikën e Kosovës dhe në universitetet private të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit janë po aq të vlefshme sa edhe diplomat e fituara në universitetet jashtë vendit. Nga ana tjetër, diplomat e marra jashtë vendit i nënshtrohen procedurës së njohjes dhe ekuivalencës në institucionet përkatëse në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vend, prandaj çdo diplomë që e kalon me sukses këtë procedurë konsiderohet ekuivalente me një diplomë të marrë në universitetet e vendit. Prandaj kushti i vendosur në pikën 7, paragrafi 2.2, nuk ka asnjë mbështetje në legjislationin aktual dhe nuk mund të konsiderohet se e përmbush garancinë kushtetuese dhe ligjore të barazisë, të respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit në këtë raport konstaton se Rregullorja (MFPT) 02/2023 për Shtesat për Kushtet e Tregut të Punës, në nenin 4. 4.3 dhe në nenin 7, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, me kushtet e përmendura, në një situatë të krahueshme, vë në pozitë të pabarabartë dhe të pafavorshme dhe trajton në mënyrë më pak të favorshme punonjësit e shërbimit civil të Kosovës, të cilët, me qëllim të një niveli më të lartë të arsimit, vetëfinancuan studimet jashtë vendit dhe i kanë kryer ato pa mbështetje financiare nga Qeveria, ose që i kanë përfunduar studimet dhe kanë marrë kualifikime përkatëse deficitare në institucionet e licencuara të arsimit të lartë publik ose privat në Republikën e Kosovës. Me këtë lloj të trajtimit, siç u arsyetua tashmë, bëhet një diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i shumëfishtë, i cili bazohet në dy baza që ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe si të tilla janë të pandashme nga njëra-tjetra, gjë që cenon parimin e trajtimit të barabartë.

Kriteret e përcaktuara në nenin 4, paragrafi 4, pika 4.3, dhe nenin 7, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, të Rregullores së MFPT nr. 02/2023 për Shtesën për Kushtet e Tregut të Punës janë

në kundërshtim me Kushtetutën, me legjislacionin aktual (Ligji Nr. 08/ L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me parimin e ligjshmërisë dhe sundimin e ligjit.

Për këtë i rekomandoi Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve: që ta ndryshojë dhe plotësojë Rregulloren (MFPT) nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ashtu që: 1. t'i fshijë dispozitat e nenit 4, paragrafi 4, pika 4.3, dhe të nenit 7, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2; si dhe 2. me dispozitat e reja drejtpërdrejt t'i definojnë pozicionet deficitare dhe punët e rralla, me të cilat do t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë zyrtarët e mundshëm të administratës publike në një situatë të krahasueshme.

Detyrimet e shtetit për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare në Republikën e Kosovës

Raporti ka për qëllim të analizojë dhe vlerësojë detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare. Kjo analizë synon të hedhë dritë mbi aspektet kyçe të disponueshmërisë, qasjes dhe cilësisë së këtyre shërbimeve, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Raporti ka për qëllim që të identifikojë sfidat ekzistuese dhe të propozojë rekomandime konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor për personat e moshës mbi 65-vjeçare, duke siguruar një qasje të barabartë e pa diskriminim për të gjithë.

Instituti të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (më tutje: IPFK) ofron shërbime të shëndetit mendor për persona me vepra të rënda penale dhe nuk ka kufizim të moshës. Shërbimet aty janë të tipit të mbyllur me një kapacitet prej 36 shtretërisht. Trajtimi për grup-moshën mbi 65-vjeçare është i njëjtë si për të gjitha grup-moshat e tjera, pra nuk kanë mundësi për shërbime të përshtatura për këtë grup-moshë. Sipas informacioneve të pranuar nga drejtori, shërbimet për këtë grup-moshë janë të kufizuara në nivel vendi, meqenëse nuk ka repart geriatric²⁹⁹ si dhe nuk ka politika sociale të përshtatura për këtë grup-moshë. Ndërsa problemet e zakonshme të shëndetit mendor, të cilat hasen te pacientët e moshës mbi 65-vjeçare, janë: demenca, çrregullimet psikosomatike dhe depresioni.

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë (më tej: ShPMPF) u ofron strehim rezidencial personave mbi 65 vjeç. Institucioni funksionon në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 10/2014, i cili përcakton kriteret për vendosjen e rezidentëve në ShPMPF dhe në Shtëpitë e Bazuara në Komunitet. Kriteret për pranimin e të moshuarve në ShPMPF përfshijnë një gjendje të mirë psikike të individëve, të cilët nuk duhet të kenë pasardhës (të birësuar ose biologjikë). Megjithatë në këtë rast ka një përjashtim meqenëse të moshuarit apo së moshuarës i lejohet prania e vajzës së martuar (e cila jeton në familjen e bashkëshortit). Vlerësimi i gjendjes psikike të individit bëhet nga një neuropsikiatër i akredituar nga institucionet shtetërore. Sipas informacioneve të pranuar, rreth 70% e rezidentëve përballen me sfida të shëndetit mendor, duke përfshirë depresionin, çrregullimet psiko-somatike, ankthin etj. Megjithatë, stafi i ShPMPF-së përballlet me kufizime në mundësitë e tyre për zhvillim profesional për shkak të faktorëve të ndryshëm.

Departamenti i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (DShSF), përveç përgjegjësisë të tjera, angazhohet në zhvillimin e legjislacionit dhe përcaktimin e standardeve minimale për

²⁹⁹ Geriatria është fushë e mjekësisë, e cila merret me aspektet klinike, parandaluese dhe sociale të sëmundjeve të të moshuarit, si dhe me rehabilitimin e tyre.

inspektimin e ofruesve të shërbimeve sociale. Ky departament ka formuluar standarde specifike për ofruesit e shërbimeve sociale, të cilat synojnë grup-moshën mbi 65-vjeçare, të cilat përfshijnë:

- a) *Standardet Minimale për Përkujdesjen Institucionale të Personave të Moshuar.*
- b) *Standardet Minimale të Cilësisë për Shërbimet Sociale në Shtëpitë për Personat e Moshuar.*
- c) *Standardet Minimale të Cilësisë për Personat e Moshuar në Shtëpitë e Komunitetit.*

Një tendencë kyçe në sektorin e shërbimeve sociale është lëvizja drejt decentralizimit të shërbimeve. Në këtë drejtim janë themeluar shtëpi me bazë në komunitet për të moshuarit në qytete të ndryshme, si: Istog, Skenderaj, Prishtinë, Novobërdë dhe Graçanicë. Gjithashtu ekzistojnë dy shtëpi private të licencuara në Zahaç dhe në Istog, si dhe një organizatë joqeveritare në Gjinoc, të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme. Përveç këtyre, rreth 50 organizata joqeveritare janë licencuar për të ofruar shërbime të përkujdesjes sociale direkte në shtëpi, duke përfshirë asistencë materiale për individët të cilët janë të paaftë të kujdesen për veten, si: të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Drejtoria për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës (më tutje: DMS), duke u bazuar në një marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komunës së Prishtinës, ka marrë përsipër kompetencat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të ShPMPF-së. Sipas kësaj marrëveshjeje, Komuna e Prishtinës obligohet të pranojë rezidentë edhe nga komunat e tjera, të cilat janë jashtë kompetencës territoriale të saj. Po ashtu, Komuna e Prishtinës do të zbatojë legjislacionin ekzistues për funksionimin e ShPMPF-së, përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit dhe të vendosjes së rezidentëve në këtë institucion, që nënkupton se vlerësimi profesional realizohet nga niveli qendror. DMS-ja po ashtu drejton dy qendra sociale për të moshuar, me orar të punës nga ora 8:00 deri në orën 16:00. Komuna e Prishtinës ndan edhe grante për sektorin joqeveritar dhe aktualisht janë disa organizata joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për të moshuarit, përfshirë edhe shërbimet psikologjike.

Qendra mbi Moshimin, në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (më tutje: IKShPK). Qendra mbi Moshimin angazhohet në promovimin dhe edukimin për shëndetin e të moshuarve, si dhe në organizimin e aktiviteteve që rrisin vetëdijen për moshimin e shëndetshëm. Si një departament brenda IKShPK-së, Qendra përballët me sfidën e mungesës së një linje të veçantë buxhetore për realizimin e aktiviteteve të saj, ku një pjesë e madhe e aktiviteteve janë të bazuara në projekte.

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë dhe Psikiatrikë (më tutje: QIRSKP) në Shtime ofron trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve kronikë psikiatrikë dhe ka mision riintegrimin dhe risocializimin e tyre në komunitet. Kriteret e pranimit të rezidentëve janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ (MSh) nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës. Përkundër faktit se ky udhëzim është shfuqizuar (me Vendimin QRK, nr. 02/50, datë 23 dhjetor 2021), QIRSKP ndjek praktikën e bazuar në këtë UA, i cila kriter pranimi e përfshin moshën 18-65 vjeç. Pacientë që e kanë arritur moshën 65-vjeçare vazhdojnë të mbahen QIRSKP. Kriteret e tjera janë: diagnostikimi me skizoferi paranoide dhe mungesa e përkujdesjes familjare. Për sa u përket mangësive në sistem për grup-moshën mbi 65-vjeçare, është mungesa e repartit të geriatriisë.

Instituti Special në Shtime (më tutje: ISSh) ofron kujdes social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillim mendor. Si kriter pranimi, ndër të tjerash është edhe mosha mbi 18 dhe deri në 65-vjeçare. Në ISSh ndodhen 5 persona të moshës mbi 65-vjeçare dhe këta të moshuar janë të vendosur në të njëjtin vend, por nuk kanë shërbime të veçanta për këtë grup-moshë. ISSh-ja funksionin në bazë të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 11/2014 për Punën

dhe Kriteret për Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillimin Mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

Qendra e Shëndetit Mendor (më tutje: QShM) në Prishtinë ofron shërbime psikiatrike, shërbime psikologjike, shërbime psiko-sociale, psiko-edukim të familjes, vizita shtëpiake, qëndrim ditor, terapi individuale dhe grupore, aktivitete rehabilituese dhe aktivitete rekreative për të gjitha grup-moshat, pa kufizim. Ekziston nga një QShM për çdo njësi funksionale administrative-rajonale (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Gjiilan, Prizren dhe Ferizaj). Të gjitha qendrat kanë shtëpitë për integrim në bashkësi, të cilat ofrojnë shërbime rezidenciale në funksion të rehabilitimit dhe të riintegritimit social të klientëve me sëmundje dhe çrregullime kronike të shëndetit mendor (në remision) për grup-moshat nga 18 deri në 65-vjeçare. Personat që i mbushin 65 vjet nuk i largojnë nga shtëpitë dhe tash për tash janë disa rezidentë mbi moshën 65-vjeçare. Shërbimet për këtë grup-moshë duhet të jenë specifike marrë parasysh nevojat e tyre, por qendrat/shtëpitë për integrim në bashkësi nuk kanë shërbime të specializuara për grup-moshën mbi 65-vjeçare.

Avokati i Popullit vëren se shëndeti mendor nuk renditet ndër të drejtat taksativisht të numëruara në KEDNJ. Mirëpo GjEDNJ-ja pranoi parimin se të drejtat për shëndet mund të përfshihen në nenin 2 të KEDNJ-së duke zgjeruar interpretimin e së drejtës për jetë. Vendimet e rasteve të GjEDNJ-së kanë trajtuar shëndetin mendor në kuadër të neneve 2, 3, 5 dhe 8 të KEDNJ-së, veçanërisht në lidhje me vendosjen dhe trajtimin e detyrueshëm në institucionet shëndetësore të personave me çrregullime mendore.

Në rastet e trajtuara nga GjEDNJ-ja theksohet një qasje e ndjeshme ndaj të drejtave të të moshuarve, duke u përqendruar në të drejtën për jetë, trajtimin në institucione, kujdesin dhe qasjen në shërbime shëndetësore. Rastet si *Volintiru kundër Italisë*, *Dodov kundër Bullgarisë*, *Verein KlimaSeniorinnen Schëeiz kundër Zvicrës* dhe *Watts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, trajtojnë sfidat e trajtimit mjekësor dhe mbikëqyrjes në institucionet e kujdesit për të moshuarit, si dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe transferimeve të detyruara në shëndetin e tyre.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm përfshin 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Në vitin 2008 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Deklaratën e Mijëvjeçarit, sipas tekstit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/55/2, aprovuar më 8 shtator 2000. Përqendrimi në shëndetin mendor lidhet ngushtë me Objektivin 3: "*Siguro shëndet të mirë dhe promovoj mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat*", veçanërisht në nënobjektivin 3.4, i cili synon të promovojë shëndetin dhe mirëqenien mendore dhe të reduktojë numrin e vdekjeve dhe sëmundjeve nga abuzimi me substancat dhe çrregullimet mendore.

Avokati i Popullit vëren se në praktikë këtyre personave u ofrohen shërbime nga Klinika Psikiatrike, megjithatë kriteri i vendosur në rregullore përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe përbën diskriminim të bazuar në moshë. Po ashtu, konstaton se Shtëpitë Integruese në Bashkësi, të cilat funksionojnë në kuadër të Qendrave të Shëndetit Mendor, Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë (QIRSKP) në Shtime, përkundër shfuqizimit të Udhëzimit Administrativ (MSh) nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor, vazhdojnë të ndjekin praktikat e vendosura nga ky udhëzim për sa u përket kriterëve të pranimit, duke përfshirë kufizimin e moshës nga 18 deri në 65-vjeçare.

Shërbimet e shëndetit mendor dhe ato të përkujdesjes sociale, të cilat përfshijnë kujdesin spitalor dhe rezidencial, të ofruara nga institucionet përkatëse, nuk janë të adaptuara për të adresuar nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen personat e moshës mbi 65-vjeçare. Mungesa e trajnimeve dhe e ekspertizës së duhur në mesin e personelit profesional për t'i trajtuar në mënyrë efikase kërkesat dhe nevojat specifike të kësaj grup-moshe kërkon hapa konkretë për t'i rritur kapacitetet e personelit profesional dhe për të zhvilluar programe të shërbimeve që janë të përshtatura për nevojat e kësaj grup-moshe.

Avokati i Popullit konstaton se kufizimi i moshës deri në 65-vjeçare, si kriter për t'u pranuar në

institucione rezidenciale, përbën shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor sfidon zbatimin e ligjit dhe krijon hapësirë për praktikat diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor lidhur me kufizimin e moshës për personat mbi 65 vjeç. Përveç mungesës së akteve nënligjore, mungesa e kriterëve të qarta në aktet nënligjore ekzistuese, shfuqizimi i akteve nënligjore me vendime të qeverisë në vend të nxjerrjes së akteve të reja nënligjore³⁰⁰ dhe kufizimi i të drejtave të garantuara me ligj me anë të akteve nënligjore janë në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit.

Rregullorja e Brendshme e Repartit të Urgjencave dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik, në bazë të së cilës rregullohet veprimtaria e Repartit të Urgjencave dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik, përveç që nuk i përmbush standardet e një akti normativ, ajo ka përcaktuar kufizime të të drejtave të njeriut të cilat garantoohen me ligj.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ndërmarrë masa për hartimin e planit kombëtar mbi moshimin në Republikën e Kosovës; Ministrisë së Shëndetësisë i rekomandoi që me rastin e ndryshim-plotësimit apo hartimit të Ligjit të ri për Shëndetin Mendor, të përfshihen edhe shërbime apo detyrime specifike të shëndetit mendor për këtë grup-moshë - shërbimet geriatrike si dhe të përcaktohen afatet obligative për nxjerrjen e akteve nënligjore, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm. Po ashtu të zhvillojë fushata dhe aktivitete ndërgjegjësimi mbi të drejtat e të moshuarve në fushën e shëndetit mendor, për të luftuar stigmën dhe diskriminimin e bazuar në moshë.

Ministrisë së Drejtësisë i rekomandoi që të hartojë dhe të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në dispozitat fuqizuese të ligjit dhe me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative; të nxjerrë një qarkore me shkrim për ISSh-në dhe Shtëpitë me Bazë në Komunitet, lidhur me eliminim e kufizimit të ofrimit të shërbimeve rezidenciale për personat mbi moshën 65-vjeçare; të ndërmarrë veprime për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit profesional në kuadër të Institutit Special në Shtime, për specifikat e kujdesit psiko-social të personave mbi 65 vjeç.

Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës i rekomandoi që të hartojë rregulloret e brendshme bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura; të shfuqizojë dispozitat e neneve në rregulloret e brendshme në kuadër të Klinikës Psikiatrike, të cilat kufizojnë ofrimin e shërbimeve spitalore për personat mbi moshën 65-vjeçare; të ndërmarrë të gjitha masat për rritjen e numrit të neuropsikiatërve në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prishtinë dhe në qendrat tjera rajonale, sipas nevojës; të ndërmarrë veprime për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit profesional në kuadër të Klinikës Psikiatrike, qendrave të shëndetit mendor dhe shtëpive integruese, Qendrës për Integrim, Rehabilitim, Risocializim të të Sëmureve Kronik Psikiatrik në Shtime, për specifikat e kujdesit të shëndetit mendor për kategorinë e personave mbi 65 vjeç; të ndërmarrë veprime për të ofruar dhe integruar shërbimet geriatrike brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Ndërsa Komunës së Prishtinës, të Istogut, të Skenderajt, të Novobërdës dhe të Graçanicës i rekomandoi që të ndërmarrin veprime për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit profesional në kuadër të Shtëpisë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, për specifikat e kujdesit psiko-social të personave mbi 65 vjeç.

³⁰⁰ Udhëzimit Administrativ nr.07/2009 (në Shëndetësi) për shërbimet profesionale të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës, i cili është shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50, datë 23.12.2021.

Zgjerimi i listës së barnave esenciale duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda

Raporti është hartuar mbi bazën e disa ankesave të pranuar në institucion dhe si i tillë analizon vështirësitë me të cilat ballafaqohen qytetarët e prekur nga disa sëmundje, trajtimi i të cilave është i kushtueshëm e shpeshherë edhe i papërballueshëm dhe nevojën që ata kanë për përkrahje nga shteti. Për këtë nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit kërkon nga Ministria e Shëndetësisë që ta zgjerojë listën e barnave esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe që kanë nevojë të domosdoshme për trajtim mjekësor më efektiv.

Nga praktika e GjEDNj-së vërehet se ekzistojnë sisteme të ndryshme të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe se shteteve u lejohet një hapësirë e vlerësimit për përfshirjen e ilaçeve që ofrohen falas. GjEDNj-ja ka gjetur shkelje në rastin kur ilaçi nuk është zëvendësuar me ndonjë ilaç ekuivalent. GjEDNj-ja ka vlerësuar se shteteve nuk mund t'u imponohet një detyrë për të barazuar dallimet midis kujdesit shëndetësor në dispozicion në vende të ndryshme. Ndërsa për sa i përket trajtimit të pabarabartë apo diskriminim, GjEDNj-ja nuk ka gjetur në asnjërin prej rasteve të trajtuara më sipër se ka pasur diskriminim.

Për sa u përket ankesave të pranuar, Avokati i Popullit vëren se pacientëve u ofrohet një lloj terapie falas, por e cila duket se nuk është mjaftueshëm efektive për trajtimin e sëmundjeve. Avokati i Popullit bazohet edhe në rekomandimet e mjekëve ekspertë se për trajtimin e sëmundjeve të sipërpërmendura tanimë ekzistojnë ilaçe më të avancuara e të cilat nuk janë të përfshira në LBE.

Avokati i Popullit vlerëson faktin se ka rritje të buxheti për sëmundjet e natyrës onkologjike, megjithatë, duke marrë parasysh qëndrimet e Kolegjit të Klinikës Onkologjike, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme dhe mjaft të nevojshme qasjen e pacientëve në shërbimet më të avancuara shëndetësore. Për këtë iu rekomandua Ministrisë së Shëndetësisë që ta plotësojë/ndryshojë Listën e Barnave Esenciale dhe të përfshijë në këtë listë terapitë “braf pozitiv” për të sëmurët me melanomë të avancuar dhe “Pirfenidone-267 mg” për të sëmurët me fibrozë idiopatike pulmonare. Po ashtu iu rekomandua edhe t’ua mundësojë të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlçi qasjen falas në imunoterapinë “pembrolizumab”, që është në listën e barnave esenciale.

Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

Gjendja e lumit dhe e hapësirave përreth tij në lagjen “Kalabria” në Prishtinë

Qëllimi i këtij raporti është t’ia tërheqë vëmendjen Komunës së Prishtinës përkitazi me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve të menjëhershme për pastrimin e lumit në lagjen “Kalabria” në Prishtinë dhe hapësirave përreth tij, me qëllim të përmbushjes së të drejtave të qytetarëve të lagjes, për gëzimin e një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) nëpërmjet raportit nga inspektimi i vendit të ngjarjes ka evidentuar të gjeturat si në vijim: *“Gjatë inspektimit në këtë lagje, konkretisht të rrjedhjës ujore-prrocka, ekipi vërejti se prrocka shërben si deponi e mbeturinave të ngurta (orendi shtëpiake, trupa të drunjëve të prerë, barishte etj) dhe të lëngëta, ku edhe vërehen gypa shkarkues të ujërave të zeza të cilat derdhen në këtë rrjedhje ujore. Nga kjo prrockë kundërmon erë shumë e fortë dhe e rendë.*

Në bisedë me banorët e lagjes , ankesa kryesore e tyre është kundërmimi i pa durueshëm nga kjo rrjedhje ujore, e cila ju shkakton shqetësim shëndetësor dhe janë të detyruar të kërkojnë ndihmë mjekësore. Për arsye të hedhjes së mbeturinave të ngurta në rrjedhje ujore

pas çdo reshje shtëpitë në këtë lagje vërshohen. Gjithashtu banorët ankohen për prezencën e insekteve (miza, mushkonja etj.) si dhe brejtëseve.

Për të gjitha këto shqetësime banorët u janë drejtuar institucioneve relevante (Komunës së Prishtinës, Inspektoratit Komunal, Departamentit për Shërbime Publike etj.) mirëpo nuk kanë marr asnjë përgjigje dhe nuk është vërejtur asnjë veprim, përpos para një jave kur janë prerë drunjtë rreth prrockës dhe të njëjtat janë lënë në vendin e prerjes. Këto mbetje të drunjeve të prerë pengojnë rrjedhjen e ujit. Bazuar në vlerësimin e inspektimit si dhe deklaratat e banoreve kushtet për jetesë në këtë lagje janë të vështirësuar dhe ka rrezikshmëri për shëndetin e banorëve.”

Për më tepër, IKShPK-ja në raportin në fjalë i ka përmbledhur të gjeturat dhe rekomandimet adresuar strukturave relevante, si në vijim:

“Gjatë inspektimit në terren vërehet se:

Në prrocke ka shkarkim të ujërave të ndotura, mbeturina të ngurta dhe barishta të ndryshme që përveç që kundërmojnë erë të keqe edhe favorizojnë shumimin e mikroorganizmave, parazitëve, brejtësve dhe insekteve;

Situata epidemiologjike për momentin në këtë lagje është e qetë, përkundër rasteve individuale me ankesa të kohëpaskohshme, por gjithsesi ekziston rrezik permanent për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje infektive dhe rrjedhimisht rrezik për shëndetin e qytetarëve në këtë zonë.”

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të banorëve të kësaj zone dhe sanimit të kësaj situate, IKShPK-ja u rekomandoi strukturave relevante që urgjentisht të bëjnë hulumtimin dhe eliminimin e derdhjeve të mundshme të ujërave të zeza dhe ndotësve të tjerë potencialë. Inspektorët komunalë të mjedisit dhe ata sanitarë të marrin masa konkrete për zbulimin dhe zgjidhjen e këtij problemi, si dhe deri në zgjidhjen përfundimtare, përraska që kalon në lagje, të mirëmbahet rregullisht nga strukturat relevante dhe nga vetë banorët (largimi i mbeturinave dhe i barishteve si dhe të ndalohet hedhja e mbeturinave në përroskë). Po ashtu IKShPK-ja konsideron se zbatimi i këtyre masave është i domosdoshëm për tejkalimin e problemit aktual dhe rrjedhimisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Avokati i Popullit vlerëson se një ndër parimet e së drejtës ndërkombëtare mjedisore është arritja e një zhvillimi të qëndrueshëm që u mundëson qytetarëve cilësi të lartë jetese në një mjedis të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm. Duke u bazuar në gjendjen në terren, e në veçanti në Raportin e IKShPK-së, sipas të cilit: *“Ekziston rrezik permanent për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje infektive dhe rrjedhimisht rrezik për shëndetin e qytetarëve në këtë zonë.”*, vlerëson se gjendja e krijuar në mjedis nga ndotja e lumit, duke e pamundësuar një jetë kualitative të banorëve, përbën rrezik për shëndetin e tyre.

Edhe pse në dijeni për projektin e Komunës për ndërtimin e kolektorit, implementimi i të cilit është tejzgjatur, konstaton se niveli i lartë i ndotjes dhe mundësia e ndikimit të rëndë në të drejtat e njeriut dhe në shëndetin e banorëve kërkon veprime të menjëhershme nga autoritetet përgjegjëse për pastrimin e lumit, deratizimin dhe dezinfektimin e hapësirave.

Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, gjendja në lagjen në fjalë kërkon ndërhyrje urgjente të autoriteteve kompetente për sanimin e gjendjes, si dhe parandalimin e kufizimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë dhe të familjes dhe të mundësisë serioze të cenimit të shëndetit të banorëve nga ndotja.

GjEDNj-ja³⁰¹ ka vlerësuar se ndotja e mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe të parandalojë gëzimin e shtëpisë, në mënyrë të tillë, duke ndikuar negativisht në jetën private dhe familjare dhe se shteti duhet t'i përmbushë detyrimet pozitive për t'ua respektuar jetën e tyre private dhe familjare (neni 8 i Konventës).

301 Guerra dhe të tjerët kundër Italisë.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit sjell në vëmendje se Objektivi 6.3 i Agjendës 2030 shprehimisht potencon përmirësimin e cilësisë së ujit duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza: *“6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.”*

Me këtë rast Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, t’i ndërmarra veprimet e nevojshme me efekt të menjëhershëm për pastrimin e lumit dhe të hapësirave përreth tij, në lagjen “Kalabria” në Prishtinë; të veprojë në pajtim me rekomandimet e IKShPK-së, që urgjentisht të bëjnë hulumtimin dhe eliminimin e derdhjeve të mundshme të ujërave të zeza dhe ndotësve të tjerë potencialë; inspektorët komunalë të mjedisit dhe ata sanitarë të marrin masa konkrete për zbulimin dhe zgjidhjen e këtij problemi; deri në zgjidhjen përfundimtare, përraska që kalon në lagje, të mirëmbahet rregullisht nga strukturat relevante dhe nga vetë banorët (largimi i mbeturinave dhe i barishteve si dhe të ndalohej hedhja e mbeturinave në përraskë). Po ashtu rekomandoi që të informohet ankuesja për veprimet e ndërmarra nga organet komunale në drejtim të zgjidhjes së problematikës së ngritur.

Cenimi i së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si pasojë e derdhjes së ujërave të zeza në kanal in e ujërave atmosferike, në fshatin Dujakë të komunës së Gjakovës

Raporti është hartuar duke u bazuar në një ankesë individuale të një banori të fshatit Dujakë, komuna e Gjakovës, dhe ka për qëllim t’i vlerësojë detyrimet e autoriteteve përgjegjëse përkitazi me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, të së drejtës së jetës dhe të të drejtave të fëmijëve në një lagje të fshatit Dujakë të komunës së Gjakovës.

Raporti përmes analizës së instrumenteve ndërkombëtare, bazës kushtetuese dhe ligjore, argumenton përgjegjësitë e organeve shtetërore për evitimin e ndikimit të efekteve të dëmshme të shkarkimeve të ujërave të pa trajtuara në kanal in për ujitje dhe në mjedis. Po ashtu raporti mbështetet edhe në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave dhe të fakteve të mbledhura, analizës mes instrumenteve ndërkombëtare, Kushtetutës së vendit si dhe ligjeve relevante, të cilat garantojnë respektimin e të drejtat e njeriut dhe përcaktojnë rregullat për përmbushjen e obligimeve pozitive, konstaton se mosarritja e përmbushjes së përgjegjësive nga Komuna e Gjakovës, si autoritet kompetent për infrastrukturë ujore dhe mjedis, nëpërmjet masave efektive në raport me nevojat e banorëve të fshatit Dujakë, ka ndikuar në kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, në mundësinë e cenimit të së drejtës për jetën, si dhe në cenimin e së drejtës së fëmijëve.

Avokati i Popullit konsideron se mosveprimi i Komunës së Gjakovës, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, që i referohen mbrojtjes së mjedisit, të shëndetit publik, të së drejtës së fëmijës, përgjegjësive të dala nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe instrumenteve ndërkombëtare, paraqet mosarritje të përmbushjes së pritjeve legjitime të qytetarëve. Duke marrë parasysh përkufizimin e Gjykatës Evropiane: *“Të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja, përbën rrezik të lartë për shëndetin.”*³⁰², mosndërmarrja e veprimeve inspektuese nga inspektorati dhe po ashtu veprimeve të tjera nga DShP-ja, me theks të veçantë pas rekomandimeve të qarta të Raportit të IKShPK-së, konsiderohet

302 Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës.

mosarritje e përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore nga Komuna e Gjakovës për respektimin e të drejtave të qytetarëve të vet. Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Gjakovës që pa vonesa të ndërmarrë masa për rregullimin e infrastrukturës ujore dhe të kanalizimeve në fshatin Dujakë, sipas rekomandimeve të raportit të IKShPK-së si dhe të ndërmarrë masa për ta mbuluar pjesën e hapur të kanalit, i cili paraqet rrezik për jetën dhe sigurinë e fëmijëve dhe të banorëve të tjerë.

Opinion në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut përkitazi me rastin e ndërtimit të fabrikës së çimentos në Dollc, komuna e Klinës

Opinionin pasqyron qëndrimet e Avokatit të Popullit në lidhje me respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut, si dhe parandalimin e cenimit të tyre si rrjedhojë e procesit të ndërtimit të fabrikës së çimentos në fshatin Dollc të komunës së Klinës. Opinionin sjell në vëmendjen e autoriteteve kompetente, në këtë rast Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejme: MMPHI) dhe Komunës së Klinës, rëndësinë e respektimit të plotë të të drejtave të qytetarëve duke vënë në fokus balancimin e drejtë mes interesave të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit ekonomik të vendit në fushën e industrisë minerale.

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij Opinioni sjell në vëmendje përgjegjësitë dhe detyrimet pozitive të shtetit për respektimin e së drejtës së qytetarëve për vendimmarrje për çështje mjedisore në vendin ku jetojnë dhe për përmbushjen e të drejtave nga shteti pa afektuar të drejtat e tjera të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet e aplikueshme në fuqi.

Opinionin bazohet në ankesën e parashtruar nga një grup i qytetarëve nga fshatrat Dollc, Gremnik dhe Dresnik të komunës së Klinës, i përcjell me peticionin e nënshkruar nga 3901 qytetarë, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e fabrikës së çimentos në fshatin Dollc të Klinës, me pretendimin se ndikon negativisht në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Nëpërmjet këtij opinioni Avokati i Popullit sjell praktikën e GjEDNj-së për sa u përket çështjeve mjedisore dhe jetës private dhe familjare dhe interpretimit që gjykata ka dhënë në këto raste. Në rastin *Pavlov dhe të tjerët kundër Rosisë*, GjEDNj-ja argumenton se edhe pse aplikuesit në Pavlov jetonin në distanca të konsiderueshme nga vendet ndotëse dhe nuk kishin ofruar prova që tregonin një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e tyre, shumica e gjyqtarëve ishin të kënaqur duke vërejtur se “nivelet e ndotjes [...] nuk ishin të papërfillshme” (paragrafi 71) dhe jashtë niveleve të ndotjes që priten në përgjithësi nga “jeta në çdo qytet modern”. Distanca e konsiderueshme nga fabrika nuk e pengoi gjykatën të vlerësonte nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar apo jo, në vend që ta ketë refuzuar ta shqyrtonte rastin për shkak të distancës së vendit ndotës.

Ndikimi i ndotjes së mjedisit në mirëqenien e qytetarëve po ashtu pasqyrohet edhe në rastin e GjEDNj-së, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, në të cilin gjykata ka vlerësuar se ndotja e mjedisit mund të ndikonte negativisht në mirëqenien e individëve dhe në gëzimin e shtëpisë, respektivisht në jetën private dhe familjare, duke theksuar se shteti nuk e ka përmbushur detyrimin e tij pozitiv për ta siguruar të drejtën e ankuesve për të respektuar jetën e tyre private dhe familjare, që binte në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës.

Avokati i Popullit bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë opinion konstaton se qytetarëve nuk u është ofruar një qasje e përshtatshme në informacion për qëllimin dhe kohën e debatit publik dhe për pasojë jo të gjithë qytetarëve të interesuar u është krijuar mundësia të merrnin pjesë në debatin publik. Në mënyrë që kjo e drejtë e garantuar të marrë karakterin e zbatimit efektiv, shteti duhet t’u mundësojë qytetarëve jo vetëm pjesëmarrjen, por edhe mundësinë që ata të ndikojnë dhe të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes.

Banorëve nuk u është ofruar informacion konkret dhe i detajuar për gjithë procesin e iniciuar, përfshirë procedurat zyrtare, veprimet dhe hapat konkretë lidhur me projektin e ndërtimit të fabrikës së çimentos. Obligimi ligjor i autoriteteve shtetërore, qendrore dhe lokale, është se ato duhet të jenë mjaftueshëm transparente në lidhje me projektet dhe proceset e zhvillimeve ekonomike, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë mundësinë t'i monitorojnë zhvillimet. Kjo praktikë forcon bindjen e qytetarëve në institucionet e qeverisjes dhe ndihmon në ndërtimin e një shoqërie më të përfshirë dhe të informuar.

Duke marrë parasysh se zhvillimet ekonomike në fushën e industrisë minerale, si në këtë rast projekti për ndërtimin e fabrikës së çimentos, është konstatuar se autoritetet kompetente nuk kanë ofruar një hulumtim të mirëfilltë për vlerësimin dhe parashikimin e ndikimeve negative në mjedis. Një studim dhe hulumtim është i domosdoshëm për të ofruar informacion konkret mbi nivelin e ndikimit negativ të mundshëm në mjedis në të gjithë komponentët, si ndikimi në aspektin e dëmeve materiale, po ashtu edhe në aspektin e dëmeve jomateriale, ose të paprekshme, si p.sh.: cilësia e ajrit, niveli i zhurmës etj.

Duke qenë se në rastin konkret aktivizohen e drejta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, Avokati i Popullit vlerëson se nuk është ofruar një studim profesional i proporcionalitetit për të arritur deri te ruajtja e balancës midis dy aspekteve, e drejta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe mbrojtja e mjedisit jetësor. Përderisa zhvillimi ekonomik siguron rritje të ekonomisë, punësim, dhe përparim shoqëror, ndërthurja e tij me ndikimin mbi mjedisin mund të ketë pasoja negative të paqëndrueshme. Andaj shteti duhet të sigurojë që në rastet e ndërlikuara në të cilat mund të ndeshen të drejtat themelore të njeriut, ndikimi në cenimin e të drejtave të jetë në shkallën më të ulët të mundshme.

Mospërgjigjja e MMPHI-së në shkresat e Avokatit të Popullit konsiderohet si pengesë në punën e Avokatit të Popullit në analizimin dhe vlerësimin racional të rastit në aspektin e të drejtave të njeriut. Mosbashkëpunimi me Avokatin e Popullit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 132, paragrafi 3, shprehimisht përcakton: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.”

Avokati i Popullit vlerëson se organet shtetërore duhet ta kenë parasysh ruajtjen e vlerave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ruajtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj, ruajtjen e burimeve ujore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e florës dhe faunës, në mënyrë që të gjitha vendimet për proceset e zhvillimit ekonomik, të cilat mund t’i prekin këto dukuri natyrore, të jenë të qasshme për qytetarët e interesuar, të merren me shumë seriozitet, analizim dhe vlerësim të detajuar paraprak, në atë mënyrë që ndikimi negativ në pengimin e gëzimit të të drejtave të njeriut të jetë sa më i vogël i mundshëm, dhe në atë mënyrë që qytetarët të mos ndihen të rrezikuar për gëzimin e jetës dhe të shtëpisë së tyre në të ardhmen nga zhvillimet e industrisë minerale, nën hijen e territ informativ.

Raportet e vizitave të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim

Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Qëllimi i kësaj vizite është vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria. Qëllimi i vizitës është edhe vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të dërguara përmes raportit të datës 28 dhjetor 2023, hapja e kutive të ankesave, si dhe intervistimi i të paraburgosurve/ burgosurve, të cilët kanë kontaktuar me institucion, si dhe intervistimi i rasteve me lëndime trupore, të cilat janë përcjellë nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB).

Bashkëpunimi me MKP-në i zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës (më tej: ShKK) dhe i zyrtarëve të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) gjatë vizitës tregoi në QKD ishte i nivelit të kënaqshëm. Ekipi pati qasje në të gjitha vendet që i ka vizituar dhe i janë siguruar të gjitha informacionet e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues e as të personelit shëndetësor.

Kurse gjatë vizitës së MKP-së në QKD, më 22 korrik 2024, në Pavijonin D, zyrtarët korrektues nuk kishin njohuri për monitorimet që i realizon MKP-ja edhe pas orarit të punës.

Disa nga të gjeturat dhe konstatimet që dalin nga kjo vizitë janë se mosfunksionimi i Pavijonit nr. 2 ndikon te personat e dënuar për të drejtën për hapësirë të mjaftueshme dhe në mbipopullim të pavijoneve të tjera. Mungesa e ujit të ngrohtë në disa pavijone ndikon në sigurimin e higjienës personale të personave të dënuar.

Mungesa e dyshekëve dhe e jastëkëve cilësorë ndikon në shëndetin e të burgosurve dhe në pastërtinë në përgjithësi. Furrë e amortizuar dhe pajisjet e vjetruara në kuzhinë paraqesin vështirësi në përgatitjen e ushqimit cilësor, si dhe rrezikojnë të punësuarit në kuzhinë. Mosfunksionimi i elektronikës së ashensorit në depon e kuzhinës paraqet rrezik për jetën e personave që janë të angazhuar në bartjen e ushqimit, dhe po ashtu rrjedhja e ujit nga tavani i depon shkakton probleme në kryerjen e punëve.

Rrjedhja e ujit nga tavani në lavanderi dhe mosfunksionimi i tri lavatriçeve paraqesin vështirësi për kapacitetin e të gjitha pavijoneve. Po ashtu, lagështia dhe mosfunksionimi i ventilimit paraqesin rrezik për shëndetin e stafit dhe të të dënuarve. Vendosja e rasteve të rënda në krahun e psikiatrisë në spitalin e burgut, që nuk i plotësojnë as kushtet minimale, paraqet shkelje të të drejtave për këtë kategori të personave.

Pamundësia e qasjes në shërbimet sociale për shkak të numrit të vogël të punëtorëve socialë, mund të ndikojë në mirëqenien e të dënuarve brenda burgut, po ashtu pamundësia e realizimit të thirrjeve telefonike jashtë shtetit dhe koha e shkurtër e realizimit të thirrjeve nëpërmjet Skype paraqesin shkelje të të drejtave të të burgosurve.

Mosfunksionimi i kamerave të sigurisë në disa pavijone paraqet pasiguri për mbrojtje nga keqtrajtimi. Salla e sportit në PGjH duke qenë jofunksionale ndikon në mosrealizimin e aktiviteteve.

Me këtë rast iu rekomandua Ministrisë së Drejtësisë që: të gjendet zgjidhje për funksionalizimin e Pavijonit nr. 2.; Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të furnizohen mjaftueshëm me ujë të ngrohtë; Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të pajisen me dyshekë dhe jastëkë cilësorë në të gjitha pavijonet; Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që kuzhina të pajiset me furrë të re për pjekjen e bukës dhe me pajisje të

reja për përgatitjen e ushqimit; të ndërmerren masa urgjente për riparimin e ashensorit në depon e kuzhinës, si dhe të evitohet rrjedhja e ujit nga tavani; të evitohet rrjedhja e ujit nga tavani në lavanderi dhe të funksionalizohen lavatriçet dhe ventilimi; Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të krijohen kushtet adekuate për të hospitalizuarit në spitalin e burgut; Avokati i Popullit ri përsërit rekomandimin që të rritet numri i punëtorëve socialë; të gjithë shtetasve të huaj, të cilët janë në vuajtje të dënimit, të t'u mundësohet komunikimi me Skype, kur nuk kanë mundësi të telefonatës apo të vizitës; të funksionalizohen kamerat e sigurisë në disa pavijone dhe në kuzhinë; të funksionalizohet salla e sportit në Pavijonin Gjysmë të Hapur; të organizohen trajnime për zyrtarët korrektues që të njoftohen për nenin 17 të Ligjit nr.05/L-19 për Avokatin e Popullit dhe për mandatin e MKP-së.

Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në pikën e kalimit kufitar Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”

Qëllimi i kësaj vizite është vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të huajve të cilët, bazuar në Ligjin për të Huajt në Republikës së Kosovës dhe me ligjet tjera relevante, nuk mund të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës; janë subjekt i kthimit në vendet nga kanë ardhur; apo mbahen përkohësisht në hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Gjatë vizitave në këtë pikë të kalimit kufitar, bashkëpunimi me MKP-në i zyrtarëve policorë, të cilët ishin në detyrë, ka qenë i plotë. Ekipi ka pasur qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën.

Të huajt, të cilët duan ta kalojnë kufirin e Republikës së Kosovës dhe për këtë nuk i plotësojnë kriteret ligjore, si dhe nëse avio-transportuesi nuk është në gjendje që ta bëjë kthimin e tyre të menjëhershëm, mbahen në hapësira të veçanta në ANP, deri në 72 orë. Këto hapësira njihen edhe si hapësira të mbajtjes në pikën hyrëse nëpër aeroporte. Gjatë vizitës, MKP-ja nuk ka hasur në të huaj të akomoduar në këto hapësira. Ajo çfarë është vërejtur gjatë vizitës është se personat e ndaluar në këto hapësira nuk janë të regjistruar në ndonjë regjistër të posaçëm. Sipas policisë kufitare, këta persona regjistrohen vetëm në formularin e policisë, nga policët që janë në ndërrim.

Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: *KPT*), për të huajt e ndaluar, bazuar në Ligjin për të Huajt, i publikuara në vitin 1997,³⁰³ përcaktojnë se personat e ndaluar mbi këtë bazë duhet të kenë në dispozicion hapësirë adekuate për fjetje, të kenë qasje në valixhet e tyre dhe në hapësira adekuate sanitare dhe të pastrimit, si dhe ajrosje (dalje në ajër të pastër) në baza ditore. Më tej këto standarde përcaktojnë se i huaji në këto hapësira duhet të ketë qasje në ushqim dhe, nëse është e nevojshme, duhet të ketë kujdes shëndetësor.

Gjatë vizitës është vërejtur se këto dhoma ofrojnë kushte të pranueshme për akomodim, pastërtia është në nivel të duhur, tualete të furnizuara me mjete higjienike, dushe në gjendje të mirë, shtretër me dollapë si dhe dritë artificiale të mjaftueshme. Bazuar në pohimet e zyrtarëve të policisë kufitare, të huajve, të cilët mbahen në këto hapësira, u jepet mundësia të dalin në ajër të pastër (ajrosje) në baza ditore. Ekipi i MKP-së vlerëson se kushtet e akomodimit në këto dhoma janë sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.

Njësia Shëndetësore, e cila funksionon në kuadër të ANP-së, është shërbim i cili organizohet nga ANP-ja. Ekipi i MKP-së ka vizituar këtë pjesë shëndetësore, me ç' rast është thënë se të ndaluarit vizitohen në raste emergjente nga kjo njësi.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve mjekësore kur nevojitet shërbim më i specializuar në institucione të tjera publike shëndetësore jashtë ANP-së, ai dërgohet në këto institucione, nën përcjelljen e zyrtarëve policorë.

303 <https://rm.coe.int/16806ce90e>.

Për sa i përket kontaktit me botën e jashtme, mund të themi se dhomat ende nuk janë pajisur me informata të nevojshme, përmes të cilave të huajt mund të njoftohen për të drejtat e tyre, si dhe informata për mundësinë e kontaktit me mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në gjuhë të ndryshme dhe, siç u theksua me lart, nuk ka informata lidhur me mundësinë e qasjes në “wi-fi”. Ekipi i MKP-së ka vërejtur se ekzistojnë broshurat në gjuhë të ndryshme në zyrat e policisë, por konsideron se ato duhet të jenë të vendosura dhe të jenë të dukshme në dhomat e ndalimit.

Në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në ANP, Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme që të krijohet një regjistër i posaçëm për të ndaluarit në dhomat e ndalimit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, si dhe në hapësirat e mbajtjes (ndalimit) në pikat hyrëse të këtij aeroporti të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme (poster dhe broshura), përmes së cilave të huajt njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për të kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ashtu të vendosen edhe informatat lidhur me “wi-fi”-në.

Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: MKP), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll (në tekstin e mëtejshëm: QMH), e cila funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM), të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Qëllimi i kësaj vizite është monitorimi i respektimit të të drejtave të të huajve që mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas nenit 2 të Rregullosës (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera.

Kapaciteti i QMH-së është për 75 persona. Gjatë vitit 2023 janë ndaluar 11 persona në QMH, ku më së shumti kanë qëndruar 5 deri 6 muaj, ndërsa nga janari 2024 e deri në ditën e vizitës (21 gusht) janë mbajtur 21 persona të rritur, asnjë fëmijë i pashoqëruar.

Në këtë raport MKP-ja konstaton se në mungesë të personelit të kualifikuar mjekësor, personeli i Qendrës ua shpërndan terapinë të huajve në mbajtje duke u bazuar në raportin e shkruar nga mjeku kompetent, e cila është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt dhe me standardet ndërkombëtare të përcaktuara për paraburgimin për shkak të imigrimit. Për këtë gjetje është rekomanduar edhe më parë: “QMH-ja duhet ta ketë në dispozicion së paku një infermier, e cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.”

Në mungesës të personelit të kualifikuar mjekësor, raportet shëndetësore mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit, e cila e cenon konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore dhe është në kundërshtim me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt, me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me standardet ndërkombëtare.

Kamerat të cilat janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik, si dhe mbrojtje për personelin nga akuzat e rrejshme, nuk kanë pamje të qartë, disa edhe nuk funksionojnë fare si dhe ndriçimi mbrapa objektit është shumë i dobët. Për këtë gjetje, gjatë vitit 2022 kemi dhënë rekomandimet të cilat ende nuk janë zbatuar.

Objekti i ndërtuar për stafin administrativ të Qendrës, i cili i plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore, por për shkak të mungesës së linjës së internetit dhe mosfunksionimit të ngrohjes, ky objekt është jashtë funksionit.

Duke pasur parasysh se ndalimi për shkak të imigrimit është formë e ndalimit administrativ të personave dhe jo paraburgim klasik, MKP-ja e Avokatit të Popullit konstaton se Rregullorja nr. 04/2018 për *Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt* ka kufizime për sa u përket kontakteve me botën e jashtme si p.sh. qasje në internet, Skype, dhe se ka mungesë të aktiviteteve rekreative, sidomos për personat që qëndrojnë gjatë.

Nëpërmjet këtij raporti iu rekomandua Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike që të funksionalizohet objekti i dedikuar për stafin si dhe të shtohen aktivitete rekreative.

Raport për vizitat e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në stacionet policore

Bazuar në mandatin dhënë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit, ka vizituar stacionet policore si në vijim: Stacionin Policor në Shtërpcë, Stacionin Policor “Qendra”, Stacionin Policor në Podujevë, Stacionin Policor në Istog, Stacionin Policor Drenas, Stacionin Policor Skenderaj, Stacionin Policor Mitrovicë – Jugu, Stacionin Policor Mitrovicë – Veri, Stacionin Policor Malishevë, Stacionin Policor Rahovec, Stacionin Policor Gjakovë, Stacionin Policor Gjilan, Stacionin Policor Graçanicë. Qëllimi i vizitës në stacionet e lartpërmendura policore është për të vlerësuar nëse janë respektuar tri të drejtat themelore të personave të arrestuar: E drejta për ta njoftuar anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për faktin e arrestimit; E drejta për avokat mbrojtës; E drejta për shërbime mjekësore si dhe kushtet e akomodimit në qendrat e ndalimit policor. Këto të drejta janë të përcaktuara dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës.

Avokati i Popullit, nga të gjeturat gjatë vizitave në stacionet e lartcekura, vëren së në të gjitha qendrat e ndalimit, saktësisht në dhomat (qelitë) e ndalimit, nuk është i instaluar sistemi i thirrjes (zilja). Avokati i Popullit konstaton së në mungesë të sistemit të thirrjes (ziles), ekziston një rrezik i konsiderueshëm se policia nuk mund të ndërhyjë në kohën e duhur në rast incidentesh të ndryshme (dhunë midis personave të ndaluar, tentativë vetëvrasjeje, zjarr, kërkesa shëndetësore etj.). Andaj instalimi i sistemit të thirrjes mundëson dhe garanton që personat e ndaluar të kenë një siguri dhe komunikim me të shpejtë dhe më të mirëfilltë me stafin mbikëqyrës policor.

Në disa qendra të ndalimit mungonin broshura dhe karta të varura në mur, ku do të ilustrheshin të drejtat e njeriut të ndaluar në polici. Pavarësisht se personat e ndaluar njoftohen për drejtat e tyre gjatë intervistimit, përmes formularit të nënshkruar, Avokati i Popullit konsideron se edhe vendosja në dhomat e ndalimit e broshurave dhe e kartave për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar do t'i mundësonte personit të ndaluar një njoftim më të qartë për të drejtat e tij.

Për sa u përket kushteve materiale të qendrave të ndalimit, nga të gjeturat e lartcekura konstatojmë se qendrat e ndalimit në stacionet policore në Prishtinë, Drenas, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Shtërpcë, Gjakovë dhe Malishevë duhet të sanohen të gjitha defektet, po ashtu të rinovohen dhe të funksionalizohen për pranimin dhe mbajtjen e personave të ndaluar, sipas standardeve minimale të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.³⁰⁴ Po ashtu Avokati Popullit konstaton se zyrat e marrjes në pyetje në Stacionin Policor në Podujevë duhet të rregullohen dhe të rinovohen sipas këtyre standardeve.

304 <https://rm.coe.int/16806cd1d5>

Në të gjitha stacionet policore ka pasur mungesë të mjeteve higjienike.

Lidhur me funksionalizimin e kamerave në qendrat e ndalimit, Avokati i Popullit vëren se në stacionet policore në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Avokati i Popullit konstaton se mosfunksionalizimi i kamerave në stacionimet në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë paraqet rrezik për keqtrajtim të personave në ndalim, andaj sa më shpejt të jetë e mundur duhet të funksionalizohen kamerat e sigurisë në këto qendra të ndalimit.

Ushqimi për të ndaluarit është jocilësor, i thatë dhe i pamjaftueshëm për nga sasia në të gjitha qendrat e ndalimit që i kemi vizituar. Zyrtarët policorë në stacionet policore të lartcekura, problemin më të madh e kanë me personat që janë përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor dhe këto kategori po ua vështirësojnë shumë punën, pasi janë vështirë të menaxhueshëm dhe pandërprerë për 48 orë duhet të vëzhgohen, nga frika e tentimit për vetëlëndim/vetëvrasje. Këta persona po paraqesin rrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për t'i trajtuar këto kategori të të ndaluarve.

Në të gjitha stacionet policore kemi pranuar shqetësime dhe kemi vërejtur se kushtet e punës për zyrtarët policorë, në shumicën e stacioneve të lartcekura, janë të pafavorshme për punë, pasi ka mungesë të inventarit, të printerëve, të mjeteve higjienike dhe të veturave.

Me këtë raport i është rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme që të gjitha qendrat e ndalimit në stacionet policore të lartcekura të pajisen me sistemin e thirrjes - zilen e thirrjes; në të gjitha dhomat/qelitë në qendrat e ndalimit të vendosen në mure kartat për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar; të sanohen problemet dhe të funksionalizohen qendrat e ndalimit në stacionet policore në Prishtinë, në Drenas, në Mitrovicën e Jugut, në Mitrovicën e Veriut, në Gjakovë, në Shtërpcë dhe në Malishevë; të ndaluarit të furnizohen me mjete të mjaftueshme higjienike; të funksionalizohen kamerat e sigurisë në stacionet policore në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë; të ndaluarit të ushqehen me ushqim cilësor dhe të bollshëm; të mbahen trajnime adekuate për stafin policor për trajnimin e personave të ndaluar me sëmundje mendore; të krijohen kushtet e punës për zyrtarët policorë, të pajisen me inventar adekuat (karrige, tavolina), me printerë, me mjete higjienike dhe me vetura.

Raport për vizitën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vizitoi Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) dhe Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur (QEKM) në Lipjan. Qëllimi i vizitave është monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të mitur të privuar nga liria, të cilat u garantohen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria, vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dërguara përmes raportit të vitit 2022, hapja e kutive të ankesave, intervistimi i të miturve të cilët kanë kërkuar të kontaktohen nga Avokati i Popullit, si dhe intervistimi dhe kontrolli i dosjeve të rasteve të cilat janë përcjellë nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve.

Nga të gjeturat e vizitës në Qendrën Korrektuese për të Mitur, konstatojmë se në Pavijonin D mungojnë dollapët për vendosjen e rrobave dhe dyshekët janë të vjetruar. Mungesa e dyshekëve cilësorë ndikon në shëndetin fizik të të miturve, kurse mungesa e dollapëve në pastërtinë në përgjithësi. Temperaturat e larta gjatë verës nëpër dhomat e të miturve ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor të të miturve, duke shkaktuar dehidrim dhe lodhje. Ushqimi jocilësor dhe i pamjaftueshëm për të miturit ndikon në dobësimin e sistemit imunitar dhe rritjen e rrezikut për sëmundje. Mungesa e aktiviteteve të të miturit e paraburgosur ndikon në

moszhvillimin e raporteve sociale për komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët. Kujdestaria e një infermieri për tri qendrat korrektuese në Lipjan nuk mund të ofrojë kujdes të mjaftueshëm.

Mungesa e një institucioni ku mund të trajtohen të miturit e burgosur me probleme të shëndetit mendor dhe vështirë të menaxhueshëm, mund të ndikojë në përkeqësimin e shëndetit mendor të të miturve, po ashtu mungesa e këtyre institucioneve të specializuara mund të përbëjë shkelje të këtyre të drejtave, duke i lënë ata të pafavorizuar në krahasim me të rriturit. Me këtë raport i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë: “Të miturit të furnizohen me dyshekë cilësorë dhe me dollapë për vendosjen e rrobave; të ndërmerren masa që në dhomat ku mbretërojnë temperaturat e larta të pajisen me kondicionierë; të miturve t’u sigurohet ushqim cilësor dhe i mjaftueshëm; të bëhen përpjekje që të miturit e paraburgosur të angazhohen më tepër në aktivitete; të themelohet një institucion ku ofrohet kujdes i veçantë për të miturit e burgosur me probleme të shëndetit mendor duke u mundësuar të miturve trajtim të duhur.”

Mendimet e Avokatit të Popullit të shprehura në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae)

Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+

Ky mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës analizon deklaratat e disa deputetëve lidhur me komunitetin LGBTIQ+, të shprehura në seancën plenare të datës 16 mars 2022, në të cilën është debatuar Projektkodi Civil nr. 08/L-124.

Krahas ankesës së parashtruar në institucionin e Avokatit të Popullit të parashtruar në emër të organizatave joqeveritare: Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Kosovës (YIHR), Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Mbrojtësit e të Drejtave Qytetare, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, të cilat me autorizim përfaqësohen nga znj. Marigona Shabiu nga Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Kosovës. Ata parashtruan edhe padinë (C.nr 2993/2024) në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave të rastit, i ofroi kësaj gjykate mendimin e tij në cilësinë e mikut të gjykatës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbajti një seancë plenare, ku ndër të tjerash, zhvilloi edhe shqyrtimin e parë të Projektkodit Civil nr. 08/L/124. Dispozita që nxiti diskutimin kontradiktor ndërmjet deputetëve të Kuvendit të Kosovës ishte neni 1138, paragrafi 2, i Projektkodit Civil, që parashikon: *“Lejohen bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave të së njëjtës gjini. Kushtet dhe procedurat rregullohen me ligj të veçantë.”*

Në këtë seancë u shprehen deklaratat negative ndaj personave LGBTIQ+ nga disa deputetë, të cilët jo vetëm që propagandonin hapur “familjen natyrale” dhe “ruajtjen e llojit” dhe “traditës”, por edhe verbalizonin paragjykime ndaj çifteve të së njëjtës gjini. Sipas tyre, Kodit i ri do të rrezikonte “moralin publik” dhe do të përfaqësonte “pangopshmërinë seksuale”, “degjenerimin moral”, “sëmundjen”, “shkatërrimin”, sjelljen që është “në kundërshtim me natyrën njerëzore”, “shkeljen e shenjtërisë së familjes”, “përfaqëson një akt që seriozisht dëmton shëndetin publik, duke u bërë shkak për sëmundje të rënda dhe të pashërueshme, si HIV/AIDS-i”, dhe që në fund rezulton në “traumë shoqërore”.

Para diskutimit parlamentar, disa deputetë u shfaqën edhe në publik me deklaratat dhe pretendime se pse nuk duhet të votohet për Projektkodin Civil. Këto qëndrime ngjallën komente negative në rrjetet sociale dhe në opinionin publik, të cilat më tej shpërfaqën narrativë dhe qëndrime homofobe.

Organizatave e Shoqërisë Civile reagojnë kundër gjuhës që përdorej ndaj komunitetit LGBTIQ+

gjatë debatit për Projektkodin Civil. Në reagimet e tyre, ato theksuan se diskriminimi dhe stigmatizimi shoqëror dëmtojnë mirëqenien psikologjike, fizike, sociale dhe ekonomike të personave LGBTIQ+.

Duke marrë parasysh objektin e kësaj ankese, Avokati i Popullit thekson se është e nevojshme të përcaktohet nëse qëndrimet dhe deklaratat e bëra nga deputetët në këtë seancë plenare gjatë shqyrtimit të parë të Projektkodit Civil nr. 08/L-124, përbëjnë shkelje të dispozitave të LMD-së. Respektivisht, nëse qëndrimet dhe deklaratat e bëra nga këta deputetë përbëjnë shkelje të dinjitetit të personave ose grupit të personave mbi bazën e karakteristikës së tyre personale, konkretisht orientimit seksual dhe nëse këto deklarata krijojnë një ambient armiqësor, poshtërues dhe fyes për pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ+ dhe nëse këto deklarata mund të konsiderohen si gjuhë urrejtjeje.

Betimi në respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit i obligon deputetët që të zbatojnë dhe të respektojnë Kushtetutën dhe legjisllacionin për mbrojtje nga diskriminimi edhe të shtetasve të Republikës së Kosovës që i përkasin komunitetit LGBTIQ+.

Rekomandimi CM/Rek (2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 31 mars 2010, në takimin e 1081-të të Zëvendësministrave), jep një numër rekomandimesh: duke rikujtuar se, mes të tjerash, lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin, marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave; duke pasur parasysh se jurisprudenca e GjEDNj-së dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë; duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur; duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare dhe as rregullat e një "kulture dominuese" nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor.

Avokati i Popullit ka parasysh rëndësinë e lirisë së mendimit dhe shprehjes dhe në këtë kontekst thekson se çdo individ ka të drejtë të shprehë mendimin dhe qëndrimet e tij personale, gjë që përbën bazën e çdo shoqërie të lirë demokratike. Megjithatë, e drejta për lirinë e fjalës, pavarësisht mënyrës së shprehjes dhe publikimit të ideve dhe qëndrimeve, nuk duhet të jetë një justifikim për diskriminim. Prandaj, shprehja e qëndrimeve dhe bindjeve që shkelin dinjitetin e personave ose grupit të personave dhe dëmtojnë reputacionin, si dhe të drejtat e garantuara të të tjerëve nuk mund të justifikohet me të drejtën për lirinë e shprehjes.

Këto qëndrime dhe deklarata kanë një peshë të veçantë kur merret parasysh se deputetët e Kuvendit të Kosovës janë pjesë e një institucioni që është organi më i lartë përfaqësues dhe bartësi i pushtetit kushtetues dhe legjisllativ në vend dhe që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendosjen e sistemit demokratik dhe që përfaqëson bazën për vendosjen e sundimit të ligjit, mbikëqyrjen e proceseve të qeverisjes dhe respektimin e instrumenteve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka trajtuar raste që përfshijnë fjalime diskriminuese të përdorura nga zyrtarë publikë, duke përfshirë politikanë dhe përfaqësues të qeverisë. Këtu janë disa pika dhe parime kryesore që rrjedhin nga jurisprudenca e GjEDNj-së:

- a. GjEDNj-ja njeh rëndësinë e lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes për zyrtarët publikë, si një e drejtë themelore sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund t'u nënshtrohet kufizimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për të folur që mund të dëmtojë të drejtat ose interesat e të tjerëve.
- b. GjEDNj-ja bën dallimin mes kritikës legjitime ose shprehjes së mendimit dhe gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes, veçanërisht kur përdoret nga zyrtarët publikë, mund të dëmtojë kohezionin social dhe të cenojë dinjitetin njerëzor dhe nuk gëzon mbrojtje sipas nenit 10 nëse tejkalon kufijtë e lejueshëm të lirisë së shprehjes.
- c. Konteksti në të cilin shfaqet fjalimi diskriminues është vendimtar. Deklaratat e bëra nga zyrtarët publikë kanë peshë dhe mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në diskursin publik dhe qëndrimet shoqërore. Prandaj, deklarata të tilla mund t'i nënshtrohet një shqyrtimi dhe llogaridhënieje më të rreptë.
- d. GjEDNj-ja thekson rëndësinë e mjeteve juridike efektive për viktimat e deklaratave diskriminuese. GjEDNj-ja pret që shtetet të sigurojnë mekanizma për të adresuar gjuhën e urrejtjes dhe për të siguruar llogaridhënie, duke përfshirë masat ligjore, gjyqësore dhe administrative.

Avokati i Popullit vlerëson se liria e fjalës, shprehjes dhe informimit nuk duhet të jenë një justifikim për asnjë lloj diskriminimi dhe nënvlerësimi për ndonjë karakteristikë personale, as për promovimin e paragjyqimeve dhe krijimin e një mjedisi armiqësor dhe fyes për një grup të caktuar njerëzish. Gjithashtu, liria e shprehjes nuk mund të përdoret si justifikim për gjuhën e urrejtjes. Deklaratat e përfaqësuesve të popullit, të cilët përcjellin mesazhe dhe formësojnë qëndrimet e opinionit publik, janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe prandaj deklaratat e tyre nuk duhet të mbështesin paragjykimet, stereotipat dhe modelet e tjera të papranueshme shoqërore. Për këtë arsye, të gjithë zyrtarët shtetërorë dhe organet publike kanë një përgjegjësi të veçantë dhe një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në promovimin e tolerancës, promovimin e së drejtës për dallim dhe krijimin e një shoqërie ku të drejtat e të gjithëve respektohen pa diskriminim.

Deklaratat e deputetëve të bëra më 16 mars 2022, gjatë debatit në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, gjatë shqyrtimit të nenit të Projektkodit Civil nr. 08/L-124, lidhur me nenin 1138, paragrafi 2, janë diskriminuese, shkelin dinjitetin e personave LGBTIQ+ duke krijuar një mjedis poshtëruës dhe fyes ndaj tyre dhe, duke u bazuar në praktikën e GjEDNj-së përbëjnë gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+.

Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) ofruar Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, lidhur me detyrimet e organeve shtetërore për respektimin e parimit të ligjshmërisë me rastin e anulimit të vendimeve

Ky mendim juridik (*amicus curiae*) përqendrohet në sqarimin e bazës dhe të analizës ligjore përkritazi me ankesën e ankuesit në lidhje me mosrespektimin e parimit të ligjshmërisë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e marrjes së vendimit sipas ankesës së tij dhe detyrimet e organeve shtetërore për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Avokati Popullit, pa paragjykuar vendimin final të gjykatës, vëren se KPMSHCK-ja, me Vendimin A.nr. 1237/2023, e ka anuluar vendimin e ministres së MASHTI-t (Vendimi Nr. Protokolli 2357, datë 20 shtator 2023) me arsyetimin se është nxjerrë nga organi jokompetent. Edhe pse KPMSHCK-ja, me Vendimin A.nr. 1237/2023, ka anuluar vendimin e ministres për shkak të mungesës së kompetencës për të nxjerrë një vendim të tillë, KPMSHCK-ja megjithatë e ka lënë në fuqi pasojën e atij vendimit, rrjedhimisht e ka refuzuar kërkesën e ankuesit për kthimin e tij në pozitën që ai e mbante sipas akt emërimit të mëhershëm.

Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 52, përcakton rrethanat se kur një akt administrativ është i paligjshëm. Në pikën 1.2 përcakton se akti administrativ i paligjshëm është akt i nxjerr nga organi publik, i cili nuk ka kompetencë. Për vlerësimin e Avokatit të Popullit, qëllimi i anulimit të aktit administrativ të paligjshëm është vendosja e ligjshmërisë, pra që me vendimin e anuluar të evitohen edhe pasojat që ka prodhuar një vendim i paligjshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se KPMSHCK-ja nuk e ka evituar pasojën që ka rrjedhur si rezultat i vendimit të paligjshëm i nxjerr nga organi jokompetent dhe se në rastin konkret është cenuar parimi i ligjshmërisë. Parimi i ligjshmërisë është parim themelor i funksionimit të tërë sistemit juridik në vend, duke përfshirë edhe funksionimin e administratës shtetërore, ndërsa aplikimi i tij parandalon organet e administratës të marrin vendime arbitrare. Respektimi i plotë i këtij parimi, në procedurën administrative, krijon më shumë siguri juridike për të gjitha palët në procedurë. Rëndësia parësore e parimit të ligjshmërisë konsiston në respektimin e procedurës ligjore dhe nxjerrjen e vendimeve të ligjshme.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se KPMSHCK-ja e ka pasur për obligim ligjor që me rastin e marrjes së Vendimit A.nr. 1237/2023, ta respektonte plotësisht parimin e ligjshmërisë, që me rastin e anulimit të vendimit, ta anulonte edhe pasojën juridike që e ka shkaktuar ai vendim dhe me këtë ta mbronte dhe ta garantonte të drejtën e ankuesit.

Mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) ofruar Gjykatës Themelore në Prishtinë

Ky mendim i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, përkritazi me ankesën e që ka të bëjë me zhvillimin e procedurave në gjykatë e që ka të bëjë me shkëputjen e kontratës së punës.

Ankuesja ka filluar punën provuese në pozitën asistente e drejtorit në një institucion publik sipas kontratës së nënshkruar me afat të pacaktuar, me kushtin e përfundimit të suksesshëm të punës provuese dhe konfirmimit të vlerësimit të performancës në punë. Kjo kontratë është shkëputur nga punëdhënësi për afërsisht pas një viti që, sipas saj, arsyeja e shkëputje së kontratës është bazuar në draft-raportin e auditimit financiar që ka të bëjë me performancën e institucionit dhe jo me performancën e saj.

Ankuesja pretendon se ajo ndihet e diskriminuar nga punëdhënësi mbi bazën aktivitetit publik dhe të bindjeve politike, gjendjes familjare dhe martesore të bashkëshortit të saj, që ka shërbyer një kohë në cilësinë e këshilltarit politik në Zyrën e Kryeministrit dhe Zyrën e Presidentit.

Avokati i Popullit vlerëson se ndërprerja e marrëdhënies së punës për arsyet të cilat nuk parashikohen me ligj mund të cenojnë parimin e sigurisë juridike në kuptimin e pritjes legjitime. Koncepti i pritjeve legjitime në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka integruar konceptin e pritjeve legjitime në shqyrtimin e rasteve të ngritura në këtë gjykatë.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, paragrafët 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, paragrafi 73, GJEDNJ 2002-VII), “pritja legjitime” duhet të jetë e një natyre më konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e ankueses është që asaj të mos i ndërpritet kontrata për arsyet të cilat nuk janë të përcaktuara me ligj.

Nëse dokumentet e klasifikuara nuk përmbajnë ndonjë arsye të vlefshme për shkëputjen e kontratës, përveç atyre të cilat përcaktohen me ligj, atëherë mund të ketë dyshime të bazuara se kontrata është shkëputur në mënyrë diskriminuese për shkak të orientimit politik të bashkëshortit të ankueses.

Rrjedhimisht, mund të bëhet fjalë për diskriminim me shoqërizim kur diskriminimi vjen jo për shkak të vetive të vetë ankuesit, pra personit të diskriminuar, por për shkak të lidhjes me një person ose grup që kanë një nga shkaqet e mbrojtura (rasti *Molla Sali v. Greece* Application no. 20452/14).

**Promovimi i
drejtave dhe i
lirive themelore
të njeriut nga
IAP-ja gjatë vitit
2024**

Promovimi i drejtave dhe i lirive themelore të njeriut nga IAP-ja gjatë vitit 2024

Roli i IAP-së në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë

Promovimi dhe edukimi mbi të drejtat e njeriut përbëjnë njërin nga tri shtyllat më të rëndësishme në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisë të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, edhe përgjatë vitit 2024, ka mbetur i përkushtuar në ndërmarrjen e aktiviteteve të ndryshme me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit dhe edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Po ashtu ka vazhduar me përbushjen e obligimeve që dalin nga instrumentet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nga Ligji për Avokatin e Popullit, si dhe qëllimin strategjik të dytë të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025, mbi promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe rolit të IAP-së.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka organizuar një sërë tryezash të rëndësishme, ku janë diskutuar çështje të të drejtave e njeriut, me qëllim të rritjes së vetëdijesimit për mbrojtjen dhe respektimin e tyre. Në këto tryeza janë paraqitur gjithashtu edhe të gjeturat nga raportet e ndryshme të Avokatit të Popullit. Përmes një bashkëpunimi të ngushtë me shoqërinë civile dhe me organizatat ndërkombëtare, janë zhvilluar fushata të shumta informuese në terren, ligjërata me studentë dhe të rinj, si dhe aktivitete të tjera promovuese dhe sensibilizuese.

Në vijim paraqitja tabelore e aktiviteteve të organizuara nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2024:

Lloji i aktivitetit	Qëllimi	Numri total
Tryeza tematike të organizuara nga IAP-ja dhe në bashkëpunim me partnerë	Diskutimi mbi të drejtat e njeriut, promovimi i të drejtave të njeriut, prezantimi i të gjeturave në raportet e publikuara me rekomandime	16
Tryeza tematike dhe fushata informuese në terren me OSHC (ACDC)	Ngritja e vetëdijesimit mbi të drejtat e njeriut, promovimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit me nivelin lokal	5
Tryeza tematike dhe fushata informuese në terren me organizata ndërkombëtare (OSCE)	Ngritja e vetëdijesimit mbi të drejtat e njeriut, promovimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit me nivelin lokal	9
Ligjërata dhe takime me të rinj	Edukimi dhe informimi mbi të drejtat e njeriut	7
Trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë	Edukimi dhe informimi i profesionistëve ligjorë mbi të drejtat e njeriut, praktikën e GjEDNJ-së dhe mandatin e IAP-së	2
Takime me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në kuadër të fushatës "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit"	Edukimi mbi të drejtat e njeriut dhe ngritja e vetëdijesimit	30
Takim me nxënësit e nivelit parashkollorë		1
Takime dhe ngjarje të tjera lansuese	Bashkëpunimi në avancimin e të drejtave të njeriut	10

Takime në kuadër të Forumit për Dialog me OSHC	Fuqizimi i bashkëpunimit dhe avancimi i promovimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut	3
--	---	---

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe ngritja e vetëdijesimit përmes fushatave informuese në terren

Në vitin 2024, Avokati i Popullit, në bashkëpunim dhe mbështetje të OSBE-së, ka organizuar 8 tryeza të diskutimit në komuna të ndryshme të Kosovës në: Graçanicë³⁰⁵, Rahovec, Klinë, Dragash, Mamushë³⁰⁶, Letnicë dhe 2 tryeza në Shtërpçë. Në këto tryeza morën pjesë kryetarët e komunave, përfaqësues nga drejtoritë komunale, zyrtarë për të drejtat e njeriut, barazi gjinore e komunitete, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe qytetarë nga komunitetet joshumicë si: serbë, turq, boshnjakë dhe kroatë.

Qëllimi kryesor i këtyre tryezave është ngritja e vetëdijes mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, informimi për mandatin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, dëgjimi dhe adresimi i ankesave të qytetarëve, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet lokale dhe shoqërinë civile.

Më 8 nëntor 2024, në tryezën e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me zyrën e OSBE-së, u prezantuan të gjeturat e mbledhura nga informatat e marra në terren si dhe nga ankesat e paraqitura nga qytetarët, ku të njëjtat u diskutuan me përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale.³⁰⁷

Problemet, sfidat, ankesat të cilat janë adresuar nga ana qytetarëve në këto tryeza dhe të cilët do të adresohen nga Avokati i

Popullit përbrenda kompetencave të tij, janë: *problemet mjedisore, duke filluar ndotja e ajrit, lumenjëve, mosmenaxhimi i zhurmës, mungesa e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse mjedisore, mungesa e inspektorëve komunalë mjedisorë; mangësi në respektimin e përdorimit të gjuhës amtare për qytetarët e komuniteteve joshumicë në proceset gjyqësore, administrative, rekrutimit në punë; mungesë e organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut nga radhët e komuniteteve joshumicë; numri i ulët i përfaqësimit të grave në pozita publike lokale; vështirësi në procesin e njohjes së diplomave, veçanërisht për komunitetin serb; mungesa e qasjes fizike dhe infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara në institucione publike, si; gjykatat, komunat dhe shkollat; mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm në disa komuna si shembull në Klinë etj.*

Bashkëpunimi me shoqërinë civile për promovimin e të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit në bashkëpunim me Qendrën Avokuese për Kulturën Demokratike (ACDC), gjatë vitit 2024, në kuadër të projektit “Përparimi i të drejtave të njeriut përmes rritjes së vetëdijes publike”, i zbatuar nga OJQ “ACDC” dhe i mbështetur nga UNMIK-u, organizuan një seri tryezash në regjione të ndryshme të Kosovës si në: Prizren³⁰⁸, Ferizaj³⁰⁹, Mitrovicë të Veriut³¹⁰, Gjilan³¹¹, Stanishor.³¹² Qëllimi i këtyre tryezave, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të institucioneve komunale lokale e përfaqësues të organizatave joqeveritare nga radhët e komuniteteve serb, rom, ashkali dhe egjiptian, boshnjak, goran dhe turq, ka qenë diskutimi mbi situatën e të drejtave të njeriut në nivel lokal, respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë si dhe fuqizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë dhe informimi mbi

305 <https://oik-rks.org/2024/06/18/avokati-i-popullit-diskuton-ne-gracanice-per-te-drejtat-gjuhesore/>

306 <https://oik-rks.org/2024/09/23/tryeze-diskutimi-me-perfaqesuesit-e-komunes-dhe-organizatave-joqeveritare-ne-mamushe/it>

307 <https://oik-rks.org/2024/11/08/iap-prezanton-te-gjeturat-nga-takimet-me-qytetare/>

308 <https://oik-rks.org/2024/02/28/avokati-i-popullit-takoi-perfaqesues-te-shoqerise-civile-dhe-institucioneve-lokale-te-regjionit-te-prizrenit/>

309 <https://oik-rks.org/2024/02/08/avokati-i-popullit-diskutoi-per-te-drejtat-e-njeriut-me-perfaqesues-lokal-dhe-te-shoqerise-civile-ne-ferizaj/>

310 <https://oik-rks.org/2024/03/28/avokati-i-popullit-takoi-perfaqesuesit-e-ojq-ve-ne-mitrovic-te-veriut/>

311 <https://oik-rks.org/2022/05/23/avokati-i-popullit-diskutoi-per-te-drejtat-e-njeriut-ne-gjilan/>

312 <https://oik-rks.org/2024/06/04/>

rolin dhe kompetencat e IAP-së në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në këto takime dhe tryeza, lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë, si sfida dhe çështje me nevojë për adresim, janë evidentuar: vonesat në proceset gjyqësore e veçanërisht ato kontestimore; respektimi jo i mjaftueshëm i së drejtës për përdorim të gjuhës amtare në procedurat gjyqësore; moslegalizimi i pronave, mungesa e librave shkollorë në gjuhët amtare; mungesa e komunikimit në gjuhët lokale gjatë marrjes dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore, e veçanërisht gjatë zhvillimit të procedurave administrative e më gjerë.

Promovimi i të drejtave të njeriut përmes artit

Më 5 qershor 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare që për fokus ka promovimin e mjedisit të shëndetshëm dhe të pastër “EcoZ” dhe “Save the Children Kosova/o”, u shënuua Dita Botërore e Mjedisit.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi mbi çështjet dhe sfidat mjedisore me fëmijët nga grup-mosha 7-15 të Asamblesë Mjedisore të Fëmijëve. Me qëllim të promovimit të së drejtës për mjedis të shëndetshëm jetësor, si e drejtë e njeriut, përmes artit, në fund të këtij aktiviteti fëmijët patën mundësi që nëpërmjet kreativitetit të tyre, pikturimit e vizatimit ta paraqisnin mjedisin jetësor të shëndetshëm dhe të drejtat e njeriut.



313 <https://oik-rks.org/2024/02/06/prezantohet-raporti-i-avokatit-te-popullit-ne-lidhje-me-gjuhen-ne-diskursin-publik/>

314 <https://oik-rks.org/2024/03/08/per-nder-te-dites-se-gruas-avokati-i-popullit-priti-ne-takim-grupin-e-prinderve-me-femijet-me-aftesi-te-kufizuar/>

Tryezat tematike të organizuara gjatë vitit 2024

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2024 ka organizuar 16 tryeza tematike, disa prej të cilëve janë organizuar në bashkëpunim me partnerë, ku është diskutuar gjendja e të drejtave të njeriut në vend, mundësitë për promovimin e mëtutjeshëm të tyre dhe mbrojtjen si edhe janë prezantuar të gjeturat e raporteve të Avokatit të Popullit.

Prezantimi i raportit me rekomandime “Gjuha në diskursin publik në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”

Më 6 shkurt 2024, Avokati i Popullit, në tryezën e organizuar prezantoi raportin me rekomandime “Gjuha në diskursin publik në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”.³¹³ Raporti u diskutua në dy panele të diskutimi me temë “Gjuha e papërshtatshme në diskursin publik” dhe “Roli i institucioneve vendore në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe respektimin e kufijve të saj”. Të gjeturat e raportit nënvizuan përdorimin e gjuhës indirekte të urrejtjes në disa debate parlamentare, ashpërsinë e gjuhës në debatet televizive dhe një përdorim shumë më të ulët të gjuhës së urrejtjes në platformat e mediave sociale.

Promovimi i ekspozitës “Buqetë Zembrash”

Më 8 mars 2024, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Avokati i Popullit priti në takim grupin e prindërve avokues për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga organizata Handikos. Gjatë takimit u prezantua ekspozita e pikturave “Buqetë Zembrash”,³¹⁴ e cila është vendosur në hapësirat e IAP-së, nëpërmjet së cilës

16 nëna të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë përçuar mesazhin e motivit, forcës dhe përkrahjes përballë sfidave që ato kalojnë. Në takim po ashtu është theksuar nevoja për fuqizimin e mbështetjes shtetërore për fëmijët me aftësi të kufizuara, krijimin e hapësirave publike të qasshme, trajtimin e barabartë dhe sigurimin e pajisjeve ndihmëse, si dhe zbatimin e plotë të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.



Tryezë diskutimi me përfaqësues të sindikatave të vendit

Më 12 mars 2024, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësuesit e sindikatave të sektorëve të ndryshëm, për të adresuar çështje të rëndësishme lidhur me të drejtat e të punësuarve, dialogun social dhe lirinë e organizimit sindikal.³¹⁵

Sindikatat e arsimit, policisë, shëndetësisë, shërbimit korrektues, zjarrfikësve, doganave, administratës tatimore, aeroportit dhe sektorit

të minierave shprehen shqetësime për mungesën e dialogut me pushtetin ekzekutiv. Pas diskutimeve, u arrit një marrëveshje për të organizuar një takim të përbashkët me qeverinë dhe ministrinë përkatëse, për të adresuar kërkesat dhe shqetësimet e sindikalistëve.

Tryezë diskutimi “Restaurimi i të drejtave pronësore të nacionalizuara”

Më 19 mars 2024, Avokati i Popullit organizoi një tryezë diskutimi mbi restaurimin e të drejtave pronësore të nacionalizuara, ku morën pjesë edhe përfaqësues të sistemit gjyqësor në vend.³¹⁶

Qëllimi i takimit është diskutimi mbi rastet e marrjes së pronave private, pa kompensim në periudhën e komunizmit dhe modalitetet që duhet t'i ndjekë Republika e Kosovës, me qëllim të kompensimit të atyre pronarëve, pronat e të cilëve janë marrë pa kompensim. Takimi nxori si rekomandim nevojën për miratimin e Ligjit për Denacionalizimin e Pronave dhe përcaktimin ligjor të rasteve të kompensimit ose kthimit të pronave të nacionalizuara, nëse kjo është e mundur.

Tryezë diskutimi me rastin e shënimit të Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur

Më 26 prill 2024, me rastin e shënimit të Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur, u organizua tryezë diskutimi, ku mori pjesë Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë, Këshilli Koordinues i Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës dhe Qendra Burimore për Personat e Zhdukur.³¹⁷

Tryeza pati për qëllim diskutimin mbi detyrimet e shtetit për t'u garantuar familjeve të personave të zhdukur të drejtën për të ditur të vërtetën për fatin e familjarëve të zhdukur

315 <https://oik-rks.org/2024/03/12/avokati-i-popullit-takoi-perfaqesuesit-e-sindikatave/>

316 <https://oik-rks.org/2024/03/19/avokati-i-popullit-organizoi-tryezen-me-titull-restaurimi-i-te-drejtave-pronesore-te-nacionalizuara/>

317 <https://oik-rks.org/2024/04/26/u-mbajt-tryeze-diskusimi-me-rastin-e-shenimit-te-dites-kombetare-per-personat-e-pagjetur/>

me forcë dhe për të garantuar drejtësi për viktimat, e po ashtu edhe për veprimet e ndërmarra nga shteti deri më tani. Po ashtu u prezantuan të gjeturat e Raportit të Avokatit të Popullit “Drejtësia Tranzicionale dhe zbatimi i mekanizmave të saj”, që ka vlerësuar nga perspektiva e të drejtave të njeriut përmbushjen e detyrimeve të shtetit për dokumentimin e krimeve të luftës dhe sigurimin e drejtësisë për viktimat.



Tryezë diskutimi mbi “Respektimin e së drejtës së qytetarëve në shërbime shëndetësore, me theks shëndetin seksual dhe riprodhues – si e drejtë e njeriut”

Më 8 maj 2024, në bashkëpunim me OJQ “Qendra për Barazim dhe Drejtësi”, u organizua në Prizren tryeza me temë “Respektimi i së drejtës së qytetarëve në shërbime shëndetësore, me theks shëndetin seksual dhe riprodhues – si e drejtë e njeriut”.³¹⁸

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i gjetjeve të Raportit të Avokatit të Popullit “Të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues” dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve nga autoritetet përgjegjëse. Në këtë tryezë morën pjesë edhe kryetari i komunës Suharekës ai i Dragashit, të cilët diskutuan për përmirësimin e shërbimeve mjekësore dhe sfidat që kërkojnë adresim në sektorin e shëndetësisë.

Lansimi i Raportit mbi zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në komuna dhe në gjykata themelore

Më 23 maj 2024, në tryezën e organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët, u lansuan të gjeturat e Raportit për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në komuna dhe në gjykata themelore.³¹⁹ Gjatë tryezës, nga Avokati i Popullit u theksua rëndësia e zbatimit të Ligjit për Gjuhët për garantimin e të drejtave të qytetarëve në shërbimet publike. Raporti i paraqitur pasqyron gjetjet nga monitorimi i ueb-faqeve zyrtare të komunave dhe të gjykatave, duke vënë në dukje se dygjuhësia respektohet në shumicën e komunave dhe gjykatave themelore. Megjithatë, në disa raste, si në Graçanicë dhe në Prishtinë, ka mangësi në mbishkrimet orientuese, ndërsa në Mitrovicën e Jugut dhe në Prishtinë janë identifikuar më shumë probleme në këtë aspekt.

Tryezë diskutimi mbi mbrojtjen e fëmijëve nga ngacmimi seksual

Më 25 qershor 2024, u organizua tryezë diskutimi mbi mbrojtjen e fëmijëve nga ngacmimi seksual, veprat penale kundër jetës dhe trupit, si dhe ato kundër integritetit seksual.³²⁰

Gjatë tryezës, Avokati i Popullit shprehu shqetësimin për rastet e abuzimit seksual të fëmijëve në Kosovë dhe theksoi nevojën për veprime institucionale. Ai nënvizoi se këto ngjarje ekspozojnë pasigurinë dhe rrezikun për fëmijët, veçanërisht për vajzat, duke shkaktuar pasoja fizike, psikologjike dhe sociale, të cilat po ashtu përbëjnë shkelje të të drejtave të fëmijëve, të garantuara nga ligjet dhe konventat ndërkombëtare.

318 <https://oik-rks.org/2024/05/08/diskutohen-te-drejtat-e-shendetit-seksual-dhe-riprodhues-ne-prizren/>

319 <https://oik-rks.org/2024/05/23/iap-dhe-zkgj-lansuan-raportin-ne-lidhje-me-zbatimin-e-ligjit-per-gjuhet/>

320 <https://oik-rks.org/2024/09/23/tryeze-diskutimi-per-permiresimin-e-bashkepunimit-nderinstitucional-per-mbrojtje-te-femijeve/>

Tryezë diskutimi me organizata ndërkombëtare në vend

Më 27 qershor 2024, Avokati i Popullit priti në takim përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në vend, për të diskutuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe nevojën për një koordinim më të ngushtë të aktiviteteve. Gjatë takimit, Avokati i Popullit theksoi disa çështje që akoma mbesin sfiduese, si: zvarritja e procedurave gjyqësore, mospërgjegjia e institucioneve administrative, si dhe mungesa e dialogut social dhe e kontratës së përgjithshme kolektive, që kufizojnë të drejtat e punëtorëve. Po ashtu, u prezantua Strategjia e rishikuar 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2024-2025 i IAP-së, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të implementimit të projekteve të ndryshme.



Tryezë diskutimi me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor

Më 9 tetor 2024, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), i Institucionit të Avokatit të Popullit, organizoi tryezë me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi mbi: trajtimin e personave me çrregullime mendore, me fokus trajtimin e pavullnetshëm; trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim; të gjeturat e Avokatit të Popullit dhe mekanizmave ndërkombëtar; si dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen institucionet e shëndetit mendor në trajtimin e rasteve. Përfaqësuesit e institucioneve publike

theksuan sfidat dhe problematikat e tyre, të paraqitura gjatë trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në raport me trajtimin e pavullnetshëm dhe trajtimin e detyrueshëm me ndalim.

Tryezë diskutimi mbi shëndetin mendor të fëmijëve

Më 18 nëntor 2024, u organizua tryezë diskutimi për shëndetin mendor të fëmijëve si dhe u prezantuan të gjeturat preliminare të raportit për përgjegjësitë e shtetit në raport me mbrojtjen e fëmijëve.³²¹ Gjatë diskutimeve u theksua mungesa e mekanizmave për identifikimin e hershëm të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor dhe kufizimin e qasjes në mbështetjen e specializuar psikologjike në kujdesin parësor dhe dytësor, si dhe mungesa e psikologëve. Pjesëmarrësit, përfshirë profesionistë që punojnë me fëmijë, theksuan rëndësinë e identifikimit të hershëm dhe rritjes së vetëdijes të prindërit për stigmën, ofrimin e trajtimit dinjitoz dhe forcimin e resurseve për shëndetin mendor në nivel komunal.

Prezantimi i të gjeturave të Raportit të Avokatit të Popullit, lidhur me respektimin e të drejtave të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, në procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit

Më 19 nëntor 2024, Avokati i Popullit organizoi një tryezë³²² për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e Raportit ex-officio lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Disa nga të gjeturat e raportit që u prezantuan ishin: mungesa e përcaktimit të afatit kohor për përfundimin e procedurës; paqartësi në mjetet juridike në dispozicion të palëve; mungesa e parimit të dyshkallshmërisë në procesin e rishqyrtimit të aplikacioneve; arsyetimet e paplota të vendimeve; mungesa e ofrimit të shërbimeve psiko sociale nga institucione

321 <https://oik-rks.org/2024/11/18/iap-mbajti-tryeze-diskutimi-per-shendetin-mendor-te-femijeve/>

322 <https://oik-rks.org/2024/11/19/u-prezantua-raporti-i-avokatit-te-popullit-per-viktimat-e-dhunes-seksuale/>

shtetërore; mungesa e pajisjes me kartela identifikuese; zvarritjet e procedurave në gjykatë; mungesa e sigurimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucione publike të nivelit primar, sekondar dhe terciar pa pagesë për viktimat si dhe kufizimi i afat kohor të dorëzimit të kërkesave për njohje dhe verifikim të statusit. Presidentja e Kosovës, e cila mori pjesë në tryezë, theksoi nevojën për mbështetje shëndetësore dhe heqjen e kufizimeve në afatet e aplikacioneve, ndërsa ministrja e Drejtësisë e mbështeti raportin dhe njoftoi për angazhimin e Qeverisë për adresimin e nevojave të viktimave në kuadër të Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale.



Tryezë diskutimi mbi të drejtat pronësore të grave, nga perspektiva e kornizës ligjore dhe nga praktika

Më 20 nëntor 2024, në kuadër të shënimit të përvjetorit të themelimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, u mbajt një tryezë diskutimi me temë “Të drejtat pronësore të grave: Korniza ligjore, teoria dhe praktika”.³²³

Në tryezë, Avokati i Popullit theksoi se vetëm 20% e grave janë pronare të regjistruara të pronave dhe se ka mangësi në zbatimin e ligjeve dhe njohjen e të drejtave pronësore të grave. Si sfida kryesore në këtë fushë u theksuan: drejta zakonore, normat kulturore, informaliteti, mungesa e informacionit mbi trashëgiminë dhe zvarritjet e procedurave gjyqësore. Konkluzionet e takimit përfshijnë nevojën për zbatimin e plotë të ligjeve, vetëdijesimin e grave për të drejtat e tyre dhe zvogëlimin e informalitetit në pronësi.

Konferencë mbi lansimin e raportit “Zërat e Rinj”

Më 21 nëntor 2024, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të të Drejtave të Fëmijëve, u mbajt konferenca për lansimin e raportit “Zërat e Rinj”, për vitin 2024, realizuar nga “Save the Children Kosova”, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.³²⁴

Anketa “Zërat e Rinj” paraqet perspektivat e 1071 fëmijëve në Kosovë mbi çështje si: siguria, arsimit, ndryshimet klimatike dhe shëndeti mendor. Disa rezultate kryesore të anketës tregojnë se: 91% e fëmijëve mendojnë se komuna duhet të investojë më shumë në hapësira për të rinjtë; 64% do të donin të merrnin pjesë në konsultime publike; 26% nuk dinë ku ta adresojnë depresionin; 37% nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë për dhunën; 68% besojnë se fëmijët përjetojnë diskriminim; 86% mendojnë se shkollat duhet të mbështesin më shumë fëmijët me aftësi të kufizuara.

323 <https://oik-rks.org/2024/11/20/institucioni-i-avokatit-te-popullit-mbajti-tryeze-diskusimi-per-te-drejtat-pronesore-te-grave/>

324 <https://oik-rks.org/2024/11/20/u-prezantua-raporti-zerat-e-rinj-per-vitin-2024/>



Tryezë diskutimi lidhur me të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Konventës së Stambollit

Më 27 nëntor 2024, në kuadër të shënimit të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, Avokati i Popullit së bashku me Qendrën për Barazi dhe Drejtësi dhe Asociacionin e Gruas “Feminae”, organizuan në Prizren një tryezë³²⁵ për të diskutuar lidhur me të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Konventës së Stambollit.

Gjatë diskutimeve, ku morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme, u theksua nevoja për bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe publikut për të parandaluar dhunën ndaj grave. U diskutua gjithashtu rëndësia e funksionalizimit të mbikëqyrjes elektronike për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe krimeve të tjera.

Tryezë diskutimi mbi të drejtat gjuhësore

Më 10 dhjetor 2024, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët dhe IOM-in, organizoi tryezën “Të drejtat gjuhësore: Rrugë drejt të drejtave themelore të njeriut”.³²⁶ Ky takim ishte pjesë e nismës mbështetëse të aktivitetit programor të titulluar “Përparimi dhe promovimi i të drejtave gjuhësore – Faza 2”.

325 <https://oik-rks.org/2024/11/27/u-mbajt-tryeze-me-rastin-e-shenimit-te-16-diteve-te-aktivizmit-kunder-dhunes-ne-familje-dhe-dhunes-ne-baza-gjinore/>

326 <https://oik-rks.org/2024/12/10/iap-organizoi-tryeze-per-te-drejtat-gjuhesore/>

Gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e të drejtave gjuhësore për promovimin e përfshirjes, diversitetit dhe barazisë, si dhe ndikimi i tyre në të drejtat themelore të njeriut. Avokati i Popullit theksoi se ligji për gjuhët nuk po zbatohet plotësisht dhe ngriti nevojën për angazhimin e institucioneve dhe vullnetit politik për zbatimin e tij.

Edukimi mbi të drejtat e njeriut

Avancimi i edukimit dhe i informimit të qytetarëve mbi të drejtat e njeriut, si dhe mbi mekanizmat e mbrojtjes së tyre, ka qenë një nga prioritetet kryesore të Avokatit të Popullit për vitin 2024. Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka organizuar një seri takimesh dhe ligjëratah me studentë dhe të rinj, ku janë diskutuar çështje të të drejtave të njeriut dhe roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave. Po ashtu janë realizuar vizita në terren, sidomos në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, në kuadër të fushatës informuese “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”. Për më tepër, në kuadër të edukimit mbi të drejtat e njeriut për profesionistët ligjorë, janë mbajtur trajnime të specializuara me gjyqtarë dhe prokurorë të sapoemëruar në detyrë. Aktivitete e IAP-së në këtë fushë janë të pasqyruara në tabelat si në vijim:

Loji i aktivitetit	Qëllimi
Trajnim për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar	Informimi i profesionistëve ligjorë mbi të drejtat e njeriut, mekanizmat mbrojtës të tyre si dhe mbi rolin dhe mandatin e IAP-së dhe procedurat e pranimit dhe adresimit të ankesave
1.	Më 15 prill 2024, Avokati i Popullit mirëpriti në institucion, gjeneratën e dhjetë e prokurorëve të sapoemëruar.
2.	Më 22 nëntor 2024, Avokati i Popullit mirëpriti në institucion, gjyqtarët e sapoemëruar.

Ligjëratë dhe takime me të rinj dhe studentë

Edukimi mbi të drejtat e njeriut dhe mekanizmat mbrojtës të tyre si dhe informimi mbi rolin dhe mandatin e IAP-së dhe procedurat e pranimit dhe adresimit të ankesave

1. Më 25 janar 2024, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij takuan studentët e programit “The European Master’s Degree in Human Rights and Democratization (EMA)”, me seli në Vjenë të Austrisë dhe Venedik të Italisë.
2. Më 20 maj 2024, Avokati i Popullit mirëpriti studentët e Universitetit Shtetëror të Floridas, ShBA.
3. Më 29 maj 2024, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Organizatën për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), takoi studentët e universiteteve publike në Kosovë, i cili takim u mbajt në kuadër të Kongresit të Aktivizmit Studentor.
4. Më 16 korrik 2024, Avokati i Popullit priti në takim një grup studentësh pjesëmarrës në Kursin e Universitetit Veror, në grupin Gjinia dhe Legjislacioni.
5. Më 2 dhjetor 2024, Avokati i Popullit mbajti një ligjëratë me studentët e Kolegjit Universum, ku diskutoi për të drejtat e njeriut si dhe për punën dhe kompetencat e Avokatit të Popullit.
6. Më 10 dhjetor 2024, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit realizoi një bashkëbisedim me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”
7. Më 13 dhjetor 2024, Avokati i Popullit bashkëbisedoi me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.





Po ashtu me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit, përmes edukimit dhe arsimimit ligjor, më 12 shkurt 2024, Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj dhe rektori i Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi.³²⁷ Ky bashkëpunim, përveç të tjerash, do të mundësojë edhe qasjen për nevoja studimore në të dhënat dhe rastet praktike të zhvilluara nga IAP-ja si edhe vizita studimore në institucion nga studentët.

Arritjet në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë si dhe planifikimet për vitin 2025

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit ka realizuar aktivitete të shumta për informimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Këto aktivitete përfshijnë fushata, takime me qytetarë dhe përfaqësues të komuniteteve joshumicë, ku janë diskutuar sfidat e përditshme. Po ashtu janë zhvilluar takime me shoqërinë civile për promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë. Këto përpjekje kanë sjellë një rritje të ndjeshme të informimit dhe vetëdijesimit

për rolin e Avokatit të Popullit, duke nxitur qytetarët të paraqesin ankesat e tyre dhe të angazhohen më shumë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Ky angazhim është reflektuar edhe në vlerësimin e Raportit të Progresit për Kosovën 2024, ku potencohet: “IAP ka vazhduar të luajë rol kyç në promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut; ruajtja e pavarësisë së tij, në përputhje me Parimet e Parisit e ato të Venedikut, mbetet thelbësore.”³²⁸

Në vitin 2025, Avokati i Popullit do të vazhdojë të realizojë aktivitete të rëndësishme, të cilat janë pjesë e Planit të Punës për vitin 2024/2025 të Forumit për Dialog me shoqërinë civile. Po ashtu do të vazhdojë me fushata informuese dhe me implementimin e projekteve të përbashkëta me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, me fokus në fuqizimin e mëtejshëm të edukimit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Gjithashtu gjatë vitit 2025 do të vazhdojë fushata informuese mbi të drejtat e njeriut dhe misionin e IAP-së: “*Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit*”, me nxënës dhe mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulët.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile, me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet publike në vend

Edhe gjatë vitit 2024, bashkëpunimi me shoqërinë civile, me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet publike ka qenë jashtëzakonisht i thelluar dhe i suksesshëm, duke kontribuar në avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky bashkëpunim ka vazhduar të forcohet përmes implementimit të projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve të ndryshme, të cilat kanë pasur për qëllim promovimin e të drejtave të njeriut dhe ngritjen e vetëdijesimit për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave. Aktivitetet e realizuara janë një pasqyrë e angazhimit të përhershëm të institucioneve dhe të shoqërisë civile për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë, duke reflektuar

327 <https://oik-rks.org/2024/02/12/iap-dhe-universiteti-i-prizrenit-nenshkruajne-memorandum-mirekuptimi/>

328 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/12/Kosovo-2024-Report-SQ.pdf> fq. 32

përpjekjet e përbashkëta për të adresuar nevojat dhe sfidat e qytetarëve.

Gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit, zëvendësit e Avokatit të Popullit, si dhe stafi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), kanë marrë pjesë në një sërë ngjarjesh të rëndësishme të organizuara nga partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto ngjarje kanë shërbyer si platforma për diskutimin e çështjeve të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut, ku IAP-ja ka kontribuar aktivisht me prezantimin e mandatit të tij, si dhe me paraqitjen e qëndrimeve të institucionit mbi çështjet e diskutueshme nga fusha e të drejtave të njeriut. Pjesëmarrja në këto ngjarje ka mundësuar një bashkëpunim të frytshëm dhe shkëmbim të përvojave, duke theksuar angazhimin e IAP-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndër-institucional.

Në tabelën në vijim është paraqitja numerike e ngjarjeve ku Avokati i Popullit dhe stafi i IAP-së ka marrë pjesë gjatë vitit 2024:

Lloji i aktivitetit	Numri
Tryeza të organizuara nga institucione të ndryshme dhe shoqëria civile.	60
Konferenca të organizuara nga partnerë vendorë e ndërkombëtarë.	18
Punëtori	11
Ngjarje të tjera promovuese dhe ceremoni lansuese të aktiviteteve apo të projekteve të ndryshme.	20

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, në kuadër të projekteve të ndryshme

IAP-ja po ashtu ka vazhduar me implementimin e projekteve të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut me organizata ndërkombëtare. Në këtë drejtim, IAP-ja është mbështetur nga UNDP-ja përmes trajnimit dyditor të mbajtur në datat 5-6 mars 2024, për fuqizimin e kapaciteteve të stafit të IAP-

së për trajtimin dhe adresimin e çështjeve nga fusha mjedisore.



Prezantimi i të gjeturave të Raportit të Avokatit të Popullit lidhur me qashtëmërinë në trotuare dhe në hapësira publike

Nën ombrellën e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Përdoruesve të Karrocës, përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në një tryezë të organizuar nga Handikos-i në Ferizaj, ku prezantuan Raportin ex-officio³²⁹ me rekomandime për vlerësimin e qashtëmërisë në trotuare dhe në hapësira publike për persona me aftësi të kufizuara.³³⁰ Të gjeturat e raportit për qytetin e Ferizajt, që po ashtu ishte pjesë e hulumtimit, treguan se rreth 66% e trotuareve të vlerësuara nuk ofrojnë kushte themelore për lëvizje të pavarur dhe të sigurt, me prezencë të pengesave fizike dhe dëmtimeve në trotuare. Me këtë rast u bë thirrje autoriteteve komunale të pranishme në takim, që t'i kushtohet vëmendje të shtuar plotësimit të kriterëve të qashtëmërisë, me rastin e lëshimit të lejeve ndërtimore si dhe në fazën e implementimit të projekteve.



329 <https://oik-rks.org/2023/09/25/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-6482021-ne-lidhje-me-qashten-ne-trotuare-hapesira-publike-dhe-levizjen-e-lire-te-qytetareve-si-dhe-respektimin-e-se-drejt-es-per-mjedis-te-sigurt-dhe-te-s/>

330 <https://oik-rks.org/2024/03/01/>

Po ashtu më 23 maj 2024, Avokati i Popullit dhe drejtori ekzekutiv i organizatës “Save the Children Kosova/o”, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim për të kontribuar në gjithëpërfshirje, barazi, transparencë e llogaridhënie për arsim dhe aftësim profesional cilësor, në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të avancimit të të drejtave të njeriut në vend.

Më 27 shtator 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra e Komisionarit për Gjuhët organizuan takim të përbashkët me qëllim të diskutimit mbi e fazën e re të implementimit të projektit “Promovimi dhe Avancimi i të Drejtave Gjuhësore në Kosovë”.

Faza e dytë e projektit parasheh që të mbahen një sërë aktivitetesh, duke përfshirë aktivitete promovuese, trajnime për përkthyes dhe gazetarë e aktivitete të tjera. Projekti financohet nga UNMIK-u dhe zbatohet nga IOM-i.

Diskutimi mbi Raportin e shoqërisë civile mbi gjendjen e të drejtave të njeriut

Bashkëpunimi me shoqërinë civile vazhdoi edhe në vitin 2024, në kuadër të realizimit të projekteve të përbashkëta për promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Më 17 korrik 2024, Avokati i Popullit organizoi një takim me organizatat e shoqërisë civile, ku u diskutuan gjetjet nga Raporti i vitit 2023 i shoqërisë civile mbi gjendjen e të drejtave të njeriut.³³¹ Përfaqësuesit e shoqërisë civile vlerësuan rëndësinë e trajtimit të çështjeve të ngritura në raport nga Avokati i Popullit dhe kërkuan që ky bashkëpunim të vazhdojë. Avokati i Popullit, nga ana e tij, theksoi se shumë rekomandime nga ky raport do të reflektohen edhe më tutje në punën e institucionit. Po ashtu u diskutua edhe Plani i Punës për vitin 2024/2025 i Forumit për Dialog, i hartuar në bashkëpunim me Shoqërinë Civile.



Forumi për Dialog me Shoqërinë Civile

Edhe përgjatë vitit 2024, Forumi për Dialog ka vazhduar punën dhe aktivitetet e veta në drejtim të veprimit të përbashkët për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend. Forumi në vitin 2024 ka mbajtur 3 takime të rregullta të punës.

Takimi i parë i rregullt i punës për vitin 2024

Më 19 prill 2024, u mbajt takimi i parë i punës për vitin 2024, i Forumit për Dialog, ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.³³² Në këtë takim u prezantuan raportet e publikuara nga Avokati i Popullit lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, gjuhën e përdorur në diskursin publik, qasshmërinë në hapësira dhe në objekte publike për personat me aftësi të kufizuara, punësimin e procesin e rivlerësimit në komisionet mjekësore, si edhe raportin lidhur me cilësinë e përkthimit të akteve juridike dhe mospërputhjen e tyre gjuhësore.

Njëngaçështjet kryesoretë ngriturapërdiskutim, me kërkesë për veprim të menjëhershëm, ishin rastet e shpeshta të vrasjeve të grave, duke nxjerrë në pah mungesën e raportimit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Po ashtu u diskutuan ngacmimet seksuale në shkolla dhe universitete, shëndeti mendor dhe ndikimi i tij në mirëqenien e qytetarëve, si dhe tema të tjera që prekin komunitetet joshumicë.

331 <https://oik-rks.org/2024/09/23/ojq-te-diskutojne-me-avokatin-e-popullit-raportin-e-tyre-per-gjendjen-e-te-drejtave-te-njeriut/>

332 <https://oik-rks.org/2024/04/19/>

Në përfundim të takimit u nda një mirënjohje post-mortem për kontributin e dhënë nga aktivisti i ndjerë, z. Naim Osmani, ish-drejtor ekzekutiv i organizatës CRPK, e cila iu dorëzua familjarëve të tij në shenjë mirënjohjeje për punën e tij të palodhur në fushën e të drejtave të njeriut.

Hartimi i planit të punës për vitin 2024/2025

Më 22 maj 2024, u mbajt një punëtori triditore mes Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, me qëllim hartimin e Planit të Punës për vitin 2024/2025 të Forumit për Dialog me Shoqërinë Civile.

Punëtorja pati për fokus vlerësimin e funksionimit dhe të arriturave të deritanishme në kuadër të bashkëpunimit në këtë Forum, ku po ashtu u vendosen edhe aktivitetet dhe temat prioritare për trajtim gjatë vitit 2024. Punëtorja u organizua me mbështetje të OJQ-së “ACDC” dhe të UNMIK-ut.

Takimi i dytë i rregullt i punës për vitin 2024

Më 12 qershor 2024 u zhvillua takimi i dytë i rregullt i punës i Forumit për Dialog.³³³ Gjatë takimit u prezantua Plani i Punës dhe i aktiviteteve për vitin 2024/2025, i hartuar në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. U diskutua gjithashtu bashkëpunimi në implementimin e përbashkët të aktiviteteve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend.

Plani i Veprimit për vitin 2024/2025 përqendrohet në angazhimin e përbashkët për trajtimin e çështjeve si në vijim: shëndeti mendor i fëmijëve dhe i personave mbi 65 vjeç, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna; promovimi i barazisë gjinore; ruajtja e mjedisit dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuara. Si çështje me nevojë për adresim të menjëhershëm u ngritën: për mungesën e shërbimeve për personat mbi 65 vjeç në Projektligjin për

Shëndetin Mendor, dhe për mungesën e shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara, ata pa kujdes prindëror dhe ata në situatë rruge.



Takimi i tretë i rregullt i punës për vitin 2024

Më 29 tetor 2024 u mbajt takimi i tretë i rregullt i punës për vitin 2024, i Forumit për Dialog ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile³³⁴, ku u diskutuan sfidat aktuale nga fusha e të drejtave të njeriut dhe koordinimi i aktiviteteve për shënimin e 10-dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Gjatë takimit, si çështje me rëndësi për diskutim, që u sollën në vëmendje nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, ishin: *rol i këshillave të bashkësive lokale, dëgjimi dhe adresimi i shqetësimeve të tyre; sfidat në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara e veçanërisht të fëmijëve me dëmtime në dëgjim, pastaj mungesa e gjuhës së shenjave dhe shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve, mungesa e materialeve e interpretëve të gjuhës së shenjave dhe mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë mësimore.*

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj) ka një rëndësi thelbësore në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Përmes shkëmbimit të njohurive, përvojave

333 <https://oik-rks.org/2024/06/18/prezantohet-plani-punes-ndermjet-iap-it-dhe-oshc-ve/>

334 <https://oik-rks.org/2024/10/31/mbahet-takimi-i-forumit-per-dialog-mes-institucionit-te-avokatit-te-popullit-dhe-organizatave-te-shoqerise-civile/>

dhe praktikave më të mira, këto institucione mund të adresojnë sfidat e përbashkëta, të forcojnë kapacitetet institucionale dhe të kontribuojnë në avancimin e parimeve universale për të drejtat e njeriut. Ky bashkëpunim ndërkombëtar brenda sistemit global të të drejtave të njeriut, përfshirë mekanizmat e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat rajonale, është një mjet i domosdoshëm për të rritur efektivitetin e IKDNj-ve. Ai jo vetëm që mundëson qasje më të gjerë ndaj burimeve dhe ekspertizës ndërkombëtare, por gjithashtu siguron përfaqësimin dhe ngritjen e shqetësimeve të përbashkëta në platforma globale.

Në thelb të funksionimit efektiv të IKDNj-ve qëndron pavarësia e tyre. Pavarësia, si në mandatin, ashtu edhe në veprimtarinë e këtyre institucioneve, është një parakusht thelbësor për besueshmërinë, paanshmërinë dhe aftësinë e tyre për t'i mbajtur përgjegjëse autoritetet publike. Një IKDNj e pavarur garanton besimin e publikut dhe krijon një mjedis ku shkeljet e të drejtave të njeriut mund të hetohen pa ndërhyrje apo ndikime të papërshtatshme.

Parimet e Parisit³³⁵, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara bashkë me Parimet e Venecias³³⁶, të miratuara nga Këshilli i Evropës, përbëjnë bazën ndërkombëtare për garantimin e pavarësisë, mandatit dhe funksionimit efektiv të IKDNj-ve dhe institucioneve të Avokatit të Popullit. Këto standarde theksojnë nevojën që këto institucione të krijohen me ligj, të gëzojnë autonomi financiare dhe operacionale dhe të ushtrojnë mandatin e tyre të lirë nga presionet politike. Zbatimi i këtyre standardeve ndërkombëtare siguron që IKDNj-të të jenë të afta të luajnë rolin e tyre kritik si mbrojtës të të drejtave të njeriut, duke forcuar llogaridhënien, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës,

gjatë vitit 2024, u përball më një kërcënim për sa i përket funksionimit të tij të pavarur, kur Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 23 maj 2024, e shqyrtoi me vonesë dhe më pas nuk e miratoi Raportin Vjetor për vitin 2022, edhe pse ai ka marrë dritën e gjelbër dhe ishte rekomanduar për miratim nga tri komisione funksionale të Kuvendit.

Avokati i Popullit vazhdimisht është përpjekur të tërheqë vëmendjen se qëllimi i paraqitjes së Raportit vjetor në Kuvend arrihet kur çështjet e ngritura aty dhe gjendja e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend e respektimi i tyre nga autoritetet bëhen objekt diskutimi e trajtimi nga Kuvendi, i cili e ka fuqinë dhe detyrën t'i shtyjë përpara rekomandimet e Avokatit të Popullit, duke kërkuar llogari dhe përgjegjësi nga autoritetet publike, sa herë kjo të jetë e nevojshme. Vota PRO ose KUNDËR nuk e ndryshon as e tjetëron realitetin dhe situatën me të drejtat dhe liritë e njeriut në vend. Edhe votimi PRO i raporteve vjetore, pa debat parlamentar dhe pa veprime pasuese të legjislativit, që ndikojnë në respektimin e drejtave të qytetarëve të vendit, nuk ka asnjë kuptim.³³⁷

Në lidhje me këtë çështje, pati një reagim të fuqishëm ndërkombëtar, prej disa rrjeteve në të cilat IAP-ja është e anëtarësuar. Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) dhe Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET) në letrën e tyre të përbashkët, të datës 7 qershor 2024, adresuar Parlamentit dhe Presidencës së Republikës së Kosovës thuhej se me shqetësim kanë pranuar informacionin për mosmiratimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2022, duke bërë thirrje që të sigurohet respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe regjionale të aplikueshme për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, Institucionet e Ombudsmanëve dhe organet e barazisë, në mënyrë që të parandalohet ndikimi negativ në funksionimin e pavarur dhe efektiv të

335 Parimet e Parisit janë kriteret minimale që duhet të ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare. Dokumenti i plotë i qasshëm në: <https://ganhri.org/paris-principles/>

336 Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmanëve (Parimet e Venecias), Komisioni i Venedikut, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

337 <https://oik-rks.org/2024/05/27/>

institucionit. Në këtë letër theksohej: “Një kërkesë thelbësore e Parimeve të Parisit, është që IKDNJ-të të jenë në gjendje që të funksionojnë pa ndërhyrje politike, dhe se qeveria është e obliguar që të përgjigjet në rekomandimeve të IKDNJ-ve dhe të tregojë brenda një afati të arsyeshëm kohor, se si i kanë zbatuar ato. Kjo përforcohet edhe më tutje përmes Rekomandimit për IKDNJ-të të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili përcakton se shtetet duhet të sigurojnë që IKDNJ-të të paraqesin raportin e tyre vjetor para Parlamentit për shqyrtimin e tij dhe se shteti duhet të sigurojë një përcjellje efektive të rekomandimeve të IKDNJ-ve brenda afateve. Parimet e Venecias tutje theksojnë se raportet vjetore duhet të merren parasysh nga autoritetet. Njëjtë, Politika e Përgjithshme nr. 2 e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) rekomandon që mekanizmat e barazisë duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur në nivel operacional dhe të lirë nga çdo” ndërhyrje nga shteti, partitë politike apo aktorë të tjerë”. Për më tepër, ai në mënyrë eksplicite rekomandon që raportet vjetore të mekanizmave të barazisë duhet të diskutohen në parlament apo nga komisionet e tij dhe nga qeveria, por ato nuk duhet t’i nënshtrohen miratimit të tyre. Pavarësia e institucioneve është e përcaktuar edhe në Direktivat e BE-së nr. 2024/1499 dhe 2024/1500 të miratuara rishtazi, të cilat përcaktojnë standardet për organet e barazisë, sipas të cilave shteteve anëtare iu kërkohet që të miratojnë masa në mënyrë që të sigurohen se mekanizmat e barazisë veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të lire nga çdo ndikim i jashtëm. Këto institucione nuk duhet të kërkojnë apo pranojnë udhëzime nga qeveria ose ndonjë entitet tjetër publik apo privat, në kryerjen e detyrave të tyre apo ushtrimin e kompetencave të tyre, të cilat përfshijnë po ashtu hartimin e raportit vjetor të aktiviteteve.” Situata e krijuar në seancën parlamentare të datës 23 maj 2024, sinjalizon për shpërfillje të këtyre standardeve, ashtu siç minon sistemin e kontrollit dhe balancave institucionale dhe rolin që ka vetë Parlamenti.

Për më tepër, Avokati i Popullit z. Qelaj pati një mbështetje të menjëhershme edhe nga

Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI), cili e afirmoi mbështetjen e tij përmes një takimi të realizuar dhe një letre të dërguar më pas, në të cilën ritheksohej përkushtimi i tij për t’i dalë në ndihmë dhe për të reaguar, kurdo që IAP-ja përballet me sfida e kërcënime të ngjashme në të ardhmen.

Lidhur me çështjen e njëjtë, organizatat kryesore ndërkombëtare, të cilat veprojnë në Kosovë, më 9 korrik 2024 i dërguan një letër të përbashkët kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes së cilës kërkuan që të respektohet pavarësia e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në këtë letër, këto organizata, duke bërë referencë në standardet e përcaktuara ndërkombëtare, i kërkuan Kuvendit të shqyrtojë me kohë raportet vjetore të Avokatit të Popullit, në pajtueshmëri me ligjin, si dhe të merren në konsideratë të gjeturat dhe rekomandimet e tij dhe të përcillet zbatimi i tyre, në pajtueshmëri me Parimet e Parisit dhe me Parimet e Venecias. Kurse Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (HRN) reagoi ndaj këtij veprimi të Kuvendit, duke shtuar: “Kjo mënyrë e sjelljes së Kuvendit, duke mos mbajtur asnjë debat parlamentar lidhur me raportin e IAP, mos votimin e këtij raporti, shqyrtimin e këtij raporti me rreth një vit vonesë, paraqet qartë mungesën e respektit të Kuvendit për të drejtat e njeriut dhe vet punës së IAP. Kjo qasje e Kuvendit, duke votuar me lehtësi kundër miratimit të këtij raporti, paraqet tendencë të Kuvendit për ndërhyrje në pavarësinë e punës së IAP dhe mund të shihet si tendencë për të vënë nën presion një mekanizëm të pavarur kushtetues si IAP.”

Kur flasim për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është e nevojshme që të përmendet se sistemi ndërkombëtar dhe regional në vazhdimësi po punon që të krijojë standarde adekuate për të trajtuar sfidat aktuale dhe ato që parashikohen për të ardhmen, në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, në vitin 2024, zhvillime të rëndësishme ndërkombëtare kontribuuan në përforcimin e standardeve për të drejtat e njeriut.

Në mesin e tyre, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës lidhur me Inteligjencën Artificiale

(IA) dhe të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, e miratuar më 17 maj 2024, nga Komiteti i Ministrave, si dhe Akti i BE-së lidhur me Inteligjencën Artificiale (Akti IA), i miratuar nga Bashkimi Evropian, i cili hyri në fuqi më 1 gusht 2024, përfaqësojnë hapa përpara në adresimin e sfidave që vijnë nga ndikimi në rritje i teknologjisë në shoqëri.

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës lidhur me Inteligjencën Artificiale (IA)³³⁸ është instrumenti i parë ndërkombëtar detyrues për inteligjencën artificiale, i cili vendos një kornizë të fuqishme për të garantuar se përdorimi i inteligjencës artificiale i respekton të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Në mënyrë të ngjashme, Akti i BE-së për Inteligjencën Artificiale³³⁹ synon të rregullojë përdorimin e inteligjencës artificiale duke adresuar rreziqet e saj të mundshme dhe duke vendosur masa për të parandaluar diskriminimin dhe dëmet, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë, si: shëndetësia, punësimi dhe drejtësia.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka një rol vendimtar në monitorimin e zbatimit të këtyre standardeve dhe në sigurimin që ligjet kombëtare të jenë në harmoni me këto zhvillime ndërkombëtare. Prandaj angazhimi i tij në mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë mbetet thelbësor për të siguruar që standardet globale të përkthehen në masa konkrete, duke përfshirë mbrojtjen kundër abuzimit teknologjik dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë.

Në këtë kontekst, përmes bashkëpunimit me institucione homologe, organizata e rrjete ndërkombëtare, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të shfrytëzojë burime dhe ekspertizë të rëndësishme për të forcuar efektivitetin e tij dhe për të adresuar sfida globale të të drejtave të njeriut. Këto përpjekje jo vetëm që përmirësojnë përgjigjet ndaj sfidave kombëtare dhe zbatimin e obligimeve ndërkombëtare në nivel lokal, por gjithashtu forcojnë kontributin e Kosovës në dialogun global mbi të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit raportues, Institucioni i Avokatit

të Popullit gjithashtu miratoi zyrtarisht Deklaratën e Përtërirë të Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve³⁴⁰, duke riafirmuar kështu përkushtimin e tij për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Deklarata, me përkushtimet e ripërtërira, u zbulua zyrtarisht më 20 nëntor 2024, Ditën Botërore të Fëmijëve, që konsiston në ditën e njëjtë kur Lidhja e Kombeve miratoi Deklaratën origjinale të Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve 100 vjet më parë. Kjo mbështetje përputhet me përpjekjet e vazhdueshme të IAP-së për të forcuar kornizën ligjore dhe të politikave për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht atyre që u përkasin grupeve të cenueshme. Ky veprim pasqyron qasjen proaktive të Institucionit në promovimin e standardeve ndërkombëtare dhe integrimin e tyre në praktikën vendore.

Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Bashkëpunimi me institucionet homologe dhe me organizatat ndërkombëtare mbetet një shtyllë e rëndësishme e përpjekjeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut.

Gjatë periudhës raportuese, IAP-ja ka forcuar angazhimin e vet me institucionet e Ombudsmanëve në rajon dhe më gjerë, duke shkëmbyer praktika të mira, përvoja dhe duke ndërtuar partneritete për të adresuar sfidat e përbashkëta. Njëkohësisht, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, përfshirë rrjetet ndërkombëtare në të cilat IAP-ja është e anëtarësuar, ka luajtur një rol kyç në rritjen e kapaciteteve të Institucionit për të trajtuar çështje sistematike dhe për të avokuar për harmonizimin e praktikave vendore me standardet ndërkombëtare. Këto përpjekje të përbashkëta jo vetëm që kanë forcuar ndikimin e Institucionit, por gjithashtu kanë kontribuar në dialogun më të gjerë rajonal dhe botëror për të drejtat e njeriut.

Për më tepër, IAP-ja çdo vit pranon pyetësorë të tematikave të ndryshme nga organizata

338 <https://rm.coe.int/1680afae3c>

339 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32024R1689>

340 <https://declaration2024.org/signatories/>

ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe për shkëmbimin e praktikave për qëllime hulumtuese e krahasuese. Edhe këtë vit janë dërguar 23 raportime të tilla lidhur me aspekte të ndryshme të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

IAP-ja ka prioritet bashkëpunimin ndërkombëtar dhe do të vazhdojë të jetë e pranishme në takime e forume të ndryshme

ndërkombëtare, të cilat do të ndikojnë në forcimin e avokimit për të drejtat e njeriut, ngritjen e kapaciteteve si dhe shkëmbimin e përvojave më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2024, IAP-ja ka marrë pjesë në 73 ngjarje ndërkombëtare, prej të cilave 38 me pjesëmarrje fizike dhe 35 me pjesëmarrje online, të cilat janë të listuara në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data	Organizatori
1.	Forumi për Leadership i Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut(ENNHRI) Bruksel, Belgjikë	22-24 janar 2024	ENNHRI
2.	Trajnimi për trajnerë "Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor – Qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike" Podgoricë – Mal i Zi	22-24 janar 2024	Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas (MYLA)
3.	Takimi i Jashtëzakonshëm i Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për Drejtat e Njeriut (ENNHRI) Online	7 shkurt 2024	ENNHRI
4.	Takimi lidhur me të drejtat e njeriut dhe ato të komuniteteve joshumicë dhe praktikant në vazhdimësi Bruksel, Belgjikë	12-14 shkurt 2024	Parlamenti Evropian
5.	Takimi përgatitor lidhur me tryezën e diskutimit "Partneriteti i ri për sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut në vendet në zgjerim" Online	16 shkurt 2024	ENNHRI
6.	Tryezë diskutimi "Partneriteti i ri për sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut në vendet në zgjerim" Bruksel, Belgjikë	20 shkurt 2024	ENNHRI
7.	Trajnimi mbi pjesëmarrjen e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve kur kemi të bëjmë me fëmijët në kujdesin alternativ Online	27 shkurt 2024	ENOC/ENYA

8	Uebinari “Çështja e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara: Qasja, infrastruktura dhe vendbanimi” Online	27 shkurt 2024	EQUINET
9.	Forumi për të Drejtat Themelore “Të drejtat në lëvizje: Respektimi i të drejtave të njeriut për të ardhmen e Evropës” Online	11-12 mars 2024	FRA
10.	Takimi i Grupit Punues për Azilin dhe Migracionin i Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut Online	14 mars 2024	ENNHRI
11.	Takimi me temën “Strategjitë bashkëpunuese në adresimin e gjuhës së urrejtjes: një qasje shumëdimensionale” Online	21-22 mars 2024	Këshilli i Evropës
12.	Uebinari “Organet e barazisë në mbrojtjen e të drejtave të familjeve ylber” Online	26 mars 2024	EQUINET
13.	Uebinari me temën “Promovimi i të drejtave të njeriut: Roli i institucioneve të Avokatit të Popullit” Online	26 mars 2024	Qendra Kërkimore e Ombudsmanit Afrikan (AORC) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve(IOI)
14.	Trajnimi “Monitorimi i qendrave të ndalimit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit të ekstremizmit në burgje Shkup, Maqedoni	26-27 mars 2024	ODIHR
15.	Vizitë studimore në Finlandë Helsinki, Finlandë	15-18 prill 2024	UNMIK/IOM
16.	Trajnimi për trajnerë “Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor dhe qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike” Beograd, Serbi	16-19 prill 2024	Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas (MYLA)
17.	Takimi përgatitor lidhur me konsultimet për të drejtat themelore në vendet në zgjerim Online	17 prill 2024	Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Fqinjësinë, Zgjerimin dhe Negociatat (DG NEAR) & ENNHRI
18.	Takimi i Grupit Punues të EQUINET lidhur me kornizën ligjore për barazi si dhe Trajnimi për organet e barazisë lidhur me dhënien e opinioneve për gjykatat Dablin, Irlandë	17-19 prill 2024	EQUINET

19.	Programi Trajnues Online lidhur me Fuqizimin e Grave në Shërbimin Publik Online	6-24 maj 2024	Akademia Diplomatike e Vjenës/Shkolla e Vjenës për Studimet Ndërkombëtare
20.	Takimi vjetor i Aleancës Botërore të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI) Gjenevë, Zvicër	6-8 maj 2024	GANHRI
21.	Punëtorja e TAIEX me shumë shtete lidhur me Standardet për Organet e Barazisë Tiranë, Shqipëri	14-15 maj 2024	TAIEX& Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i Shqipërisë
22.	Uebinari i Qendrës Berkeley mbi Barazinë Krahasuese dhe Ligjin Kundër Diskriminimit mbi ndikimin e Inteligjencës Artificiale në të drejtat e personave LGBTQI+ Online	16 maj 2024	EQUINET
23.	Asambleja e Përgjithshme dhe Konferenca Botërore e Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI) Hagë, Holandë	13-17 maj 2024	IOI
24.	Seminari i Forumit të bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Shoqërisë Civile Durrës, Shqipëri	20-22 maj 2024	OJQ ACDC & UNMIK
25.	Seminari pranveror i Rrjetit Evropian të Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC) me temën: “Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve në Kujdesin Alternativ” dhe “Të drejtat e fëmijëve me prindër të burgosur” Talin, Estoni	3-4 qershor 2024	ENOC
26.	Takim lidhur me pavarësinë e IKDNJ-ve dhe reagimin e ENNHRI-t në rastet e kërcënimeve Online	4 qershor 2024	ENNHRI
27.	Forumi Evropian i Mekanizmave Kombëtarë Parandalues Strasburg, Francë	4-5 qershor 2024	Këshilli i Evropës
28.	Takimi online lidhur me vlerësimin e funksionimit të Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) Online	10 qershor 2024	Vlerësuese e jashtme, e cila është angazhuar që të kryejë Monitorimin dhe Vlerësimin e ENNHRI-t

29.	Takimi i Grupit Punues për Moshën të Rrjetit Evropian për Organet e Barazisë (EQUINET) Online	11 qershor 2024	EQUINET
30.	Uebinari me temën “Inteligjenca Artificiale dhe Ndërsektorialiteti: Si të parandalohet dhe të luftohet diskriminimi?” Online	14 qershor 2024	EQUINET
31.	Ngjarja e veçantë lidhur me temën “Fëmijët në migrim” Online	20 qershor 2024	Rrjeti Evropian për Migrimin (EMN) & Ombudsmani për Fëmijë dhe të Rinj i Luksemburgut (OKAJU)
32.	Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut me temën “Sigurizimi dhe të drejtat e njeriut – Roli i IKDNJ-ve” Bratisllavë, Sllovaki	16-21 qershor 2024	ENNHRI/ ODIHR
33.	Takimi konsultativ lidhur me nevojat specifike dhe sfidat e IKDNJ-ve që veprojnë në vende në konflikt ose përreth vendeve të konflikteve të armatosura Online	25 qershor 2024	ENNHRI
34.	Takimi i 14-të i Platformës Bashkëpunuese të CoE-FRA- ENNHRI- EQUINET, me temën “Qasja e të rinjve në të drejtat sociale dhe ekonomike: Adresimi i ndikimit të krizës për kushtet e jetesës” & Takimi i Grupit të Punës të ENNHRI për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore Vilnius, Lituani	1 korrik 2024 2 korrik 2024	Këshilli i Evropës
35.	Takimi i rrjetit “Nga gjuha e urrejtjes tek krimi i urrejtjes - Organet e barazisë në tranzicionin e adresimit të formave të racizmit në shoqëri” Strasburg, Francë	1-2 korrik 2024	Këshilli i Evropës
36.	Takimi “Luftimi i racizmit: promovimi i standardeve evropiane” Strasburg, Francë	3-4 korrik 2024	Këshilli i Evropës
37.	Takimi Bilateral i Avokatëve të Popullit të Kosovës dhe Shqipërisë “Shkëmbimi i praktikave të mira dhe përvojës në përmbushjen e mandatit të Avokatit të Popullit në shtetet respektive” Pejë, Kosovë	3-5 korrik 2024	IAP

38.	Vizitë studimore “Ndarja e ekspertizës sllovaqe me Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” Bratisllavë, Sllovaki	8-13 korrik 2024	SlovakAid
39.	Konferenca Ndërkombëtare e Ombudsmenëve “Roli i Ombudsmanit si Garantues i të Drejtave” Cassino dhe Montecasino, Itali	12-13 shtator 2024	Ombudsmani i Regjionit të Lacios
40.	Takimi i Projektit për Standardet për Organet e Barazisë të EQUINET Online	17 shtator 2024	EQUINET
41.	Konferenca e 28-të Vjetore dhe Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC) Helsinki, Finlandë	18-20 shtator 2024	ENOC
42.	Uebinari i EQUINET me temën: “Një perspektivë gjinore në punësim në epokën e Inteligjencës Artificiale” Online	20 shtator 2024	EQUINET
43.	Takimi i ndërtimit të kapaciteteve të Grupit Punues të ENNHRI për Inteligjencën Artificiale Bruksel, Belgjikë	23-24 shtator 2024	ENNHRI
44.	Tryeza e diskutimit me temën: “Monitorimi Efektiv i Qasjes në Kujdesin Shëndetësor Cilësor për rom dhe komunitete të tjera racore” Online	25 shtator 2024	Equinet
45.	Konferenca e Forumit të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalim (NPM), më temën: “Përmirësimi dhe mbrojtja e kushteve shëndetësore të personave të privuar nga liria me çrregullime të përdorimit të substancave (SUD)” Strasbourg, Francë	24-25 shtator 2024	Këshilli i Evropës
46.	Takimi i Grupit Punues të ENNHRI lidhur me Azilin dhe Migrimin Online	25 shtator 2024	ENNHRI
47.	Takimi online me temë: “Fuqizimi i rolit të IKDNJ-ve si mekanizma mbrojtës të Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut” Online	26 shtator 2024	ENNHRI

48.	Konferenca e 16-të e Institucioneve të Ombudspersonëve për Forcat e Armatosura (16ICOAF) Gjermani, Berlin	30 shtator-2 tetor 2024	Komisionari për Forcat e Armatosura i Parlamentit Gjerman dhe Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF)
49.	Konferenca e Varshavës për Dimezionin Njerëzor, sesioni lidhur me Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut Varshavë, Poloni	7 tetor 2024	ODIHR (Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut) brenda OSBE
50.	Punëtori e Nivelit të Lartë për miratimin historik të direktivave për standardet e barazisë Bruksel, Belgjikë	15 tetor 2024	EQUINET
51.	Takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian për Organet e Barazisë (EQUINET) Bruksel, Belgjikë	15-16 tetor 2024	EQUINET
52.	Takimi joformal i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së Vjenë, Austri	16 tetor 2024	OSBE
53.	Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) Bruksel, Belgjikë	28-29 tetor 2024	ENNHRI
54.	Takimi lidhur me rolin edhe funksionet e IKDNJ-ve që operojnë në konflikte të armatosura Bruksel, Belgjikë	29-30 tetor 2024	ENNHRI
55.	Konferenca Rajonale "Përputhshmëria e kuadrit ligjor dhe politik kombëtar në fushën e aksesueshmërisë, përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në 3 vende të Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe rekomandime për harmonizim" Tiranë, Shqipëri	29 tetor 2024	HANDIKOS Kosova
56.	Vizitë zyrtare e Departamentit të Fëmijëve nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Shqipërisë, me qëllim të shkëmbimit të përvojave Prishtinë, Kosovë	5-7 nëntor 2024	IAP

57.	Forumi i Katërt Rajonal i OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut për Evropën dhe Azinë Qendrore Budva, Mali i Zi	11-12 nëntor 2024	UNDP
58.	Takimi konsultativ lidhur me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në Evropë Online	12-13 nëntor 2024	OHCHR & Instituti Suedez për të Drejtat e Njeriut, Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut, Instituti Raoul Wallenberg dhe Instituti Gjerman për të Drejtat e Njeriut
59.	Vizitë studimore në parlamentin gjerman Berlin, Gjermani	11-14 nëntor 2024	OJQ CASA (Qendra për Veprime Shoqërore Afirmative)
60.	Uebinari me temën: “Integrimi i monitorimit dhe raportimit për të drejtat në shëndet seksual dhe riprodhues” Online	18 nëntor 2024	ENNHRI & UNFPA
61.	Takimi “Fuqizimi i kapacitetit të institucioneve qeveritare dhe organeve të barazisë për promovimin e politikave dhe masave kundër racizmit” Online	19 nëntor 2024	Këshilli i Evropës
62.	Takimi “Rritja e rolit të organeve të barazisë në ngritjen e vetëdijes dhe promovimin e kundër narrativave për luftimin e gjuhës së urrejtjes” Online	19 nëntor 2024	Këshilli i Evropës
63.	Konferenca regjionale lidhur me Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut Shkup, Maqedoni e Veriut	19-21 nëntor 2024	Ombudsmeni i Maqedonisë së Veriut, GANHRI, ENNHRI, UNDP
64.	Seminar “Ndryshimet Klimatike dhe fokusi në ndikimin e saj në barazi: Mjete për organet e barazisë” Online	20 – 21 nëntor 2024	EQUINET
65.	Takimi i Rrjetit të NPM-ve të Evropës Juglindore Vjenë, Austri	29-29 nëntor 2024	Bordi i Ombudsmanëve të Austrisë
66.	Uebinari “Organet e barazisë mbështesin procedurat gjyqësore strategjike lidhur me të drejtat e LGBTI në nivel kombëtar dhe atë të BE-së” Online	3 dhjetor 2024	IGLA Europe

67.	Sesion informues “Demistifikimi i Aktit të Bashkimit Evropian lidhur me Inteligjencën Artificiale: Implikimet për punën e Organeve të Barazisë Online	4 dhjetor 2024	Equinet
68.	Takimi i tretë i Grupit Punues për Standardet për Organet e Barazisë Online	5 dhjetor 2024	EQUINET
69.	Shënimi i 30-vjetorit të themelimit të Institucionit të Ombudsmanit në Slloveni & Konferenca e Nivelit të Lartë lidhur me Efektivitetin e Institucioneve të Ombudsmanëve dhe IKDNJ-ve në adresimin e sfidave bashkëkohore Bled & Lubjanë, Slloveni	5-6 dhjetor 2024	Ombudsmeni i Sllovenisë
70.	Konferenca e Nivelit të Lartë “Kodimi i barazisë në Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale: Organet e barazisë në përgatitje për sfidat” Online	12 dhjetor 2024	EQUINET
71.	Takimi i Asamblesë së Jashtëzakonshme e Rrjetit Evropian të Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC) Online	13 dhjetor 2024	ENOC
72.	Punëtorja “Horizontet digjitale: Mbrojtja e të dhënave në Epokën e Inovacionit” Ohër, Maqedoni e Veriut	16 dhjetor 2024	Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Komiteti i Helsinkit të Maqedonisë së Veriut dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi
73.	Takimi i Grupit Punues të ENNHRI-t lidhur me Inteligjencën Artificiale Online	16 dhjetor 2024	ENNHRI

Tabela 1: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (IKDNj) në mekanizma dhe rrjete ndërkombëtare shërben për të avancuar marrëdhëniet dinamike që duhet të ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sistemit

ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Meqë IAP-ja tashmë është anëtarësuar në rrjetet dhe organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, edhe këtë vit është kujdesur që të ndërveprojë me to, duke mbajtur takime të përbashkëta, shkëmbim të informatave e praktikave të mira, që ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Më poshtë paraqesim mekanizmat ndërkombëtarë ku IAP-ja është e anëtarësuar:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009
3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)	2015
6.	Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcave të Armatosura (ICOAF)	2015
7.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
8.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut	2017
9.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)	2019
10.	Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC)	2022

Tabela: Lista e anëtarësimeve të IAP-së në rrjete ndërkombëtare

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat, për shkak të barrierave politike, është vetëm anëtare vëzhguese, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit)³⁴¹;
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore - SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).³⁴²

³⁴¹ Kusht për anëtarësimin në këtë organizatë është anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara.

³⁴² Kusht për anëtarësimin në këtë rrjet rajonal është aderimi i Kosovës në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës.

Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka vazhduar angazhimin për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut në përputhje me angazhimet ndërkombëtare, përfshirë ndikimin e shtuar në implementimin e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Ky angazhim i konsiston me rolin e theksuar të Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (IKDNj).

Rikujtojmë se më 25 shtator 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, nëpërmjet Rezolutës A/RES/70/1, si një plan veprimi global, me 17 objektiva dhe me 169 caqe specifike të synuara, të cilave u korrespondojnë 231 tregues. Si rrjedhojë, më 25 janar 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë për t'u angazhuar në zbatimin e kësaj kornize globale, nëpërmjet Rezolutës Nr. 06-R-001, për miratimin e OZhQ-ve. Kjo u përcoll më pas me themelimin Këshillit për

Zhvillim të Qëndrueshëm, në tetor të vitit 2018, si një mekanizëm ndërinstitucional në kuadër të Kuvendit, në shërbim të koordinimit të proceseve drejt përmbushjes së kësaj Agjende, e cila mbart një vizion universal të pranuar nga shtetet, që ka të vendosura në thelb *popullatën, prosperitetin, planetin, paqen dhe partneritetin*, si shtylla të cilat mbështet zhvillimi i qëndrueshëm dhe i vërtetë.

Për më tepër, Agjenda 2030 ka në themel parimet e të drejtave të njeriut, të barazisë dhe të mosdiskriminimit dhe paraqet përkushtimin për çrrënjosjen e varfërisë, pabarazisë, realizimin e dinjitetit njerëzor dhe premtimin për të mos lënë askënd pas e për t'i arritur së pari ata që janë të lënë më anash. Ndërlidhja e Agjendës me të drejtat e njeriut theksohet te *Deklarata e Meridas*³⁴³ për rolin e IKDNj-ve në zbatimin e Agjendës 2030. Aty pohohet se Agjenda ka të mishëruar fuqishëm Kartën e Kombeve të Bashkuara³⁴⁴, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut³⁴⁵, traktate dhe instrumente ndërkombëtare.

Institucionet e kësaj natyre, gjithandej ku funksionojnë, aplikojnë *qasje të bazuar në të drejta të njeriut*.³⁴⁶ Në përputhshmëri me këtë qasje, gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka ndërtuar ndërlidhjen e objektivave dhe synimeve të OZhQ-ve me të dhënat që burojnë nga ankesat e adresuara në IAP, në atë mënyrë për t'i integruar këto objektiva më veprimtarinë e përditshme të IAP-së, përkatësisht përmes ndërlidhshmërisë së tyre me natyrën e rasteve individuale dhe sistematike të trajtuara në IAP, përmes sistemit të bazës së të dhënave.

Baza e re e të dhënave në IAP, e cila është funksionalizuar me 1 janar 2024, mundëson që çdo ankesë e regjistruar të ndërlidhet me objektivat përkatëse, duke ofruar një mjet të fuqishëm për analizë dhe vlerësim të politikave dhe masave që shteti i ka ndërmarrë apo planifikon t'i ndërmarrë për të

343 <https://ennhri.org/our-work/topics/sustainable-development-goals/#:~:text=The%20M%C3%A9rida%20Declaration%2C%20adopted%20by,human%20rights%20and%20sustainable%20development.>

344 <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>

345 <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

346 <https://ennhri.org/about-nhris/human-rights-based-approach/>

përmbushur angazhimet ndërkombëtare dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. Po ashtu ky proces ndihmon në identifikimin e mangësive dhe mundësive për përmirësim, duke siguruar që të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i qëndrueshëm të jenë pjesë e një strategjie të koordinuar dhe të orientuar për përfitime afatgjata për qytetarët.

Si rrjedhojë e këtij procesi, Avokati i Popullit për herë të parë ka nxjerrë statistikën e ankesave dhe rasteve të hapura në IAP, të ndërlidhura me 17 objektivat që burojnë nga Agjenda 2030. Statistikat përkatëse janë të vendosura te pjesa e statistikave në këtë raport. Avokati i Popullit vlerëson se gjenerimi i statistikave përkatëse përbën një hap të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e angazhimeve të shtetit për arritjen e këtyre objektivave dhe po ashtu kontribuon për të vlerësuar progresin e zbatimit të OZhQ-ve në nivel nacional.

Po ashtu, angazhimi përkatës konsiston me synimet e IAP-së për t'u fokusuar jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave, por edhe në përputhshmërinë me prioritetet globale që ndihmojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe garantimin e barazisë për të gjithë individët.

Përveç të tjerash, rastet që lidhen me të drejtat sociale, si dhe ato që përfshijnë grupe të cenueshme, janë identifikuar si tërësisht të përputhshme me parimet dhe objektivat e Agjendës. Kjo ka ndihmuar në identifikimin e masave konkrete që duhet të merren nga autoritetet kompetente, në përputhje me rekomandimet dhe konstatimet e IAP-së.

Po ashtu, gjatë vitit raportues Avokati i Popullit, në raportet me rekomandime dhe opinionet e adresuara tek autoritetet publike, është përkujdesur për të siguruar përputhshmërinë e natyrës së tyre me objektivat e Agjendës 2030 dhe në ndërlidhje të ngushtë me përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit ka vazhduar të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve, duke ofruar mbështetje dhe duke u rekomanduar autoriteteve publike që përveç respektimit dhe përmbushjes së të drejtave të njeriut të garantuara me rendin juridik të vendit, për të

zbatuar edhe objektivat e Agjendës 2030.

Në përfundim, Avokati i Popullit ka vazhduar të përmbushë rolin e tij si monitorues dhe këshillues në zbatimin e të drejtave të njeriut, duke kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të Agjendës 2030 dhe duke siguruar që askush të mos lihet pas.

Komunikimi me publikun dhe mediat

Në përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor, si dhe në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka komunikuar me publikun duke ngritur bashkëpunimin me mediat. Kjo është bërë përmes publikimit të materialeve që paraqesin punën dhe aktivitetet e institucionit, qoftë përmes përgjigjeve në pyetjet e mediave për të marrë opinionet, qëndrimet ose edhe për të marrë të dhëna lidhur me raste apo fusha të caktuara të të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjatë vitit raportues, mediat kanë mbuluar dhe i kanë dhënë hapësirë ngjarjeve dhe kanë raportuar për raportet me rekomandime dhe opinionet e Avokatit të Popullit. Në varësi të situatave, mediat kanë kërkuar edhe qëndrim apo mendim të Avokatit të Popullit për temat të cilat ato i kanë trajtuar. Një numër i tyre janë paraqitur edhe nga mediat e komuniteteve, e në veçanti nga komuniteti serb.

Duke u bazuar në raportimet e mediave, Avokati i Popullit ka filluar 7 raste të hetimeve sipas detyrës zyrtare. Ky fakt është një tregues që tregon rëndësinë për publikun që ka raportimi i saktë dhe profesional i mediave, përmes gazetarisë hulumtuese duke raportuar raste kur ka shkelje dhe cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për Avokatin e Popullit janë informata të rëndësishme dhe burim për hetim për rastet kur mund të konstatohet se ka shkelje sistematike të të drejtave të njeriut. Prandaj duhet inkurajuar angazhimin e mediave në prezantim dhe raportim të rasteve kur ka informata për shkeljen eventuale të të drejtave të njeriut, sepse puna e tyre tërheq vëmendjen e autoriteteve dhe institucioneve për çështjet që janë jetike për jetën e qytetarëve.

Gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit

ka ndryshuar ueb-faqen e vet duke ofruar një dizajn më tërheqës dhe miqësor. Dizajni i ri ofron qasje për qytetarët për të paraqitur ankesat e tyre dhe risi e këtij ndryshimi është mundësia që kanë ankuesit për të përcjellë rastet e tyre se në cilën fazë gjenden. Ueb-faqja, si një mjet për shpërndarje të lajmeve dhe informatave (mbi 120 lajme më 2024), e po ashtu edhe rrjetet sociale (Facebook, Instagram dhe X), kanë qenë hapësira ku qytetari është informuar për punën dhe aktivitetet e IAP-së dhe angazhimin e Avokatit të Popullit në veçanti. Mediat kanë mbuluar tryezat e rrumbullakëta ku Avokati i Popullit takohet me qytetarë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve lokale.

Qytetarët kanë shfrytëzuar edhe rrjetin social Facebook, konkretisht Messenger, për të komunikuar me Avokatin e Popullit. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve (102 qytetarë gjatë vitit 2024) kanë kërkuar këshilla dhe informacione se si mund të paraqesin ankesat e tyre për trajtim në IAP. Në nëntor 2024, faqja zyrtare e IAP-së e Facebook-u kanë kaluar 9 mijë ndjekës të kësaj faqeje.

Në prill 2024, Avokati i Popullit pati tërhequr vëmendjen e portaleve në lidhje me publikimin e një lajmi për arrestimin e një personi për shkak të kryerjes së veprës penale “marrëdhënie seksuale brenda familjes”, duke përmendur përkatësinë etnike të personit të dyshuar. Megjithatë, mediat thuhet se kanë raportuar mbi bazën e njoftimit të Policisë së Kosovës. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit ka ua rikujtuar të gjitha palëve për qëndrimet e Avokatit të Popullit të shprehura në Raportin me Rekomandime Ex-officio gjatë vitit 2019³⁴⁷, ku mes të tjerash, i ka rekomanduar Policisë së Kosovës, që në njoftimet për media dhe në komunikimet e tjera me publikun, përveç publikimit të inicialeve të emrit dhe mbiemrit të personit/personave të përfshirë në rastet ku ka dyshime për vepra penale, në çfarëdo cilësie, t’i mbrojnë të dhënat e tjera personale, përfshirë të dhënat për përkatësinë etnike.

Avokati i Popullit pati kërkuar nga Policia e Kosovës si dhe portalet në Kosovë që të kenë kujdes me rastin e raportimit duke mos publikuar karakteristikat personale në rastet kur ekzistojnë dyshime për vepra penale, me theks të veçantë në përkatësinë etnike të këtyre personave.

Zyra për Komunikim me Publikun po ashtu trajton kërkesat për qasje në dokumente publike. Gjatë vitit 2024, IAP-ja ka trajtuar 13 kërkesa të parashtruara nga ankues, qytetarë, media dhe organizata joqeveritare, me kërkesë për qasje në dokumente publike, statistika, vendime dhe të tjera. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave është lejuar qasje e plotë në 12 kërkesa dhe 1 kërkesë është refuzuar. Të gjitha kërkesat janë paraqitur përmes postës elektronike dhe po ashtu përmes postës elektronike janë dërguar përgjigjet.

347 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/12/Ex-Officio-Raporti-me-rekomandime-468-2019-compressed.pdf>

Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021- 2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2024- 2025

Avokati i Popullit ka vazhduar ushtrimin e mandatit të tij nëpërmjet Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025, të miratuar më 18 mars 2021. Qëllimi i strategjisë është rritja e ndikimit të punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në parandalimin e shkeljeve të të drejtave nga ana e institucioneve publike, përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut. Synimet kryesore në të cilat përqendrohen kapacitetet institucionale të IAP-së janë: identifikimi dhe hetimi i rasteve ex-officio, të cilat përfshijnë shkeljet sistematike; ngritja e numrit të rasteve individuale, hetimi dhe shqyrtimi efektiv i tyre.

Të gjitha këto synime janë paraparë të realizohen nëpërmjet katër qëllimeve strategjike, të cilat janë:

- i. Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij.
- ii. Promovimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së.

iii. Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

iv. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP.

Gjatë vitit raportues, strategjia është zbatuar nëpërmjet Planit të Veprimit të Strategjisë 2024-2025, në kuadër të të cilit veprojnë katër (4) Qëllimet Strategjike:

- i. Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut.
- ii. Promovimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së.
- iii. Ndërlidhja e Agjendës 2030 dhe e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) me të drejtat e njeriut.
- iv. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së.

Strategjia e IAP-së 2021 - 2025 (rishikuar më 2024) vendos shtyllat kryesore të zbatimit të politikave të institucionit dhe bashkë me Planin e Veprimit shërben për vlerësimin e performancës së segmenteve specifike të organizimit dhe të punës së IAP-së. Në vitin raportues, Avokati i Popullit ka nxjerrë Vendim nr.172/2024 për formimin e Grupit punues për monitorim, mbikëqyrje dhe raportim të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit në fjalë. Ky grup është angazhuar për të siguruar mbikëqyrjen dhe analizimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2024, përmes raporteve të detajuara të dorëzuara çdo gjashtë muaj, respektivisht për periudhën T1/T2/T3/T4.

Nga një këndvështrim i përgjithshëm, Grupi punues ka vlerësuar se Strategjia dhe Plani i Veprimit janë zbatuar në përgjithësi në nivel pozitiv dhe me përmasa të afërta me objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara. Në këtë kontekst, ka pasur një realizim të qëndrueshëm të synimeve të theksuara, duke treguar se IAP-ja ka kontribuar në mënyrë aktive në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

Në nivelin e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes së të drejtave dhe lirive themelore, Avokati i Popullit ka arritur të rriste ndikimin përmes

trajtimin të rasteve sistematike, duke e intensifikuar rolin e tij në parandalimin e shkeljeve nga ana e institucioneve publike. Grupi punues ka konstatuar se ka pasur një rritje të numrit të rasteve ex-officio të trajtuara dhe hetuara nga institucionet përkatëse, që janë të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Në aspektin e promovimit të të drejtave dhe lirive, në përpjekje të vazhdueshme ka ngritur ndërgjegjësimin dhe edukimin në lidhje me të drejtat e njeriut. IAP-ja ka realizuar aktivitete për promovimin e të drejtave, duke përfshirë tryeza diskutimi, sesione informuese, ligjërata, prania në media dhe në rrjete sociale, si dhe bashkëpunimi me organizata të tjera të shoqërisë civile, që kanë ndihmuar në promovimin dhe avancimin e njohurive për të drejtat e njeriut dhe në veçanti për të drejtat e komuniteteve joshumicë në vend.

Për sa i përket ndërlidhjes me Agjendën 2030 dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ), është vënë re një përpjekje për t'i integruar këto objektiva në veprimtarinë e përditshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht përmes ndërlidhjes së tyre me natyrën e ankesave të pranura në IAP, përmes sistemit të bazës së të dhënave. Ka pasur një angazhim për t'u fokusuar jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave, por edhe në përputhshmërinë me prioritetet globale që ndihmojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe garantimin e barazisë për të gjithë individët.

Në lidhje me kapacitetet institucionale dhe burimet njerëzore, është vlerësuar se janë realizuar hapa të rëndësishëm për zhvillimin dhe përfundimin e strukturave të brendshme të IAP-së. Rritja e kapaciteteve profesionale dhe trajnimi i stafit ka kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të punës dhe në përmbushjen e mandatit të IAP-së.

Përfundimisht, raportet dhe analizat e realizuara kanë treguar se, në përgjithësi, janë arritur përparime të rëndësishme në implementimin e Strategjisë së IAP-së dhe Planit të Veprimit 2024-2025, duke përmbushur në nivel të përafërt objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara. Kjo tregon se, megjithëse sfida të caktuara mund

të mbeten për t'u adresuar, IAP-ja po ecën në drejtimin e duhur për të rritur ndikimin dhe efikasitetin e vet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Buxheti i IAP-së

IAP-ja është institucion i pavarur kushtetues, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Kurse kërkesën e vet buxhetore për vitin kalendarik një dhe trevjeçar e paraqet në Kuvendin e Republikës të Kosovës, mbi bazën e prioriteteve dhe nevojave të punës sipas kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore për ushtrimin e mandatit kryesor: mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, IAP-ja e “përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës”.³⁴⁸ Po sipas kësaj dispozite ligjore, për IAP-në mund të ndahet buxhet i nevojshëm shtesë për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe ligjet e tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.³⁴⁹

Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

IAP-ja, bazuar në procedurat ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, e ka paraqitur kërkesën e vet buxhetore për vitin 2024 në muajin qershor të vitit 2023, për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), sipas afatit ligjor.

Kërkesa buxhetore për vitin 2024 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur mbi bazën e planifikimit të nevojave dhe aktiviteteve të punës së IAP-së për vitin kalendarik 2024, bazuar në mandatin ligjor dhe strategjisë zhvillimore të IAP-së.

Buxheti i IAP-së për vitin 2024, sipas Ligjit të Buxhetit, është ndarë në shumën prej 1.300.017.99 €, i destinuar për këto kategori ekonomike buxhetore:

- Paga dhe mëditje në shumë prej 982.520.99€;
- Mallra dhe Shërbime në shumë prej 310.497.00 €;
- Shpenzime komunale në shumë prej 7.000.00 €.

Pasqyrimin e gjendjes dhe të rrjedhës të shpenzimeve të buxhetit të IAP për vitin 2024 do ta paraqesim sipas kërkesës buxhetore të IAP-së dhe në raport të buxhetit të ndarë sipas Ligjit të Buxhetit për 2024, të shpenzimeve buxhetore në fund të vitit fiskal si dhe në raport të deklarimit të kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe të shkurtimeve të tjera buxhetore me Vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës, do ta paraqesim në formën tabelore dhe sipas të dhënave të kategorive ekonomike buxhetore.

IAP-ja njëherësh duhet ta paraqesë edhe Raportin Financiar të veçantë dhe detajuar për vitin buxhetor 2024 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, mbi bazën e raportimit të rregullt vjetor sipas formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, siç kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.³⁵⁰

Më konkretisht, në paraqitjen tabelore në vijim do të pasqyrohet buxheti i IAP-së për vitin 2024, duke e filluar me Kërkesën fillestare buxhetore, buxhetin e ndarë me Ligjin Vjetor për Buxhetin e vitit 2024, Deklarimin e kursimeve buxhetore nga IAP-ja, dhe të shkurtimit të buxhetit të IAP-së në fund të vitit fiskal me Vendimin të Qeverisë, Nr.03/239 dt. 24.12.2024

348 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 3.

349 Po aty.

350 Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

Tabela 1: Buxheti i IAP-së për vitin 2024, sipas të dhënave në vijim:

Kategoria Ekonomike	Kërkesa buxhetore e IAP-së për vitin 2024	Buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2024	Deklarimi i kursimeve nga IAP-ja 2024	Shkurtimet me Vendim të Qeverisë, Nr. 03/239 datë 24.12.2024	Buxheti Final 2024
Paga dhe mëditje	1.073.964.00	982.520.99	(50.000.00)	(61.172.49)	921.348.50
Mallra dhe shërbime	279.797.00	310.497.00	(35.000.00)	0.00	310.497.00
Shpenzime komunale	7.000.00	7.000.00	(2.700.00)	0.00	7.000.00
Shpenzimet kapitale	63.000.00	00	00	0.00	0.00
Gjithsej buxheti	1.423.761.00	1.300.017.99	87.700.00	61.172.49	1.238.845.50

Planifikimi i buxhetit dhe shpenzimi i buxhetit për vitin 2024 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë në interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes të punës dhe funksionimit sipas planit të punës të IAP.

Kurse lidhur me mosshpenzimin e buxhetit për vitin 2024, në raport me planifikimin e buxhetit dhe të ndarjes të buxhetit, si edhe të buxhetit final në fund të vitit fiskal, kanë ndikuar edhe donacionet ndërkombëtare, përmes të cilave donacioneve IAP-ja ka siguruar nevojat dhe aktivitetet e ndryshme të punës me interes të lartë të ushtrimit të mandatit si dhe planit të punës për vitin 2024 të IAP. Njëherësh në IAP nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin sa më ekonomik dhe efektiv të buxhetit.

Për vitin buxhetor 2024, sipas procedurave ligjore dhe kërkesës së bërë nga MFPT-ja, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore 2024 në shumën totale 87.700.00 €.

Kurse nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve janë tërhequr vetëm 61.172.49 € nga kategoria e Pagave dhe Shtesave, me Vendimin e Qeverisë, Nr.03/239, datë 24.12.2024, por jo edhe shuma totale e

deklarimit të kursimit buxhetor dhe jo edhe për deklarimin e kursimeve nga IAP-ja dhe për kategorinë Mallra, Shërbimeve dhe Shpenzimet Komunale.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2024

Buxheti i IAP-së për vitin buxhetor 2024 është realizuar në masën monetare 1.169.502.11 €, apo shprehur në përqindje për 94.40 %, sipas gjendjes të buxhetit final në fund të vitit buxhetor.

Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2024, sipas të dhënave buxhetore të kategorive ekonomike të shprehura në përqindje për totalin e realizuar të buxhetit dhe sipas kategorive ekonomike buxhetore.

Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për 2024	Buxheti i shpenzuar 2024	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	921.348.50	921.348.50	0.00	100.00%
2.	Mallra dhe shërbime	310.497.00	244.484.00	66.013.00	78.74%
3.	Shpenzime komunale	7.000.00	3.669.61	3.330.39	52.42%
4.	Shpenzime kapitale	0.0	0.00	0.00	0.00
Gjithsej		1.238.845.50	1.169.502.11	69.343.39	94.40%

**RAPORTI VJETOR
2024
NR. 24**

